



**AUTORITETI I
KONKURRENCËS**

BULETINI ZYRTAR

NR. 9, 2013

TIRANË, 2013

Buletini Zyrtar nr. 9, 2013

Përgatitur nga:
Autoriteti i Konkurrencës

Përpunimi grafik:
Studio Grafike “West Print”

Botuar nga:
Autoriteti i Konkurrencës, 2014

© Autoriteti i Konkurrencës, Tiranë, 2014

“WEST PRINT” Shtëpi Botuese & Shtypshkronjë
Rr. “Qemal Stafa”, nr. 130 Tiranë - ALBANIA
Tel.: 067 20 60 546
[http:// www.westprint-al.com](http://www.westprint-al.com)
E-mail: info@westprint-al.com

Përmbajtja

Faqe	7	Vendimi Nr. 260, Datë 11.01. 2013, “Mbi revokimin Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 258, datë 21.12.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë”
Faqe	9	Vendimi Nr. 261, Datë 11.01.2013, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë”.
Faqe	12	Vendimi Nr.262, Datë 14.01.2013, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”.
Faqe	18	Vendimi Nr. 263, Datë 14.01.2013, “Për marrjen e masave të përkohshme për tregtimin e biletave të pajtimit mujor (aboneve) të studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”.
Faqe	23	Vendimi Nr. 264 , Datë 05.02.2013, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimi të kontrollit të vetëm të Albanian Chrome Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga DCM DECOmetal GmbH dhe DCM Beteiligungs GmbH tek Balfin Sh.p.k”.
Faqe	29	Vendimi Nr. 265, datë 05.02. 2013, “Mbi vendosje gjobe ndaj shoqërisë Viloil Sh.A për mosnjohimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të Viloil Sh.A nëpërmjet transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar, nga shoqëria “City Investment Holding S.A”, tek aksionerët z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko”.
Faqe	32	Vendimi Nr. 266, datë 05.02.2013, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të Viloil Sh.A nëpërmjet transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar, nga shoqëria “City Investment Holding S.A”, tek aksionerët z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko”
Faqe	37	Vendimi Nr.267, Datë 05.02. 2013, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Olympic Air S.A nga shoqëria Aegean Airlines S.A, nëpërmjet përfitimit të 100% të kapitalit aksionar të saj nga Marfin Investment Group S.A.”.
Faqe	41	Vendimi Nr. 268, Datë 08.02.2013, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Delhaize Albania Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga Lion Retail Holding s.a.r.l dhe Delhaize Serbia d.o.o tek Balfin Sh.p.k” .
Faqe	46	Vendimi Nr. 269, Datë 18.02.2013, “Përdisa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në tregun e policës së sigurimit kufitar”.

Faqe	48	Vendimi Nr.270, Datë 20.02.2013, Për miratimin e Raportit Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2012 dhe synimet kryesore për vitin 2013”.
Faqe	50	Vendimi Nr. 271, Datë 26.02.2013, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Japan Tobacco International Netherlands B.V të shoqërisë Nefftekx World II B.V nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga Batata S.A”.
Faqe	54	Vendimi Nr. 272 , Datë 26.02.2013, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëritë Bregal Fund III LP dhe Quadriga Capital Private Equity Fund IV LP të shoqërisë LR Global Holding GmbH”.
Faqe	58	Vendimi Nr. 273, Datë 18/03/2013, Për një ndryshim në vendimin nr. 262, datë 14.01.2013 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”.
Faqe	60	Vendimi Nr. 274, Datë 18/03/2013, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Gjirokastrës dhe Qytetin e Sarandës”
Faqe	63	Vendimi Nr. 275, Datë 25.03.2013, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë”.
Faqe	71	Vendimi Nr. 276, Datë 18/03/2013, “Përmiratimin e rregullores “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”.
Faqe	73	Vendimi Nr. 277, Datë 03/04/2013, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm në zonën Porto Romano”.
Faqe	76	Vendimi Nr. 278, Datë 15.04.2013, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Investndërtim Tirana Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga GPL Costruzioni Generali S.r.l tek Investment Joti –Infosoft Group Sh.p.k”.
Faqe	81	Vendimi Nr. 279, Datë 22.04.2013, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Euromax Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga shoqëria Balfin Sh.p.k tek shoqëria CM Balkans B.V”.
Faqe	86	Vendimi Nr. 280, Datë 22.04.2013, “Për një ndryshim në vendimin Nr. 275, datë 25.03.2013 përhapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë”.
Faqe	89	Vendimi Nr. 281, Datë 30.04.2013, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të Hec Ulëz

Shkopet nëpërmjet transferimit të 100% të aksioneve të kësaj të fundit tek shoqëria Kurum International Sh.a”.

- Faqe 95 Vendimi Nr. 282, Datë 30.04.2013, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të Hec Bistrice 1 Bistrice 2 nëpërmjet transferimit të 100% të aksioneve të kësaj të fundit tek shoqëria Kurum International Sh.a”.
- Faqe 101 Vendimi Nr. 283, Datë 08.05.2013, “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës”.
- Faqe 109 Vendimi Nr. 284 , Datë 13.05.2013, “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit të lulediellit ndaj ndërmarrjeve “Erbiron” sh.p.k”, “Olim” sh.a dhe “Crystal” sh.p.k.
- Faqe 118 Vendimi Nr. 285 , Datë 20.05.2013, “Për shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes “Vodafone Albania” SHA për revokimin e Vendimit nr.275, datë 25.03.2013 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë”.
- Faqe 121 Vendimi Nr. 286 , Datë 21.05.2013, Për miratimin e rregullores “Për kategoritë e marrëveshjeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e transportit ajror”.
- Faqe 125 Vendimi Nr. 287 , datë 04.06.2013, “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Gjirokastrës dhe qytetin e Sarandës”.
- Faqe 130 Vendimi Nr. 288, Datë 25.06.2013, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit indirekt në shoqëritë Tirana International Airport Sh.p.k dhe Hochtief Airport Retail Sh.p.k nga Public Sector Pension Investment Board, nëpërmjet përfutimit të 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë Hochtief Airport GmbH”.
- Faqe 135 Vendimi Nr. 289, Datë 4/07/2013, “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm në portin “Porto Romano”.
- Faqe 141 Vendimi Nr. 290 , Datë 23.07.2013, “Për vendosje gjore ndaj ndërmarrjeve “Ferlut” SHA, “Tirana Lines” Shpk, “Alba Trans” Shpk, “Tirana Urban Trans” SHA dhe “Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve” shpk, për kufizim të konkurrencës në tregun e tregtimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”.
- Faqe 179 Vendimi Nr. 291 , Datë 23.07.2013, “Mbyllja e hetimit të thelluar në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të çimentos 42.5 rifuxho dhe të paketuar ndaj ndërmarrjeve “ANTEA CEMENT” SHA, “FUSHE-KRUJE CEMENT FACTORY”, SHPK, “EUROTECH CEMENT” SHPK, “ELBASAN CEMENT FACTORY” SHPK dhe

“COLACEM ALBANIA” SHPK”.

Faqe	188	Vendimi Nr.292, Datë 16.09.2013, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë tëkarburanteve për kufizime të mundshme të konkurrencës”.
Faqe	191	Vendimi Nr. 293, Datë 1.10.2013, “Për shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes “Alba Trans” sh.p.k për revokimin e Vendimit nr. 290, datë 23.07.2013 “ Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Ferlut” SHA, “Tirana Lines” Shpk, “Alba Trans” Shpk, “Tirana Urban Trans” SHA dhe “Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve” shpk, për kufizim të konkurrencës në tregun e tregtimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve)të përgjithshme dhe studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”.
Faqe	194	Vendimi Nr. 294, Datë 28.10.2013, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria AD-Trade Sh.p.k të shoqërisë Primo Communications Sh.p.k, nëpërmjet përfutimit të 100% të kuotave të saj nga Telekom Slovenije d.d”.
Faqe	199	Vendimi Nr. 295 , Datë 14.11.2013, Per miratimin e Udhezimit “Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale”.
Faqe	257	Vendimi Nr. 296 , Datë 18.11.2013, “Për vlerësimin e ankesës së ndërmarrjes “NISATEL” për hapjen e hetimit në tregun me shumicë të shërbimit të internetit “broadband”.
Faqe	263	Vendimi Nr. 297, Datë 18.11.2013, “Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimeve për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit policë sigurimi për mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta” .
Faqe	266	Vendimi Nr. 298, Datë 06.12.2013, “Për vlerësimin ligjor mbi përputhshmërinë me ligjin dhe rregulloret e “Marrëveshjes së bashkëpunimit mes shoqërive të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve të transportit për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”.
Faqe	271	Vendimi Nr. 299 , Datë 06.12. 2013, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100 % të aksioneve të shoqërisë Europa Kazino 2009 SHA nga z. Edmond Plaku”.
Faqe	275	Vendimi Nr. 300, Datë 06.12.2013, “Për një ndryshim në Vendimin nr. 291, datë18.11.2013 "Mbi hapjen e procedurës se hetimit paraprak në tregun e sigurimeve për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit policë sigurimi për mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”.
Faqe	278	Vendim Nr. 301, Datë 06.12.2013, Për vlerësimin e ankesës së ndërmarrjes “GEN-I” në tregun e tregtimit me shumicë të energjisë elektrike.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 260, Datë 11.01. 2013

“Mbi

**revokimin Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 258,
datë 21.12.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit
paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | |
|---|--------------------------|------------|
| ▪ | Znj. Lindita Milo (Lati) | Kryetar |
| ▪ | Znj. Rezana Konomi | Zv/kryetar |
| ▪ | Znj. Servete Gruda | Anëtar |
| ▪ | Z. Koço Broka | Anëtar |
| ▪ | Znj. Iva Zajmi | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 11.01.2013 trajtoi çështjen me:

Objekt: Revokimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 258, datë 21.12.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë”.

Baza ligjore: Ligji nr. 9367 datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (te ndryshuar), neni 37, pika 4, gërma e dhe ë, si dhe Pjesa VI, Seksioni IV, Neni 123 e në vijim të Kodit të Procedurës Administrative.

Komisioni i Konkurrencës,

VËREN SE:

Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës ushtrohet në bazë të Ligjit 9120 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, akteve ligjore e nënligjore përkatëse si dhe konform legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Në zbatim të Ligjit, Autoriteti i Konkurrencës kryen hetime në tregje të ndryshme me qëllim që të garantohet konkurrenca e lirë dhe efektive.

Me anë të Vendimit Nr. 258, datë 21.12.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë”, Autoriteti i Konkurrencës ka filluar hetimin në këtë treg. Ky vendim, bazuar në deklaratimet personale, është marrë në kushtet e konfliktit të interesit në dukje.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 37, pika 4, gërma e dhe ë Ligji nr. 9367 datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (te ndryshuar), si dhe Pjesa VI, Seksioni IV, Neni 123 e në vijim të Kodit të Procedurës Administrative

V E N D O S I:

- I.** Revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 258, datë 21.12.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë.
- II.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS**Servete GRUDA****Koço BROKA****Iva ZAJMI****Rezana KONOMI**

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar**Lindita MILO (LATI)**

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 261, Datë 11.01.2013

**“Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun
e telefonisë celulare me pakicë”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

▪	Znj. Lindita Milo (Lati)	Kryetar
▪	Znj. Rezana Konomi	Zv/kryetar
▪	Znj. Servete Gruda	Anëtar
▪	Z. Koço Broka	Anëtar
▪	Znj. Iva Zajmi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.01.2013 trajtoi çështjen me:

Objekt: Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i (ndryshuar), si dhe neni 37, pika 6, gërma a (i) dhe (ii), dhe gërma b (ii), të Ligjit nr. 9367 datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (te ndryshuar),

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të Drejtorisë së Mbikëqyrjes dhe Hetimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike, Procedurave dhe Hetimit;

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi propozimin për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë me parapagim”;

VËREN SE:

1. Tregu i telefonisë celulare është një nga tregjet kryesorë që ndikon në zhvillimin e ekonomisë në tërësi. Autoriteti i Konkurrencës për mbikqyrjen e këtij tregu të rregulluar ka bashkëpunim në mënyrë të vazhdueshme me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për të siguruar funksionimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.
2. Sipas dokumentit të AKEP “Tregues statistikorë dhe financiarë të tregut të komunikimeve elektronike për vitin 2011”, rezulton se në tregun e telefonisë celulare janë gjeneruar gjithsej 39.2 miliardë lekë të ardhura nga 4 operatorët që ofrojnë shërbime të telefonisë celulare. Ky treg karakterizohet nga ndërmarrje me pozitë dominuese në tregun e shërbimeve të telefonisë së lëvizshme me pakicë.
3. Bazuar në informacionet e depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës, në këtë treg kohët e fundit vihen re shenja sjelljeje potencialisht anti-konkurruese të një/disë operatorëve, që mund të kenë si qëllim dhe/ose pasoje kufizimin e konkurrencës së lirë dhe efektive
4. Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës ushtrohet në bazë të ligjit 9120 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, akteve ligjore e nënligjore përkatëse si dhe konform legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
5. Në bazë të ligjit nr .9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, shqyrtimi i kësaj çështje realizohet në kushtet e konfliktit të interesit në dukje të dy anëtarëve të Komisionit nga pesë anëtarët e tij. Komisioni i Konkurrencës është organi vendimmarrës, i cili vepron si organ kolegjial.
6. Një situatë e tillë është parashikuar në Ligjin 9367 në nenin 37 pika 6, gërma a (i dhe ii) si dhe gërma b(ii), në të cilën theksohet se zyrtari lejohet të ushtrojë funksion dhe të kryejë detyrën me kusht që konflikti i vetëm i interesit i pashmangshëm **është ai në dukje** dhe kur ai është ose i pazëvendësueshëm në ushtrimin e funksioneve; ose vetë-përfjashtimi i tij është i pamundur.

7. Në këtë rast, nuk ka një institucion epror, Komisioneri nuk ka interesa private që mund të transferohen dhe nuk ka kuptim, që për një rast konflikti të tillë, ai të japë detyrimisht dorëheqjen.

8. Vendosja nëse një praktikë e caktuar e një ndërmarrjeje në treg është apo jo në përputhje me Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës” gjithashtu nuk është çështje e diskrecionit apo e gjykimit vetjak të një komisioneri, por një çështje e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, i interpretuar në bazë të instrumenteve interpretues të përdorura nga Bashkimi Europian siç parashikohet në Marrëveshjen e Asocimit e Stabilizimit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 37, pika 6, gërma a (i) dhe (ii), dhe gërma b (ii), të Ligji nr. 9367 datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (te ndryshuar),

V E N D O S I:

- I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë me parapagesë.
- II. Periudha e hetimit do të jetë nga Janari 2012 deri në Nëntor 2012.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 28. 02.2013.
- IV. Ky vendim i dërgohet për dijeni palëve dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Rezana KONOMI
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 262, Datë 14.01.2013

**“Për
hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun në shërbimin e
transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

▪	Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪	Rezana	KONOMI	Zv.Kryetar
▪	Servete	GRUDA	Anëtar
▪	Koço	BROKA	Anëtar
▪	Iva	ZAJMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.01.2013, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit të hetimit paraprak në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës.

Baza ligjore: Nenet 24, (shkronja d); 26 dhe 43, (pika 1) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit paraprak në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës;

- Relacionit e Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës

VËREN SE :

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit Nr. 252, datë 26.11.2012 të Komisionit të Konkurrencës, vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Në zbatim të këtij vendimi inspektorët e Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës kanë kryer inspektime dhe kanë administruar informacionin nga ndërmarrjet që veprojnë në këtë treg.

II. TREGU PËRKATËS

3. Përcaktimi i tregut përkatës është realizuar në bazë të Udhëzimit nr.76 dt 07/06/2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”.
4. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:
 - a) *Tregu përkatës i produktit*
 - b) *Tregu përkatës gjeografik*

II.1 Tregu përkatës i produktit

5. Tregu përkatës i produktit është tregtimi i biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe studentit në shërbimin e transportit qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës. Pra nga ky përkufizim kemi të bëjmë me dy nëntregje të përcaktuara:
 - A. Nëntregu i përkatës i tregtimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme;
 - B. Nëntregu i përkatës i tregtimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) “Studenti”;

II.2 Tregu përkatës gjeografik

6. Tregu përkatës gjeografik është qyteti i Tiranës, pasi në këtë qytet ushtrojnë veprimtarinë e tyre ndërmarrjet e transportit rrugor qytetas që janë objekt hetimi.

III. STRUKTURA DHE RREGULLIMI I TREGUT

7. Në bazë të nenit 13 të Ligjit 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, transporti qytetas është një shërbim i veçantë që plotëson nevojat e popullsisë së një qyteti, duke kryer shërbim të rregullt me autobusë brenda vijave

kufizuese të tij ose duke lidhur qendra të rëndësishme ekonomike dhe sociale me pjesët e tjera të qytetit. Kriteret, rregullat, afatet dhe dokumentacioni për dhënien e licencës dhe certifikatës përcaktohen në Udhëzimin e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nr. 15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, të ndryshuar. Në nenin 6, pika 1 të këtij Udhëzimi është përcaktuar dhe autoriteti kompetent për lëshimin e licencave, i cili në rastin e transportit në linjë të rregullt qytetase është Bashkia.

8. Në Udhëzimin e MF-së Nr. 11, datë 25.06.2007 “Për organizimin, shtypjen dhe emetimin e biletave në transportin rrugor”, rregullohet dhe transporti i udhëtarëve me shërbim të parapaguar (abonetë). Sipas këtij Udhëzimi, aboneja është biletë udhëtimi, që emetohet dhe shpërndahet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, modeli i së cilës përcaktohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.
9. Veprimtaria e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës mbikëqyret nga Bashkia e Tiranës. Ajo bën përcaktimin e numrit të aboneve të përgjithshme dhe të studentit për secilën ndërmarrje dhe numrin për çdo ndërmarrje ia dërgon çdo muaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të realizuar emetimin dhe shpërndarjen e tyre.
10. Transporti rrugor qytetas i udhëtarëve në qytetin e Tiranës ofrohet nga ndërmarrjet e licensuara: Alba Trans Shpk, Tirana Lines Shpk, Tirana Urban Trans Sha, Ferlut Sha, Gerard-A Shpk dhe Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve sh.a, të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në linja të ndryshme në qytetin e Tiranës.
11. Disa nga ndërmarrjet e mësipërme janë organizuar në Shoqatën Kombëtare të Transportit Qytetas, në kuadër të së cilës ato realizojnë mbledhje periodike lidhur me problematikën që hasin në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës. Lidhur me çështjet që shqyrton SHKTQ-ja, anëtarët e saj shprehen me vendime.
12. Gjatë procedurave hetimore nga ana e Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës ju janë kërkuar të dhëna ndërmarrjeve lidhur me numrin e aboneve të marra nga Bashkia dhe numrin e aboneve të shitura. Gjithashtu në treg deri në muajin gusht 2012 ka operuar edhe ndërmarrja “OTTO AL”.

IV. SJELLJA E NDËRMARRJEVE

IV.1 Sjellja e ndërmarrjeve në lidhje me ankuesit

13. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, dy ndërmarrjet “Alba-Trans” sh.p.k dhe “Gerard-A” Sh.p.k kanë paraqitur ankesë nëpërmjet të cilës pretendojnë se Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas (SHKTQ) e përbërë nga anëtarët e saj: Tirana Urban Trans, Tirana Lines dhe Ferlut, të cilët operojnë në fushën e transportit rrugor qytetas ka shkelur Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

14. Shoqëria “Gerard-A” Sh.p.k pretendon se me marrëveshje anëtarët e SHKTQ, kanë vendosur në xhamat e autobusëve urbanë dhe kioskat shitëse të aboneve, një njoftim me përmbajtje: “KUJDES nga abonetë dhe kartonat falsë” duke mos njohur abonetë e papajisura me kartonin e lëshuar nga SHKTQ. Duke qenë se shoqëria “Gerard-A” nuk është pjesë e SHKTQ, kjo e fundit vendosi mos-pajisjen me kartonin shoqërues për abonetë për muajin tetor 2012.
15. Në zyrën e SHKTQ-së është gjetur vendimi i Shoqatës i datës 29.10.2012, i firmosur nga përfaqësuesit e ndërmarrjeve “Ferlut”, “Tirana Lines”, “Tirana Urban Trans” si dhe nga Sekretari dhe Kryetari i SHKTQ, nëpërmjet të cilit anëtarët e SHKTQ-së, në kundërshtim me vendimin e Bashkisë Tiranë, për dhënien e 5500 kartonave shoqërues për ndërmarrjen “Gerard-A” SHPK, kanë vendosur që për muajin nëntor 2012, operatori i ri “Gerard-A” SHPK të pajiset me vetëm 1200 copë kartona shoqërues aboneje, duke penguar këtë konkurrent të tregtojeabone sipas numrit të përcaktuar.
16. Gjithashtu në zyrën e SHKTQ-së është gjetur në formë elektronike dhe një njoftim mbi mos njohjen e aboneve pa kartonin shoqërues për muajin korrik 2012, sjellje e kryer me qëllim për të penguar shitjen e aboneve të ndërmarrjes “Alba-Trans”, e cila kishte deklaruar daljen nga SHKTQ, si dhe nuk kishte tërhequr kartonët shoqërues të aboneve me logon e SHKTQ për këtë muaj.
17. Referuar sa më sipër, sjellja e anëtarëve të SHKTQ lidhur me refuzimin e dhënies së kartonave shoqërues të aboneve sipas sasisë së vendosur nga Bashkia Tiranë ndërmarrjes “Gerard – A” si dhe refuzimin për të njohur abonetë pa kartonin shoqërues me logon e SHKTQ të ndërmarrjes “Alba-Trans” bazuar në nenin 4 pika 1, germa b të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar mund të përbëjë pengim, kufizim ose shtrembërim të konkurrencës

IV.2 Sjellja e ndërmarrjeve në lidhje me abonetë e studentit

18. Në selinë e SHKTQ-së janë gjetur në formë elektronike dhe në formë të shkruar dokumente të cilat datojnë që nga viti 2007, nga shqyrtimi i të cilave rezulton se anëtarët e SHKTQ-së, përkatësisht ndërmarrjet “Ferlut’ SHPK, “Tirana Lines” SHA, “Alba-Trans” SHPK, “Tirana Urban Trans” SHA dhe “OTTO-AL”, gjatë vitit 2007 kanë marrë vendime për të kufizuar me 50 % numrin e aboneve të studentit të hedhura në treg dhe për periudhën 2008-2012 e kanë kufizuar me 80 % numrin e aboneve të studentit të hedhura në treg.
19. Gjithashtu pranë SHKTQ-së janë gjetur të gjitha porosítë e kryera nga SHKTQ-ja për kartona të aboneve të studentit dhe të përgjithshme, për të gjitha linjat e shërbimit të transportit qytetas të Tiranës, si dhe muajin për të cilin janë porositur, për vitet 2011 dhe 2012. Nga krahasimi i numrit total të aboneve të përgjithshme dhe aboneve të studentit, numri i kartonave të porositur është e barabartë me shumën e aboneve të përgjithshme plus rreth 20% të shumës së aboneve të studentit, sjellje e cila së

bashku me evidencat e mbledhura gjatë inspektimeve mund të përbëjë një marrëveshjeje midis ndërmarrjeve antare të SHKTQ për kufizimin e tregtimit të abonesë së studentit me rreth 80% të sasisë totale të aboneve të studentit të dhënë nga Bashkia Tiranë për çdo ndërmarrje.

20. Në ndërmarrjen “Alba Trans”, janë gjetur në formë elektronike tabela ku paraqitet sasia e aboneve të përgjithshme, aboneve të studentit dhe aboneve të linjave të marra nga kjo ndërmarrje dhe sasia e shitur për secilën nga llojet e aboneve. Tabelat përmbajnë edhe një rresht, i cili quhet “BLLOKUAR” që korrespondon me kolonën e aboneve të studentit dhe në të cilën jepet sasia e aboneve të studentit të bllokuar nga kjo ndërmarrje duke mos u tregtuar.
21. Nga llogaritja e sasisë (numrit) së aboneve të studentit të marra dhe sasisë së shitur të tyre, rezulton se ndërmarrja “Alba Trans” SHPK ka tregtuar rreth 20% të sasisë totale të aboneve të studentit të marrë, duke zbatuar marrëveshjen midis ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës.
22. Pranë ndërmarrjes “Alba Trans” SHPK është gjetur korrespondencë elektronike midis një punonjësi të kësajndërmarrjeje dhe Sekretarit të Përgjithshëm të SHKTQ-së. Në korrespondencë është dhe një e-mail dërguar ndërmarrjes “Ferlut” SHA. Në këtë korrespondencë, e cila zhvillohet nga data 27.07.2012, deri më datë 16.10.2012 flitet në lidhje me bllokimin e shitjes së aboneve të studentit dhe nxjerrjen në shitje të vetëm 20% të sasisë totale. Bllokimi do kryhej në zyrën e Shoqatës për të gjithë operatorët. Në një e-mail, konfirmohet bllokimi i 80% të aboneve të studentit, 4240 fije, shumë e cila i korrespondon sasisë totale prej 5300 abone studenti që ka në dispozicion ndërmarrja “Alba Trans” SHPK.
23. Në ndërmarrjen “Tirana Lines” SHPK, është gjetur shkresa me titull: TABELË PËRMBLEDHËSE E KARTONAVE E ABONEVE PËR PLANIFIKIM MUJOR, e cila i përket muajit shkurt 2012, në të cilën tregohen sasinë faktike të marrjes së aboneve të përgjithshme, studenti dhe linje, për secilën nga ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës, përkatësisht: “Ferlut” SHPK, “Tirana Lines” SHA, “Alba Trans” SHPK, “Tirana Urban Trans” SHA, “PARKU I TRANSPORTIT URBAN TË UDHËTARËVE” SHPK dhe “OTTO-AL”. Në kolonën që i korrespondon aboneve të studentit, rezulton se 80% e sasisë së këtyre aboneve bllokohen nga të gjitha ndërmarrjet dhe vetëm 20% e tyre hidhen në shitje.
24. Hyrësi i ri në treg (nga tetori 2012), ndërmarrja “Gerard- A” sipas të dhënave të administruara gjatë inspektimit në këtë ndërmarrje rezulton se ka hedhur në treg të gjithë sasinë e aboneve të studentit për muajt tetor dhe nëntor 2012 dhe nuk rezulton të jetë pjesë e marrëveshjes në asnjë nga dokumentet e administruara gjatë procedurave të hetimit paraprak.

25. Referuar evidencave në formë të shkruar dhe elektronike, të gjetura pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës dhe pranë SHKTQ-së, rezulton se ndërmarrjet “Ferlut” SHPK, “Tirana Lines” SHA, “Alba Trans” SHPK, “Tirana Urban Ttrans” SHA, “Parku I Transportit Urban TË UDHËTARËVE” SHPK dhe “OTTO-AL”, kanë bërë një marrëveshje me anë të të cilës kanë bllokuar shitjen e 50% të sasisë së aboneve të studentit, për vitin 2007 dhe rreth 80% të sasisë së aboneve të studentit për periudhën 2008-2012, e cila në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma (b) dhe (c), të Ligjit 9121, datë 23.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, mund të përbëjë kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në treg duke kufizuar dhe kontrolluar shitjen e aboneve të studentit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 4, nenit 24, (shkronja d) dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe në nenin 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”,

V E N D O S I:

- I.** Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e tregtimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe studenti në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës, ndaj ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë në këtë treg dhe konkretisht: “FERLUT” SHPK, “TIRANA LINES” SHA, “ALBA TRANS” SHPK, “TIRANA URBAN TRANS” SHA, “PARKU I TRANSPORTIT URBAN TË UDHËTARËVE” SHPK dhe “OTTO AL”;
- II.** Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 1 Janar 2007 - 31 Dhjetor 2012;
- III.** Procedurat e hetimit të thelluar dhe dorëzimi i raportit duhet të bëhen jo më vonë se 2 muaj nga dalja e këtij vendimi.
- IV.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Rezana KONOMI
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 263, Datë 14.01.2013

**“Për
marrjen e masave të përkohshme për tregtimin e biletave të pajtimit
mujor (aboneve) të studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas
të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

▪	Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪	Rezana	KONOMI	Zv/Kryetar
▪	Servete	GRUDA	Anëtar
▪	Koço	BROKA	Anëtar
▪	Iva	ZAJMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 14.01.2013, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit të hetimit paraprak në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës.

Baza ligjore: Nenet 4, pika 1, 24, germa d, 44, pika 1 dhe 2, të ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, këtu dhe me poshtë Ligji

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

➤ Raportit të hetimit paraprak në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës;

➤ Relacionit e Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës

VËREN SE :

1. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit nr. 252, datë 26.11.2012 të Komisionit të Konkurrencës, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”, vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
2. Transporti rrugor i udhëtarëve, në Republikën e Shqipërisë, rregullohet nga Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar. Ky shërbim mund të jetë qytetës, rreth-qytetës, ndërqytetës, ndërkombëtar dhe shërbim i rregullt, i specializuar.
3. Hyrja në treg e operatorëve të transportit rrugor të mallrave dhe udhëtarëve kërkon plotësimin e disa kushteve, të cilat përcaktohen në nenin 6 të Ligjit, si dhe në Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 325, datë 19.03.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”, i ndryshuar.
4. Në bazë të nenit 13 të Ligjit, transporti qytetës është një shërbim i veçantë që plotëson nevojat e popullsisë së një qyteti, duke kryer shërbim të rregullt me autobusë brenda vijave kufizuese të tij ose duke lidhur qendra të rëndësishme ekonomike dhe sociale me pjesët e tjera të qytetit. Këshilli bashkiak, duke u mbështetur në nevojat e popullsisë për transportin qytetës, përcakton linjat, organizon, financon dhe vendos për këtë lloj transporti brenda juridiksionit të vet. Licenca për transportin qytetës jepet nga kryetari i bashkisë.
5. Kriteret, rregullat, afatet dhe dokumentacioni për dhënien e licencës dhe certifikatës përcaktohen në udhëzimin e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nr. 15, datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor”, të ndryshuar.
6. Në nenin 6, pika 1 të këtij Udhëzimi është përcaktuar dhe autoriteti kompetent për lëshimin e licencave, i cili në rastin e transportit në linjë të rregullt qytetase është Bashkia.
7. Në Udhëzimin e MF-së Nr. 11, datë 25.06.2007 “Për organizimin, shtypjen dhe emetimin e biletave në transportin rrugor”, rregullohet dhe transporti i udhëtarëve me shërbim të parapaguar (abonetë). Sipas këtij Udhëzimi, aboneja është biletë udhëtimi, që emetohet dhe shpërndahet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve,

modeli i së cilës përcaktohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Aboneja do të përmbajë detyrimisht numrat serialë të parashtypur dhe vleftën e saj, së bashku me TVSH-në, konform çmimeve të miratuara nga vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 146, datë 26.02.1998 “Për tarifat e transportit udhëtar”. Kjo biletë mund të përdoret në të gjitha shërbimet e transportit publik tokësor të udhëtarëve.

8. Veprimtaria e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës mbikëqyret nga Bashkia e Tiranës. Ajo bën përcaktimin e numrit të aboneve të përgjithshme dhe të studentit për secilën ndërmarrje dhe numrin për çdo ndërmarrje ia dërgon çdo muaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të realizuar emetimin dhe shpërndarjen e tyre.
9. Transporti rrugor qytetas i udhëtarëve në qytetin e Tiranës ofrohet nga ndërmarrjet: Alba Trans Shpk, Tirana Lines Shpk, Tirana Urban Trans Sha, Ferlut Sha, Gerard-A Shpk dhe Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve sh.a, të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në linja të ndryshme në qytetin e Tiranës. Gjithashtu në treg deri në muajin gusht 2012 ka operuar edhe ndërmarrja “OTTO AL”.
10. Një pjesë e ndërmarrjeve të mësipërme janë organizuar në Shoqatën Kombëtare të Transportit Qytetas, në kuadër të së cilës ato realizojnë mbledhje periodike lidhur me problematikën që hasin në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës. Lidhur me çështjet që shqyrton SHKTQ-ja, anëtarët e saj shprehen me vendime.
11. Gjatë inspektimeve të kryera nga Grupi i Inspektorëve të Autoritetit të Konkurrencës pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës, si dhe pranë Shoqatës Kombëtare të Transportit Qytetas (SHKTQ), janë gjetur evidenca në formë shkresore dhe evidenca në formë elektronike, që tregojnë se ndërmarrjet “Ferlut” shpk, “Tirana Lines” sha, “Alba Trans” shpk, “Tirana Urban Trans” sha, “Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve” shpk dhe “Otto-al”, duke filluar që nga viti 2007 e deri më sot, nuk kanë tregtuar të gjithë numrin e biletave të pajtimit mujor për nxënësit dhe studentët (abone studenti) që kanë pasur në dispozicion, por me marrëveshje midis tyre kanë kufizuar shitjen gjatë vitit 2007 me 50 % të numrit të përgjithshëm të këtyre aboneve dhe nga viti 2008-2012 kanë bllokuar 80 % të numrit të përgjithshëm të këtyre aboneve.
12. Kjo sjellje e këtyre ndërmarrjeve bëhet për të kufizuar shitjen e aboneve të studentit të cilat kanë një çmim më të ulët, me qëllim për të përfituar nga shitja e biletave dhe të aboneve të përgjithshme të cilat kanë një çmim më të lartë. Sjellja e mësipërme, bazuar në nenin 4 pika 1, germa (b) dhe (c) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar mund të përbëjë pengim, kufizim ose shtrembërim të konkurrencës.

13. Nga kjo sjellje i shkaktohet një dëm konsumatorëve të këtij shërbimi, (studentëve dhe nxënësve) të cilët janë të detyruar të blejnë bileta apo abone të përgjithshme me çmime më të larta.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve 4, pika 1, 24, germa d, 44, pika 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, duke marrë në konsideratë rrezikun e kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 4 të Ligjit,

V E N D O S I:

- I. Marrjen e masave të përkohshme për eliminimin e pasojave antikonkurruesesipas nenit 44, pika 1, si vijon:

Shpërndarjen dhe tregëtimin e menjëhershëm dhe pa vonesë nga ndërmarrjet: “FERLUT” SHPK, “TIRANA LINES” SHA, “ALBA TRANS” SHPK, “TIRANA URBAN TRANS” SHA dhe “PARKU I TRANSPORTIT URBAN TË UDHËTARËVE” SHPK.” të të gjithë sasisë së biletave të pajtimit mujor për nxënësit dhe studentët (abone studenti) sipas sasisësë përcaktuar nga Bashkia e Tiranës, duke filluar nga muaji Janar 2013.

- II. Masat e përkohshme duhet të zbatohen me marrjen në dijeni të këtij vendimi dhe zbatimi i tyre do të mbikëqyret në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës;
- III. Këto masa të përkohshme do të zbatohen për një periudhë kohe deri në përfundim të hetimit;
- IV. Moszbatimi i Vendimit për masa të përkohshme, i cituar në pikën 1 të këtij Vendimi, ndëshkohet me gjobë deri në 10 % të xhiros vjetore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 74, pika 1, germa b të Ligjit;
- V. Në rast të moszbatimit të masave të përkohshme brenda afateve të përcaktuara në këtë vendim, në bazë të nenit 76, pika b, të Ligjit 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës mund të vendosë gjoba periodike deri në 5 % të xhiros mesatare ditore të vitin financiar para-ardhës, e cila llogaritet nga data e marrjes së këtij vendimi;

- VI.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për komunikimin e vendimit të gjitha ndërmarrjeve sipas pikës I të këtij Vendimi, si dhe ndjekjen e zbatimit të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

Nr. 264 , Datë 05.02.2013

“Mbi

autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimi të kontrollit të vetëm të Albanian Chrome Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga DCM DECOMetal GmbH dhe DCM Beteiligungs GmbH tek Balfin Sh.p.k”

Komisioni i Konkurrencës me përbërjen e:

▪	Znj. Lindita	Milo (Lati)	Kryetar
▪	Znj. Rezana	Konomi	Zv. Kryetar
▪	Znj. Servete	Gruda	Anëtar
▪	Z. Koço	Broka	Anëtar
▪	Znj. Iva	Zajmi	Anëtar;

Në mbledhjen e tij të datës 05.02.2013, me pjesëmarrjen e Znj. Lindita Milo (Lati) kryetar, Znj. Rezana Konomi , zv. Kryetar, Znj. Servete Gruda, anëtar, Znj. Iva Zajmi, anëtar; shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimi të kontrollit të vetëm të Albanian Chrome Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga DCM DECOMetal GmbH dhe DCM Beteiligungs GmbH tek Balfin Sh.p.k.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, dhe neni 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të

ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit “ dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Balfin Sh.p.k me Albanian Chrome Sh.p.k dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

VËREN SE:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet në bazë të ‘Marrëveshjes për blerjen shitjen e Albanian Chrome Sh.p.k’ e lidhur më datë 9 Janar 2013, ndërmjet palëve “Balfin Sh.p.k” në cilësinë e blerësit dhe “DCM DECOmetal GmbH” dhe “ DCM Beteiligungs GmbH” në cilësinë e aksionerëve shitës të shoqërisë Target me qëllim përftimin e kontrollit të shoqërisë Albanian Chrome Sh.p.k nga shoqëria Balfin Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave.

Ky transaksion i cili ndryshon cilësinë e kontrollit në ndërmarrjen target (Albanian Chrome Sh.p.k) në formën e transferimit të kuotave nga shitësit të blerësi përbën një përqendrim në bazë të nenit 10 pika 1), shkronja b) e Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar. Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit për sa i përket xhirove (neni 12/1).

2. Palët në transaksion

❖ **Balfin Sh.p.k**, në cilësinë e **blerësit**, me seli në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II, ABA Business Centre, kati 12, Tiranë. Shoqëria kryen aktivitet në fushën e (i) import- eksportit, shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve tekstile, veshjeve të të gjitha llojeve; (ii) shitjen me shumicë dhe pakicë të mallrave industriale dhe ushqimorë, etj.

❖ **DCM DECOmetal GmbH**, në cilësinë e **shitësit** është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në përputhje me legjislacionin e Republikës së Austrisë, me seli në adresën: Grazerplatz, nr 5, 8280 Furstenfeld, Austri. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në fushën e nxjerrjes, përpunimit dhe tregtimit të hekurit dhe mineraleve në tregun global.

❖ **DCM Beteiligungs GmbH**, në cilësinë e **shitësit** është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në përputhje me legjislacionin Austriak , me seli në adresën: Grazerplatz, nr 5, 8280 Furstenfeld, Austri.

Shitësit zotërojnë dhe kontrollojnë në mënyrë të përbashkët ndërmarrjen ACR Holding S.r.l e cila zotëron dhe kontrollon në masën 100% ndërmarrjen target të përqendrimit dhe gëzon cilësinë e ortakut të vetëm në të.

❖ **ACR Holding S.r.l** është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në përputhje me legjislacionin italian me seli në adresën: via Borgogna 2, 20122 Milano, Itali.

❖ **Albanian Chrome Sh.p.k**, në cilësinë e **ndërmarrjes target** është një shoqëri që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar me seli në adresën: Rr. 'Ibrahim Rugova', nr. 5, Sky Tower 6/4, Tiranë. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në (i) nxjerrjen e kromiteve në minierat Bulqizë, Prenjas dhe Pojska, në riaktivizimin e kromiteve në stabiliment në Bulqizë dhe Klos dhe prodhimin e Ferro-Kromit në stabilimente në Elbasan dhe Burrel, duke përdorur know-how dhe stabilimentet e Ortakut (*ACR Holding S.r.l*), etj.

3. Xhiro për vitin 2011

- Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është XXX miliard Lekë, ku:
 - Balfin sh.p.k.së bashku me shoqëritë e lidhura: XXXX lekë;
- Xhiro totale në **tregun e brendshëm**: është XXX miliardë lekë, ku:
 - Balfin sh.p.k. si shoqëri e vetme : XXXX lekë
 - Balfin së bashku me shoqëritë e lidhura: XXXX lekë
 - Albanian Chrome sh.p.k: XXXX lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1 të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

3. ANALIZA E KONKURRENCËS

A. Tregu përkatës

Albanian Chrome sh.p.k e kryen aktivitetin në fushën e nxjerrjes dhe përpunimit të mineralit të kromit dhe prodhimit të ferrokromit. ACR ka dy koncesione të qeverisë shqiptare ku përfshihen Miniera e Kromit Bulqizë, Impianti i Përpunimit në Klos, Uzina e Ferrokromit Burrel dhe Uzina e Ferrokromit Elbasan.

Minerali i kromit është i destinuar të përdoret në prodhimin e ferrokromit. Produkti përfundimtar, ferrokromi, e ka përdorimin final në industrinë e prodhimit të çelikut. ACR eksporton totalisht të gjithë produktin e saj.

Veprimtaria e ndërmarrjes Balfin sh.p.k konsiston në import, eksport, shitje me shumicë dhe pakicë e produkteve tekstile, veshjeve të të gjitha llojeve, mallrave industriale, tregtim i artikujve të ndryshëm, import, eksport, shitje me pakicë dhe shumicë e paisjeve elektrike, elektronike, lëndë e parë për industrinë, materiale ndërtimi e hidrosanitare, paisje zyrash, kancelari, pjesë këmbimi auto e makineri të çdo lloji, paisje teknologjike e të tjera (shitje, blerje, qera, transport mallrash dhe udhëtarësh brenda dhe jashtë vendit,

manaxhim i qendrave tregtare, bare e restorante). Ofrim i shërbimeve të konsulencës në fushën e biznesit, manaxhimit, taksave e të tjera.

Ndërmarrja Balfin sh.p.k. nuk operon në fushën e veprimtarisë të ndërmarrjes ACR, pra në fushën e nxjerrjes dhe përpunimit të mineralit të kromit dhe prodhimit të ferrokromit dhe në këtë mënyrë nuk kemi tregje të përbashkëta të palëve pjesëmarrëse në këtë përqëndrim.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

I) tregu i produktit, dhe

II) tregu gjeografik.

I. Tregu i produktit: Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do konsiderohet tregu i nxjerrjes dhe përpunimit të mineralit të kromit dhe prodhimit të ferrokromit me dy nëntregjet e tij:

- Nxjerrja dhe përpunimi i mineralit të kromit, dhe
- Prodhimi i ferrokromit.

II. Tregu gjeografik:

ACR e kryen aktivitetin e nxjerrjes dhe përpunimit të kromit dhe prodhimit të ferrokromit me anë të minierave, impianteve apo uzinave, të cilat janë të shpërndara në territorin e Republikës së Shqipërisë, megjithëse produktin e prodhuar e eksporton.

Për analizimin e këtij rasti *treg gjeografik* do të konsiderohet **tregu i brendshëm**, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

B. Tendenca e tregut.

Proçesi i liçensimit, dhënies së lejeve minerare ka filluar në vitin 1995. Deri më 01.01.2012 janë dhënë gjithsej rreth 711 leje minerare. Nga këto, leje shfrytëzimi janë dhënë 622. Për mineralin e kromit janë dhënë 202 leje shfrytëzimi, në 13 rrethe të vendit.

Duke u nisur nga prodhimi i kromit dhe nënprodukteve të tij, nga të dhënat e METE rezulton se në total prodhimi i kromit për vitin 2012 ishte rreth 400 211 ton dhe ndërmarrja target ACR ka prodhuar 29 676 ton ose rreth 7.4 % të totalit të prodhimit.

Produkti i kromit i pasuruar(ferrokromi) eksportohet dhe sipas të dhënave të palës njoftuese vlera totale e tregut arrin në rreth 50-60 milionë lekë. Ndërmarrja target ka realizuar shitje(eksport) në rreth 43.4 milionë dollar ose rreth 43.8 milionë lekë, që përbën rreth 73 për qind të totalit të eksporteve. Ndërmarrja objekt përqëndrimi e eksporton totalisht produktin e saj.

C. Pozicioni në treg pas përqendrimit

Pjesa e tregut që Albanian Chrome Sh.p.k do të zotërojë pas transaksionit do të ngelet po e njëjtë me pjesën e tregut të zotëruar nga kjo shoqëri para tij, pasi përfituesi i kontrollit Balfin sh.p.k. (blerësi) nuk është prezent në këtë treg produkti në Shqipëri. Si pasojë, transaksioni nuk sjell ndryshime në strukturën e tregut pas përqendrimit dhe nuk krijon dhe as forcon një pozicion dominues të Albanian Chrome Sh.p.k në tregun përkatës, duke mos e kufizuar kështu konkurrencën në tregun përkatës të produktit.

Me anë të këtij përqendrimi Balfin sh.p.k.synon të shtojë gamën e aktiviteteve tregëtare që ai ushtron.

4. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Përqendrimi i realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të ndërmarrjes Albanian Chrome Sh.p.k nëpërmjet blerjes së 100% të kuotave nga Balfin Group është një ndryshim kontrolli sipas parashikimeve të nenit 12 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar që nuk sjell ndryshime në strukturën e tregut në aspektin e përqendrimit të tregut dhe presionit konkurrues.

Ndërmarrja përfituese e kontrollit para realizimit të këtij përqendrimi nuk ka qenë aktive në tregun përkatës të nxjerrjes dhe përpunimit të mineralit të kromit dhe për pasojë përqendrimi nuk sjell asnjë ndryshim në pjesën e tregut që zë aktualisht shoqëria Albanian Chrome Sh.p.k.

Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për këto arsye propozojmë t’i kërkon Komisionit autorizimin e këtij përqendrimi në përputhje me nenin 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin të realizuar nëpërmjet përfitimi i kontrollit të vetëm të Albanian Chrome Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga DCM DECOmetal GmbH dhe DCM Beteiligungs GmbH tek Balfin Sh.p.k.

2. Ngarkohet Sekretari i përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

Nr. 265, Datë 05.02. 2013

“Mbi

**vendosje gjobe ndaj shoqërisë Viloil Sh.A për mosnjoftimin
e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Viloil Sh.A
nëpërmjet transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar, nga
shoqëria “City Investement Holding S.A”, tek aksionerët z. Apostol Goçi
dhe z. Albano Aliko”**

Komisioni i Konkurrencës me përbërjen e:

- | | | | |
|---|--------------|-------------|------------|
| ▪ | Znj. Lindita | Milo (Lati) | Kryetar |
| ▪ | Znj. Rezana | Konomi | Zv. Kyetar |
| ▪ | Znj. Servete | Gruda | Anëtar |
| ▪ | Z. Koço | Broka | Anëtar |
| ▪ | Znj. Iva | Zajmi | Anëtar; |

Në mbledhjen e tij të datës 05.02.2013, me pjesëmarrjen e Znj. Lindita Milo (Lati) kryetar, Znj. Rezana Konomi ,zv. Kyetar, Znj. Servete Gruda, anëtar, Znj. Iva Zajmi, anëtar; shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Vendosjen e gjobës së lehtë për kundravajtje administrative ndaj shoqërisë Viloil Sh.A për mosnjoftim të përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar, nga shoqëria “City Investement Holding S.A”, tek aksionerët z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko”.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, neni 73

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretares së Përgjithshme mbi mos-njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar, nga shoqëria “City Investment Holding S.A”, tek aksionerët z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko”.

V Ë R E N S E:

I. Procedura e ndjekur

Përqendrimi është realizuar në bazë të “Marrëveshjes për Blerjen e Aksioneve” e nënshkruar midis palëve shoqëria ‘City Investment Holding S.A’ dhe aksionereve (të shoqërisë Viloil Sh.a) z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko, me datë 4 Shkurt 2012, me objekt përfitim të kontrollit të shoqërisë Viloil Sh.a, nëpërmjet transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar nga shoqëria City Investment Holding S.A tek aksionerët z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko. Këta të fundit do të zotërojnë shoqërinë target në masën prej 50% të aksioneve seicili.

Përqendrimi nuk është njoftuar brenda afatit 30 ditore të parashikuar në nenin 12, pika 2 dhe për këtë arsye Komisioni i Konkurrencës e ka filluar procedurën me nismën e tij me vendimin Nr. 250 , datë 20.11. 2012" Mbihapjen e procedurës së kontrollit të përqendrimit si rezultat i transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar të shoqërisë Viloil Sh.a, nga shoqëria City Investment Holding S.A, tek aksionerët z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko”.

II. Njoftimi i përqendrimit pas vendimit të Komisionit

Pas njohjes me vendimin e Komisionit, pala përfituese ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës formularin e thjeshtuar të përqendrimit dhe dokumentacionin shoqërues. Me sigurimin e të dhënave, Autoriteti i Konkurrencës, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm, me shkresën Nr. 592/5 Prot. datë 09.01.2013, (i) njoftoi palën për fillimin e procedurës së kontrollit të përqendrimit në përputhje me nenin 54 të Ligjit.

III. Konkluzione

Mosnjoftimi i përqendrimit në kuptim të nenit 73, pika 1 gërma dhe të Ligjit vlerësohet si kundravajtje administrative dhe për këtë arsye i propozoj Komisionit të Konkurrencës vendosjen e një gjobe për shkelje të lehtë.

Ky transaksion i cili ndryshon cilësinë e kontrollit në ndërmarrjen Viloil Sh.a në formën e zvogëlimit të numrit të aksionerëve nuk sjell ndryshime strukturore në treg pasi nuk ndryshon indeksi i përqendrimit të tregut dhe për pasojë nuk jemi para rastit të parashikuar në nenin 74, pika 1. Gërma d pasi përqendrimi nuk ka efekte të kufizimit të konkurrencës në treg.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të neneve: 24, (shkronja d); nenit 12, pika 2, nenit 53, pika 1, germa a, nenit 73, pika 1, germa dh e Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar), dhe nenit 12 të rregullores “Për gjokat dhe lehtësimin prej tyre”.

VENDOSI:

1. Të gjobisë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) Lekë ndërmarrjen Viloil Sh.A për mosnjofitimin e përqëndrimit të realizuar.
2. Ngarkohet Sekretari i përgjithshëm për njofitimin e palëve dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS**Servete GRUDA****Koço BROKA****Iva ZAJMI****Rezana KONOMI**

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar**Lindita MILO (LATI)**

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 266, Datë 05.02.2013

“Mbi

**autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit
të Viloil Sh.A nëpërmjet transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit
themeltar, nga shoqëria “City Investement Holding S.A”,
tek aksionerët z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

▪	Znj. Lindita	Milo (Lati)	Kryetar
▪	Znj. Rezana	Konomi	Zv. Kryetar
▪	Znj. Servete	Gruda	Anëtar
▪	Z. Koço	Broka	Anëtar
▪	Znj. Iva	Zajmi	Anëtar;

Në mbledhjen e tij të datës 05.02.2013, me pjesëmarrjen e Znj. Lindita Milo (Lati) kryetar, Znj. Rezana Konomi, zv. Kryetar, Znj. Servete Gruda, anëtar, Znj. Iva Zajmi, anëtar; shqyrtoi çështjen me:

Objekt: “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Viloil Sh.A nëpërmjet transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar, nga shoqëria “City Investement Holding S.A”, tek aksionerët z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko”

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, dhe në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit “ dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi është realizuar në bazë të “Marrëveshjes për blerjen e aksioneve” e nënshkruar midis palëve shoqëria ‘City Investement Holding S.A’ dhe aksionereve (të shoqërisë Viloil Sh.a) z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko, me datë 4 Shkurt 2012, me objekt përfitim e kontrollit të shoqërisë Viloil Sh.a, nëpërmjet transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar nga shoqëria City Investement Holding S.A tek aksioneret z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko. Këta të fundit do të zotërojnë shoqërinë target në masën prej 50% të aksioneve sejcili.

Ky transaksion i cili ndryshon cilësinë e kontrollit në ndërmarrjen Viloil Sh.a në formën e zvogëlimit të numrit të aksionerëve përbën një përqendrim në bazë të nenit 10 pika 1) , shkronja b) e Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar. Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përse i përket xhirove (neni 12/1).

2. Palët në transaksion

- **City Investement Holding S.A:** (Shitësi) është një shoqëri zviceriane me seli në adresën: Rue de la Croix D;Or, 19 A, 1204 Gjenevë, Zvicër. Shoqëria ka objekt veprimtarie tregtimin ndëkombëtar te naftës si dhe menaxhimin financiar, blerjen dhe pjesëmarrjen në shoqëri të tjera të ngjashme etj. Shoqëria është zotëruese e 100% të aksioneve të shoqërsë bijë City Trade& Investment S.A e cila zotëron nga ana e saj Viloil Sh.a.

- **Blerësit** (përfutuesit e kontrollit) janë personat fizikë z. **Apostol Goçi** dhe z. **Albano Aliko** me aftësi të plotë për të vepruar. Z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko kanë zotëruar seicili nga 15% të kapitalit aksionar të shoqërisë Viloil Sh.a dhe e kanë rritur zotërimin e tyre në 50% secili duke kontrolluar së bashku shoqërinë target.

- **Viloil Sh.a:** (shoqëria Target) është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar me seli në adresën Rr. Ibrahim Rugova, SKY Tower 9/ 2, Tiranë: me veprimtari kryesisht në fushën e import-eksportit dhe tregtisë me shumcë dhe pakicë të hidrokrabureve dhe nënprodukteve të tyre, naftë, benzinë, vajra lubrifikantë, solar etj nën markën tregtare “ALPET”. Që prej vitit 2005 ajo tregon hidrokrabure nën markën tregtare “ALPET”

3. Xhiro për vitin 2011

- Xhiro totale në **tregun e brendshëm:** është XXX miliard **Lekë:**
 - o **Ndërmarrja VILOIL sh.a:** XXXX Lekë

➤ Për sa i përket xhiros në tregun ndërkombëtar:

o **Ndërmarrja VILOIL sh.a:** nuk operon në tregun ndërkombëtar.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1 të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

4. ANALIZA E KONKURRENCËS

A. Tregu përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

I). tregu i produktit, dhe

II). tregu gjeografik.

I. Tregu i produktit: Referuar Udhëzuesit “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe mbështetur në veprimtarinë e palëve, treg përkatës do konsiderohet tregu i importit dhe shitjes me shumicë të karburanteve me dy nëntregjet e tij.

- Importi dhe tregtimi me shumicë i benzinës, dhe

- Importi dhe tregtimi me shumicë i eurodieselit 10ppm.

II. Tregu gjeografik:

Ndërmarrja Viloil Sh.a operon vetëm në tregun e brendshëm shqiptar. Ushtrimi i aktivitetit të saj si kompani importi i karburanteve me shumicë, realizohet përmes furnizimit të kompanive të tregëtimit me pakicë, të cilat e ushtrojnë aktivitetin e tyre përmes stacioneve të karburantit të marra me qira dhe/ose në pronësi të tyre, të shtrira në të gjithë territorin e Shqipërisë. Ndërmarrja Viloil sh.a, me këto shoqëri të tregëtimit me pakicë ka nënshkruar kontrata furnizimi duke iu ofruar gjithashtu të drejtën e tregëtimit nën markën ALPET. Për analizimin e këtij rasti *treg gjeografik* do të konsiderohet **tregu i brendshëm**, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

B. Struktura e tregut (Tregu i karburanteve në Shqipëri)

Tregu i karburanteve në Shqipëri është tregu më i madh në vend me një qarkullim vjetor 900 milionë -1 miliard \$/vit ose 9-10% të PPB të vendit, si dhe me ndikim të fuqishëm në qëndrueshmërinë dhe zhvillimin ekonomik tërësor.

Sipas Shoqatës së Shoqërive Hidrokarbure, në Shqipëri operojnë në tregun e karburanteve rreth 156 kompani që merren me importin dhe tregtimin e naftës dhe benzinës. Shoqëritë importuese më së shumti punojnë me rafineritë italiane dhe ato greke dhe cilësia që importohet është e njëjtë me atë të vendeve të Bashkimit Evropian.

Oferta për karburante në territorin e Shqipërisë sigurohet nga importi dhe prodhimi vendas. Sipas të dhënave të disponueshme rezulton se kërkesa për benzinë mbulohet vetëm nga importi dhe kërkesa për diesel mbulohet nga importi dhe prodhimi i rafinerisë së Ballshit dhe Fierit, pronë e kompanisë ARMO.

C. Pozicioni në treg pas përqendrimit

Përqendrimi nuk sjell ndryshim të strukturës së tregut të karburanteve në Shqipëri pasi kemi të bëjmë me një transferim aksionesh nga City investment Holding S.A (aksioner me 70% të aksioneve të Viloil) tek dy aksionerët e tjerë të ndërmarrjes Viloil sh.a, Apostol Goci dhe Albano Aliko, pra zvogëlim të numrit të aksionerëve të ndërmarrjes Viloil.

City investment Holding S.A nuk është prezent në Shqipëri me asnjë filial, degë, shoqëri të lidhur apo asete (apo ndonje formë tjetër aktiviteti). Blerësit Apostol Goci dhe Albano Aliko nuk kanë kontroll në ndërmarrje të tjera që veprojnë në tregun përkatës.

Me anë të këtij përqendrimit ku blerësit janë bërë aksionerë secili me 50% të kapitalit të ndërmarrjes Viloil sh.a, synohet të arrihet një menaxhim më i mirë i kësaj shoqërie në mënyrë që aktiviteti ekonomik i saj të krijojë mundësitë financiare për shlyerjen e borxhit të ndërmarrjes Viloil sh.a në favor të City Trade & Investment S.A.

Zgjedhja konsumatore mbetet e njëjtë, pasi kemi të bëjmë me të njëjtin numër stacionesh të shitjes me pakicë, të cilat furnizohen nga ndërmarrja Viloil sh.a si shoqëri e tregëtimit me shumicë drejt shoqërive të tregëtimit me pakicë që operojnë si stacione të karburanteve, të cilat shërbejnë si furnizim i konsumatorit final.

5. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Përqendrimi i cili është realizuar nëpërmjet transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar nga shoqëria City Investment Holding S.A tek aksionerët z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko, përbën një përqendrim në formën e zvogëlimit të numrit të aksionerëve.

Përqendrimi nuk sjell ndryshim të strukturës së tregut të karburanteve në Shqipëri, pasi City Investment Holding i shet pjesën e vet të aksioneve të ndërmarrjes Viloil sh.a dy aksionerëve të tjerë të kësaj ndërmarrjeje dhe nuk është më prezente në Shqipëri me asnjë filial, degë, shoqëri të lidhur apo asete (apo ndonje formë tjetër aktiviteti).

Pas realizimit të përqendrimit pjesët e tregut të ndërmarrjes VILOIL sh.a nuk ndryshojnë, si rrjedhojë dhe përqendrimi i tregjeve të importit dhe shitjes me shumicë të benzinës dhe naftës mbetet i njëjtë.

Tregu është i hapur për konkurrencë, pa barrierra ligjore për sa i përket dhënies së licencave për të hyrë në treg, por karakterizohet nga barriera të larta ekonomike, si për të hyrë ashtu edhe për të dalë nga tregu.

Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për këto arsye propozojmë t'i kërkon Komisionit autorizimin e këtij përqendrimi në përputhje me nenin 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të Viloil sh.a përmes transferimit të 70% të aksioneve të kapitalit themeltar, nga shoqëria “City Investment Holding S.A”, tek aksioneret z. Apostol Goçi dhe z. Albano Aliko.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

Nr.267 , Datë 05.02. 2013

“Mbi

autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Olympic Air S.A nga shoqëria Aegean Airlines S.A, nëpërmjet përfutimit të 100% të kapitalit aksionar të saj nga Marfin Investment Group S.A.”

Komisioni i Konkurrencës me perberjen e:

▪	Znj. Lindita	Milo (Lati)	Kryetar
▪	Znj. Rezana	Konomi	Zv. Kryetar
▪	Znj. Servete	Gruda	Anëtar
▪	Z. Koço	Broka	Anëtar
▪	Znj. Iva	Zajmi	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 05.02.2013, me pjesëmarrjen e Znj. Lindita Milo (Lati) kryetar, Znj. Rezana Konomi , zv. kryetar, Znj. Servete Gruda, anëtar, Znj. Iva Zajmi, anëtar; shqyrtoi çështjen me:

Objekt: “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Olympic Air S.A nga shoqëria Aegean Airlines S.A, nëpërmjet përfutimit të 100% të kapitalit aksionar të saj nga Marfin Investment Group S.A.”

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, dhe neni 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit “ dhe Formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit të Aegean Airlines me Olympic Air dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet nëpërmjet “Marrëveshjes paraprake për blerjen e aksioneve” e nënshkruar më datë 22 Tetor 2012, ndërmjet Aegean Airlines S.A në cilësinë e blerësit dhe aksionerit të vetëm Marfin Investment Group në cilësinë e shitësit me objekt 1005 të kapitalit aksionar të ndërmarrjes Olympic Air S.A.

Ndërmarrja target Olympic Air S.A do të zotërohet 100% nga Aegean Airlines S.A dhe do të jetë degë e kësaj të fundit dhe Marfin Investment Group i cili zotëron Olympic 100% nuk do të mbajë më asnjë aksion.

Përqendrimi i ka për qëllim të sjellë përfundimin e kontrollit të vetëm të drejtpërdrejtë nga Aegean Airlines S.A tek Olympic Air S.A në bazë të nenit 10 pika 1) shkronja b) e Ligjit. Ky operacion sjell ndryshimin e kontrollit mbi ndërmarrjen target Olympic Air S.A dhe për pasojë përbën një përqendrim i cili duhet autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës.

2. Palët në transaksion

- **Aegean Airlines S.A (në cilësinë e ndërmarrjes Blerëse)** është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit grek me seli në adresë: Kifisia Attikis, Biltaniëti 31, Athinë, Greqi. Shoqëria ofron shërbime të transportit ajror për pasagjerë si dhe shërbime të transportit kargo në destinacionet brenda Greqisë dhe në destinacione internacionale të afërta.

- **Marfin Investment Group (në cilësinë e aksionerit Shitës)** është një shoqëri anonime me seli ligjore në Kifisia Attikis, Thiseos nr. 67, Nea Eruthraia. Ajo është zotëuese e ligjshme e pjesës prej një milion e gashtëqind e dymbëdhjetë mijë e psëqind (1612500) aksioneve e vlerë nominale të çdo aksioni njëqind (100) Euro të shoqërisë Olympic Air. Shoqëria Marfin Investment Group është bërë aksionere e Olympic Air në kuadër të privatizimit të kësaj të fundit nga sheti grek, në vitin 2009, sipas ligjit 3759/2009.

- **Olympic Air S.A (në cilësinë e ndërmarrjes Target)** është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit grek me seli në adresë: Spata-Artemida, Attika, Aeroporti Ndërkombëtar i Athinës – ndërtesa 53A, Greqi. Shoqëria përbëhet nga tre entitete (i) Olympic Air, aktive që prej 1 Tetorit 2009 e cila pason privatizimin e shoqërisë Olympic Airlines; (ii) Olympic Handling, e cila ofron një rreze të gjerë të shërbimeve të asistencës nga toka në 39 aeroporte, si për Olympic Air edhe për palë të treta; dhe (iii) Olympic Engineering, e cila vepron në fushën e ofrimit të shërbimeve të mirëmbajtjes, riparimit dhe testimit të avionëve.

3. Xhiro për vitin 2011

Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është XXX leke, ku:

- Aegean Airlines S.A (XXX Eur = XXX lekë)
- Olympic Air S.A (XXX Euro = XXX lekë)

Xhiro totale në **tregun e brendshëm**: është XXX Lekë, ku:

-Olympic Air Albania Branch : = XXX leke

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1 të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

4. ANALIZA E KONKURRENCËS

A. Tregu përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- I) tregu i produktit, dhe
- II) tregu gjeografik.

Tregu i produktit

Në tregun përkatës të produktit shoqëritë Aegean Airlines S.A dhe Olympic Air S.A janë aktive kryesisht në këto fusha : a) shërbimi i transportit ajror të pasagjerëve, b)shërbimi i transportit ajror të postes dhe mallrave dhe c) shërbime të mbështetjes teknike dhe mirëmbajtjes së avionëve ne tokë, etj.

Shoqëria Aegean Airlines S.A nuk është prezente në Shqipëri. Shoqëria Olympic Air S.A është prezente në Shqipëri nëpërmjet degës së saj Olympic Air Albania Branch e cila ushtron veprimtarinë e saj në shërbimin e transportit ajror të pasagjerëve dhe transportit kargo(poste dhe mallra) në linjën Tiranë - Athinë.

Si treg **përkatës i produktit në Shqipëri konsiderohet shërbimi i transportit ajror të pasagjerëve dhe kargo në linjen Tiranë - Athinë.**

Tregu gjeografik:

Për vlerësimin e këtij transaksioni dhe efektet që do të sjellë në treg, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet **tregu i brendshëm**/territori i Republikës së Shqipërisë.

5. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Transaksioni i cili është realizuar nëpërmjet transferimit të 70% të aksioneve të përqëndrimi i njoftuar është një ndryshim kontrolli sipas parashikimeve të nenit 10, pika 1, gërma b të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe nuk pritet të sjellë ndryshime në strukturën e tregut përkatës pasi palët pjesëmarrëse veprojnë në tregje gjeografike të ndryshme.

Si konkluzion, përqëndrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe për këto arsye propozojmë t’i kërkon Komisionit autorizimin e këtij përqëndrimi në përputhje me nenin 56/1 të Ligjit nr 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin të realizuar nëpërmjet nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Olympic Air S.A nga shoqëria Aegean Airlines S.A, nëpërmjet përfutimit të 100% të kapitalit aksionar të saj nga Marfin Investment Group S.A..
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

V E N D I M

Nr. 268, Datë 08.02.2013

“Mbi

autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Delhaize Albania Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga Lion Retail Holding s.a.r.l dhe Delhaize Serbia d.o.o tek Balfin Sh.p.k”

Komisioni i Konkurrencës me perberjen e:

▪	Znj. Lindita	Milo (Lati)	Kryetar
▪	Znj. Rezana	Konomi	Zv. Kryetar
▪	Znj. Servete	Gruda	Anëtar
▪	Z. Koço	Broka	Anëtar
▪	Znj. Iva	Zajmi	Anëtar;

Në mbledhjen e tij të datës 08.02.2013, me pjesëmarrjen e Znj. Lindita Milo(Lati) Kryetare, Znj. Rezana Konomi, zv/kryetare, Znj. Servete Gruda, anetare, Znj. Iva Zajmi, anetare shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Delhaize Albania Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga Lion Retail Holding s.a.r.l dhe Delhaize Serbia d.o.o tek Balfin Sh.p.k

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, dhe neni 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit “ dhe Formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Balfin Sh.p.k me Delhaize Albania Sh.p.k dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet në bazë të ‘Memorandumit të mirëkuptimit’ dhe të ‘Marrëveshjes për blerje-shitjen e Delhaize Albania Sh.p.k’ të lidhura përkatësisht në datat 20 Dhjetor 2012 dhe 3 Janar 2013, ndërmjet palëve “Balfin Sh.p.k” në cilësinë e blerësit dhe “Lion Retail Holding s.a.r.l” dhe “Delhaize Serbia d.o.o” në cilësinë e aksionerëve shitës të shoqërisë *target* me qëllim përfitim të kontrollit të shoqërisë Delhaize Albania Sh.p.k nga shoqëria Balfin Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave.

Ky transaksion i cili ndryshon cilësinë e kontrollit në ndërmarrjen *target* (Delhaize Albania Sh.p.k) në formën e transferimit të kuotave nga shitësit të blerësi dhe përbën një përqendrim në bazë të nenit 10 pika 1), shkronja b) e Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar. Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përse i përket xhirove (neni 12/1).

2. Palët në transaksion

❖ **Balfin Sh.p.k**, në cilësinë e **blerësit**, me seli në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II, ABA Business Centre, kati 12, Tiranë. Shoqëria kryen aktivitet në fushën e (i) import- eksportit, shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve tekstile, veshjeve të të gjitha llojeve; (ii) shitjen me shumicë dhe pakicë të mallrave industriale dhe ushqimorë, etj.

❖ **Lion Retail Holding s.a.r.l**, në cilësinë e **shitësit**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit të Luxenburgut, me seli në adresën: d’Olm 51, L-8281 Khelen Grand Duchy, Luxenburg, e regjistruar ne Rregjistrin Tregtar të Dhomës së Tregtisë me numër B 159.001. Shoqëria merret me administrimin e shoqërive të Grupit Delhaize.

❖ **Delhaize Serbia d.o.o**, në cilësinë e **shitësit**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar dhe që funksionon sipas legjislacionit Serb me seli në Juria Gagarina 14, Beograd, Serbi. Veprimtaria e shoqërisë konsiston në shitjen më pakicë në dyqane të paspecializuara të cilat ofrojnë produkte të kategorive të ndryshme kryesisht ushqimi, pije dhe duhan

❖ **Delhaize Albania Sh.p.k**, në cilësinë e ndërmarrjes **target** është një shoqëri e themeluar dhe funksionon sipas legjislacionit shqiptar, me seli në Kashar, Tiranë. Objekti i kësaj shoqërie ishte importi eksporti; tregtimi i artikujve të ndryshëm (kryesisht

ushqime, pije, duhan), servis paisjesh elektronike dhe elektroshtëpiake, automjetesh etj; transport të mallrave dhe udhëtarëve urbanë, ndërurbanë dhe ndërkombëtarë.

3. Xhiro për vitin 2011

- Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është XXX Lekë, ku:
 - Delhaize Group: 21 119 000 000 Euro = XXX lekë
 - Balfin sh.p.k.së bashku me shoqëritë e lidhura: XXXX lekë
- Xhiro totale në tregun e brendshëm: është XXXXLekë, ku:
 - Balfin së bashku me shoqëritë e lidhura: XXXX leke(Balfin sh.p.k. si shoqëri e vetme: = XXXX lekë)
 - Delhaize Albania sh.p.k. XXXX leke

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1 të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

3. ANALIZA E KONKURRENCËS

A. Tregu përkatës

Tregu i produktit

Tregu përkatës i produktit do të përkufizohet si tregu i shitjes me pakicë i produkteve ushqimore dhe mallrave të konsumit që kanë qëllim furnizimin ditor dhe të rastit të familjeve nëpërmjet formateve të dyqaneve të paspecializuara si dyqanet në afërsi të lagjes (convenience stores), supermarketeve dhe hipermarketeve.

Tregu gjeografik:

Për analizimin e këtij rasti *treg gjeografik* konsiderohet **tregu i brendshëm**, pra territori i Republikës së Shqipërisë.

Palët pjesëmarrëse në transaksion veprojnë në tregje të ndryshëm produktesh, çka do të thotë se nuk kemi një mbivendosje të veprimtarisë së tyre apo tregje të prekura nga ky transaksion, pasi Balfin sh.p.k. nuk është prezent në këtë treg.

B. Tendenca e tregut

Tregu i shitjes me pakicë në Shqipëri konsiderohet si një treg i vogël, por me tendencë pozitive zhvillimi. Referuar indeksit GRDI, Shqipëria renditet në vendin e 13-të, si një treg ende i pangopur përse i përket rrjetit të supermarketeve/hipermarketeve apo formave të tjera të shitjes me pakicë në format modern.

Tregu i shitjes me pakicë i ushqimeve dhe mallrave të konsumit është i formuar kryesisht nga dyqane të mesëm e të vegjël dhe të pavarur nga njëri tjetri, duke patur kështu

karakteristikat e një tregu kryesisht tradicional. Ndërkohë, tregtia me pakicë në format modern (supermarkete, hipermarkete etj) ka marrë zhvillim vetëm gjatë viteve të fundit. Për shkak të strukturës që ka tregu i shitjes me pakicë në Shqipëri (numrit të madh të dyqaneve të vogla dhe të mesme dhe pavarësisë nga njëri tjetri), por edhe të përqindjes së tregut që zotërojnë pjesëmarrësit në të, mundësitë e tyre për të rritur çmimet në mënyrë të njëanshme janë të limituara. Gjithashtu, për të njëjtat arsye, krijimi apo zhvillimi i praktikave të përbashkëta veçanërisht për fiksimin e çmimit nga pjesëmarrësit në treg do të ishte i pamundur.

Sa i përket formës së organizimit në tregun gjeografik, Delhaize Grup është i pranishëm në tregun shqiptar nëpërmjet aktiviteteve të shoqërisë në zotërim të saj Delhaize Albania sh.p.k.

Delhaize Albania shpk kryen aktivitet nëpërmjet 18 dyqaneve me sipërfaqe nga 170–6000 m² ku tregtohen me pakicë rreth 16000 lloje produktesh. Dyqanet janë të shpërndarë në zonën gjeografike në Tirane, Durrës, Fier, Vlorë dhe Elbasan. Aktiviteti mbizotërues është tregtia me pakicë e produkteve ushqimore dhe mallrave të konsumit (kryesisht ushqime, pije, duhan, veshje, produkte kozmetike etj) .

Delhaize Albania sh.p.k ashtu si edhe i gjithë rrjeti i grupit Delhaize, konsiston kryesisht në keto formate të shitjes me pakicë, duke filluar nga dyqanet në afërsi/ dyqanet e lagjes, supermarketeve dhe hipermarketeve .

Shoqëria Balfin sh.p.k. nuk operon në aktivitetin e tregtisë me pakicë të produkteve ushqimore dhe mallrave të konsumit që kanë qëllim furnizimin ditor dhe të rastit të familjeve nëpërmjet formateve të dyqaneve të pa-specializuara si dyqanet në afërsi të lagjes (convenience stores), supermarketeve dhe hipermarketeve.

4. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Tregu i shitjes me pakicë i ushqimeve dhe mallrave të konsumit është i formuar kryesisht nga dyqane të mesëm e të vegjël dhe të pavarur nga njëri tjetri, duke patur kështu karakteristikat e një tregu kryesisht tradicional. Tregtia me pakicë në format modern përfaqëson vetëm 9% të tregut me pakicë dhe është kryesisht prezente nëpërmjet formatit të supermarketeve dhe dyqaneve të vogla në afërsi.

Tregu i shitjes me pakicë në Shqipëri konsiderohet si një treg i vogël por me tendencë pozitive zhvillimi. Ai gjithashtu është një treg ende i pangopur përse i përket rrjetit të supermarketeve/hipermarketeve apo formave të tjera të shitjes me pakicë në format modern. Nëpërmjet përfutimit të kontrollit të drejtëpërdrejtë të Delhaize Albania shpk nga shoqëria Balfin sh.p.k., kjo e fundit synon të shtojë gamën e aktiviteteve tregtare në portofolin e tij. Përqendrimi nuk sjell asnjë ndryshim në pjesën e tregut që zë aktualisht shoqëria Delhaize Albania sh.p.k pasi përfituesi i kontrollit nuk është prezent në tregun shqiptar të produktit para përqendrimit dhe për pasojë nuk ndryshon struktura e tregut pas përqendrimit.

Si konkluzion, përqëndrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqëndrimin të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Delhaize Albania Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga Lion Retail Holding s.a.r.l dhe Delhaize Serbia d.o.o tek Balfin Sh.p.k
2. Ngarkohet Sekretari i përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 269, Datë 18.02.2013

**“Për
disa rekomandime ndaj Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare
në tregun e policës së sigurimit kufitar”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

▪	Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪	Rezana	KONOMI	Zv/Kryetar
▪	Servete	GRUDA	Anëtar
▪	Koço	BROKA	Anëtar
▪	Iva	ZAJMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.02.2013, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit të monitorimit në tregun e sigurimeve.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 70, pika 2.

Ligji Nr. 8485 datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të monitorimit në tregun e sigurimeve, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës;
- Relacionit e Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës

VËREN SE:

1. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) me shkresën nr.3411 prot të datës 21.12.2012 ka njoftuar Autoritetin e Konkurrencës për draft-rregulloren e Byrosë Shqiptare të Sigurimeve “Mbi administrimin dhe trajtimin e dëmeve që rrjedhin nga lëshimi i policës kufitare nga B.Sh.S” së bashku me kopjen e policës kufitare.
2. Gjatë monitorimit të tregut nga ana e Autoritetit të Konkurrencës më datë 29.01.2013 u konstatua se “Polica e sigurimit kufitar” ishte e njëjtë tek të gjithë agjentët dhe në të ishte e vendosur logoja e BSHS-së bashkë me logot e të gjitha shoqërive të sigurimit, që ushtrojnë veprimtari në këtë treg.
3. Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 5 të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, pas vlerësimit të marrëveshjes së njoftuar nga shoqëritë e sigurimit, me vendimin nr. 225, datë 28.05.2012, ka vendosur të përjashtojë nga ndalimi marrëveshjen e bashkëpunimit për shkëmbimin e informacionit mbi ofrimin e shërbimit të Policës Kufitare të sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta.
4. Në asnjë dispozitë të marrëveshjes së njoftuar nga ndërmarrjet e sigurimit dhe përjashtuar prej Komisionit të Konkurrencës, me anë të vendimit nr. 225, datë 28.05.2012, nuk parashikohet *dalja në treg nën një logo të përbashkët me emrat e të gjitha kompanive*, si dhe nuk parashikohet *shkëmbimi i informacionit për primet e shitjes në treg*, por referuar edhe kushteve dhe detyrimeve lejohet vetëm shkëmbimi i informacionit për numrin e aplikimeve për përfitime nga dëmet, si edhe shkëmbimin e informacionit statistikor që zotërojnë palët për përgatitjen e pasqyrave të primit të rrezikut.
5. AMF-ja me vendimin e Bordit nr. 86, datë 22.06.2012, ka miratuar kushtet e përgjithshme të kontratës së sigurimit kufitar të përgjegjësisë së mbajtësve të mjeteve motorike, si dhe ka dhënë pëlqimin për fillimin e procedurave për emetimin dhe prodhimin e policës së sigurimit, duke shtuar sqarime me qëllim mbrojtjen e konsumatorit.
6. Sa më sipër rezulton se rregullatori AMF, në bazë të nenit 14, pika 8, të Ligjit të tij organik, ka miratuar, sipas kërkesës së Byrosë Shqiptare të Sigurimit, kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të Policës së Sigurimit Kufitar. Kjo formë e Kontratës së Sigurimit Kufitar nuk lidhet me kriteret e vendosura në vendimin për përjashtim Nr. 225, datë 28.05.2012 të Komisionit të Konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, geramat d) dhe f), nenin 70, pika 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

1. T’i rekomandojë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Byrosë Shqiptare të Sigurimeve dhe të gjitha ndërmarrjeve të sigurimit:

- **Rishikimin, brenda afatit 1 muor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të kushteve të veçanta të Policës së Sigurimit Kufitar në mënyrë që shoqëritë e sigurimeve ta tregtojnë produktin “Policë kufitare” me emrin e secilës prej tyre, në mënyrë individuale.**

2. Para miratimit të kushteve, të përgjithshme dhe të veçanta, të kontratës së sigurimit, që shoqëritë e sigurimit do të hedhin në treg, Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare dhe Byroja Shqiptare e Sigurimeve duhet të sigurojnë që sjellja e shoqërive të sigurimit në treg të jetë në mënyrë individuale në përcaktimin dhe aplikimin e çmimit të shitjes së produktit policë kufitare për sigurimin e përgjegjësisive ndaj palëve të treta.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS**Servete GRUDA****Koço BROKA****Iva ZAJMI****Rezana KONOMI**

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar**Lindita MILO (LATI)**

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr.270, Datë 20.02.2013

Për miratimin e Raportit Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2012 dhe synimet kryesore për vitin 2013”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

▪	Znj. Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪	Znj. Rezana	KONOMI	Zv/Kryetar
▪	Znj. Servete	GRUDA	Anëtar
▪	Z. Koço	BROKA	Anëtar
▪	Znj. Iva	ZAJMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.02.2013, shqyrtoi materialin e paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm, të titulluar “Raporti vjetor 2012 dhe synimet kryesore për vitin 2013”. Bazuar në nenet 24, gërma e, dhe 29, gërma ç, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar), pas shqyrtimit të projekt-raportit të paraqitur nga Sekretari i Përgjithshëm,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Raportin Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2012 dhe synimet kryesore për vitin 2013” sipas raportit bashkëlidhur këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Rezana KONOMI
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 271, Datë 26.02.2013

“Mbi

autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Japan Tobacco International Netherlands B.V të shoqërisë Nefftekx World II B.V nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga Batata S.A”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

▪	Znj. Lindita	Milo (Lati)	Kryetar
▪	Znj. Rezana	Konomi	Zv. Kryetar
▪	Znj. Servete	Gruda	Anëtar
▪	Z. Koço	Broka	Anëtar
▪	Znj. Iva	Zajmi	Anëtar;

Në mbledhjen e tij të datës 26.02.2013, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Japan Tobacco International Netherlands B.V të shoqërisë Nefftekx World II B.V nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga Batata S.A

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, dhe në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit “ dhe Formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Japan Tobacco International Netherlands B.V dhe Nefftekx World II B.V dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet në bazë të “Marrëveshjes për shitje aksionesh” e lidhur më datë 15 nëntor 2012, ndërmjet palëve JT International Holding B.V (blerësi), Batata S.A (në cilësinë e aksionerit shitës) dhe Z. Adel Ahmed Saleh El Ibiary, Z. Shrif Ahmed Saleh El Ibiary, Z. Emad El Din Ahmed Saleh El Ibiary dhe Z. Saleh Ahmed Salh El Ibiary (në cilësinë e Garantuesve) me qëllim përfundim të kontrollit të Nefftekx Wolrd II B.V dhe shoqërive të saj bija (shoqëritë target) nga JT International Holding B.V.

Ky transaksion i cili ndryshon cilësinë e kontrollit në ndërmarrjet target në formën e zëvendësimit të pronësisë dhe transferimit të kuotave nga shitësit te blerësi dhe përbën një përqendrim në bazë të nenit 10 pika 1), shkronja b) e Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar. Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit për sa i përket xhirove (neni 12/1).

2. Palët në transaksion

- **Jappan Tobacco International Holding B.V (JTI Holding B.V)**, në cilësinë e **blerësit**, me seli në Hollandë, kryen aktivitet në fushën e prodhimit dhe shitjes së cigareve të prodhuara nëpërmjet makinerive (FMC), gjithashtu edhe në prodhimin dhe shitjen e produkteve të tjera të duhanit përfshirë RYO/MYO, duhanin që thithet me hundë, purot dhe purot e holla.
- **Batata S.A**, në cilësinë e **shitësit**, është një shoqëri që është themeluar në qershor 2012 dhe që funksionon në bazë të legjislacionit të Luksemburgut.
- **Nefftekx World II B.V** në cilësinë e **shoqërisë target**, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit Hollandez, me seli në Amsterdam, Hollandë. Veprimtaria ekonomike e shoqërisë kryhet nga filialet e saj Al Naklah Tobacco S.A.E dhe Al Naklah Tobacco Free Zone S.A.E (së bashku Al Nakhla, në cilësinë e **shoqërive target**).

3. Xhiro për vitin 2011

- Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është XXX miliard Lekë:
 - **Japan Tobacco Group:**
2 034 miliard JPY = XXX miliard Euro= XXX miliard Lekë
 - **Nefftekx World II BV:**
XXX EGP = XXX miliard Lekë
- Xhiro totale në **tregun e brendshëm**: është XXX miliard Lekë:
 - **JT International Tirana** : XXX miliard Lekë

Për sa më lart plotësohen kriteret e xhiros në tregun ndërkombëtar dhe në tregun e brendshëm sipas parashikimeve të nenit 12 të Ligjit.

4. ANALIZA E KONKURRENCËS

A. Tregu përkatës i produktit

Referuar rasteve të ngjashme trajtuara nga AK si dhe KE, industria e duhanit ndahet në nivelet e mëposhtme rritja dhe kujdesi, përpunimi, *prodhimi, dhe shpërndarja*. Shpërndarja e produkteve të duhanit tek konsumatori final duke përdorur kanalet e tregtimit që mbizotërojnë në çdo shtet (psh shitësit me shumicë, distributorët, shitësit me pakicë, kioska, makina shitëse).

Në tregun e brendshëm treg përkatës do të konsiderohet vetëm segmenti i shpërndarjes me shumicë dhe pakicë të produkteve të duhanit.

B. Tregu gjeografik:

Tregu përkatës gjeografik për shitjen e produkteve FMC dhe RYO/MYO është tregu gjeografik i Republikës së Shqipërisë.

5. Tregu i produkteve të duhanit dhe efektet e përqendrimit të realizuar

a) Cigaret e fabrikuara (FMC)

Konkurrentët kryesorë në këtë treg janë subjektet Philip Morris Albania Shpk (PM) me 31% të tregut, AGNA Group me 27.7% të tregut, JTI Tirana me 15% të tregut dhe British American Tobacco Albania (BAT) me 9.1%.

Për sa i takon këtij tregu, në nivel horizontal, ky transaksion nuk sjell mbivendosje të aktivitetit të palëve apo tregje të prekura pasi Al Nakhla nuk është e pranishme në tregun e brendshëm në tregtimin e cigareve të fabrikuara. Si rrjedhojë, ky transaksion nuk shkakton asnjë efekt apo shqetësim në lidhje me konkurrencën në këtë treg. Pas realizimit të këtij përqendrimi, pjesa e tregut e JTI Tirana në tregun e produkteve FMC nuk ndryshon, si rrjedhojë as pozicioni apo fuqia e saj ekonomike. JTI Tirana sërish do të vazhdojë të hasë konkurrentë të fortë në treg si Philip Morris apo AGNA Group.

b) Duhani rrotulloje vetë (RYO/MYO)

Konkurrentët kryesorë në këtë treg janë subjektet Igla sh.p.k. me 55% të tregut, AGNA Group me 17% të tregut dhe Vizion Lazarat me 15%. Në nivel ndërkombëtar, vetëm JTI është aktive në prodhimin dhe tregtimin e duhanit RYO/MYO. Për sa i takon tregut të brendshëm vetëm JTI është bërë prezent me produktet e saj në këtë treg pas realizimit të përfutimit të kontrolli J T I Holding B.V / V.D.M Invest COMM. VA .

6. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Blerja e Al Nakhla është një mundësi për JTI për të zgjeruar prezencën e saj në tregun në rritje të duhanit “shisha” në mbarë botën. JTI do të investojë në një biznes inovativ

të Al Nakhlas. JTI do të vijojë të ndërtojë një portofol të fort markash mbi disa kategori produktesh të duhanit.

Nga transaksioni nuk do të rezultojnë efekte negative për konkurrencën, konkurrentët ose konsumatorët në Shqipëri. Al Nakhla nuk shet as nuk prodhon produkte në Shqipëri dhe nuk ka gjeneruar xhiro në Shqipëri. Për këtë arsye nuk ka mbivendosje horizontale në aktivitetin e Palëve. Veç kësaj nuk ka as marrëdhënie vertikale midis palëve në Shqipëri. Në këtë aspekt Transaksioni nuk do të ndikojë në pjesën e tregut në Shqipëri dhe nuk do të ndikojë mbi konkurrencën në tregun e duhanit, ose ndonjë treg tjetër.

Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Japan Tobacco International Netherlands B.V të shoqërisë Nefftekkx World II B.V nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga Batata S.A
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Rezana KONOMI
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 272 , Datë 26.02.2013

“Mbi

autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëritë Bregal Fund III LP dhe Quadriga Capital Private Equity Fund IV LP të shoqërisë LR Global Holding GmbH”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

▪	Znj. Lindita	Milo (Lati)	Kryetar
▪	Znj. Rezana	Konomi	Zv. Kryetar
▪	Znj. Servete	Gruda	Anëtar
▪	Z. Koço	Broka	Anëtar
▪	Znj. Iva	Zajmi	Anëtar;

Në mbledhjen e tij të datës 26.02.2013, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëritë Bregal Fund III LP dhe Quadriga Capital Private Equity Fund IV LP të shoqërisë LR Global Holding GmbH.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, dhe në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit “ dhe Formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Bregal Fund III LP - Quadriga Capital Private Equity Fund IV LP dhe LR Global Holding GmbH dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet në bazë të “Marrëveshjes për shitje aksionesh” e lidhur më datë 22 dhjetor 2012, ndërmjet Alocos Beteiligungsgesellschaft GmbH (në cilësinë e Blerësit) dhe LR Global Holding GmbH dhe Alov S.a.r.l (në cilësinë e shitësit), me qëllim përfitim të kontrollit nga Bregal Fund III LP dhe Quadriga Capital Private Equity Fund IV LP të të gjithë kapitalit aksionar në LR Global Holding GmbH.

Ky transaksion i cili ndryshon cilësinë e kontrollit në ndërmarrjet target në formën e zëvendësimit të pronësisë dhe transferimit të aksioneve nga shitësi te blerësi, përbën një përqendrim në bazë të nenit 10 pika 1), shkronja b) e Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar. Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit për sa i përket xhirove (neni 12/1).

2. Palët në transaksion

- **Bregal Fund III L.P (“Bregal Fund”)**, në cilësinë e **blerësit**, është një shoqëri që është themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit të Jersey-t (Mbretërisë së Bashkuar). Shoqëria është një shoqëri menaxhuese investimesh e cila administron disa nga fondet e investimit Bregal
- **Quadriga Capital Private Equity Fund IV LP (“Quadriga”)**, në cilësinë e **blerësit** është një shoqëri që është themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit të Jersey-t (Mbretërisë së Bashkuar). Shoqëria është një fond privat kapitalesh i cili është në pronësi të The Chariot Charitable Trust, ky i fundit është një kartel i themeluar sipas ligjeve të Islandës dhe Jersey-t.
- **Aloco Beteiligungsgesellschaft GmbH (“Aloco GmbH”)** në cilësinë e **blerësit** është një shoqëri që është themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit Gjerman. Aloco GmbH është një instrument investimi i krijuar posaçërisht dhe zotërohet nga shoqëria Aloco Holding (Luksemburg).
- **Alov S.a.r.l**, në cilësinë e **shitësit**, është një shoqëri që funksionon në bazë të legjislacionit të Luksemburg-ut.
- **LR Global Holding GmbH (“LR”)**, në cilësinë e **shoqërisë target** është një shoqëri që është themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit Gjerman. Shoqëria është shoqëria holding e Grupit LR. LR është një shoqëri shëndeti dhe bukurie e fokusuar në furnizimin dhe shpërndarjen si dhe prodhimin e aditivëve, kozmetikës, bizhuterive dhe aksesoreve.

3. Xhiro për vitin 2011

- Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është XXXX **Lekë**, ku:
 - LR Global Holding GmbH : 230 674 016 Euro = XXXX lekë
 - Bregal Fund III : 12 218 500 000 Euro = XXXX lekë

- Quadriga : 1 770 000 000 Euro = XXXX lekë

- Xhiro totale në **tregun e brendshëm**: është XXXX **lekë**, ku:
- LR Health and Beauty Systems sh.p.k : XXXX Euro= XXXX lekë

Për sa më lart plotësohen kriteret e xhiros në tregun ndërkombëtar dhe në tregun e brendshëm sipas parashikimeve të nenit 12 të Ligjit.

4. ANALIZA E KONKURRENCËS

4.1 Tregu përkatës

LR është aktive vetëm në shitjen e drejtpërdrejtë me anë të një marketingu shumë-nivelesh. Kozmetika dhe aditivët bëjnë respektivisht rreth 49% dhe 41% të aktivitetit të LR, ndërkohë që bizhuteritë dhe aksesorët kontribuojnë me rreth 6%. Produktet e stampuara për qëllime marketingu përbëjnë pjesën tjetër të mbetur prej 4% të aktivitetit të LR.

4.1.1. Tregu përkatës i produktit:

Transaksioni i propozuar ka të bëjë me një numër tregjesh potenciale të produktit siç karakterizohet më poshtë. Duke iu referuar praktikës së Komisionit European për rastet e ngjashme do të përshkruhen tregjet potenciale të produktit si më poshtë. Meqë përqendrimi nuk sjell shqetësime për konkurrencën, pasi aktivitetet e palëve nuk mbivendosen as në Shqipëri apo në ndonjë vend tjetër në botë, tregjet përkatëse mund të lihen të papërcaktuara. Tregjet kryesore ku e ushtron aktivitetin veprimtarinë shoqëria objekt e përqendrimit janë suplementet ushqyese, kozmetika, bizhuteritë dhe aksesorët dhe produktet e stampuara.

4.1.2 Tregu përkatës gjeografik:

Për vlerësimin e këtij përqendrimi, tregu përkatës gjeografik është në të gjithë territorin gjeografik të Republikës së Shqipërisë.

4. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Transaksioni i realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët mbi ndërmarrjen LR nga Begal Fund III dhe Quadriga Capital Fund IV është një ndryshim kontrolli sipas parashikimeve të nenit 10 pika 1) shkronja b) të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, që nuk sjell ndryshime në strukturën e tregut në aspektin e përqendrimit të tregut dhe presionit konkurrues.

Ndërmarrjet përfituese të kontrollit para realizimit të këtij përqendrimi nuk kanë qenë aktive në asnjë nga tregjet e produktit në të cilat LR është aktive dhe për pasojë përqendrimi nuk sjell asnjë ndryshim në pjesën e tregut që zë aktualisht ndërmarrja LR.

Nëpërmjet përfutimit të përbashkët të kontrollit mbi LR nga Begal Fund III dhe Quadriga Capital Fund IV, këto të fundit synojnë të realizojnë një investim financiar.

Përqendrimi nuk sjell asnjë ndryshim në pjesën e tregut që zë aktualisht shoqëria LR Health&Beauty Systems Sh.p.k, pasi përfituesit e përbashkët të kontrollit nuk janë prezent në tregun shqiptar të produktit para përqendrimit dhe për pasojë nuk ndryshon struktura e tregut pas përqendrimit.

Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëritë Bregal Fund III LP dhe Quadriga Capital Private Equity Fund IV LP të shoqërisë LR Global Holding GmbH
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 273, Datë 18/03/2013

Për

**një ndryshim në vendimin nr. 262, datë 14.01.2013 “Për hapjen e
procedurës së hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të transportit
rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

▪	Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪	Rezana	KONOMI	Zv/Kryetar
▪	Servete	GRUDA	Anëtar
▪	Koço	BROKA	Anëtar
▪	Iva	ZAJMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.03.2013, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me procedurën e hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës.

Baza ligjore: - Neni 24, shkronja d); neni 43, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar);

- Ligji Nr. 8485, datë 11.11.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Pasi mori në shqyrtim relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me procedurën e hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 262, datë 14.01.2013 ka hapur procedurën e hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës, për periudhën 1 Janar 2007 – 31 Dhjetor 2012.
2. Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, ngriti Grupin e Punës përgjegjës për ndjekjen procedurave të këtij hetimi.
3. Për realizimin e kësaj procedure nga Grupi i Punës është kërkuar informacion nga Bashkia e Tiranës, si dhe nga ndërmarrjet nën hetim “Ferlut” SHA, “Alba Trans” SHPK, “Tirana Urban Trans” SHA, “Tirana Lines” SHPK, “Parku i Transportit të Udhëtarëve” SHA dhe “OTTO AL”. Ky informacion nuk ka ardhur akoma në mënyrë të plotë pranë Autoritetit të Konkurrencës.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se sigurimi i një informacioni të plotë dhe të detajuar, për të parë më mirë sjelljen e ndërmarrjeve në treg është i nevojshëm për të siguruar një vendimarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 43, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, si dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11.11.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”,

VENDOSI:

1. Në Vendimin Nr. 262, datë 14.01.2013 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”, pika “III”, të ndryshohet si vijon:
“III. Procedurat e hetimit të thelluar dhe dorëzimi i raportit duhet të bëhen jo më vonë se data 15 Prill 2013.”
2. Ngrakohet Sekretaria e Përgjithëshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Rezana KONOMI
_____	_____	_____	_____
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 274, Datë 18 /03/2013

“Për

**hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit
të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Gjirokastrës
dhe Qytetin e Sarandës”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

▪	Lindita	MILO (LATI)	Kryetare
▪	Rezana	KONOMI	zv/Kryetare
▪	Servete	GRUDA	Anëtare
▪	Koço	BROKA	Anëtare
▪	Iva	ZAJMI	Anëtare

Në mbledhjen e tij të datës 18.03.2013, trajtoi çështjen me:

Objekt: Mbi shqyrtimin e propozimit për hapjen e hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Gjirokastrës dhe Qytetin e Sarandës .

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

❖ Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi shqetësimet për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Gjirokastrës dhe Qytetin e Sarandës,

VËREN SE:

Pranë Autoritetit të Konkurrencës janë paraqitur shqetësime mbi kufizimin e mundshëm të konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Gjirokastrës dhe Qytetin e Sarandës pasi disa firma janë duke bashkëpunuar gjatë pjesëmarrjes në prokurimet publike si dhe duke mbuluar njëra-tjetrën me paraqitjen e ofertave në masën 99% të Fondit Limit, duke u bërë në këtë mënyrë pengesë për hyrjen e operatorëve të tjerë në këtë treg.

Sipas shqetësimeve të hasura në këtë treg, mënyra kryesore e bashkëpunimit mes konkurrentëve që mund të ketë sjellë kufizime të konkurrencës në treg lidhet me disa shenja të bashkëpunimit si përgatitja e ofertave nga punonjës të përbashkët të cilët punojnë ngushtësisht me njëri-tjetrin; përdorimi i skemës së ofertës së mbuluar; ndarja e tregut (klientëve në këtë rast autoritetet kontraktore) etj.

Ky bashkëpunim pretendohet se ka ndodhur në rastin e procedurave të prokurimit të zhvilluara nga disa autoritete kontraktore.

Bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg; si dhe në Udhëzimin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, këto shenja tregojnë për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet marrëveshjeve në oferta midis operatorëve në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Gjirokastrës dhe Qytetin e Sarandës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

- I.** Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në Qarkun e Gjirokastrës dhe Qytetin e Sarandës për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.
- II.** Periudha e Hetimit do të jetë nga Janari deri në Dhjetor 2012.

- III.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 25.05.2013.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 275, Datë 25.03.2013

**“Për
hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone
Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | | |
|---|---------|-------------|------------|
| ▪ | Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| ▪ | Rezana | KONOMI | Zv/Kryetar |
| ▪ | Servete | GRUDA | Anëtar |
| ▪ | Koço | BROKA | Anëtar |
| ▪ | Iva | ZAIMI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 18.03.2013, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e raportit të hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë me parapagesë.

Baza ligjore: Nenet 24, (shkronja d); 26 dhe 43, (pika 1) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit paraprak “Në tregun e telefonisë celulare me pakicë me parapagesë”, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës për këtë qëllim Nr. 39/1 Prot., datë 11.03.2013.

VËREN SE:

I. PROCEDURA E NDJEKUR

1. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit Nr. 261, datë 11.01.2013 të Komisionit të Konkurrencës, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë”, vendosi hapjen e hetimit për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës.

2. Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, në bazë të nenit 28 dhe 29 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, nenit 22 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës, si dhe Vendimit Nr. 261, datë 11.01.2013 të Komisionit të Konkurrencës, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë”, me anë të Urdhrit Nr. 6, datë 17.01.2013 “Për ngritjen e grupit të punës për hetimin paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë”, ngriti grupin e punës (GP) përkatës për ndjekjen procedurave të këtij hetimi.

3. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Grupi i Punës ka kërkuar të dhëna dhe informacion nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), si dhe nga ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në këtë treg, përkatësisht: AMC, VODAFONE, EAGLE dhe PLUS, nga të cilat janë administruar edhe përgjigjet përkatëse të depozituara.

4. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 65, datë 04.02.2013 “Autorizim Inspektorësh”, Grupi i Punës gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjeve që veprojnë në treg, duke marrë shpjegime për fakte dhe dokumente që lidhen me objektin dhe qëllimin e hetimit nga përfaqësuesit e ndërmarrjeve, si më poshtë: nga data 06.02.2013 - 13.02.2013, ku u mbajtën dhe proces-verbalet përkatëse.

II. TREGU PËRKATËS

II.1. Tregu përkatës i produktit

5. Tregu përkatës i produktit përfshin të gjitha shërbimet e telefonisë celulare të ofruar nga kompanitë celulare në tregun e shitjes me pakicë me parapagesë, që përfshin të

gjitha shërbimet e telefonisë celulare me pakicë me parapagesë (si thirrjet dalëse, sms, mms, internetin).

II.2 Tregu përkatës gjeografik

6. Zona gjeografike i shërbimit të telefonisë së lëvizshme të kompanive celulare me pakicë është territori i Republikës së Shqipërisë. Në bazë të licencave individuale, me të cilat operatorët operojnë, ato ofrojnë shërbimet e tyre, vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

III. VLERËSIMI I POZITËS DOMINUESE NË TREGUN PËRKATËS

7. Kriteret kryesore të vlerësimit të pozitës dominuese të një ose më shumë ndërmarrjeve, bazuar në nenin 8 të Ligjit janë: pjesët e tregut përkatës, pengesat në hyrje në tregun përkatës, konkurrenca potenciale, fuqia ekonomike dhe financiare, varësinë ekonomike të furnizuesve të blerësve, fuqinë kundërvepruese të blerësve; zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes etj., si dhe karakteristika të tjera të tregut përkatës.

III.1 Pjesët e tregut përkatës të konkurrentëve

8. Një nga kriteret kryesore, që përcaktojnë pozitën dominuese në treg është pjesa e tregut që zënë ndërmarrjet në tregun përkatës. Përvoja e vendeve të Bashkimit Europian (BE) udhëzon që pozita dominuese nuk është e mundur nëse pjesa e tregut përkatës të ndërmarrjes është më e vogël se 40%.

9. Referuar ndarjes në tërësi e tregut për periudhën Janar-Nëntor 2012 (thirrje dalëse, SMS të ardhura totale, dhe nr pajtimtarësh), ndërmarrja me pjese tregu me të larte për nga numri i pajtimtarëve, të ardhurave nga thirrjeve dalëse dhe SMS është Vodafone Albania. Pozita në treg e tre konkurrentëve aktual të marrë së bashku është më e vogël se konkurrenti Vodafone (për nga të ardhurat). Operatori AMC ka zvogeluar pjesën e tregut në të gjithë treguesit në krahasim me vitin 2011, ndërsa dy operatorët e vegjel (Eagle Mobile dhe Plus Communication) zënë një pjesë shumë të vogël të tregut përkatës.

10. Nga vlerësimi i kriterit të ndarjes së tregut përkatës në tërësi (të ardhurat dhe pajtimtarët) rezulton se, Vodafone Albania zotëron për periudhën Janar-Nëntor 2012 44% të pjesës së tregut për nga numri i pajtimtarëve, duke e rritur këtë pjesë me rreth 4%, (krahasuar me vitin 2011), ka pjesën kryesore të tregut për nga kriteri i të ardhurave rreth 54% ose më shumë se tre operatorët e marrë së bashku. Vodafone Albania për periudhën Janar-Nëntor 2012 ka rritur pjesën e tregut për nga kriteri i të ardhurave me 2.81%.

11. Konkurrenti më i afërt i Vodafone është AMC me 39.16% të tregut për nga numri i pajtimtarëve i cili është ulur me 2.15%; zotëron 36.14% të pjesës së tregut për nga kriteri i të ardhurave, i cili është ulur me 2.14% për periudhën Janar-Nëntor 2012, krahasuar me Vitin 2011. Dy konkurrentët e tjerë zënë në tregun perkates rreth 9% sipas të ardhurave dhe 17% sipas numrit pajtimtarëve.

III.2 Vlerësimi i fuqisë së tregut

12. Nga të dhënat vihet re një vlerë shumë e lartë e indeksit HHI¹, ku sipas të ardhurave të gjeneruara në tregun përkatës është 4375 dhe për numrin përdoruesve është 3656. Operatori Vodafone e rrit ndjeshëm shkallën e përqendrimit sipas treguesit të të ardhurave, si dhe tejkalon vetë ky operator shkallën e lartë të përqendrimit duke shkuar në 3010. Në këtë shkallë përqendrimi nuk ndjehet shume fuqia e dy operatorëve me te rinj: Eagle Mobile dhe Plus Communication.

III.3 Pengesat në hyrjen në treg

13. Tregu i telefonisë së lëvizshme në Shqipëri është i rregulluar nga AKEP. Pengesat në hyrje janë faktorë të cilët i pengojnë operatorët e rinj të hyjnë në një treg të caktuar. Këto mund të jenë administrative, teknike dhe ekonomike.

III.3.1 Barrierat administrative dhe teknike

14. Në Republikën e Shqipërisë numri i licencave për të ushtruar veprimtari në tregun e telefonisë celulare është i kufizuar, për shkak të burimeve të kufizuara natyrore siç janë frekuencat. Aktualisht në treg janë dhënë të 4 (katër) licencat dhe nuk ka licenca të tjera në dispozicion.

III.3.2 Barrierat ekonomike

15. Operatorët për tu futur në tregun e telefonisë së lëvizshme, duhet të kryejnë investime të mëdha, si për blerjen e licensës, ashtu edhe për ndërtimin e rrjetit të tij të telefonisë celulare, që do të thotë se këto përbëjnë barrierë ekonomike për operatorët e rinj për të hyrë në treg.

16. Ekonomitë e shkallës dhe të qëllimit mund t'i japin ndërmarrjes dominuese një avantazh mbi konkurrentët e vegjël. Operatorëve të rinj do tu duhet kohë dhe mjete monetare të konsiderueshme për tu bërë pjesë efektive e këtij tregu. Numri i abonentëve potencialë të mbetur në treg është relativisht i kufizuar. Për të siguruar një nivel

¹ Indeksi Herfindahl-Hirschmann ("HHI"), mat përqendrimin e tregut duke mbledhur përqindjet e tregut në katror të të gjitha firmave të industrisë. Kur një HHI është më i vogël se 1 000, atëherë përqendrimi i tregut konsiderohet si i ulët kur një HHI është midis 1 000 dhe 1 800 konsiderohet mesatarisht i përqendruar, ndërsa nëse HHI është më i madh se 1 800 konsiderohet si i lartë.

konkurrues të pranueshëm, këta operatorë të rinj do të duhet t'i marrin përdoruesit e shërbimeve të tyre nga operatorët ekzistues, proces i vështirë për shkak të epërsive që kanë këta të fundit. Ky proces padyshim që përbën një barrierë të konsiderueshme për operatorët e rinj.

III.4 Konkurrenca potenciale

17. Autoriteti i Konkurrencës dhe AKEP kanë ndërmarrë një sërë aktesh rregulluese për rritjen e konkurrencës në treg, nëpërmjet zbatimit të ligjit të konkurrencës dhe nxjerrjes së akteve rregulluese të këtij tregu, por përsëri tregu ka një shkallë shumë të lartë përqendrimi, në sajë të pjesës së madhe të tregut, kryesisht të Vodafone.

III.5 Fuqia kundërvepruese e bleresve.

18. Struktura e tregut të telefonisë së lëvizshme celulare me pakicë është e tillë, që përdoruesit që blejnë sasira të konsiderueshme shërbimi celular janë mjaft të pakët në numër, gjithashtu numri i përdoruesve me parapagesë zë rreth 90-95% të numrit të përgjithshëm të përdoruesve. Vodafone shërbimin me parapagesë e ka 95% të të gjithë shërbimit me pakicë. Abonentët e shërbimit me parapagim gjithsesi janë përdorues të vegjël dhe nuk kanë fuqi kundërvepruese. Në këto kushte është e qartë, që përdoruesit në tregun e telefonisë celulare me pakicë me parapagesë, nuk zotërojnë ndonjë fuqi kundërvepruese, për tu marrë në konsideratë. Kjo fuqi kundërvepruese është akoma edhe më e pandjeshme për shkak të efektit të mbajtjes së abonentëve brenda rrjetit VF Club.

III.6 Fuqia ekonomike dhe financiare e ndërmarrjeve

19. Vodafone Albania² Sh.A. është pjesë e Vodafone Group Plc - kompani lider në botë në fushën e komunikimeve elektronike. Marka Vodafone renditet si marka e shtatë më e vlerësuar në botë. Vodafone është i pranishëm në më shumë se 30 vende të botës dhe është partner me rrjete të tjera në mbi 40 vende. Kompania Vodafone është një ndërmarrje e madhe jo vetëm në tregun e telefonisë së lëvizshme, por dhe në ekonominë shqiptare.

20. Kompania Vodafone rezulton të ketë rritur xhiron me te madhe duke rezultuar me 52% të të ardhurave totale. Kompania AMC³ ka ulur të ardhurat në krahasim me vitin 2011 me rreth 2% dhe të ardhurat e saj rezultojnë rreth 70% më pak se Vodafone Albania. Kompania AMC ka ulur të ardhurat në vite nga 42% në vitin 2009 në 32% në vitin 2012⁴.

² Burimi: http://www.vodafone.al/vodafone/Vodafone_Albania_202_1.php.

³ Sipas AKEP, Analize e Tregut të telefonisë së Levizshme fq 61.

⁴ Burimi për të ardhurat e vitit 2012 janë të dhënat e sjella nga ndërmarrjet.

21. Treguesi i xhiros së realizuar, por edhe tregues të tjerë, si numri i pajtimtarëve, të ardhurat e gjeneruara në tregun përkatës, etj, evidentojnë fuqinë e konsiderueshme ekonomike dhe financiare të ndërmarrjes Vodafone.

Nisur nga pjesët e tregut⁵, konkretisht sipas: a- numrit të pajtimtarëve (44%); b- të ardhurave në tregun përkatës (54%);, por si dhe nga pengesat e hyrjes në treg; konkurrenca potenciale; fuqia ekonomike e ndërmarrjeve; fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se në mbështetje të nenit 3, pika 5 dhe nenit 8 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, por dhe nga përvoja e rasteve precedente të Gjykatës Europiane të Drejtësisë, ndërmarrja Vodafone Albania ka pozitë dominuese tregun e telefonisë celulare me pakicë me parapagesë.

IV. SHENJA E KUFIZIMIT TË KONKURRENCËS NË TREG

Nga analiza e kushteve të konkurrencës në treg për të gjithë operatorët rezulton se:

IV.I. Diferencimi i tarifave brenda rrjetit dhe jashtë rrjetit

22. Sjellja e ndërmarrjes Vodafone Albania me pozitë dominuese në tregun përkatës është analizuar në kuptim të evidentimit të shenjave të kufizimit të konkurrencës në treg si pasojë e sjelljes me planet tarifore që kjo ndërmarrje ofron dhe sjellja e kësaj ndërmarrje në lidhje me konkurrentët e saj lidhur me distributorët e kartave telefonike.

23. Klientët në Vodafone Club nxiten dhe mbahen në Club nëpërmjet tarifimit dhe ofertave shumë herë më avantazhuese brenda rrjetit (on-net) sesa jashtë rrjetit (off-net). Tentativa për të reduktuar çmimet përkundrejt operatorëve të tjerë mbetet simbolike dhe këto tarifa, të vëna në zbatim që prej Tetorit 2012, nuk reflektojnë absolutisht reduktimet në tarifat e terminimit nga ana e operatorëve të tjerë.

24. Rrjedha e fluksit të trafikut drejt on-net (ku Vodafone 95% të thirrjeve të tij i ka brenda rrjetit) është rezultat i zbatimit të diferencimit të tarifave midis praktikave për thirrjet on-net dhe off-net. Rrjedhja e fluksit të trafikut on-net (Vodafone zotëron 51% të thirrjeve on-net/totalin e thirrjeve on-net të të gjithë operatorëve) ka prirje për të zvogëluar pjesët e tregut të operatorëve më të vegjël.

⁵ Sipas të Drejtës së Konkurrencës të Bashkimit Evropian: zotërimi nga ndërmarrjet i pjesëve të konsiderueshme të tregut të produktit për një farë kohe, ka shumë të ngjarë që të jetë tregues i pozitës së tyre dominuese në treg, por vetëm ky tregues nuk mund ta provojë këtë pozitë. Rasti i vetëm, kur ky tregues konsiderohet i mjaftueshëm është kur ndërmarrjet zotërojnë 50% apo më shumë të tregut të produktit. Shih cshtjen nr. 85/76, date 13.02.1979 Hofmann-La Roche, (paragrafët 39, 41) si dhe dhe AKZO “Në rast të zotërimit të një pjese tregu prej të paktën 50%, Pozita Dominuese mund të prezumohet”.

IV.2. Bonusi si politikë përjashtuese për konkurrentët

25. Ndërmarrja me pozitë dominuese Vodafone, ka rritur përqindjen e bonusit që përfitohet nga pikat e shitjes së produkteve të operatorëve celularë. Ky bonus jepet vetëm me kushtin që t'i jepet përparësi ndërmarrjes Vodafone ndaj operatorëve të tjerë celularë, si dhe heqja e logove reklamuese të operatorëve të tjerë dhe vendosja në pikat e shitjes e vetëm logove të Vodafone.

IV.2. Kufizimi i zgjedhjes konsumatore

26. Operatori Vodafone ka ofruar një shërbim në kuadrin e ofertave promociionale për planet tarifore me parapagesë “oferta e portabilitetit për klientët me parapagesë” që përfshin komunitetin e Vodafone Club dhe Planin tarifar Vodafone card. Në bazë të këtyre ofertave klientet Vodafone Club do të përfitojnë me shumë trafik dhe shërbime celulare me një çmim më të ulët me qellim për t'i mbajtur brenda rrjetit. Vodafone për uljet e përfutuara nga klienti gjatë kohës që është përdorur shërbimi, i kërkon kompensim nëse klienti do të kalojë në një operator tjetër.

27. Në këtë mënyrë tërhiqen klientë të rinj dhe brenda rrjetit, duke ofruar për klientët tarifa më të ulëta, sesa çmimet që u ofrohen klientëve aktualë të Vodafone, për të rritur kështu pjesën e tregut të Vodafone në raport me operatorët e tjerë.

28. Referuar analizës së mësipërme, rezulton se ka shenja të kufizimit të konkurrencës si pasojë e sjelljes së ndërmarrjes me pozitë dominuese në tregun përkatës Vodafone Albania, në kuptim të nenit 9, pika 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, (shkronja d) dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe në nenin 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”,

V E N D O S I:

I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania Sha, në tregun e telefonisë celulare me pakicë.

II. Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2011 deri në 31.12.2012.

III. Procedurat e hetimit të thelluar duhet të përfundojnë jo më vonë se 6 muaj nga data e marrjes së këtij vendimi.

IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

Nr. 276, Datë 18/03/2013

“Përmiratimin e rregullores “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

▪	Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪	Rezana	KONOMI	Zv/Kryetar
▪	Servete	GRUDA	Anëtar
▪	Koço	BROKA	Anëtar
▪	Iva	ZAJMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.03.2013, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e rregullores “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve” në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (I ndryshuar)

Baza ligjore: Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 6, dhe 24, shkronja d), dh).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Projekt - rregullores “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”
- Opinioneve të paraqitura nga palët e interesuara:

VENDOSI:

1. Të miratojë rregullores “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve” sipas tekstit të bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS**Servete GRUDA****Koço BROKA****Iva ZAJMI****Rezana KONOMI**

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar**Lindita MILO (LATI)**

K R Y E T A R

RREGULLORE

Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve

Autoriteti i Konkurrencës:

- Në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji) miraton rregulloret mbi kategoritë e marrëveshjeve që përjashtohen nga ndalimi i parashikuar në nenin 4 të Ligjit.
- Në përmbushje të detyrimeve të parashikuara në fushën e konkurrencës në Planin Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit(PKZMSA).
- Pas zhvillimit të takimeve konsultative me palët e interesit, shoqëritë e sigurimeve, Byronë Shqiptare të Sigurimit dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Duke pasur parasysh se:

- (1) Rregullorja është e përshtatur plotësisht me rregulloren e Komisionit Evropian nr. 267/2010 të datës 24.03.2010 “Mbi zbatimin e nenit 101/3 të Traktatit të Bashkimit Evropian për disa kategori marrëveshjesh, vendimesh dhe praktikash të bashkërenduara në sektorin e sigurimeve” (indeks: 38010R0267).
- (2) Rregullorja, sipas parashikimeve të nenit 6 të Ligjit, parashikon përjashtimin nga ndalimi të disa kategorive të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e sigurimeve të cilat kanë për objekt bashkëpunimin në lidhje me:
 - Vendosjen e tarifave të primeve të rrezikut të zakonshëm bazuar në statistika të konstatuara kolektivisht ose në numrin e pretendimeve,
 - Vendosjen e kushteve të policave standarde të përbashkëta;
 - Mbulimi i zakonshëm për disa lloje të caktuara rreziqesh,
 - Shlyerja e dëmeve,
 - Testimi dhe pranimi i pajisjeve të sigurisë,
 - Regjistrat dhe informacioni mbi rreziqet e rënda.
- (3) Rregullorja ka për synim të sigurojë një mbrojtje efektive të konkurrencës ndërsa ofron përfitime për konsumatorët dhe siguri ligjore të përshtatshme për ndërmarrjet.
- (4) Rregullorja parashikon që Komisioni të përcaktojë kategoritë e marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara në të cilat

ajo zbatohet, të specifikojë kufizimet ose dispozitat të cilat mund të shfaqen ose jo në marrëveshjet, vendimet dhe praktikën e bashkërenduara dhe të specifikojë dispozitat të cilat duhet të jenë pjesë e marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara ose kushtet e tjera që duhet të plotësohen.

- (5) Përfitimet e përjashtimit në bllok nga kjo Rregullore, duhet të kufizohet në ato marrëveshje, për të cilat prezumohet me siguri të mjaftueshme që përmbushin kushtet e Nenit 6 të Ligjit. Për zbatimin e përjashtimeve sipas nenit 6 të Ligjit, nuk është e nevojshme të përcaktohen marrëveshjet që ndalohen sipas nenit 4 të Ligjit. Në të njëjtën kohë, nuk prezumohet që marrëveshjet që parashikohen në nenin 6 të përjashtimit, t'i nënshtrohen dispozitave të nenit 4 të Ligjit.
- (6) Bashkëpunimi midis shoqërive të sigurimit ose mes shoqatave të shoqërive të sigurimit në hartimin e informacionit (i cili mund të përfshijë disa llogaritje statistikore) duke lejuar llogaritjen e kostos mesatare të mbulimit të një rreziku specifik në të shkuarën ose për siguracionin e jetës, tabelat e normave të vdekshmërisë apo të frekuencës së sëmundjeve, aksidentet dhe invaliditeti, bën të mundur përmirësimin e njohurive mbi rreziqet dhe lehtëson vlerësimin e rreziqeve për kompanitë individuale.
- (7) Kjo mund të lehtësojë hyrjet e reja në treg dhe kështu t'i shërbejë konsumatorëve si dhe mund të zbatohet mbi studimet e përbashkëta mbi impaktin e mundshëm të rrethanave të panjohura, të cilat mund të influencojnë frekuencën ose shkallën e dëmeve, ose normën e kthimit të investimeve.
- (8) Një bashkëpunim i tillë është i përjashtuar në atë masë sa është e nevojshme për arritjen e këtyre objektivave. Për këtë arsye është e nevojshme që të theksohet se marrëveshjet mbi primet e shitjes nuk përjashtohen. Primet e shitjes mund të jenë më të ulët se shumica e treguar nga informacionet e përmbledhura, tabelat ose rezultatet e studimeve në fjalë, përderisa siguresit mund të përdorin të ardhura nga investimet e tyre për të ulur primet.
- (9) Përmbledhjet, tabelat ose studimet në fjalë nuk duhet të jenë detyruese dhe duhet të shërbejnë vetëm për qëllime reference. Shkëmbimi i informacionit i bërë jo domosdoshmërisht për të arritur objektivat e përcaktuara në këtë përshkrim, nuk mbulohet nga kjo Rregullore.
- (10) Sa më shumë kufizohen kategoritë në të cilat statistikën mbi koston e mbulimit të një rreziku specifik në të shkuarën grupohen, aq më shumë shoqëritë e sigurimit me liri veprimi duhet të diferencojnë primet e shitjes të tyre kur i llogarisin. Ndaj është e përshtatshme të përjashtohen përmbledhjet e përbashkëta të kostove të shkuara të rreziqeve me kusht që statistikën në dispozicion të jenë të pajisura me sa më shumë detaje dhe diferencime sa duhen për përlllogaritjet.
- (11) Aksesit të përmbledhjet e përbashkëta, të tabelat dhe rezultatet e studimeve është e nevojshme si për shoqëritë e sigurimit aktive në tregun gjeografik apo tregun e produktit në fjalë, si edhe për ato shoqëri që po

marrin në konsideratë të hyjnë në treg. I njëjti akses mund t'ju nevojiten organizatave të klientëve/konsumatorëve.

- (12) Shoqërive të sigurimit të cilat ende nuk janë aktive në tregun në fjalë dhe organizatave të konsumatorëve duhet tu jepet akses te tabelat përmbledhëse të përbashkëta, tabelat dhe rezultatet e studimeve, në kushte të arsyeshme, të përballueshme dhe jo-diskriminuese, në krahasim me shoqëritë e sigurimit të cilat janë aktive në atë treg. Këto kushte mund të përfshijnë për shembull, një angazhim të shoqërisë ende jo aktive në treg për të vënë në dispozicion informacione statistikore mbi dëmet, në rast të hyrjes në treg; mund gjithashtu të përfshijë anëtarësimin në shoqatën e sigurve për përgjegjëse për përpilimin e tabelave përmbledhëse statistikore.
- (13) Një përjashtim për kushtin e garantimit të aksesit të organizatave të klientëve/konsumatorëve duhet të jetë i mundur, mbi bazat e sigurisë publike, si për shembull kur informacioni lidhet me sistemet e sigurisë së centraleve bërthamore ose mangësitë në sistemet e parashikimit e mbrojtjes nga përmytjet.
- (14) Besueshmëria e përmbledhjeve të përbashkëta, tabelave dhe studimeve rritet me rritjen e statistikave mbi të cilat ato bazohen. Siguruesit me pjesë të madhe tregu mund të gjenerojnë statistika të mjaftueshme së brendshmi për të bërë të mundur përpilimin e përmbledhjeve të besueshme, por ata me pjesë të vogël në treg, mund të mos jenë në gjendje ta bëjnë këtë dhe hyrësit e rinj në treg aq me pak. Përfshirja në këto përmbledhje të përbashkëta, e tabelave, informacioneve dhe studimeve nga gjithë siguruesit në treg, përfshirë siguruesit e mëdhenj, në parim promovojnë konkurrencën duke ndihmuar siguruesit e vegjël si dhe duke lehtësuar hyrjen në treg. Duke patur parasysh këtë veçanti të sektorit të sigurimeve, nuk do ishte e përshtatshme të bëhej ndonjë përjashtim për përmbledhëse të përbashkëta, tabela e studime të kufijve të pjesëve tregut.
- (15) Pool-et (grupimet) e bashkë-sigurimit ose bashkë-risigurimit lejohen, në disa rrethana të kufizuara, kur është e nevojshme, për të lejuar pjesëmarrjen e një prej shoqërive pjesë e grupimit, për të ofruar sigurim ose ri-sigurim për rreziqe, për të cilat ato mund të ofrojnë mbulim të pamjaftueshëm në mungesë të grupimit. Këto tipe grupimesh, përgjithësisht nuk kufizojnë konkurrencën sipas parashikimeve të nenit 4 të Ligjit dhe për pasojë nuk janë të ndaluara.
- (16) Grupimet e bashkë-siguruesve dhe bashkë-risiguruesve mund të lejojnë siguruesit dhe risiguruesit të ofrojnë sigurim dhe risigurim për rreziqe edhe nëse të grupuarit shkon përtej asaj çka është e nevojshme për të bërë të mundur që ky rrezik të mbulohet. Megjithatë, grupime të tilla mund të përfshihen në kufizime të konkurrencës, si për shembull në standardizimin e kushteve të politikave dhe madje në shumat e mbulimeve dhe primeve është më e përshtatshme të përcaktohen rrethanat në të cilat grupime të tilla mund të përfitojnë nga përjashtimi.

- (17) Për rreziqet mirëfilltazi të reja, nuk është e mundur të dihet më para ç'kapacitet është i nevojshëm për të mbuluar rrezikun, as nëse dy ose më shumë grupime mund të bashkë-ekzistojnë për qëllimet e ofrimit të llojit të veçantë të sigurimit në fjalë. Një marrëveshje grupimi që i ofron bashkë-sigurim ose bashkë-risigurim për këto lloj rreziqesh të reja mundet kështu të përjashtohet nga ndalimi për një periudhe kohë të kufizuar pa patur kushtet për kufijtë e pjesëve të tregut. Por mbetet kusht vetëm periudha kohore prej tre vjet e cila është periudha kohore e përshtatshme për mbledhjen e informacionit historik të mjaftueshëm mbi dëmet, për tu vlerësuar nevoja ose jo për një grupim.
- (18) Rreziqet që nuk ekzistojnë më parë duhet të konsiderohen si rreziqe të reja. Gjithsesi, në rrethana të jashtëzakonshme, një rrezik mund të konsiderohet rrezik i ri, kur një analizë objektive tregon që natyra e rrezikut ka ndryshuar kaq shumë sa nuk është e mundur të dihet më parë ç'kapacitet duhet për të mbuluar një rrezik të tillë.
- (19) Për rreziqet që nuk janë të reja, grupimet e bashkë-sigurimit dhe bashkë-risigurimit që përbëjnë një kufizim të konkurrencës, mund në disa rrethana të kufizuara të përfshijnë përfitime në atë masë sa të justifikojnë përjashtimin sipas Nenit 6 të Ligjit, edhe nëse ata mund të zëvendësoheshin nga dy ose më shumë subjekte sigurimi konkurruese. Për shembull ata mund të lejojnë shoqëritë pjesëmarrëse të sigurimit të fitojnë mjaftueshëm eksperiencë në sektorin e sigurimeve të përfshirë, ose mund të lejojnë uljen e kostove ose uljen e primeve shitjes nëpërmjet risigurimit të përbashkët me kushte favorizuese. Gjithsesi, çdo përjashtim duhet të kufizohet të marrëveshjet të cilat nuk mund të bëjnë që shoqëritë e përfshira të eliminojnë konkurrencën në lidhje me një pjesë të konsiderueshme të produkteve në fjalë.
- (20) Konsumatorët mund të përfitojnë nga grupimet vetëm nëse ka konkurrencë të mjaftueshme në tregun përkatës në të cilat grupimet operojnë. Ky kusht duhet të konsiderohet i përmbushur kur pjesa e tregut të një grupimi mbetet poshtë pragut të dhënë dhe kështu mund të prezumohet të jetë objekt konkurrence aktuale apo potenciale nga ndërmarrje që nuk janë pjesëmarrëse në atë grupim.
- (21) Kjo rregullore garanton një përjashtim për çdo grupim bashkë-sigurimi apo bashkë-risigurimi të tillë, që ka ekzistuar për më shumë se tre vjet, ose që nuk është krijuar për të mbuluar një rrezik të ri, me kushtin që pjesa e tregut e kombinuar që kanë ndërmarrjet pjesëmarrëse të mos kalojë pragje të caktuara. Pragu për grupimet e bashkë-sigurimit mund të përfshijë kushte uniforme të kushteve të policave të sigurimit dhe primeve shitjes. Për vlerësimin nëse një grupim përmbush kushtin e pjesës së tregut, shuma totale e ndërmarrjeve pjesëmarrëse duhet të mbledhet. Pjesa e tregut për çdo ndërmarrje pjesëmarrëse bazohet në primin e përgjithshëm bruto të ndërmarrjes pjesëmarrëse si brenda dhe jashtë grupimit në të njëjtin treg përkatës. Këto përjashtime gjithsesi, nuk duhet të zbatohen nëse grupimi në fjalë përmbush kushtet e tjera të përcaktuara në këtë rregullore, të cilat kanë për qëllim të mbajnë në nivele minimale

- kufizimet e konkurrencës mes ndërmarrjeve pjesëmarrëse në grupim. Një analizë individuale do ishte e nevojshme në raste të tilla, në mënyrë që të përcaktohet nëse kushtet e vendosura nga rregullorja përmbushen ose jo.
- (22) Në mënyrë që të lehtësohet konkludimi i marrëveshjeve, disa prej të cilave mund të përfshijnë vendime investimi të konsiderueshëm, vlefshmëria e kësaj rregulloreje do të jetë 5 vjet.
- (23) Komisioni mund të tërheqë përfitimin nga kjo rregullore, mbi zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenin 6 të Ligjit, kur gjen se në një rast të veçantë, se një marrëveshje ku përfitohen përjashtimet e kësaj rregulloreje, ka gjithsesi efekte të papajtueshme me të.

Miraton këtë rregullore:

Neni 1

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore parashikon përjashtimin nga ndalimi i parashikuar në nenin 6 të Ligjit të disa kategorive të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e sigurimeve të cilat kanë për objekt bashkëpunimin në lidhje me:

- Vendosjen e tarifave të primeve të rrezikut të zakonshëm bazuar në statistika të konstatuara kolektivisht ose në numrin e pretendimeve,
- Vendosjen e kushteve të policave standarde të përbashkëta;
- Mbulimi i zakonshëm për disa lloje të caktuara rreziqesh,
- Shlyerja e dëmeve,
- Testimi dhe pranimi i pajisjeve të sigurisë,
- Regjistrat dhe informacioni mbi rreziqet e rënda.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje, shprehjet e mëposhtme do të kenë këto kuptime:

1. “Marrëveshje”- është ajo marrëveshje, ose një vendim i një grupim ndërmarrjesh ose shoqate, ose një praktikë e bashkërenduar;
2. “Ndërmarrje pjesëmarrëse”- janë ndërmarrjet që janë pjesë e marrëveshjes, si dhe ndërmarrjet e tjera të lidhura me to.
3. “Ndërmarrje të lidhura” janë ato ndërmarrje në të cilat:

a)njëra palë në marrëveshje, e cila përfshihet drejtpërdrejtë, ose jo-drejtpërdrejtë me:

- i) më tepër sesa gjysmën e të drejtës së votës; ose
- ii) të drejtën për të emëruar më shumë se gjysmës së anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, të bordit të menaxhimit, ose organeve ligjërisht përfaqësuese të ndërmarrjes; ose
- iii) të drejtën e administrimit të veprimtarisë tregtare.

b) zotërojnë mbi një ndërmarrje që është pjesë e marrëveshjes (drejtpërdrejtë, ose jo-drejtpërdrejtë), të drejta, ose pushtetet e përcaktuara dhe të renditura në pikën a, si më sipër;

c) ato mbi të cilat një ndërmarrje e përmendur në pikën b), zotëron drejtpërdrejtë, ose jo-drejtpërdrejtë, të drejta ose pushtete të renditura në pikën a;

d) zotërojnë së bashku të drejta, ose pushtete të renditura në pikën “a”, brenda një ndërmarrje, pjesë e marrëveshjes si dhe një ose me shumë ndërmarrje të shënuara në pikat a, b, c, (ose dy, ose me shumë se dy nga këto ndërmarrje të fundit).

e) janë ndërmarrjet ku të drejtat ose pushtetet e renditura në pikën a mbahen bashkërisht prej:

- i) Palëve në marrëveshje, ose ndërmarrjeve të lidhura, përkatësisht sipas pikave “a” deri në “d”; ose
- ii) një, ose shumë palëve të marrëveshjes, ku një, ose shumë ndërmarrje të tyre kanë lidhje të përcaktuara në pikat nga “a” në “d”, si dhe një, ose shumë palë të treta;

4. *”Grupimet e bashkë-siguruesve”* janë grupime të themeluara midis:

- disa ndërmarrje sigurimesh në mënyrë të:- drejtpërdrejtë
- me ndërmjetësimin e përfaqësuesve;
- ose të agjentëve të autorizuar, me përjashtim të marrëveshjeve të bashkë-siguruesve të krijuar posaçërisht ; duke konkluduar mbi një nën-treg, një pjesë e përcaktuar nga një rrezik të dhënë dhe duke qenë mbuluar nga një sigurues dhe nga pjesa e qëndrueshme e rrezikut, ose
- nga të tjerë bashkë-sigurues, që janë të ftuar në mbulimin e këtij të fundit, të cilët:

- a) Zotohen të nënshkruajnë, në emër dhe për llogari të gjithë pjesëmarrësve në sigurim një kategori të përcaktuar të rreziqeve; ose
- b) Autorizojnë nënshkrimin dhe administrimin e sigurimeve të një kategorie të përcaktuar rreziqesh, në emër të tyre dhe për llogari të tyre, nga njëri prej

shoqërive të sigurimit ose me një ndërmjetës së përbashkët ose nga një organizatë e përbashkët e krijuar për këtë qëllim.

5) *"Pool (grupimi) i ri-siguruesve të përbashkët"* janë:

- grupime të ndërmarrjeve të sigurimeve, duke qenë te drejtpërdrejta, ose të ndërmjetësuar me përfaqësues (broker), ose agjentë të autorizuar, rasti kur kemi konkurrim të një (ose më shumë ndërmarrjeve të sigurimit), me përjashtim të marrëveshjeve të ri-sigurimit të përbashkët të përkohshme, të përfshirë në një nën-treg;
- një pjesë e përcaktuar nga një rrezik i dhënë duke qenë i mbuluar nga një ndërmarrje krye-siguruese dhe pjesa e mbetur e këtij rreziku nga të tjerë bashkë-sigurues, të cilat pra janë të ftuara në mbulimin e rrezikut, për të:
 - a) ri-siguruar solidarisht ndaj të gjithëve, një pjesë të përcaktuar nga një kategori përkatëse e rreziqeve;
 - b) pranuar në emër dhe për llogari të gjithë pjesëmarrësve në ri-sigurimin të së njëjtës kategori të rreziqeve;

6) *"Rreziqet e reja"* quhen:

- a) rreziqe, të cilët nuk ekzistojnë më parë, dhe për të cilat sigurimi mbulon një produkt sigurimi tërësisht të ri, pa përfshirë përmirësimin, rritjen, ose zëvendësimin e një shërbimi sigurimi ekzistues; ose
- b) në raste përjashtimore, rreziqe që për nga natyra që kanë, mbi bazën e një analize objektive, produkti ka ndryshuar deri në atë masë, aq sa nuk është më e mundshme të përcaktohet paraprakisht kapaciteti përkatës, i nevojshëm për mbulimin e tyre.

7) *"Primi i shitjes"* - quhet çmimi i faturuar tek blerësi i një police sigurimi.

Kreu II

Llogaritjet e përbashkëta, tabelave dhe studimeve të përbashkëta

Neni 3

Përjashtimi

Në përputhje me nenin 6, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", si dhe sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, neni 4, i po atij ligji, nuk do të zbatohet mbi marrëveshjet, të cilat janë lidhur midis dy, ose më shumë ndërmarrjeve (në sektorin e sigurimeve), të cilat kanë të bëjnë me:

- a) përpunimin dhe shpërndarjen e përbashkët të informacioneve të nevojshme për qëllimet e mëposhtme:
- i) të llogaritjes së kostos mesatare për mbulimin e një rreziku të caktuar në të kaluarën (këtu e në vijim “përmbledhëse”)
 - ii) të hartimit *tabelave* të vdekshmërisë dhe të rasteve të sëmundjeve, aksidenteve dhe invaliditetit të lidhura me policën e sigurimit, duke përfshirë një element të kapitalizmit (këtu e në vijim- “tabelat”)
- b) realizimin e *studimeve* të përbashkëta mbi pasojat e mundshme të rrethanave të jashtme e të përgjithshme, për ndërmarrjet e përfshira: si frekuenca, ose treguesi i dëmeve të ardhshme për një rrezik, ose një kategori rreziqesh të dhëna, si dhe duke u zbatuar mbi rentabilitetin e tipave të ndryshme të investimit (këtu e më poshtë “studimet”), si dhe shpërndarja e rezultateve nga këto studime.

Neni 4

Kushtet për përjashtim

1. Përjashtimi i përcaktuar në nenin 2(a) do të zbatohet me kusht që tabelat e përbashkëta, studimet, ose tabelat:

(a) të jenë të bazuara mbi mbledhjen e të dhënave, të shpërndara në një numër vitesh risku, të zgjedhura si një periudhë vëzhgimi, e cila lidhet me risqe identike, ose të krahasueshme në një shifër të mjaftueshme për të shërbyer si baza për analiza statistikore dhe mund të japë shifrat për sa si vijon dhe ndër të tjera:

- (i) numri i pretendimeve për dëme gjatë periudhës së vëzhgimit;
- (ii) numri i rreziqeve individuale të siguruara në çdo vit rreziku (risku) të periudhës së zgjedhur të vëzhgimit;
- (iii) shuma totale e paguar, ose e pagueshme në lidhje me dëmet e pretenduara që janë shfaqur gjatë periudhës së dhënë;
- (iv) shuma totale e kapitalit të siguruar për çdo vit rreziku, gjatë periudhës së zgjedhur të vëzhgimit;

(b) të përfshihen sipas detajimit, statistikatat e disponueshme të duhura në mënyrë aktuale; ose

(c) nuk përfshihen elemente për kontigjencat, të papriturat, të ardhurat që vijnë nga rezervat, kostot administrative apo tregtare, ose kontributet para dhe pas fiskale dhe nuk do të merren në konsideratë as të ardhurat nga investimet si dhe përfitimet e parashikuara.

2. Përfshirjet e përcaktuara në nenin 2 do të zbatohen me kushtin që përmbledhëset, tabelat, ose rezultatet e studimeve:

- (a) Nuk identifikojnë ndërmarrjen e sigurimit ndaj së cilës pretendohet dëmi, ose ndonjë nga palët e siguruar;
- (b) Kur janë përpiluar dhe shpërndarë, duke përfshirë tregues të karakterit të tyre jo-detyrues;
- (c) Nuk përmbajnë ndonjë të dhënë mbi nivelin e primeve të shitjes;
- (d) I janë vënë në dispozicion me kushte të arsyeshme, të përballueshme dhe jo-diskriminuese çdo ndërmarrjeje siguroese, të cilat kërkojnë një kopje të tyre, duke përfshirë edhe ndërmarrjet që nuk janë aktive në tregun gjeografik, ose tregun e produktit, të cilit i referohen këto përmbledhëse, tabela dhe rezultate studimi;
- (e) I janë vënë në dispozicion me kushte të arsyeshme, të përballueshme dhe jo-diskriminuese, organizatave të konsumatorëve ose të klientëve, të cilat kërkojnë akses tek to në kushte të caktuara dhe për arsye të justifikuara me përjashtim kur mungesa e komunikimit të informacionit justifikohet objektivisht; mbi baza të sigurisë publike.

Neni 5

Marrëveshjet që nuk mbulohen nga përjashtimi

Përjashtimet e parashikuara në Nenin 3 nuk do të zbatohen kur ndërmarrjet pjesëmarrëse hyjnë në një ndërveprim, ose në një marrëveshje mes tyre, ose detyrojnë ndërmarrje të tjera të mos përdorin përmbledhëse, ose tabela të ndryshme nga ato të përcaktuara në Nenin 3(a), ose të ndryshme nga rezultatet e studimeve të dhëna në Nenin 3(b).

KREU III

MBULIMI I PËRBASHKËT I LLOJEVE TË ÇAKTUARA TË RREZIQEVE

Neni 6

Përjashtimi

Në bazë të nenit 6, të Ligjit, si dhe me rezervën e dispozitave të kësaj rregulloreje, pika 1 e nenit 4 të ligjit në fjalë, nuk do të zbatohet për marrëveshjet e lidhura mes dy, ose më tepër ndërmarrjeve në sektorin e sigurimeve, me synim krijimin dhe funksionimin e “pool-it” të ndërmarrjeve të sigurimit, ose ri-sigurimit, për mbulimin e përbashkët të një kategorie të veçantë rreziqesh, nën formën e bashkë-sigurimit, ose bashkë-risigurimit.

Neni 7

Zbatimi i përjashtimit dhe kufijtë e pjesëve të tregut

1. Për sa i përket pool-it të sigurimit, ose ri-sigurimit të përbashkët, i cili është krijuar posaçërisht për të mbuluar rreziqet e reja, përjashtimi i parashikuar në nenin 5, do të zbatohet për një periudhë 3 (tre) vjeçare nisur nga data fillestare e pool-it, pavarësisht pjesës së tregut të kësaj të fundit.
2. Për sa i përket pool-eve të sigurimit, ose ri-sigurimit të përbashkët, të cilat nuk përfshihen në fushën e zbatimit të pikës 1 si më sipër, përjashtimi i parashikuar në nenin 5 do të zbatohet për aq kohë sa kjo rregullore të jetë në fuqi, me kushtin që pjesa e përbashkët e tregut të ndërmarrjeve pjesëmarrëse të mos tejkalojë:
 - (a) 20 % të tregut përkatës, në rastin e pool-eve të bashkë-sigurimit;
 - (b) 25 % të tregut përkatës në rastin e pool-eve të bashkë-risigurimit;
3. Në përlllogaritjen e pjesës së përbashkët të tregut, për ndërmarrjet pjesëmarrëse në tregun përkatës, duhen marrë parasysh :
 - (a) pjesa e tregut të ndërmarrjes pjesëmarrëse në kuadër të pool-it në fjalë;
 - (b) pjesa e tregut të ndërmarrjes pjesëmarrëse brenda një tjetër pool-i, por në të njëjtin treg përkatës sikurse pool-i në fjalë, në të cilin ndërmarrja pjesëmarrëse është palë; si dhe
 - (c) pjesa e tregut të ndërmarrjes pjesëmarrëse në të njëjtin treg përkatës me atë të pool-it në fjalë, por jashtë çdo pool-i.
4. Me synim zbatimin kufijve të pjesës së tregut përkatës të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, rregullat e mëposhtme duhet të zbatohen kur:
 - (a) Pjesa e tregut do të llogaritet në bazë të të ardhurave nga primet bruto. Në qoftë se të dhënat e të ardhurave nga primet bruto nuk janë të disponueshme, vlerësimet do të bëhen në bazë të një informacioni tjetër të besueshëm të tregut, duke përfshirë sigurimin e dhënë apo vlerën e

- rrezikut të siguruar, e cila mund të përdoret për të përcaktuar pjesën e tregut të ndërmarrjes në fjalë;
- (b) Pjesa e tregut do të llogaritet në bazë të të dhënave që lidhen me vitin paraardhës kalendarik.
5. Kur pjesa e tregut të përmendur në pikën 2(a), nuk është fillimisht me shume se 20 %, por më pas rritet në vazhdim, pa kaluar nivelin 25 %, përjashtimi i parashtruar në nenin 5 do të vazhdojë të zbatohet për një periudhë prej 2 (dy) vitesh kalendarike të njëpasnjëshme pas vitit në të cilën pragu prej 20% është tejkaluar për herë të parë.
6. Kur pjesa e tregut të përmendur në pikën 2(a) fillimisht s'është më shumë se 20%, por më pas rritet në mbi 25 %, përjashtimi i parashikuar në nenin 5 do të vazhdojë të zbatohet për një periudhë prej 1 viti kalendarik pas vitit në të cilin pragu prej 25 % është kaluar për herë të parë.
7. Përfitimi nga pikat 5 dhe 6 mund të mos kombinohet për të tejkaluar një periudhë prej dy vitesh kalendarike.
8. Kur pjesa e tregut të parashikuar në pikën 2(b) fillimisht nuk kalon më shumë se 25%, por më pas ngrihet mbi atë nivel, por pa kaluar 30%, përjashtimi i parashikuar në nenin 5, do të vazhdojë të aplikohet për një periudhë prej dy vitesh kalendarike të njëpasnjëshme, pas vitit në të cilën pragu prej 25% është tejkaluar për herë të parë.
9. Kur pjesa e tregut e përmendur në pikën 2 (b) nuk është fillimisht më shumë se 25%, por më pas ngrihet mbi 30%, përjashtimi i parashikuar në nenin 5, do të vazhdojë të zbatohet për një periudhë prej një viti kalendarik pas vitit në të cilin niveli prej 30% është tejkaluar për herë të parë.
10. Përfitimi nga pikat 8 dhe 9 s'mund të kombinohet për të tejkaluar një periudhë prej dy vitesh kalendarike.

Neni 8

Kushtet e përjashtimit

Përjashtimi i parashikuar në nenin 5 do të zbatohet me kusht që:

- (a) çdo ndërmarrje pjesëmarrëse, që ka dhënë një periudhë të arsyeshme

njoftimi, ka të drejtën të tërhiqet nga pool-i pa asnjë sanksion;

- (b) rregullat e pool-it të mos detyrojnë asnjë ndërmarrje pjesëmarrëse të sigurojë, ose ri-sigurojë nëpërmjet pool-i dhe të mos kufizojë asnjë ndërmarrje pjesëmarrëse në këtë pool nga sigurimi ose ri-sigurimi jashtë pool-it, pjesërisht apo tërësisht në një rrezik do të mbulohet nga pool-i.
- (c) rregullat e pool-it të mos kufizojnë veprimtarinë e tij, apo të ndërmarrjeve të tij pjesëmarrëse për asnjë rrezik të vërejtur, për sigurimin dhe ri-sigurimin, në çdo zonë gjeografike të Republikës së Shqipërisë;
- (d) marrëveshja nuk kufizon produktin apo shitjet;
- (e) marrëveshja nuk ndan tregun apo klientët; dhe
- (f) ndërmarrjet pjesëmarrëse të ri-sigurimit të përbashkët duhet të mos kenë rënë dakord për primet e shitjes, të zbatuara për sigurimin e drejtpërdrejtë.

Kapitulli IV

Dispozitat Përfundimtare

Neni 9

Periudha e vlefshmërisë

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe do të jetë e vlefshme deri më 31.12.2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

V E N D I M
Nr. 277, Datë 03/04/2013

“Për
hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit
të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm në zonën Porto Romano”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- | | | | |
|---|---------|-------------|------------|
| ▪ | Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| ▪ | Rezana | KONOMI | Zv/Kryetar |
| ▪ | Servete | GRUDA | Anëtar |
| ▪ | Koço | BROKA | Anëtar |
| ▪ | Iva | ZAJMI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 03.04.2013, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e kërkesës së Sekretariatit për hapjen e procedurës së hetimit paraprak për abuzim të mundshëm me pozitën dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm në portin “Romano Port”.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi kufizimet e konkurrencës në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe depozitimit të gazit të lëngshëm GLN në portin “Romano Port” ,

VËREN SE:

1. Ndërmarrja “Romano Port” SHA, ka lidhur një marrëveshje koncesioni me shtetin shqiptar për ndërtimi dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës në zonën Porto Romano në Durrës. Kjo marrëveshje është miratuar me anë të Ligjit nr. 9298, datë 28.10.2004, “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim, transferim), për ndërtimin dhe shfrytëzimin e pontilit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre në zonën bregdetare Porto Romano, Durrës”. Në bazë të kësaj marrëveshjeje “Romano Port” SHA ka përfituar të drejtën ekskluzive për një periudhë 30 vjeçare për ofrimin e shërbimit të ngarkim –shkarkimit të GLN-së në zonën Porto Romano.

2. Ky eskuzivitet që ka ndërmarrja Romano Port Sha. në kuptim të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, përbën një pengesë në hyrje në tregun përkatës. Në këtë mënyrë ndërmarrja Romano Port Sh.a në bazë të nenit 8 Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” ka pozitë dominuese (monopol) në tregun e ngarkim –shkarkimit të GLN-së në zonën Porto Romano, Durrës.

3. Referuar pikës 4 të marrëveshjes së koncesionit, koncesionari detyrohet të respektojë të drejtën e barazisë për shoqëritë që do të kryejnë shërbime nëpërmjet këtij objekti, duke respektuar legjislacionin në fuqi në këtë fushë dhe ky koncesion do të jetë e vetmja veprimtari që ka të drejtë të kryejë koncesionari, sipas objektit të kësaj marrëveshjeje.

4. Me Vendimin nr. 4, datë 27.04.2009 të OSHA është miratuar “Rregullorja e funksionimit të portit të përpunimit të lëndëve djegëse për shoqërinë Romano Port SHA”. Sipas nenit 36, pika g të kësaj rregulloreje përcaktohet se “në asnjë rast nuk duhet të shkelen të drejtat operuese në radhën e shkarkimit, duke respektuar radhën e njoftimit dhe të hyrjes në port sipas rradhës së faturës doganore”.

5. Me Vendimin nr 221, datë 11.04.2012, “Për abuzim me pozitën dominuese të ndërmarrjes “Romano Port” SHA në tregun e ngarkim shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës në rrugë detare”, ndërmarrja “Romano Port “ SHA është gjobitur për abuzim me pozitën dominuese.

6. Nga operatorë që operojnë në tregun e gazit të lëngshëm ,kanë ardhur në Autoritetin e Konkurrencës ankesa me pretendimin për pengimin e shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe vazhdimin e abuzimit me pozitën dominuese nga ana e ndërmarrjes “Romano Port “ SHA

7. Kjo sjellje mund të ketë si qëllim dhe/ose pasojë kufizimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg dhe mund të përbëjë shkelje të nenit 9, të Ligjit 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar) nga ana e “Romano Port” SHA.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 9, nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm në zonën “Porto Romano” për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

II. Periudha e hetimit do të jetë nga 11.04.2012 deri në 31.03. 2013.

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se data 03.05.2013.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS**Servete GRUDA****Koço BROKA****Iva ZAJMI****Rezana KONOMI**

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar**Lindita MILO (LATI)**

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M
Nr. 278, Datë 15.04.2013

**“Mbi
autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Investndërtim Tirana Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga GPL Costruzioni Generali S.r.l tek Investment Joti –Infosoft Group Sh.p.k”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

▪	Znj.	Lindita	Milo (Lati)	Kryetar
▪	Znj.	Rezana	Konomi	Zv. Kryetar
▪	Znj.	Servete	Gruda	Anëtar
▪	Z.	Koço	Broka	Anëtar
▪	Znj.	Iva	Zajmi	Anëtar;

Në mbledhjen e tij të datës 15.04.2013, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Investndërtim Tirana Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga GPL Costruzioni Generali S.r.l tek Investment Joti –Infosoft Group Sh.p.k

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, dhe neni 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit “ dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Investndërtim Tirana Sh.p.k me Investment Joti –Infosoft Group Sh.p.k dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi i cili ka për qëllim të sjellë përfitim të kontrollit të drejtpërdrejtë të shoqërisë Investndërtim Tirana Sh.p.k nga shoqëria Investment Joti Sh.p.k është realizuar me anë të ‘Akt Shitblerje Kuotash’ e nënshkruar ndërmjet palëve GPL Costruzioni Generali S.r.l dhe Investment Joti Sh.p.k më datë 21 Janar 2013 me objekt transferimin e 100% të kuotave të shoqërisë Investndërtim Tirana Sh.p.k tek shoqëria Investment Joti Sh.p.k. Ky operacion sjell ndryshimin e kontrollit mbi ndërmarrjen target Investndërtim Tirana Sh.p.k dhe për pasojë përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10, pika 1), shkronja a) të Ligjit, i cili duhet autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës. Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përsa i përket xhirove (neni 12/1).

2. Palët në transaksion

- **Investment Joti- Infsoft Group Sh.p.k**, (këtu e mëposhtë ‘**Investment Joti Sh.p.k**’) në cilësinë e **Blerësit**, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar me seli në adresën: Gjergji Center, Rruga “Murat Toptani”, Tiranë. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është: blerja, shitja dhe mbajtja në pronësi të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, etj.

- **GPL Costruzioni Generali S.r.l**, në cilësinë e **ortakut shitës** është një shoqëri e të drejtës italiane e themeluar që në vitin 1981 dhe që funksionon në bazë të legjislacionit Italian. Shoqëria është e regjistruar pranë Dhomës së Tregtisë së Ankones me numër 00720610427, me seli në adresën: Via Fioretti 14, Ancona, Itali. Shoqëria është titullare e 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë Investndërtim Tirana Sh.p.k dhe përfaqësohet nga zonja Paola Lanari në cilësinë e administratorit të vetëm të shoqërisë GPL Costruzioni Generali S.r.l.

- **Investndërtim Tirana Sh.p.k**, në cilësinë e **shoqërisë Target**, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar me seli në adresën: Rruga “Abdi Toptani”, Torre Drin, Kati 4, Tiranë. Shoqëria ka si objekt veprimtaritë: shitjen, blerjen, administrimin, dhënie me qira, rikostruksionin e ndërtesave, hoteleve, qendrave rezidenciale, tregtare, administrative dhe turistike si dhe kryerjen e shërbimeve të ndryshme në to si p.sh shërbime tregtare, reklamave, të argëtimit , etj.

3. Xhiro për vitin 2012

- Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është XXXLekë.
- Xhiro totale në **tregun e brendshëm**: është XXX Lekë, ku:
 - Investment Joti - Infsoft Group Sh.p.k : = XXX Lekë
 - Investment Joti - Infsoft Group Sh.p.k së bashku me shoqëritë në të cilat zotëron mbi 50% të kapitalit = XXXX Lekë.

- Investndërtim Tirana Sh.p.k është XXXX Lekë

Palët plotësojnë kriteret e xhiros të parashikuara në nenin 12.1 të Ligjit.

3. ANALIZA E KONKURRENCËS

A. Tregu përkatës

Investment Joti – Infosoft Group Sh.p.k ka si objekt të veprimtarisë së saj blerjen, shitjen dhe mbajtjen në pronësi të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, pjesëmarrje në shoqëri si dhe në borde drejtuese të shoqërive; konsulencë në menaxhim dhe administrim biznesi; menaxhim i shoqërive tregtare; rekrutim dhe menaxhim i burimeve njerëzore, etj. Aktualisht shoqëria Investment Joti-Infosoft Group nuk ka veprimtari në tregun e menaxhimit të pasurive të patundshme.

Investndërtim Tirana Sh.p.k ka si objekt veprimtarie shitje, blerje, administrim, dhënie me qera, rikonstruksionin e ndërtesave, hoteleve, qendrave rezidenciale, tregtare, administrative dhe turistike, si dhe kryerjen e shërbimeve të ndryshme në to, si për shembull por duke mos u kufizuar në: shërbime tregtare, reklama, argëtim, etj;

Tregu përkatës i produktit:

Tregu i ndërtimit dhe administrimit të pasurive të paluajtshme është i gjerë. Objekti i administrimit nga shoqëria Investndërtim Tirana sh.p.k është ndërtesa Torre Drin. Në pamundësi për të siguruar informacione lidhur me madhësinë totale të tregut, në kuptimin e vlerës së shitjeve dhe volumit (në njësi), mundemi vetëm të përmendim disa prej ndërtesave të cilat administrohen, në kuptimin e shitjes dhe dhënies me qera të ambienteve të tyre, por duke mos u kufizuar vetëm në to si: Tirana Business Center, European Trade Center, Veve Business Center, Aba Business Center, apo qendra të tjera tregtare (meqenëse Torre Drin i ka kushtuar Shopping Center, tre kate të ambienteve të saj), si Qendra Tregtare Univers, Tirana East Gate, Qendra Kristal, e të tjera. Në këtë kuptim, tregu përkatës i produktit do të jetë tregu i ndërtimit dhe administrimit të pasurive të paluajtshme.

Nëpërmjet përqendrimit të realizuar, shoqëria blerëse Investment Joti - Infosoft Group do të kryejë investime të shumta në rikonstruksionin e pasurisë në pronësi të shoqërisë Investndërtim Tirana sh.p.k, që është ndërtesa e emërtuar “Torre Drin”.

Në këtë ndërtesë do të kryhet investimi më i afërt dhe konkret që është rikonstruksioni i saj, duke shfrytëzuar inovacionet më të fundit të teknologjisë lidhur me sistemin ngrohës. Kjo do të sjellë një kursim të energjisë elektrike, cilësi më të mirë të shërbimeve që ofrohen dhe uljen e kostove të tyre.

II. Tregu përkatës gjeografik:

Ky treg përfshin hapësirën ku tregtohen produktet apo shërbimet e ofruara të përcaktuara në tregun e produktit.

Për vlerësimin e këtij përqendrimi, tregu përkatës gjeografik është konsideruar Republika e Shqipërisë.

B. Pozicioni në treg pas përqendrimit

Pjesa e tregut që Investndërtim Tirana sh.p.k do të zotërojë pas transaksionit do të ngelet po e njëjtë me pjesën e tregut të zotëruar nga kjo shoqëri para tij, pasi Investment Joti - Infosoft Group sh.p.k (blerësi) nuk është prezent në asnjë nga tregjet e produktit në të cilat Investndërtim Tirana është aktive.

Si pasojë, transaksioni nuk sjell ndryshime në strukturën e tregut pas përqendrimit dhe nuk krijon dhe as forcon një pozicion dominues të Investndërtim Tirana sh.p.k në tregun përkatës, duke mos e kufizuar kështu konkurrencën efektive në tregun përkatës të produktit.

Ky përqendrim realizohet në përmbushje të qëllimeve të shoqërisë Investment Joti - Infosoft Group sh.p.k për të investuar në sektorin e administrimit të pasurive të paluajtshme, kryesisht në rikonstrukcion, shitje dhe dhënie me qera të tyre.

4. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Përqendrimi i cili ka për qëllim të sjellë përfitim të kontrollit të drejtpërdrejtë të shoqërisë Investndërtim Tirana Sh.p.k nga shoqëria Investment Joti Sh.p.k dhe sjell ndryshimin e kontrollit mbi Investndërtim Tirana Sh.p.k përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10, pika 1), shkronja b) të Ligjit. Përqendrimi nuk sjell ndryshime në strukturën e tregut në aspektin e përqendrimit të tregut dhe presionit konkurrues.

Nëpërmjet realizimit të këtij përqendrimit ndërmarrja Investment Joti - Infosoft Group sh.p.k synon të investojë në sektorin e administrimit të pasurive të paluajtshme, kryesisht në rikonstrukcion, shitje dhe dhënie me qera të tyre.

Përqendrimi nuk sjell asnjë ndryshim në pjesën e tregut që zë aktualisht shoqëria Investndërtim Tirana sh.p.k, pasi përfituesi i kontrollit nuk është prezent në tregun e produktit para përqendrimit dhe për pasojë nuk ndryshon struktura e tregut pas përqendrimit. Gjithashtu, pas përqendrimit nuk do të kemi krijim apo forcim të pozitës dominuese të ndërmarrjes Investndërtim Tirana sh.p.k në tregun përkatës.

Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Investndërtim Tirana Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga GPL Costruzioni Generali S.r.l tek Inestment Joti –Infosoft Group Sh.p.k
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

Nr. 279, Datë 22.04.2013

“Mbi

autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Euromax Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga shoqëria Balfin Sh.p.k tek shoqëria CM Balkans B.V”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | |
|----------------|-------------|-------------|
| ▪ Znj. Lindita | Milo (Lati) | Kryetar |
| ▪ Znj. Rezana | Konomi | Zv. Kryetar |
| ▪ Znj. Servete | Gruda | Anëtar |
| ▪ Z. Koço | Broka | Anëtar |
| ▪ Znj. Iva | Zajmi | Anëtar; |

Në mbledhjen e tij të datës 22.04.2013, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Euromax Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga shoqëria Balfin Sh.p.k tek shoqëria CM Balkans B.V.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, dhe neni 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit “ dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Euromax Sh.p.k me CM Balkans B.V dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet në bazë të ‘Kontratës për shit-blerje kuotash’ të lidhur më datë 6 Mars 2013, ndërmjet palëve (“CM Balkans B.V” në cilësinë e blerësit dhe “Balfin Sh.p.k” në cilësinë e shitësit”) me qëllim përfundimin e kontrollit të shoqërisë Euromax Sh.p.k nga shoqëria CM Balkans B.V nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave.

Ky transaksion i cili ndryshon cilësinë e kontrollit në ndërmarrjen target (Euromax Sh.p.k) në formën e transferimit të kuotave nga shitësit te blerësi përbën një përqendrim në bazë të nenit 10 pika 1) , shkronja b) e Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar. Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përsa i përket xhirove (neni 12/1).

2. Palët në transaksion

❖ **CM Balkans B.V** në cilësinë e **blerësit**, me seli në adresën: PrinsBernhapplein 200, 1097JB, Amsterdam, Hollandë. Shoqëria ka si objekt veprimtarie: themelimin, blerjen, zotërimin, pjesëmarrjen, tjetërsimin, menaxhimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të shoqërive dhe ndërmarrjeve që operojnë në aktivitete të shitjes me pakicë të produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore në territoret e Shqipërisë, Sllovenisë, Serbisë, Bosnie Hercegovinës, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Bullgarisë etj.

❖ **Balfin Sh.p.k**, në cilësinë e **shitësit**, me seli në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II, ABA Business Centre, kati 12, Tiranë. Shoqëria kryen aktivitet në fushën e (i) import- eksportit, shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve tekstile, veshjeve të të gjitha llojeve; (ii) shitjen me shumicë dhe pakicë të mallrave industrialë dhe ushqimorë; (iii) tregtimi i artikujve të ndryshëm; (iv) importin dhe eksportin , shitjen me shumice dhe pakicë të pajisjeve elektronike, lëndë të parë për industrinë, materiale ndërtimi e hidrosanitare, pajisje zyrash kancelari, pjesë këmbimi auto e makineri të çdo lloji, pajisje teknologjike , etj;

❖ **Euromax Sh.p.k**, në cilësinë e ndërmarrjes **target** është një shoqëri e themeluar dhe funksionon sipas legjislacionit shqiptar, me seli në Kashar, Tiranë. Objekti i kësaj shoqërie ishte importi eksporti; tregtimi i artikujve të ndryshëm (kryesisht ushqime, pije, duhan), servis paisjesh elektronike dhe elektroshtëpiake, automjeteve etj; transport të mallrave dhe udhëtarëve urbanë, ndërrurbanë dhe ndërkombëtarë.

3. Xhiro për vitin 2012

- Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është **XXXLekë**, ku:
 - CM Balkans B.V. : = XXX lekë
 - Delhaize Group : XXXX Euro = XXXX lekë
 - Balfin sh.p.k.së bashku me shoqëritë e lidhura XXX lekë
- Xhiro totale në **tregun e brendshëm**: është **XXX Lekë**, ku:
 - CMB Albania sh.p.k. = XXXX lekë
 - Delhaize Albania sh.p.k. = XXXX leke
 - Balfin së bashku me shoqëritë e lidhura = XXXX leke (Balfin sh.p.k. si shoqëri e vetme = XXXX lekë)

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1 të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

4. ANALIZA E KONKURRENCËS

4.1 Tregu përkatës

Tregu përkatës i produktit do të përkufizohet si tregu i shitjes me pakicë i produkteve ushqimore dhe mallrave të konsumit që kanë qëllim furnizimin ditor dhe të rastit të familjeve nëpërmjet formateve të dyqaneve të paspecializuara si dyqanet në afërsi të lagjes, supermarketeve dhe hipermarketeve.

Tregu përkatës gjeografik: ky treg përfshin hapësirën ku tregtohen produktet apo shërbimet e ofruara të përcaktuara në tregun e produktit. Për vlerësimin e këtij përqendrimi, tregu përkatës gjeografik është konsideruar rajoni gjeografik ku konsumatorët kanë akses pa kosto shtesë transporti në rrjetet e dyqaneve Carfour dhe Euromax duke përfshirë Tiranën, Durrësin, Fierin, Vlorën dhe Elbasanin.

4.2 Përqendrimi i tregut

Tregu i shitjes me pakicë i ushqimeve dhe mallrave të konsumit është i formuar kryesisht nga dyqane të mesëm e të vegjël dhe të pavarur nga njëri tjetri, duke patur kështu karakteristikat e një tregu kryesisht tradicional.

Ndërkohë, tregtia me pakicë në format modern (supermarkete, hipermarkete etj) ka marrë zhvillim vetëm gjatë viteve të fundit. Kështu nëse do t’i referoheshim të dhënave të mundësuar nga palët në formularin e njoftimit të përqendrimit, ajo përfaqëson jo me shume se 9% të tregut me pakicë të këtyre produkteve dhe mallrave.

Përqendrimi sjell ndryshime në rritje në pjesën e tregut që zë aktualisht shoqëria CM Balkans B.V., por nuk sjell ndryshime të mëdha në strukturën e tregut pas përqendrimit. Pas përqendrimit shoqëria CMB Albania sh.p.k. bëhet konkurrenti kryesor në këtë treg me 5.1% të tij.

Për shkak të strukturës që ka tregu i shitjes me pakicë në Shqipëri (numrit të madh të dyqaneve të vogla dhe të mesme dhe pavarësisë nga njëri tjetri), por edhe të përqindjes së tregut që zotërojnë pjesëmarrësit në të, mundësitë e tyre për të rritur çmimet në mënyrë të njëanshme janë të limituara. Gjithashtu, për të njëjtat arsye, krijimi apo zhvillimi i praktikave të përbashkëta veçanërisht për fiksimin e çmimit nga pjesëmarrësit në treg do të ishte i pamundur.

4.3 Vlerësimi i efijences se përqendrimit

Nëpërmjet përfutimit të kontrollit të drejtëpërdrejtë të Euromax Sh.p.k nga shoqëria CM Balkans B.V., kjo e fundit synon të shtrijë dhe zgjerojë aktivitetin e saj nëpërmjet filialit të saj CMB Albania sh.p.k në këtë treg duke shfrytëzuar pozitën aktuale të vetë shoqërisë target.

Përmes këtij përqendrimi, blerësi synon të zgjerojë veprimtarinë e tij në fushën e tregtisë me pakicë të mallrave ushqimorë dhe jo-ushqimorë në territorin e Shqipërisë.

Pala njoftuese shprehet se do të ketë një impakt pozitiv të përqendrimit të realizuar si përse i përket performancës financiare ashtu dhe përfitime për konsumatorët. Pas përqendrimit pritet të rriten shitjet dhe të përmirësohen kushtet e furnizimit dhe shumëllojshmëria e produkteve.

Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Euromax Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga shoqëria Balfin Sh.p.k tek shoqëria CM Balkans B.V.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Rezana KONOMI
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M
Nr. 280, Datë 22.04.2013

“Për një ndryshim në vendimin Nr. 275, datë 25.03.2013 për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | | |
|---|---------|-------------|------------|
| ▪ | Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| ▪ | Rezana | KONOMI | Zv/Kryetar |
| ▪ | Servete | GRUDA | Anëtar |
| ▪ | Koço | BROKA | Anëtar |
| ▪ | Iva | ZAIMI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 22.04.2013, trajtoi çështjen me:

Objekt: Ndryshimin e vendimin Nr. 275, datë 25.03.2013 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë”.

Baza ligjore: Nenet 24, (shkronja d); 26 dhe 43, (pika 1) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Neni 129 Ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i procedurave administrative”, neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, si dhe neni 5/3 i rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”

VËREN SE :

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), me propozim të Sekretariatit,

me anë të Vendimit Nr. 275, datë 25.03.2013 “Per hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë”.

Komisioni i Konkurrencës :

VENDOSI :

I. Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania Sha, në tregun e telefonisë celulare me pakicë.

II. Hetimi i thelluar të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2011 deri në 31.12.2012.

III. Procedurat e hetimit të thelluar duhet të përfundojnë jo më vonë se 6 muaj nga data e marrjes së këtij vendimi.

IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Në këtë vendim nuk është përfshirë adresa dhe mënyrat e komunikimit me Autoritetin, si dhe afati kohor brenda të cilit ndërmarrja dhe personat e tjerë të interesuar mund të ushtrojnë të drejtën për të bërë të njohur këndvështimet e tyre siç parashikohet në Rregulloren “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës” neni 5/3.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të Neneve 24, (shkronja d); 26 dhe 43, (pika1) të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Neni 129 ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i procedurave administrative”, neni 12 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, si dhe neni 5/3 i rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”

V E N D O S I:

I. Në dispozitivin e Vendimit nr. 275, datë 25.03.2013 për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë, të shtohen pikat V me përmbatje si vijon:

V. Ndërmarrja nën hetim dhe personat e tjerë të interesuar mund të ushtrojnë të drejtën për të bërë të njohur këndvështrimet e tyre për këtë hetim brenda 15 ditëve nga marrja e këtij vendimi. Komunikimi me Autoritetin e konkurrencës bëhet cdo ditë pune, në adresën e institucionit Rruga “S. Frashëri”, Nr. 4, Kati IV, Tiranë, Shqipëri, Tel: 04/2234504, Fax: 04/2234497, E-Mail: competition@caa.gov.al website: www.caa.gov.al.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

Nr. 281, Datë 30.04.2013

“Mbi

**autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të
vetëm të Hec Ulëz Shkopet nëpërmjet transferimit të 100% të aksioneve të
kësaj të fundit tek shoqëria Kurum International Sh.a”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | |
|----------------|-------------|-------------|
| ▪ Znj. Lindita | Milo (Lati) | Kryetar |
| ▪ Znj. Rezana | Konomi | Zv. Kryetar |
| ▪ Znj. Servete | Gruda | Anëtar |
| ▪ Z. Koço | Broka | Anëtar |
| ▪ Znj. Iva | Zajmi | Anëtar |

në mbledhjen e tij të datës 30.04.2013, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të Hec Ulëz Shkopet nëpërmjet transferimit të 100% të aksioneve të kësaj të fundit tek shoqëria Kurum International Sh.a

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit “ dhe Formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Kurum International Sh.a me Hec Ulëz Shkopet dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Transaksioni i transferimit të 100% të aksioneve të Hec Ulëz Shkopet, i cili vjen si pasojë e privatizimit të kësaj të fundit duke e shndërruar atë nga ndërmarrje shtetërore në ndërmarrje private, është realizuar me anë të “Kontratës për shitblerjen e aksioneve” datë 11 Shkurt 2013. Kjo kontratë është nënshkruar nga palët: METE në cilësinë e shitësit dhe nga Kurum International Sh.a në cilësinë e blerësit me objekt 100% të kapitalit aksionar të ndërmarrjes target Hec Ulëz Shkopet Sh.a. Me anë të kontratës palët kanë parashikuar kushtet e shitblerjes së aksioneve dhe regjimin e përgjegjësisë dhe angazhimeve të secilit për përmbylljen e transaksionit.

Përqendrimi vjen si pasojë e qëllimit të qeverisë shqiptare për të privatizuar këto hidrocentrale në bazë të ligjit për privatizimin e sektoreve strategjike duke patur parasysh aksesin më të lartë të shoqërive private në burime financiare dhe kërkesat e mëdha për investime dhe mirëmbajtje që kërkojnë sektorë të caktuar të ekonomisë.

Ky transaksion, i cili jep kontrollin e vetëm dhe të plotë mbi ndërmarrjen target (Hec Ulëz Shkopet) shoqërisë Kurum International Sh.a, në kuptim të nenit 10, pika 1) shkronja b) të Ligjit përbën një përqendrim. Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përse i përket xhirove (neni 12/1).

2. Palët në transaksion

❖ **Kurum International Sh.a**, në cilësinë e **blerësit**, është një shoqëri që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar me seli në adresën: Kombinati Metalurgjik Bradashesh - Elbasan. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë përfshin: prodhim, tregtim i çeliqueve të ndërtimit e profileve të tjera të hekurit, importimi dhe eksportimi me shumicë dhe pakicë i mallrave të ndryshëm industrialë, ushqimorë, konfeksioneve, elektroshtëpiake, karburanteve e lubrifikantëve, lëndë të para ndihmëse për industrinë e çelikut e të gjitha mineraleve të tjera, etj.

❖ **Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës (METE)** në cilësinë e shitësit.

❖ **Hec Ulëz Shkopet Sh.a**: në cilësinë e **ndërmarrjes target**, është një shoqëri aksionere me pjesëmarrje tërësisht shtetërore e krijuar në bazë të Ligjit nr. 10430, datë 09.06.2011 “Për krijimin e shoqërive HEC Ulëz - Shkopet Sh.a, HEC Tiranë-Lanabregas Sh.a dhe HEC Bistrica1 dhe Bistrica 2 Sh.a , dhe përcaktimin e formës së strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive HEC Ulëz-Shkopet Sh.a dhe HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2 Sh.a”, me adresë në Burrel. Objekti i veprimtarisë së Hec-it është prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike.

3. Xhiro për vitin 2012

- Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është XXX Lekë:
- Xhiro totale në tregun e brendshëm: është: XXXX Lekë
 - o **Kurum International sh.a.** : = XXX Lekë
 - o **HEC Ulëz - Shkopet sh.a.** : = XXX Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros të përcaktuara në nenin 12, pika 1 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

4. ANALIZA E KONKURRENCËS

Tregu Përkatës:

Spektori ekonomik objekt i këtij përqendrimi është tregu i energjisë elektrike, i cili është dizenuar dhe funksionon në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.03.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike” .

A) Tregu përkatës i produktit

Kurum International sh.a. njihet kryesisht për prodhimin, përpunimin, tregtimin import - eksportin e hekurit të ndërtimit, grumbullim, demolim, përpunim, tregtim import - eksport të skrapeve të ndryshëm në zonën e ish - Kombinatit Metalurgjik, fabrika të privatizuara nga shoqëria në vitin 2009.

Veprimtari të tjera të ndërmarrjes përfshijnë:

Prodhimin dhe tregtimin e oksigjenit, azotit, avullit dhe tregtimit të tyre (për këtë qëllim Kurum ka një marrëveshje konçesioni me shtetin shqiptar për fabrikën e oksigjenit në Elbasan).

Kërkim, zhvillim, prodhim dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të gazoil, benzinës, solarit, mazutit, bitumit, gazit të lëngëzuar të naftës (GLN), gazit dhe të gjitha nënprodukteve të tjera të naftës.

Prodhimin, tregtimin e gëlqeres (për këtë qëllim Kurum ka në pronësi fabrikën e gëlqeres në zonën e ish –Kombinatit Metalurgjik, Elbasan)

Kurum International sh.a. është klient i kualifikuar.

HEC Ulëz - Shkopet sh.a. është një shoqëri aksionere me pjesëmarrje tërësisht shtetërore, e krijuar në bazë të Ligjit Nr 10430, dt 09.06.2012 “ Për krijimin e shoqërive HEC Ulëz - Shkopet sh.a, HEC Tiranë Lanabregas sh.a. dhe HEC Bistrica 1 & Bistrica 2 sh.a, dhe përcaktimin e formës e të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive HEC Ulëz - Shkopet sh.a dhe HEC Bistrica 1 & Bistrica 2 sh.a. HEC Ulëz - Shkopet sh.a

ka qënë fillimisht pjesë e strukturës gjeneruese të shoqërisë publike KESH (KESH Gen). Asetet e pasuritë e lidhura me këtë hidrocentral u ndanë dhe u shkëputën nga struktura gjeneruese e KESH për të krijuar shoqërinë target me qëllim privatizimin e saj.

HEC Ulëz - Shkopet sh.a me fuqi dhe kapacitet përkatësisht: Ulëza me 24 MË dhe Shkopeti me 24 MË, është i licensuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me Vendim nr. 132, datë 06.12.2011 dhe në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike me Vendim nr. 133, datë 06.12.2011 nga ERE. Gjithashtu është licensuar nga ERE në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike me Vendim nr. 106, dt. 20.07.2012

Tregu përkatës i produktit është tregu i gjenerimit dhe tregtimit të energjisë elektrike.

B) Tregu përkatës gjeografik:

Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu i gjenerimit të energjisë elektrike

Tregu i gjenerimit përfshin prodhimin/gjenerimin e energjisë elektrike nga HEC-et, dhe TEC-et.

Prodhimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëria publike KESH sh.a. me strukturën e saj KESH Gen dhe nga prodhuesit privatë, të cilët kanë privatizuar dhe shfrytëzojnë HEC-et ekzistues si dhe subjektet që kanë nënshkruar marrëveshje konçesionare me Qeverinë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e HEC-eve të rinj.

Hec Ulëz Shkopet janë pjesë e HEC-eve ekzistuese publike.

Tregu i tregtimit të energjisë elektrike.

Sipas modelit shqiptar të tregut të energjisë elektrike ky treg përbëhet nga pjesa e rregulluar dhe pjesa e parregulluar e tij.

Aktorët pjesëmarrës në tregun e tregtimit të energjisë elektrike janë:

- FPSH (furnizuesi publik me shumicë), strukturë e KESH sh.a, i cili blen energji nga KESH Gen, PPE (prodhuesit e pavarur të energjisë), PVE (prodhuesit e vegjël të energjisë) dhe tregtuesit, me qëllim shitjen tek FPP (furnizuesit publik me pakicë).
- FPP është një strukturë e organizuar brenda shoqërisë së shpërndarjes (OSSH) për të kryer veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike të klientëve tariforë. FPP iu shet energji elektrike klientëve tariforë sipas një kontrate me kushte dhe tarifa të rregulluara nga ERE.
- PVE-të janë të lidhur direkt me sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe shitjen e energjisë elektrike e kryejnë nëpërmjet furnizuesit publik me shumicë

ose duke lidhur kontrata direkt me konsumatorët e energjisë me tarifa të liberalizuara.

- PPE janë prodhues të energjisë të lidhur me sistemin e transmetimit, të cilët ia shesin energjinë FPSH me cmime të rregulluara nga ERE.
- Furnizuesit e kualifikuar janë të licensuar për të furnizuar me energji klientët e kualifikuar me cmime të liberalizuara.
- Tregtuesit e energjisë janë të licensuar për të blerë dhe shitur energji duke përjashtuar furnizuesin publik me pakicë (FPP).

- Prodhimi publik i energjisë elektrike

Prodhimi publik i energjisë elektrike kryhet nga Shoqëria aksionere KESH sh.a. me 100% të aksioneve nga shteti si dhe nga Shoqëria TEC –Vlora me 100% të aksioneve nga shteti, gjithashtu pjesë e KESH sh.a.

Prodhimi publik zë rreth 93% të prodhimit të përgjithshëm neto vendas për vitin 2012.

- Prodhimi privat i energjisë elektrike

Aktualisht janë në prodhim 68 hidrocentrale nga 40 shoqëri private dhe konçesionare me fuqi të përgjithshme të instaluar prej 195.8 MË, nga të cilat rreth 120MË përbëjnë HEC që kanë filluar prodhimin gjatë vitit 2012.

Prodhimi i përgjithshëm për vitin 2012 nga gjeneruesit privat ishte 299.9GËh ose rreth 7% e prodhimit të përgjithshëm neto vendas.

Konkurenti më i madh në tregun e prodhimit të energjisë elektrike është KESH Sha, i cili aktualisht zë rreth 93% të këtij tregu.

5. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Qeveria Shqiptare inkurajon investimet private për ndërtimin e centraleve të rinj elektrik për të plotësuar kërkesat e vendit me energji elektrike dhe për të garantuar siguri të lartë furnizimi nëpërmjet diversifikimit të burimeve të gjenerimit.

Tregu i prodhimit të energjisë elektrike është një treg i rregulluar dhe i mbikqyrur nga Enti Rregullator i Energjisë Elektrike.

Nëpërmjet përfutimit të plotë të kontrollit të HEC Bistrica 1 & 2, shoqëria Kurum International sh.a. synon ezaurimin e nevojave për furnizim me energji elektrike të veprimtarive të ndryshme të grupit të shoqërive Kurum në Shqipëri. Kapaciteti i mbetur nëse do të ketë të tillë, mund të shitet tek palët e treta në përputhje me liçensat e shoqërive HEC Bistrica 1 & 2 dhe HEC Ulëz – Shkopet

Prodhimi i energjisë elektrike nga HEC-et private/konçesion do të arrijë në 14.11%. Gjithsesi për shkak të peshës së konsiderueshme që zë KESH sh.a. në tregun e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike nuk ka arsye shkaksore të krijimit të një pozite dominuese nga prodhuesit e pavarur të energjisë.

Si konkluzion, transaksioni i njoftuar konsiston në përfitim të plotë të kontrollit nga shoqëria Kurum International sh.a. nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve të HEC Ulëz Shkopet, në pronësi të Shtetit Shqiptar prej METE, dhe nuk krijon pozitë dominuese të shoqërisë pas përqendrimit.

Si konkluzion, përqëndrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të vetëm të Hec Ulëz Shkopet nëpërmjet transferimit të 100% të aksioneve të kësaj të fundit tek shoqëria Kurum International Sh.a.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 282, Datë 30.04.2013

“Mbi

autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të vetëm të Hec Bistrica 1 Bistrica 2 nëpërmjet transferimit të 100% të aksioneve të kësaj të fundit tek shoqëria Kurum International Sh.a”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | |
|----------------|-------------|-------------|
| ▪ Znj. Lindita | Milo (Lati) | Kryetar |
| ▪ Znj. Rezana | Konomi | Zv. Kryetar |
| ▪ Znj. Servete | Gruda | Anëtar |
| ▪ Z. Koço | Broka | Anëtar |
| ▪ Znj. Iva | Zajmi | Anëtar; |

Në mbledhjen e tij të datës 30.04.2013, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të vetëm të Hec Bistrica 1 Bistrica 2 nëpërmjet transferimit të 100% të aksioneve të kësaj të fundit tek shoqëria Kurum International Sh.a

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit “ dhe Formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Kurum International Sh.a me Hec Bistrica 1 Bistrica 2 dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

1. **Transaksioni dhe përqendrimi**

Transaksioni i transferimit të 100% të aksioneve të Hec Bistrice 1 dhe Bistrice 2, i cili vjen si pasojë e privatizimit të kësaj të fundit duke e shndërruar atë nga ndërmarrje shtetërore në ndërmarrje private, është realizuar me anë të “Kontratës për shitblerjen e aksioneve” datë 11 Shkurt 2013. Kjo kontratë është nënshkruar nga palët METE në cilësinë e shitësit dhe nga Kurum International Sh.a në cilësinë e blerësit me objekt 100% të kapitalit aksionar të ndërmarrjes target Hec Bistrice 1 dhe Bistrice 2 Sh.a. Me anë të kontratës palët kanë parashikuar kushtet e shitblerjes së aksioneve dhe regjimin e përgjegjësisë dhe angazhimeve të secilit për përmbylljen e transaksionit.

Përqendrimi vjen si pasojë e qëllimit të qeverisë shqiptare për të privatizuar këto hidrocentrale në bazë të ligjit për privatizimin e sektoreve strategjike duke patur parasysh aksesin më të lartë të shoqërive private në burime financiare dhe kërkesat e mëdha për investime dhe mirëmbajtje që kërkojnë sektorë të caktuar të ekonomisë.

Ky transaksion i cili jep kontrollin e vetëm dhe të plotë mbi ndërmarrjen target (Hec Bistrice 1 dhe Bistrice 2) shoqërisë Kurum International Sh.a, në kuptim të neneit 10, pika 1) shkronja b) të Ligjit përbën një përqendrim. Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përse i përket xhirove (neni 12/1).

2. **Palët në transaksion**

❖ **Kurum International Sh.a**, në cilësinë e **blerësit**, është një shoqëri që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar me seli në adresën: Kombinati Metalurgjik Bradashesh - Elbasan. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë përfshin: prodhim, tregtim i çeliqueve të ndërtimit e profileve të tjera të hekurit, importimi dhe eksportimi me shumicë dhe pakicë i mallrave të ndryshme industriale, ushqimorë, konfeksioneve, elektroshtëpiake, karburanteve e lubrifikantëve, lëndë të para ndihmëse për industrinë e çelikut e të gjitha mineraleve të tjera, etj.

❖ **Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës (METE)** në cilësinë e **shitësit**.

❖ **Hec Bistrice 1 dhe Bistrice 2 Sh.a**: në cilësinë e **ndërmarrjes target**, është një shoqëri aksionere me pjesëmarrje tërësisht shtetërore e krijuar në bazë të Ligjit nr. 10430, datë 09.06.2011 “Për krijimin e shoqërive HEC Ulëz - Shkopet Sh.a, HEC Tiranë-Lanabregas Sh.a dhe HEC Bistrice1 dhe Bistrice 2 Sh.a , dhe përcaktimin e formës së strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive HEC Ulëz-Shkopet Sh.a dhe HEC Bistrice1 dhe Bistrice 2 Sh.a”, me adresë në Sarandë. Objekti i veprimtarisë së Hec-it është prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike.

3. Xhiro për vitin 2012

- Xhiro totale në tregun ndërkombëtar është 0 Lekë:
- Xhiro totale në tregun e brendshëm: është: XXXLekë
 - o **Kurum International sh.a.** : = XXXX Lekë
 - o **HEC Bistrica 1 & 2 sh.a.** : = XXXX Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros të përcaktuara në nenin 12, pika 1 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si rrjedhojë, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

4. ANALIZA E KONKURRENCËS

7.1 Tregu Përkatës:

Sektori ekonomik objekt i këtij përqendrimi është tregu i energjisë elektrike, i cili është dizenuar dhe funksionon në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.03.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike” .

A) Tregu përkatës i produktit

Kurum International sh.a. njihet kryesisht për prodhimin, përpunimin, tregtimin import - eksportin e hekurit të ndërtimit, grumbullim, demolim, përpunim, tregtim import - eksport të skrapëve të ndryshëm në zonën e ish - Kombinatit të Metalurgjikut, fabrika të privatizuara nga shoqëria në vitin 2009.

Veprimtari të tjera të ndërmarrjes përfshijnë:

- Prodhimin dhe tregtimin e oksigjenit, azotit, avullit dhe tregtimin të tyre (për këtë qëllim Kurum ka një marreveshje konçesioni me shtetin shqiptar për fabrikën e oksigjenit në Elbasan).
- Kërkim, zhvillim, prodhim dhe tregtim me shumicë dhe pakicë të gazoil, benzinës, solarit, mazutit, bitumit, gazit të lëngëzuar të naftës (GLN), gazit dhe të gjitha nënprodukteve të tjera të naftës.
- Prodhimin, tregtimin e gëlqeres (për këtë qëllim Kurum ka në pronësi fabrikën e gëlqeres në zonën e ish –Kombinatit Metalurgjik, Elbasan)

Kurum International sh.a. është Klient i Kualifikuar

HEC Bistrica 1 & 2 sh.a. – është një shoqëri aksionere me pjesmarrje tërësisht shtetërore, e krijuar në bazë të Ligjit Nr 10430, dt 09.06.2012 “ Për krijimin e shoqërive HEC Ulëz - Shkopet sh.a., HEC Tiranë Lanabregas sh.a. dhe HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2 sh.a., dhe përcaktimin e formës e të strukturës së formulës së privatizimit të shoqërive HEC Ulëz Shkopet sh.a dhe HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2 sh.a. Hidrocentrali i Bistrica

1 & 2 ka qënë fillimisht pjesë e strukturës gjeneruese të shoqërisë publike KESH (KESH Gen). Asetet e pasuritë e lidhura me këtë hidrocentral u ndanë dhe u shkëputën nga struktura gjeneruese e KESH për të krijuar Shoqërinë Target me qëllim privatizimin e saj.

HEC Bistrica 1 & 2 me fuqi dhe kapacitet përkatësisht Bistrica 1 me 22.5Më dhe Bistrica 2 me 5Më, është e licensuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike me vendim nr 136, dt 06.12.2011 dhe në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike me vendim nr 137, dt 06.12.2011 nga ERE. Gjithashtu është liçensuar nga ERE në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike me vendim nr 110, dt 31.07.2012.

Tregu përkatës i produktit është tregu i gjenerimit dhe tregtimit të energjisë elektrike.

B) Tregu përkatës gjeografik:

Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Tregu i gjenerimit të energjisë elektrike

Tregu i gjenerimit përfshin prodhimin/gjenerimin e energjisë elektrike nga HEC-et, dhe TEC-et.

Prodhimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëria publike KESH sh.a. me strukturën e saj KESH Gen dhe nga prodhuesit privatë, të cilët kanë privatizuar dhe shfrytëzojnë HEC-et ekzistues si dhe subjektet që kanë nënshkruar marrëveshje konçesionare me Qeverinë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e HEC-eve të rinj.

Hec Bistrica 1 & 2 janë pjesë e HEC-eve ekzistuese publike.

Tregu i tregtimit të energjisë elektrike.

Sipas Modelit Shqiptar të Tregut të Energjisë Elektrike, ky tregu përbëhet nga pjesa e rregulluar dhe pjesa e parregulluar e tij.

Aktorët pjesëmarrës në tregun e tregtimit të energjisë elektrike janë:

- FPSH (furnizuesi publik me shumicë), strukturë e KESH sh.a, i cili blen energji nga KESH Gen, PPE (prodhuesit e pavarur të energjisë), PVE (prodhuesit e vegjël të energjisë) dhe tregtuesit, me qëllim shitjen tek FPP (furnizuesit publik me pakicë).
- FPP është një strukturë e organizuar brenda shoqërisë së shpërndarjes (OSSH) për të kryer veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike të klientëve tariforë. FPP iu shet energji elektrike klientëve tariforë sipas një kontrate me kushte dhe tarifa të rregulluara nga ERE.
- PVE-të janë të lidhur direkt me sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe shitjen e energjisë elektrike e kryejnë nëpërmjet furnizuesit publik me shumicë ose duke lidhur kontrata direkt me konsumatorët e energjisë me tarifa të liberalizuara.

- PPE janë prodhues të energjisë të lidhur me sistemin e transmetimit, të cilët ia shesin energjinë FPSH me çmime të rregulluara nga ERE.
- Furnizuesit e kualifikuar janë të licensuar për të furnizuar me energji klientët e kualifikuar me çmime të liberalizuara.
- Tregtuesit e energjisë janë të licensuar për të blerë dhe shitur energji duke përjashtuar furnizuesin publik me pakicë (FPP).

- Prodhimi publik i energjisë elektrike

Prodhimi publik i energjisë elektrike kryhet nga Shoqëria aksionere KESH sh.a. me 100% të aksioneve nga shteti si dhe nga Shoqëria TEC –Vlora me 100% të aksioneve nga shteti, gjithashtu pjesë e KESH sh.a.

Prodhimi publik zë rreth 93% të prodhimit të përgjithshëm neto vendas për vitin 2012.

- Prodhimi privat i energjisë elektrike

Aktualisht janë në prodhim 68 hidrocentrale nga 40 shoqëri private dhe konçesionare me fuqi të përgjithshme të instaluar prej 195.8 MË nga të cilat rreth 120MË përbëjnë HEC që kanë filluar prodhimin gjatë vitit 2012.

Prodhimi i përgjithshëm për vitin 2012 nga gjeneruesit privat ishte 299.9GËh ose rreth 7% e prodhimit të përgjithshëm neto vendas.

Konkurenti më i madh në tregun e prodhimit të energjisë elektrike është KESH Sha, i cili aktualisht zë rreth 93% të këtij tregu.

4.3 Vlerësimi pas përqëndrimit

Qeveria Shqiptare inkurajon investimet private për ndërtimin e centraleve të rinj elektrik për të plotësuar kërkesat e vendit me energji elektrike dhe për të garantuar siguri të lartë furnizimi nëpërmjet diversifikimit të burimeve të gjenerimit.

Tregu i prodhimit të energjisë elektrike është një treg i rregulluar dhe i mbikqyrur nga Enti Rregullator i Energjisë Elektrike.

Nëpërmjet përfundimit të plotë të kontrollit të HEC Bistrica 1 & 2, shoqëria Kurum International sh.a. synon ezaurimin e nevojave për furnizim me energji elektrike të veprimtarive të ndryshme të grupit të shoqërive Kurum në Shqipëri. Kapaciteti i mbetur nëse do të ketë të tillë, mund të shitet tek palët e treta në përputhje me licensat e shoqërive HEC Bistrica 1 & 2 dhe HEC Ulëz – Shkopet

Prodhimi i energjisë elektrike nga HEC-et private/konçesion do të arrijë në 14.11%. Gjithsesi për shkak të peshës së konsiderueshme që zë KESH sh.a. në tregun e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike nuk ka arsye shkakore të krijimit të një pozite dominuese nga prodhuesit e pavarur të energjisë.

Si konkluzion, transaksioni i njoftuar konsiston në përftimin e plotë të kontrollit të nga shoqëria Kurum International sh.a. nëpërmjet blerjes së 100% të aksioneve të HEC Bistrica 1 & 2, në pronësi të shtetit shqiptar prej METE, dhe nuk krijon pozitë dominuese të shoqërisë pas përqendrimit.

Si konkluzion, përqëndrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të vetëm të Hec Bistrica 1, Bistrica 2 nëpërmjet transferimit të 100% të aksioneve të kësaj të fundit tek shoqëria Kurum International Sh.a.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 283, Datë 08.05.2013

**“Për
mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit
të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

▪	Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪	Rezana	KONOMI	Zv/Kryetar
▪	Servete	GRUDA	Anëtar
▪	Koço	BROKA	Anëtar
▪	Iva	ZAIMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 08.05.2013, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Ekzistenca ose jo e marrëveshjes në oferta ndërmjet ndërmarrjeve “Alben 2 Security” Sh.p.k, “E Security” Sh.p.k, “Vaso Security” Sh.p.k, “Security Vaso” Sh.p.k, “Ernisa S” Sh.p.k, “Nisa Security” Sh.p.k”, “Hoxha” Sh.p.k, “Korca Security” Sh.p.k dhe “Hoxha Security” Sh.p.k, për kufizim të konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d); neni 26; neni 4, pika 1; neni 74 pika 1, shkronja a) dhe neni 75, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Ligji nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të grupit të punës mbi hetimin e thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës ndaj ndërmarrjeve: “Alben 2 Security” Sh.p.k, “E Security” Sh.p.k, “Vaso Security” Sh.p.k, “Security Vaso” Sh.p.k, “Ernisa S” Sh.p.k, “Nisa Security” Sh.p.k”, “Hoxha” Sh.p.k, “Korca Security” Sh.p.k dhe “Hoxha Security” Sh.p.k, të hapur me Vendimin nr. 257, datë 13.12.2012 të Komisionit të Konkurrencës si dhe relacionit perkates;
- Pretendimeve të ndërmarrjeve nën hetim: “Alben 2 Security” Sh.p.k, “E Security” Sh.p.k, “Vaso Security” Sh.p.k, “Security Vaso” Sh.p.k, “Ernisa S” Sh.p.k, “Nisa Security” Sh.p.k”, “Hoxha” Sh.p.k, “Korca Security” Sh.p.k dhe “Hoxha Security” Sh.p.k, në seancat dëgjimore përkatëse: të datës 02/04/2013, datës 03/04/2013; si dhe ato me shkrim të dërguara pranë Autoritetit të Konkurrencës

VËREN SE:

I. PROCEDURA

1. Procedura e ndjekur gjatë hetimit është bazuar në Kreun II dhe III të pjesës III të Ligjit Nr. 9121, datë 8.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (këtu e me poshtë “Ligji”) dhe Ligjit nr. 8485, datë 11.11.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.

2. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 43, pika 1, të Ligjit nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe të nenit 12 dhe 21, pika 4 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit nr. 257, datë 13.12.2012 të Komisionit të Konkurrencës, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, në qytetin e Korçës ndaj ndërmarrjeve: “Alben 2 Security” Sh.p.k, “E Security” Sh.p.k, “Vaso Security” Sh.p.k, “Security Vaso” Sh.p.k, “Ernisa S” Sh.p.k, “Nisa Security” Sh.p.k”, “Hoxha” Sh.p.k, “Korca Security” Sh.p.k dhe “Hoxha Security” Sh.p.k, me objekt ekzistencën ose jo të marrëveshjeve në oferta që kufizojnë konkurrencën në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike për periudhën kohore Janar 2011- Tetor 2012.

3. Në bazë të Vendimit nr. 257, datë 13.12.2012 të Komisionit të Konkurrencës, Sekretariati ka kryer procedurat hetimore në përputhje me Ligjin dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundim të procedurave hetimore, Sekretariati ka paraqitur pranë Komisionit të Konkurrencës raportin e hetimit të thelluar.

4. Raporti i hetimit të thelluar iu komunikua ndërmarrjeve: “Alben 2 Security” Sh.p.k, “E Security” Sh.p.k, “Vaso Security” Sh.p.k, “Security Vaso” Sh.p.k, “Ernisa S” Sh.p.k, “Nisa Security” Sh.p.k”, “Hoxha” Sh.p.k, “Korca Security” Sh.p.k dhe “Hoxha Security” Sh.p.k me anë të shkresës nr.116 prot, datë 11/3/2013.

5. Në zbatim të nenit 39 të Ligjit, palët nën hetim paraqitën pretendimet e tyre mbi raportin e hetimit të thelluar në seancat dëgjimore të mbajtura në datat 2 dhe 3 prill 2013, si dhe me shkrim¹, të cilat janë marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës.

II. PERIUDHA E HETIMIT DHE NDËRMARRJET NËN HETIM

6. Periudha e hetimit, e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin nr. 257, datë 13.12.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës, ndaj ndërmarrjeve: “Alben 2 Security”, “E-Security”, “Vaso Security”, “Security Vaso”, “Ernisa S”, “Nisa Security”, “Hoxha”, “Korça Security” dhe “Hoxha Security”, përfshin periudhën kohore Janar 2011- Tetor 2012.

7. Ndërmarrjet nën hetim janë përcaktuar në Vendimin nr. 257, datë 13.12.2012 të Komisionit të Konkurrencës. Ndërmarrjet nën hetim të përcaktuara në vendimin e mësipërm të Komisionit të Konkurrencës janë:

- Shoqëria “Vaso Security”, me NIPT: K23711001K, me seli në: Rr. “Gavril Pepo”, Lagjia nr. 3, Vila 1, Korçë;
- Shoqëria “Security Vaso”, me NIPT K84308001O, me seli në: : Rr. “Gavril Pepo”, Lagjia nr. 3, Vila 1, Korçë;
- Shoqëria “Alben 2 Security”, me NIPT 33921021M, me seli në: “Ajet Gjindolli”, Lagja 8, Korçë;
- Shoqëria “E - Security”, me NIPT K84624001L; me seli në: Rruga “Xhafer Cenko Lubonja”, Lagja 8, Korçë;
- Shoqëria “Ernisa - S”, me NIPT K14610001D, me seli në: “Sheshi i Bashkisë”, Pallati 1, Kati 2, Nr. 3 Korçë;
- Shoqëria “Nisa Security”, me NIPT K94014005A me seli në: Rr “28 Nëntori”, Pallati 1, Kati 2, Lagja 7, Korçë;
- Shoqëria “Hoxha Security”, me NIPT L02318007J; me seli në: Rr “Gjon Buzuku”, Vila përballë pallatit 100/1, Tiranë;

1 Sipas shkresave Nr. 116/1 Prot, datë 1.04.2013; Nr.116/2 Prot, datë 2.04.2013; Nr. 116/3 Prot, datë 2.04.2013; Nr. 116/4 Prot, datë 2.04.2013; Nr.116/5 Prot, datë 2.04.2013; Nr. 116/6 Prot, datë 3.04.2013 dhe Nr. 116/7 Prot, datë 3.04.2013 ...

- Shoqëria “Hoxha”, me NIPT K32717225F; me seli në Lagja Sul Papri, Pallati 123, Nr. 4, Elbasan;
- Shoqëria “Korça Security”, me NIPT K84412002A me seli në: Tregu me Shumicë Fruta Perime, Korçë.

III. STRUKTURA E TREGUT

8. Tregu përkatës, në bazë të nenit 3, pika 7, të Ligjit dhe të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 76, datë 07.04.2008 “Për miratimin e udhëzimit për përcaktimin e tregut përkatës” përcaktohet në dy dimensione:

- a) Tregu i produkteve
- b) Tregu gjeografik

III.1 Tregu përkatës i produktit

9. Tregu i produktit përfshin: shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike i cili ofrohet nga shoqëritë e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike (SHRSF) dhe ka për mision: sigurimin e objekteve publike e private në pronësi ose në përdorim të personave fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë; sigurimin dhe mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të personave fizikë, shtetas shqiptarë ose të huaj; shoqërimin e vlerave monetare e materiale ose të sendeve të çmuara gjatë transportimit të tyre.

10. Veprimtaria e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, përfshihet në kategorinë I.3 të shtojcës së Ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

11. Specifikimet teknike që paraqesin autoritetet kontraktore në prokurime publike për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike mbeten përcaktuesit kryesorë për dimensionet e tregut përkatës. Çdo tender ka specifikimet e veta të shprehura nëpërmjet specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim. Këto kritere kushtëzojnë tregun përkatës të shërbimit që është objekt hetimi.

12. Duke u bazuar në kriterin e zëvendësueshmërisë, si kriteri kryesor në përcaktimin e tregut përkatës, produkte të zëvendësueshme që mund të marrin pjesë në prokurimet publike për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, janë të gjitha shërbimet e ruajtjes dhe sigurisë fizike të cilat plotësojnë specifikimet teknike që kërkohen në një prokurim publik të organizuar nga ana e një autoriteti kontraktor.

13. Për analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve dhe efekteve që ka shkaktuar sjellja e tyre në treg, *treg përkatës produkti është tregu i prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike.*

III. 2 Tregu gjeografik

14. Ndërmarrjet nën hetim janë aktive në tregun e produktit nëpërmjet ofertimit të tyre në qytetin e Korçës. Për vlerësimin e impaktit që shkakton ofertimi, tregu gjeografik do të konsiderohet qyteti i Korçës.

IV. SJELLJA E NDËRMAREJVE NË TREG

15. Gjatë procedurës së hetimit të thelluar për sjelljen e ndërmarrjeve nën hetim: “Alben 2 Security”, “E-Security”, “Vaso Security”, “Security Vaso”, “Ernisa S”, “Nisa Security”, “Hoxha”, “Korça Security” dhe “Hoxha Security”, në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës, janë administruar një sërë evidencash për të parë sjelljen e tyre në treg, në këndvështrim të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

16. Nga analiza e konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës, bazuar dhe në metodologjinë “Për luftën ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike” rezultoi:

17. Prania e faktoreve të mëposhtëm të cilat mundesojnë egzistencën e marrëveshjeve në oferta:

- *Ofertime të përsëritura:* Autoritet Kontraktore zhvillojnë disa procedura prokurimi gjatë një viti për të njëjtin objekt prokurimi “Sherbim me roje private”;
- *Ngjashmëria në kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike nga SHRSF-të;*
- *Mundësite dhe shenjat e komunikimit midis ofertuesve:* Ofertuesit e njohin mirë njëri-tjetrin për të diskutuar ofertat në prokurime. Kjo vërtetohet bazuar në evidencat e marra gjatë hetimit të cilat tregojnë se:

a) Ndërmarrjet “Vaso Security” dhe “Security Vaso” kanë: të njëjtën adresë të vendodhjes (zyre); numra tel/fax të njëjtë; të njëjtën adresë e-mail; stemë të njëjtë; sallë operative të përbashkët.

b) Ndërmarrjet “Ernisa S” dhe “Nisa Security” kanë të njëjtën adresë të vendodhjes (zyre) dhe kompjutera të përbashkët për përgatitjen e dokumentave të tenderit;

c) Ndërmarrjet “Alben 2 Security” dhe “E-Security” kanë të njëjtën zyrë dhe kompjutera të përbashkët për përgatitjen e dokumentave të tenderit, si dhe të njëjtën sallë operative.

18. Dokumentat e dorëzuara nga autoritetet kontraktore mbi ofertat e “Vaso Security”, “Security Vaso”, “Alben 2 Security” dhe “E- Security”; “Ernisa S”, “Nisa Security” dhe “Korça Security”, bazuar edhe në metodologjinë “Për luftën ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike” kanë shenja të njëjta si:

- ✓ Formularë të sigurimit të ofertes: lëshuar nga e njëjta kompani sigurimi; në të njëjtën datë dhe numër serial të njëpasnjëshëm;
- ✓ Vërtetim nga Zyra e Përmbartimit: lëshuar në të njëjtën datë; dhe me numra protokolli të njëpasnjëshëm;
- ✓ Vërtetim lëshuar nga Agjensia e Sigurimeve Shoqërore Korçë: lëshuar në të njëjtën datë; dhe me numra protokolli të njëpasnjëshëm;
- ✓ Formulari i deklartimit të ofertes: i njëjti gabim drejtshkrimor, të njëjtin formulim, formatim dhe të njëjtën madhësi dhe lloj shkrimi;
- ✓ Formulari i çmimit të ofertes: i njëjti gabim drejtshkrimor, i njëjti format, me të njëjtin lloj shkrimi;
- ✓ Vërtetim nga Tatime: data e lëshimit e njëjtë, si dhe Nr. Prot. të njëpasnjëshëm;
- ✓ Shtojca 5 dhe 6 e DST: Plotësimet në këto shtojca janë bërë në mënyrë të njëjtë, i njëjti gabim drejtshkrimor, të njëjtin formulim, formatim dhe të njëjtën madhësi dhe lloj shkrimi;
- ✓ Emblema e Shoqërive; disa nga ndërmarrjet nën hetim paraqesin emblema të njëjta të shoqërive.

Këto shenja dhe gabime të shumta, të evidentuara gjatë shqyrtimit të ofertave të paraqitura në prokurime të ndryshme nga ndërmarrjet nën hetim, tregojnë që ndërmarrjet nën hetim kanë mundësi komunikimi me njëra tjetrën që mund të përdoren edhe për përgatitjen e ofertave për pjesëmarrje në prokurimet publike.

19. Nga evidencat e gjetura gjatë inspektimeve u konstatua se:

- a) Ndërmarrjet “Ernisa S” dhe “Nisa Security” kanë të njëjtën zyrë dhe kompjutera të përbashkët për përgatitjen e dokumentave të tenderit. Në ndërmarrjen “Ernisa-S” janë gjetur formularë ankese të ndërmarrjes “Korça Security” si dhe dokumentat e tenderave të ndërmarrjes “Nisa Security”, të grupuara sipas autoriteteve kontraktore.
- b) Ndërmarrjet “Alben 2 Security” dhe “E-Security” kanë të njëjtën zyrë, sallë operative dhe kompjutera për përgatitjen e dokumentave të tenderit. Në ndërmarrjen “Alben 2 Security” janë gjetur dokumentat e tenderave të ndërmarrjes “E-Security”, ndërmarrjes “Vaso Security” dhe “Security Vaso”, të grupuara sipas autoriteteve kontraktore. Ndërmarrjet “Vaso Security” dhe “Security Vaso” kanë

të njëjtën zyrë, sallë operative, stemë dhe kompjutera për përgatitjen e dokumentave të tenderit. Gjithashtu në zyrën e ndërmarrjeve “Vaso Security” dhe “Security Vaso” janë gjetur dokumentat e tenderave të ndërmarrjes “Alben 2 Security”, “E-Security”, “Hoxha” dhe “Ernisa-S”.

20. Nga Autoriteti i Konkurrencës u shqyrtua mundësia e përdorimit të skemës së ofertës së mbuluar nga ndërmarrjet nën hetim, duke rënë dakord më përpara, se cili do paraqesë ofertën fituese në procesin e prokurimit ku ata do të jenë pjesëmarrës, me qëllim që të kualifikohet ai që ka ofertën më të ulët. Sipas metodologjive të OECD-së dhe rasteve të ngjajshme, ofertues janë vetëm ndërmarrjet pjesë e një grupi, si dhe ofertat e paraqitura janë shumë afër fondit limit dhe lëvizin shume pak njëra nga tjetra, duke realizuar objektivin e realizimit të ofertës fituese dhe si rezultat dhe shumës që fituesi i ofertës do të marrë shumë afër me fondin limit të prokuruar.

21. Nga hetimi rezulton se në shumicën e procedurave të prokurimit të realizuara, vërehet një pjesëmarrje e gjerë e të gjitha ndërmarrjeve nën hetim apo edhe ndërmarrjeve të tjera. Gjithashtu, vihet re edhe pjesëmarrje nga ndërmarrje me qendër në qarqe të tjera.

22. Gjithashtu nga hetimi rezulton se në këto raste ka oferta të ndryshme me ulje domethënëse ndaj fondit limit. Për shkak të karakteristikave të tregut, ku kostot e shërbimit për një punonjës janë të përafërta atëherë ulja e ofertës ndaj fondit limit nuk mund të jetë shumë e madhe. Kështu për shembull në tenderin e zhvilluar nga autoriteti kontraktor “Posta Shqiptare sh.a”, me objekt: “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të objekteve e personelit të Postës Shqiptare me roje të katëgorisë “A+B”, datë 11/04/2012, Loti II: me fond limit 1.044.000 lekë, vlera e ofertave konkurruese, në raport me fondin limit dhe lëvizjet e ofertës nga oferta janë 85.96% e fondit limit.

23. Ndërsa në procedurën e prokurimit të realizuar në vitin 2012, nga autoriteti kontraktor “Ujësjellës Kanalizime”, me objekt: “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të objektit: me fond limit 7.273.220 lekë, vlera e ofertave konkurruese, në raport me fondin limit dhe lëvizjet e ofertës nga oferta janë 81.7% e fondit limit.

24. Në tenderat e realizuar nga autoriteti kontraktor “Prefektura e Qarkut Korçë”, me objekt “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të objektit, me fond limit 1.032.300 lekë ku kanë paraqitur ofertën e tyre operatorët ekonomikë “Vaso Security” me vlerë oferte 800.000 lekë, vlera e ofertave konkurruese, në raport me fondin limit dhe lëvizjet e ofertës nga oferta janë 77.5% e fondit limit.

25. Në këtë mënyrë komunikimi i zhvilluar midis këtyre firmave nuk ka rezultuar në një marrëveshje pasi numri i konkurrentëve ka qenë i madh si dhe raporti me fondin limit ka qenë i ulët (rreth 77.5% deri 86% e fondit limit), në dallim nga raste të tjera të shqyrtuara nga Autoriteti i Konkurrencës në fushën e prokurimeve.

Si konkluzion, për sa më sipër rezulton se janë gjetur prova komunikimi ndërmjet ndërmarrjeve nën hetim. Por nuk provohet se ky komunikim ka çuar në një marrëveshje në oferta në tregun e prokurimeve publike të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës për rastet e shqyrtuara.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

V E N D O S I:

I. Mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qytetin e Korçës, ndaj ndërmarrjeve: “Vaso Security” Sh.p.k, “Security Vaso” Sh.p.k, “Alben 2 Security” Sh.p.k, “E Security” Sh.p.k, “Ernisa S” Sh.p.k, “Nisa Security” Sh.p.k, “Korça Security” Sh.p.k, “Hoxha” Sh.p.k dhe “Hoxha Security” Sh.p.k;

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe për komunikimin e tij ndërmarrjeve të mësipërme, si dhe Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 284 , Datë 13.05.2013

“Për

**mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit
me shumicë të vajit të lulediellit ndaj ndërmarrjeve “Erbiron” sh.p.k”,
“Olim” sh.a dhe “Crystal” sh.p.k.**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Rezana KONOMI Zv/Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Iva ZAIMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 13.05.2013, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Ekzistenca ose jo e marrëveshjes së ndaluar ndërmjet ndërmarrjeve “Erbiron” sh.p.k, “Olim” sh.a dhe “Crystal” sh.p.k për kufizim të konkurrencës në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit të lulediellit.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d); neni 26; neni 4, pika 1; neni 74 pika 1, shkronja a) dhe neni 75, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Ligji Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

§ Raportit të hetimit të thelluar në Tregun e Importit, Prodhimit dhe Tregtimit me Shumicë të Vajit të Lulediellit ndaj ndërmarrjeve “Erbiron” sh.p.k, “Olim” sh.a dhe “Crystal” sh.p.k dhe të relacionit shoqërues.

§ Pretendimeve të ndërmarrjeve nën hetim: “Erbiron” sh.p.k dhe “Olim” sh.a në seancat dëgjimore përkatësisht të datës 9/04/2013 dhe datës 17/04/2013; si dhe ato me shkrim të depozituara pranë Autoritetit të Konkurrencës nga këto ndërmarrje.

VËREN SE:

I. PROCEDURA

1. Bazuar në shqetësimin mbi rritjen e çmimit të vajit vegjetal në mënyrë abuzive nga disa ndërmarrje si dhe fiksimin e tij, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, në bazë të nenit 28 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 ‘Për Mbrojtjen e Konkurrencës’, i ndryshuar me anë të Urdhrit nr. 105, datë 20.09.2012 ngriti grupin e punës për monitorimin e tregut të prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal.

2. Në vijim të procedurës, Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm dhe raportit të monitorimit të tregut të prodhimit/importit dhe shitjes me shumicë të vajit vegjetal, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, me anë të Vendimit nr. 245, datë 02.10.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, vendosi të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal, për periudhën e hetimit janar-tetor 2012, për të parë nëse kushtet e tregut sigurojnë konkurrencë të lirë dhe efektive.

3. Në përfundim të hetimit paraprak rezultoi se: ndërmarrjet “Erbiron” sh.p.k, “Olim” sh.a dhe “Crystal” sh.p.k, të cilat janë tre konkurrentët kryesorë në tregun e shitjes me shumicë të vajit vegjetal, me pjesë tregu të përafërt kanë aplikuar çmime të shitjes me shumicë të cilat: a) nuk reflektojnë me çmimet në tregun ndërkombëtar në rastet kur ka ulje të çmimit në tregun ndërkombëtar; b) Konvergojnë në trendet e rritjes së çmimit për periudhën objekt hetimi; shenja këto që tregojnë se mund të ketë një sjellje të bashkërenduar të këtyre ndërmarrjeve, e cila në kuptim të nenit 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar.

4. Bazuar në raportin e hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 43, pika 1, të Ligjit Nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe të nenit 12 dhe 21, pika 4 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit nr. 249, datë 09.11.2012 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit të lulediellit”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit të lulediellit ndaj ndërmarrjeve ndërmarrjet “Erbiron” sh.p.k, “Olim” sh.a dhe “Crystal” sh.p.k, për periudhën kohore nga Janari 2012 deri më 31 Tetor 2012.

5. Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, me anë të shkresës nr.655, 656, 657 datë 16.11.2012 realizoi njoftimin e ndërmarrjeve nën hetim në lidhje me Vendimin nr. 249, datë 09.11.2012 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit të lulediellit”.

6. Në bazë të vendimit nr. 249, datë 09.11.2012 të Komisionit të Konkurrencës, Sekretariati ka kryer procedurat hetimore në përputhje me Ligjin dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundim të procedurave hetimore, Sekretariati ka paraqitur pranë Komisionit të Konkurrencës raportin e hetimit të thelluar.

7. Në zbatim të nenit 39 të Ligjit palët nën hetim paraqitën pretendimet e tyre mbi raportin e hetimit të thelluar me shkrim dhe në mënyrë verbale në seancat dëgjimore të mbajtura përkatësisht të datës 9/04/2013 dhe datës 17/04/2013, të cilat janë marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës.

II. PERIUDHA E HETIMIT DHE NDËRMARRJET NËN HETIM

8. Periudha e hetimit, e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimin nr. 249, datë 09.11.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit të lulediellit”, përfshin periudhën kohore nga Janari 2012 deri më 31 Tetor 2012.

9. Ndërmarrjet nën hetim të përcaktuara në vendimin e mësipërm të Komisionit të Konkurrencës, të cilat operojnë në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit luledielli janë:

- “ERBIRON” sh.p.k, me NIPT J62001012B, me seli në: Bërxull-Domje, Autostrada Tirane-Durrës Km.5, Tiranë;
- “CRYSTAL” sh.p.k, me NIPT J62904353F, me seli në: L. 29 Nëntori, Autostrada-Metalugjik, Elbasan.
- “OLIM” sh.a, me NIPT J91327005U, me seli në: Gjokaj, Tiranë, Autostrada TR-DR.

III. ANALIZA E KONKURRENCËS

III.1 Tregu përkatës

10. Në zbatim të udhëzimit për përcaktimin e tregut përkatës, grupi i punës vlerësoi dy dimensionet e tregut përkatës:

- 1) Tregun e produkteve
- 2) Tregun gjeografik

11. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 249, datë 09.11.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit luledielli”, tregu përkatës i produktit përfshin:

- *Tregun e importit të vajit lulediellit;*
- *Tregun e prodhimit të vajit lulediellit;*
- *Tregun e shitjes me shumicë të vajit lulediellit.*

Produktet e ofruara në tregun objekt hetimi janë produkte të zëvendësueshme homogje me standarte të ndryshme.

12. Të gjitha ndërmarrjet janë aktive në tregjet e produktit, nëpërmjet ofrimit të tyre, në të gjithë territorin e Shqipërisë. Për vlerësimin e impaktit që shkakton ofrimi, *tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.*

III.2 Struktura e tregut përkatës

13. Nga analiza e çmimit të importit të vajit, rezulton se indeksi i përqendrimit është shume i larte, ku tre ndërmarrjet kryesore ne treg zotërojnë pjese të konsiderueshme tregu dhe shume ndërmarrje të tjera kanë 1-2% të tregut. Me përjashtim te ndërmarrjes “Erbiron” sh.p.k e cila importon vaj te ambalazhuar nga Hungaria, te gjitha ndërmarrjet e tjera kanë ndryshuar burimet e furnizimit.

14. Çmimi i importit të vajit gjate 2012 ka ardhur në rritje ku vlera më e larte i përket muajit shtator 2012 me rreth 8% me shume se muaji paraardhës dhe rreth 19.3% krahasuar me çmimin më të ulët të vitit (shkurt 2012).

15. Tregu i prodhimit të vajit luledielli përbëhet nga dy ndërmarrje që kryejnë përpunimin e vajit të papërpunuar që merret nga importi, të cilat janë Olim dhe Vajra Bimore. Si lëndë e parë për prodhimin e vajit në vend shërben vaji i papërpunuar që importohet. Për këtë arsye kemi analizuar dhe ndërmarrjet importuese të vajit të papërpunuar. Vaji i papërpunuar që importohet i nënshtrohet proceseve të neutralizimit, de-kolorimit dhe de-odorimit. Pas këtij procesi vaji që prodhohet pakëtohet në shishe 1, 2, 3, 4 dhe 5 litërshe. Krahas kosos së importit ku përfshihet edhe akciza ka kosto prodhimi, marketingu, etj.

16. Kërkesat për vaj luledielli në tregun shqiptar sigurohen nga importi i vajit të rafinuar dhe nga prodhimi në vend i vajit luledielli.

17. Tregu i shitjes me shumicë të vajit luledielli ka karakteristikat e një tregu oligopolistik me pesë ndërmarrje në treg me pjesë të ndryshueshme tregu. Indeksi i përqendrimit është i moderuar duke shkuar drejt një indeksi me shkallë të lartë përqendrimi, ku tre ndërmarrjet kryesore në treg (nën hetim) zotërojnë pjese të konsiderueshme tregu rreth 65.81%. Ndërmarrja Olim dhe Erbiron kanë pothuajse të njëjtën pjesë tregu gjatë periudhës nën hetim.

III.3 Vlerësimi i i sjelljes së ndërmarrjeve objekt hetimi në tregun përkatës


18. Gjatë procedurave hetimore u kryhen inspektime (Dawn Raids) në të njëjtën ditë dhe orë në të tre ndërmarrjet që përmenden në ankesë për gjetjen e evidencave direkte

dhe indirekte të një bashkëpunimi të mundshëm midis konkurrentëve, por gjatë këtyre inspektimeve nuk u gjet asnjë prove apo evidencë direkte. Gjatë inspektimeve dhe nëpërmjet kërkesave për informacion janë administruar materiale të nevojshme për hetimin për të bërë të mundur analizën nëpërmjet evidenca ekonomike: vlerësimin e strukturës së tregut, dhe vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve në tregjet përkatëse.

19. Nga analiza e strukturës së tregut të shitjes me shumicë u konstatua se ky treg është në kufirin e sipërm i një shkalle të moderuar përqendrimi dhe se shkalla e përqendrimit është rritur krahasuar me vitin 2011. Është analizuar nëse kjo fuqi tregu vjen si rezultat i koordinimit të sjelljeve të ndërmarrjeve në tregun e shitjes me shumicë.

20. Duke qenë se gjatë inspektimeve nuk u gjetën evidenca direkte të komunikimit mes konkurrenteve, bazuar në metodologjinë e OECD-së, janë kryer analiza ekonomike me qëllim evidentimin e sjelljes së mundshme të bashkërenduar mes konkurrenteve për fiksimin direkt apo indirekt të çmimit të shitjes së produktit.

21. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në lidhje me çmimin e shitjes me shumicë ka për qëllim të vlerësojë nëse ndërmarrjet vendosin direkt apo indirekt çmimet e shitjes me shumicë gjatë periudhës objekt hetimi Janar - Tetor 2012. Në vlerësimin e trendit të ndryshimit të çmimit mesatar të shitjes me shumicë është marrë në konsideratë krahasimi i çmimit mesatar mujor të shitjes me shumicë të vajit luledielli¹ që ka rezultuar nga përpunimi i të dhënave të sjella nga ndërmarrjet.



Grafiku 1. Trendi i çmimit mesatar mujor të shitjes me shumicë për ndërmarrjet nën hetim për periudhën Janar - 30 Tetor 2012².


22. Nga analiza e çmimeve mesatare mujore rezulton: trendi i rritjes së çmimit të shitjes me shumicë për të tre ndërmarrjet kryesisht në muajin Shtator 2012. Ndjekje e trendit të çmimit mesatar në rritje dhe zbritje nga ndërmarrjet Olim dhe Erbiron. Ndryshimet në

¹ Çmimi mesatar i shitjes me shumicë është llogaritur mbi mesataren e ponderuar.

² Burimi të dhënave të sjella nga ndërmarrjet, përpunuar nga grupi i punës.

çmimet mesatare midis ndërmarrjeve Erbiron dhe Olim janë të ngushta dhe rritja e çmimit në muajin Shtator, në krahasim me muajin Gusht, është e përafërt. Çmimi mesatar 10 mujor për ndërmarrjet Olim dhe Erbiron është i përafërt. Çmimi mesatar mujor i shitjes së ndërmarrjes Kristal është i ndryshëm krahasuar me dy ndërmarrjet e tjera.

23. Duke qene se indicio për hapjen e hetimit ka qenë ankesa e datës 19.09.2012 ne te cilën thuhet se “*gjate muajit gusht dhe tani ne shtator vazhdon te kemi nje rritje te pashpjegueshme te çmimit nga te dyja kompanitë qe sjellin vajin olim, dhe floriol, ...*”, është përpunuar informacioni i administruar duke krahasuar, çmimet mesatare ditore te shitjes me shumicë, volumin ditor të shitjes për të tre ndërmarrjet për vajin e tregtuar në paketim 1 litër, për ndërmarrjet Erbiron, Olim dhe Crystal, për te gjithë periudhën e rritjes 1 Gusht 31 Tetor 2012, sipas grafikut dhe pasqyrës së mëposhtme:



Grafiku 2. Trendi i çmimit mesatar ditor të shitjes me shumicë për vajin 1 liter³ për periudhën 1 Gusht - 31 Tetor 2012 për ndërmarrjet Olim, Erbiron dhe Crystal⁴

24. Nga analiza e grafikut të mësipërm vihet re se çmimi mesatar ditor i shitjes me shumicë për vajin 1 litër është rritur gradualisht gjate gjithë periudhës gusht-tetor si dhe ne fund te muajit Shtator ndjeshëm në krahasim me fillimin e muajit Gusht.




25. Ritmet e rritjes së çmimet mesatare ditore dhe mujore për vajin 1 litër është në të njëjtin trend me ritmet e rritjes së çmimeve mesatare për vajrat e tjerë (paketime te

³ Ndermarrja Olim bazuar ne te dhenat e sjella per detajimin e shifres neto te afarizmit vaji 1 liter perfaqson mbi 80% te sasise totale; sipas pyetsorve te sjelle nga supermarketet furnizohen kryesisht me vajin paketim 1 liter.

⁴ Burimi te dhënat e sjella nga ndërmarrjet, përpunuar nga Grupi i Punës çmimi mesatar ditor i shitjes për çdo ndërmarrje është llogaritur si raport i vlerës së shitjeve ditore me sasinë përkatëse ditore.

ndryshme nga 1 litër). Ndërmarrjet Erbiron dhe Olim kanë të njëjtin trend rritje. Sipas tabelës se mësipërme rezulton qe gjatë tre muajve ka ndonjë ditë kur ndërmarrjet aplikojnë një çmim me ndryshim shumë të vogël nga ndërmarrja tjetër (Olim dhe Erbiron), ose brenda dites te kene aplikuar ne ndonje rast te njëjtin çmim, por nuk janë të korreluara me sasitë si dhe ndërmarrjet kanë aplikuar dhe çmime të tjera brenda ditës të ndryshme nga njëra tjetra.

26. Vlerësimi i ritmeve të ndryshimit të çmimeve të doganës⁵ në raport me çmimet e shitjes me shumicë⁶ është bërë me qëllim që të shikohet nëse ndërmarrjet vendosin çmime indirekte të shitjes me shumicë nëpërmjet skemave për vendosjen e te njëjtave ritme ndryshimi midis dy çmimeve dhe nëse rritja e çmimit është rezultat i rritjes së çmimit të blerjes, apo i ndonjë sjellje te ndërmarrjeve në treg. Analiza e mëposhtme është realizuar nëpërmjet krahasimit të periudhës objekt hetimi (Janar-Tetor 2012).



⁵ Çmimi mesatar mujor i doganës është llogaritur mbi bazën e mesatares së ponderuar e llogaritur si raport i vlerës mujore te importit me sasinë e importuar (ne litra).

⁶ Çmimi mesatar i shitjes me shumicë, është një çmim i llogaritur mbi një mesatare te ponderuar të çmimit mesatar mujor i ndërmarrjeve të shumicës. Çmimi mesatar mujor i shitjes për çdo ndërmarrje është llogaritur si raport i vlerës së shitjeve mujore me sasinë përkatëse.

27. Nëse i referohemi të dhënave të administruara nga palët, rezulton se dy ndërmarrjet me sjellje të koordinuar ndaj çmimit të shitjes me shumicë të vajit të lulediellit, kanë strukturë të ndryshme të kostos. Por pavarësisht kostove të ndryshme çmimi për klientët në tregun e shumicës ka trend dhe sjellje të njëjtë përgjatë gjithë periudhës objekt-hetimi

28. Në përfundim të vlerësimit të sjelljes së ndërmarrjeve ndaj çmimit të shitjes me shumicë konstatohet se :

- Çmimi i importit të vajit gjate 10 mujorit 2012 për ndërmarrjet nën hetim ka qene në rritje 6-10%.
- Ndërmarrjet kanë ndjekur trendin e uljes se çmimit te importit, por jo ne të njëjtën mase me ndryshimin e tij dhe reagojnë menjëherë ndaj rritjes së çmimeve të blerjes ne tregjet ndërkombëtarë.
- Çmimi mesatar i shitjes me shumicë për të njëjtën periudhë për të tre ndërmarrjet është rritur 9%.
- Ritmi i rritjes së çmimit te shitjes me shumicë për ndërmarrjet Olim, Erbiron janë më të larta se ritmet e rritjes së çmimit të blerjes në tregun ndërkombëtar.
- Çmimet e shitjes me shumicë për ndërmarrjet Olim dhe Erbiron kanë të njëjtin trend ndërkohë që sjellja e ndërmarrjes Crystal ka një tjetër trend nga dy të parat;
- Pjesët e tregut për ndërmarrjet objekt hetimi kanë qënë dinamike për dy vitet e fundit.

III.4. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve nëpërmjet teknikës ekonometrike

29. Për të thelluar analizën e sjelljes së koordinuara mes dy firmave, Olim dhe Erbiron, janë përpunuar të dhënat e mara nga palët në një model ekonometrik ku janë zhvilluar dy teste - Analiza e korrelacionit për çmimet mesatare ditore dhe regresi mbi këto çmime me metodën GLS për një model logaritmit të tipit Linear dhe testimi i supozimeve te modelit GLS.

30. Analiza nëpërmjet teknikës ekonometrike tregon se ekziston një lidhje pozitive korreleuese midis çmimeve që tregon se këto produkte janë zëvendësues të afërt me njëri tjetrin. Nga kjo analizë rezulton se lidhja funksionale midis serive të çmimeve është lineare për çmimin e vajit Olim kundrejt çmimit me një ditë vonesë në kohë të çmimit të vajit të tregëtuar nga ndërmarrja “Erbiron” sh.p.k dhe çmimit të vajit Crystal, gjatë periudhës objekt hetimi Janar- Tetor 2012

Si konkluzion: Analiza e nivelit të konkurrencës në tregun përkatës dhe e sjelljes së ndërmarrjeve objekt hetimi, që ushtrojnë veprimtari në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të vajit të lulediellit, është bazuar në analizën e strukturës se tregut, çmimeve te shitjes me shumicë, reflektimit të çmimeve të blerjes në çmimet e shitjes.

Nga evidencat indirekte dhe analizat ekonomike konstatohet se struktura e tregut të produktit përkatës nuk është një strukturë e ngurtësuar gjatë viteve 2011-2012.

Ndërmarrjet nën hetim, “Erbiron” sh.p.k dhe “Olim” sh.a gjatë periudhës objekt hetimi shfaqin tendenca të përafërta të rritjes së çmimit, të cilat tregojnë një nivel të ulët të konkurrencës në tregun përkatës, por që nuk përbën një evidencë të mjaftueshme për të provuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar në kuptim të Ligjit 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

V E N D O S I:

I. Mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe tregimit me shumicë të vajit luledielli, ndaj ndërmarrjeve “Erbiron” sh.p.k, “Olim” sh.a dhe “Crystal” sh.p.k, për periudhën kohore nga Janari 2012 deri më 31 Tetor 2012.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm të vazhdojë monitorimin e tregut të prodhimit, importit dhe shitjes me shumicë të vajit të lulediellit.

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe për komunikimin e tij ndërmarrjeve të mësipërme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 285, Datë 20.05.2013

**“Për
shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes “Vodafone Albania” SHA
për revokimin e Vendimit nr.275, datë 25.03.2013të Komisionit
të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar
ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare
me pakicë”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

▪	Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪	Rezana	KONOMI	Zv/Kryetar
▪	Servete	GRUDA	Anëtar
▪	Koço	BROKA	Anëtar
▪	Iva	ZAIMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.05.2013, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes “Vodafone Albania SHA” për revokimin e Vendimit nr. 275, datë 25.03.2013 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë” të Komisionit të Konkurrencës”.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, germa d, dhe neni 46 .

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

Kërkesës së ndërmarrjes “Vodafone Albania SHA” për revokimin e Vendimit nr. 275, datë 25.03.2013 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë”.

Relacionit të Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës për këtë kërkesë.

VËREN SE:

Komisioni i Konkurrencës ka marrë në shqyrtim kërkesën e ndërmarrjes Vodafone Albania SHA për revokimin e Vendimit nr. 275, datë 25.03.2013 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë” të Komisionit të Konkurrencës”.

Revokimi i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, mund të bëhet vetëm nëse plotësohet njëri nga kriteret e parashikuara në nenin 46 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Sipas këtij neni Komisioni mund të revokojë ose të ndryshojë vendimet e veta, duke vendosur kushte a detyrime, ose të rifillojë procedurën kur:

a) njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit, kanë ndryshuar;

b) palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim;

c) vendimi është bazuar në të dhënat jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit.

Nga vlerësimi i kërkesës së ndërmarrjes Vodafone dhe i argumenteve të dhëna nga kjo ndërmarrje, konstatohet se nuk ndodhemi para kushteve të sipërcituara. Pra, në kuptim të nenit 46 të Ligjit 9121, datë 28.09.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kërkesa e ndërmarrjes Vodafone nuk përmbush asnjë nga kriteret e përcaktuara në këtë nen.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d, dhe nenin 46 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 275, datë 25.03.2013 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë”.

2. Mospranimin e kërkesës së ndërmarrjes “Vodafone Albania”SHA për revokimin Vendimit nr. 275, datë 25.03.2013 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë”.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi shoqërisë “Vodafone Albania” SHA.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 286, Datë 21.05.2013

**Për
miratimin e rregullores
“Për kategoritë e marrëveshjeve dhe praktikave të bashkërenduara në
sektorin e transportit ajror”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- | | | | |
|---|---------|-------------|------------|
| • | Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| • | Rezana | KONOMI | Zv/Kryetar |
| • | Servete | GRUDA | Anëtar |
| • | Koço | BROKA | Anëtar |
| • | Iva | ZAJMI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 21.05.2013, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e rregullores “Për kategoritë e marrëveshjeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e transportit ajror” në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar);

Baza ligjore: Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 6, dhe 24, shkronja d), dh).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Projekt rregullores “Për kategoritë e marrëveshjeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e transportit ajror”

- Opinioneve të paraqitura nga palët e interesuara:

VENDOSI:

Të miratojë rregulloren “Për kategoritë e marrëveshjeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e transportit ajror” sipas tekstit të bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R

Rregullore

Për kategoritë e marrëveshjeve dhe praktikave të bashkërenduara në Sektorin e Transportit Ajror¹.

Neni 1

Objekti

Objekt i kësaj rregulloreje është përjashtimi nga ndalimi i kategorive të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e transportit ajror, në zbatim të nenit 6 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”(i ndryshuar).

Në zbatim të nenit 6 të Ligjit dhe të dispozitave të kësaj Rregulloreje, neni 4 i Ligjit nuk do te zbatohet për disa kategori marrëveshjesh, vendime dhe praktika të bashkërenduara në sektorin e transportit ajror.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Në përputhje me nenin 6 të Ligjit, Komisioni vendos me anë të kësaj Rregulloreje, se neni 4 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) nuk do të zbatohet për disa kategori marrëveshjesh ndërmjet ndërmarrjeve, vendime të bashkimeve të ndërmarrjeve dhe praktika të bashkërenduara të cilat mund të kenë si objekt :
 - a) Planifikimin e përbashkët dhe koordinimin e orareve të linjave ajrore;
 - b) Konsultimet mbi tarifat për transportin e udhëtarëve, bagazheve dhe mallrave, për shërbimet ajrore të planifikuara;
 - c) Operacionet e përbashkëta mbi shërbime të reja ajrore të planifikuara, jo shumë të frekuentuara
 - d) Blerja e përbashkët, zhvillimi dhe operacionet e sistemeve kompjuterike të rezervimit në lidhje me tabelat e orareve, rezervimet dhe biletat nga ndërmarrjet e transportit ajror;
2. Bazuar në pikën 1 të këtij neni, përjashtimi i dhënë në zbatim të Ligjit, përcakton kategoritë e marrëveshjeve, vendimeve ose praktikave të bashkërenduara dhe në veçanti:

⁽¹⁾ **32009R0487**, Rregullorja e Këshillit Evropian Nr 487/2009 e datës 25 Maj 2009, “Mbi zbatimin e nenit 81(3) të Traktatit për disa kategori marrëveshjesh dhe praktika të bashkërenduara në sektorin e transportit ajror” (Fletore Zyrtare L 148, 11.6.2009).

- a) Kufizimet ose dispozitat të cilat mund, ose jo, të jenë pjesë e marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara;
- b) Dispozitat që mund të jenë pjesë e marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara, ose çdo kusht tjetër që duhet plotësuar.

Neni 3

Afati

1. Përjashtimi i dhënë në zbatim të nenit 2 të kësaj rregulloreje, do të zbatohet për një periudhë të caktuar.
2. Ai mund të shfuqizohet/revokohet ose ndryshohet kur rrethanat në lidhje me ndonjë nga faktorët të cilët kanë nxitur miratimin e tij, kanë ndryshuar. Në këtë rast, do të caktohet një periudhë kohore për ndryshimin e marrëveshjeve dhe praktikave të bashkërenduara të cilat zbatoheshin para se përjashtimi i dhënë të shfuqizohej apo ndryshohej.

Neni 4

Efektet prapavepruese

Përjashtimi i dhënë në zbatim të nenit 2 të kësaj Rregulloreje, do të përfshijë një dispozitë sipas të cilës ky vendim për përjashtim, zbatohet me efekt prapaveprues për marrëveshjet, vendimet dhe praktikat e bashkërenduara të cilat ekzistojnë në datën e miratimit të këtij përjashtimi.

Neni 5

Konsultimi me palët e treta

Para miratimit të vendimit për përjashtim në zbatim të nenit 2 të kësaj Rregulloreje, Autoriteti i Konkurrencës do të publikojnë një draft të tij dhe do të ftojë të gjithë personat dhe organizatat e interesuara që të depozitojnë komentet e tyre brenda një afati kohor të arsyeshëm, jo më pak se një muaj.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

V E N D I M

Nr. 287, Datë 04.06.2013

**“Për
mbylljen e procedurës së hetimit paraparak në tregun e prokurimit
të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Gjirokastrës
dhe qytetin e Sarandës”**

Komisioni i Konkurrencës, me përberjen e:

▪	Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪	Rezana	KONOMI	Zv/Kryetar
▪	Servete	GRUDA	Anëtar
▪	Koço	BROKA	Anëtar
▪	Iva	ZAIMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 04.06.2013, me pjesmarrjen e Znj. Lindita Milo (Lati), Znj. Rezana Konomi, Znj. Servete Gruda dhe Znj. Iva Zajmi, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Ekzistenca ose jo e shkeljes së konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Gjirokastrës dhe qytetin e Sarandës.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, dhe neni 26.

Ligji Nr. 8485 datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit “Mbi hetimin paraparak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Gjirokastrës dhe qytetin e Sarandës” dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

I. PROCEDURA

1. Duke marrë shkas nga disa shqetësime të paraqitura pranë Autoritetit të Konkurrencës mbi kufizimin e mundshëm të konkurrencës në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Gjirokastrës dhe qytetin e Sarandës, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit Nr. 274, datë 18.03.2013 të Komisionit të Konkurrencës vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Gjirokastrës dhe qytetin e Sarandës, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën e hetimit nga janari deri në dhjetor 2012.

2. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Grupi i Punës ka kërkuar të dhëna dhe informacion nga Autoritetet Kontraktore në procedurat e prokurimit e të cilave kanë marrë pjesë ndërmarrjet që operojnë në tregun përkatës.

3. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit Nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 139, datë 20.03.2013 “Autorizim Inspektorësh”, Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimet e nevojshme pranë ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg. Qëllimi i inspektimeve ishte grumbullimi i provave dhe të dhënave të nevojshme në funksion të hetimit paraprak në tregun përkatës.

II. NDËRMARRJET NËN HETIM

4. Bazuar në Vendimin 274, datë 18/03/2013 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Gjirokastrës dhe qytetin e Sarandës”, si dhe referuar të dhënave të administruara gjatë shqyrtimit të ankesave, gjithashtu edhe informacionit të administruar gjatë inspektimeve, ndërmarrjet të cilat operojnë në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Gjirokastrës dhe qytetin e Sarandës janë:

- Shoqëria **“S.B Security” Sh.p.k**, me NIPT: K64105813Q, me seli në: Lagjia Nr. 2, Rruga “Abedin Dino”, përballë Bashkisë, Vlorë, Sarandë;
- Shoqëria **“Balili Ko” Sh.p.k**, me NIPT K36603503U, me seli në: Sarandë, Godina e Ish - Bashkisë;

- Shoqëria **“Elnado” Sh.p.k**, me NIPT K74702801U, me seli në: Lagjja nr.2, Rruga “Abedin Dino”, Godina Nr.39, Kati i 2, Në krahë të Bashkisë, Vlorë - Sarandë;
- Shoqëria **“Taulanti” Sh.p.k** me NIPT K62717612B; me seli në: Gjirokastrë, Fshati “ASIM ZENELI”;
- Shoqëria **“Grup 4” Sh.p.k** me NIPT K63521603S, me seli në: L. “18 Shtatori”, Gjirokastrë.

III. STRUKTURA E TREGUT

5. Tregu përkatës, në bazë të nenit 3, pika 7, të Ligjit dhe të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 76, datë 07. 04. 2008 “Për miratimin e udhëzimit për përcaktimin e tregut përkatës” përcaktohet në dy dimensione:

- a) Tregu i produktit*
- b) Tregu gjeografik*

III.1 Tregu përkatës i produktit

6. Tregu i produktit përfshin: shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike i cili ofrohet nga shoqëritë e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike (SHRSF) dhe ka për mision: sigurimin e objekteve publike e private në pronësi ose në përdorim të personave fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë; sigurimin dhe mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të personave fizikë, shtetas shqiptarë ose të huaj; shoqërimin e vlerave monetare e materiale ose të sendeve të çmuara gjatë transportimit të tyre.

7. Veprimtaria e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, përfshihet në kategorinë I.3 të shtojcës së Ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

8. Specifikimet teknike që paraqesin Autoritetet Kontraktore në prokurime publike për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike mbeten përcaktuesit kryesorë për dimensionet e tregut përkatës. Cdo tender ka specifikimet e veta të shprehura nëpërmjet specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim. Këto kriterë kushtëzojnë tregun përkatës të shërbimit që është objekt hetimi.

9. Duke u bazuar në kriterin e zëvendësueshmërisë, si kriteri kryesor në përcaktimin e tregut përkatës, produkte të zëvendësueshme që mund të marrin pjesë në prokurimet publike për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, janë të gjitha shërbimet e ruajtjes dhe sigurisë fizike të cilat plotësojnë specifikimet teknike që kërkohen në një prokurim publik të organizuar nga ana e një Autoriteti Kontraktor.

10. Për analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve dhe efekteve që ka shkaktuar sjellja e tyre në treg, *treg përkatës produkti është tregu i prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike.*

III. 2 Tregu përkatës gjeografik

11. Për vlerësimin e impaktit që shkakton ofertimi, bazuar dhe në vendimin për hapjen e hetimit paraprak, tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet *“Tregu i prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Gjirokastrës dhe qytetin e Sarandës”.*

IV. SJELLJA E NDËRMAREJVE NË TREG

12. Për te vlerësuar sjelljen e ndërmarrjeve në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike u vlerësuan të dhënat e siguruar nga Autoritetet Kontraktore, meqënëse gjatë inspektimeve të befasishme të realizuara në ndërmarrjet e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Gjirokastrës dhe qytetin e Sarandës nuk u gjet asnjë evidencë që të vërtetonte bashkëpunimin në përgatitjen e ofertave në procedurat e prokurimit publik.

13. Gjatë vlerësimit të gjithë dokumentacionit të dërguar nga Autoritetet Kontraktore, bazuar edhe në metodologjisë që aplikon OECD për luftën ndaj koordinimit të ofertave në prokurimet publike (OECD - GUIDELINES FOR FIGHTING BID RIGGING IN PUBLIC PROCUREMENT), nuk u konstatuan shenja të bashkëpunimit midis ndërmarrjeve në përgatitjen e ofertave në procedurat e prokurimit publik në qarkun e Gjirokastrës dhe qytetin e Sarandës. Gjithashtu nga hetimi rezulton se në këto procedura prokurimi të realizuara vërehet një pjesëmarrje e të gjitha ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg.

14. Për sa më sipër, pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurave të inspektimit të realizuara në ndërmarrjet nën hetim dhe vlerësimit të dokumentacionit të dërguar nga Autoritetet Kontraktore përkatëse, rezulton se nuk janë gjetur evidenca direkte dhe indirekte të bashkëpunimit midis ndërmarrjeve në përgatitjen e ofertave në procedurat e prokurimit publik në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Gjirokastrës dhe qytetin e Sarandës (për periudhën nën hetim), duke mos pasur në këtë mënyrë shenja të një kufizimi të mundshëm të nenit 4 të ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

V E N D O S I:

I. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike në qarkun e Gjirokastrës dhe qytetin e Sarandës, pasi nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës në bazë të nenit 4 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për komunikimin e këtij vendimi ndërmarrjeve nën hetim, si dhe Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS**Servete GRUDA****Koço BROKA****Iva ZAJMI****Rezana KONOMI**

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar**Lindita MILO (LATI)**

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 288, Datë 25.06.2013

“Mbi

autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit indirekt në shoqëritë Tirana International Airport Sh.p.k dhe Hochtief Airport Retail Sh.p.k nga Public Sector Pension Investment Board, nëpërmjet përfutimit të 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë Hochtief Airport GmbH”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | |
|------------------|-------------|-------------|
| ▪ Znj. Lindita | Milo (Lati) | Kryetar |
| ▪ Znj. Rezana | Konomi | Zv. Kryetar |
| ▪ Znj. Servete | Gruda | Anëtar |
| ▪ Z. Koço | Broka | Anëtar |
| ▪ Znj. Iva Zajmi | | Anëtar; |

Në mbledhjen e tij të datës 25.06.2013, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit indirekt në shoqëritë Tirana International Airport Sh.p.k dhe Hochtief Airport Retail Sh.p.k nga Public Sector Pension Investment Board, nëpërmjet përfutimit të 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë Hochtief Airport GmbH.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 2, 10-12, dhe neni 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit “ dhe Formulari i thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi njoftimin e përqendrimit Tirana International Airport Sh.p.k, Hochtief Airport Retail Sh.p.k dhe Public Sector Pension Investment Board,

V Ë R E N S E:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Me datë 6 qershor 2013 pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar përqendrimi i realizuar në bazë të “Marrëveshjes për shitjen e aksioneve” datë 7 Maj, e lidhur ndërmjet palëve “World Airport Partners GmbH & Co.KG” në cilësinë e blerësit dhe “Hochtief Aktiengesellschaft” në cilësinë e shitësit me objekt transferimin e 100% të aksioneve të “Hochtief Airport GmbH” në cilësinë e shoqërisë target. Transaksioni ka si pasojë përfitim të kontrollit indirekt të Tirana International Airport Sh.p.k nëpërmjet përfitimit të 47% të kuotave dhe Hochtief Airport Retail Sh.p.k nëpërmjet përfitimit të 100% të kuotave nga Public Sector Pension Investment Board.

Me anë të këtij transaksioni PSP do të përfitojë kontroll të tërthortë në disa shoqëri të cilat janë në kontrollin e Target-it (HTA) përfshirë këtu edhe TIA Sh.p.k dhe HTAR Sh.p.k.

Ky transaksion, i cili ndryshon cilësinë e kontrollit indirekt në shoqëritë shqiptare Tirana International Airport Sh.p.k dhe Hochtief Airport Retail Sh.p.k nga Public Sector Pension Investment Board, përbën një përqendrim në bazë të nenit 10 pika 1) , shkronja b) e Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar. Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përse i përket xhirove (neni 12/1).

2. Palët në transaksion

- **Public Sector Pension Investment Board (PSP)** në cilësinë e blerësit është një shoqëri e themeluar në 2006 dhe që funksionon në bazë të legjislacionit kanadez me seli në adresën: 200-440Av.Laurier, Ottaëa Ontario, Kanada. Shoqëria kryen aktivitet ekonomik në fushën e administrimit dhe investimit të fondeve

- **World Airport Partners (WAP)** në cilësinë e blerësit, është një shoqëri e cila është themeluar në 31 tetor 2012 dhe që funksionon në bazë të legjislacionit gjerman.

Hochtief Aktiengesellschaft (HT) në cilësinë e shitësit, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të së drejtës gjermane. Ajo është shoqëria mëmë e shoqërisë target të këtij përqendrimit **Hochtief Airport GmbH** (HTA).

- **Hochtief Airport GmbH** (HTA) në cilësinë e shoqërisë target të përqendrimit, është një investitor dhe administrator privat industrial aeroportesh

- **Tirana International Airport Sh.p.k** (TIA) në cilësinë e ndërmarrjes në tregun gjeografik të Republikës së Shqipërisë e **zotëruar 47 % nga ndërmarrja target**, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar.
- **Hochtief Airport Retail Sh.p.k** (HTAR) në cilësinë e ndërmarrjes në tregun gjeografik të Republikës së Shqipërisë e **zotëruar 100 % nga ndërmarrja target**, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar me veprimtari shërbimet e ambjenteve dhe funksioneve brenda ambjentit të aeroportit.

3. Xhiro për vitin 2011

Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është **XXX Lekë**, ku:

- Public Sector Pension Investment Board, PSP(XXX milion \$ = XXX Lekë
- Hochtief AirPort GmbH, HTA : XXX Euro = XXX Lekë
- TIA dhe HTAR nuk janë prezent në tregun ndërkombëtar.

Xhiro totale në **tregun e brendshëm**: është **XXX Lekë**, ku:

- Tirana International Airport, TIA ⁽¹⁾ : XXX Euro = XXX Lekë
- Hochtief Airport Retail sh.p.k, HTAR : XXX Lekë

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1 të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrotjtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

4. ANALIZA E KONKURRENCËS

4.1 Tregu përkatës

4.1.1 Tregu përkatës i produktit

Në sektorin e shërbimeve aeroportuale mund të identifikohen tre kategori të ndryshme shërbimesh në pajtim me praktikën e Komisionit European:

- shërbimet e infrastrukturës aeroportuale që i ofrohen linjave ajrore (si p.sh shërbimet e ofruara nga TIA)
- shërbimet e asistencës në tokë (ground handling services) që përbëhen nga një grup shërbimesh të nevojshme dhe ndihmëse në lidhje me nisjet, uljet, qëndrimet në tokë të avionëve dhe ngarkesës së tyre (si p.sh shërbimet e ofruara nga TIA)
- shërbimet tregtare (si p.sh ato të ofruara nga HTAR) që përfshijnë ndër të tjera, administrimin e dyqaneve të shitjes së produkteve për publikun që ushtrohen nga subjekte të treta përfituese me anë të nën-konçesionit, administrimin e parkimeve dhe shitjen e hapësirave publicitare.

Treg përkatës të produktit në Shqipëri do të konsiderojmë shërbimet e infrastrukturës aeroportuale që i ofrohen linjave ajrore dhe shërbimet e asistencës në tokë, shërbime të ofruara nga TIA dhe shërbimet tregtare të ofruara nga HTAR.

4.1.2 Tregu përkatës gjeografik

Për vlerësimin e këtij transaksioni, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë brenda të cilit shoqëria koncesionare ka të drejtën ekskluzive të fluturimeve ndërkombëtare.

4.2 Situata para përqendrimit

TIA kryen veprimtarinë sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në Marrëveshjen e Koncesionit lidhur nëpërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare “Tirana Airport Partners” sh.p.k (emri i shoqërisë ndryshuar në Tirana Airport shpk), miratuar me ligjin nr. 9312, datë 11.11.2004 “Për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Tiranë dhe për dhënien e disa stimuljeve kësaj shoqërie koncesionare”.

Kompania Koncesionare Tirana Airport Partners (TAP) sh.p.k., e njohur si TIA, ka të drejtën ekskluzive në territorin e Republikës së Shqipërisë për ndërtimin, funksionimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza”.

4.2 Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Përqendrimi i njoftuar është një ndryshim kontrolli sipas parashikimeve të nenit 10, pika 1, shkronja b e Ligjit Nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe nuk pritet të sjellë ndryshime në strukturën e tregut përkatës pasi palët pjesëmarrëse veprojnë në tregje gjeografike të ndryshme dhe përfituesi i kontrollit vjen nga industria financiare dhe për rrjedhojë nuk ka tregje të prekura dhe/ose tregje të lidhura. PSP nuk zotëron aktualisht asnjë interes material në ndonjë aeroport dhe po kërkon që të hyjë në këtë transaksion si një investitor financiar, me synimin për të siguruar një përfitim financiar për kontribuesit në fondet e pensionit që ajo administron.

Pas realizimit të përqendrimit nuk do të ketë asnjë ndryshim të drejtpërdrejtë në strukturën e pronësisë të kuotave të TIA apo HTAR. PSP do të bëhet pronar jo i drejtpërdrejtë i një pjesëmarrje kapital prej 47% në TIA dhe pjesëmarrje kapital prej 100% në HTAR nëpërmjet pjesëmarrjes së tij në HTA. HTA do të mbetet ortak i drejtpërdrejtë në TIA dhe për rrjedhojë nuk do të ketë asnjë ndryshim të drejtpërdrejtë në administrimin apo operimin e TIA apo HTAR.

PSP, në bazë të kontratës së shitblerjes (SPA) synon, nëpërmjet WAP, blerjen e 100% të kuotave të HTA. Si rrjedhim, PSP do të përfitojë kontroll të tërthortë mbi HTA nga HT, dhe në këtë mënyrë do të përfitojë: i) kontroll të tërthortë mbi TIA dhe HTAR; dhe ii) pjesëmarrje në shoqëritë e tjera të cilat administrojnë aeroportet.

Në sjelljen ndaj çmimit/çmimeve, në bazë të kontratës koncensionare është parashikuar rregullimin e tarifave nga Organi Shtetëror i Autorizuar në formën që Organi i Autorizuar Shtetëror dhe Shoqëria do të rishikojnë pagesat për shërbimet e aeroportit çdo tre vjet gjatë periudhës së koncesionit, proces i cili ka nisur nga Organi Shtetëror i Autorizuar. Ndryshimi i kontrollit të tërthortë nuk pritet të sjellë ndryshim të sjelljes ndaj çmimit pasi përfituesi i kontrollit është shoqëri financiare.

Si konkluzion, përqëndrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqëndrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit indirekt në shoqëritë Tirana International Airport Sh.p.k dhe Hotchief Airport Retail Sh.p.k nga Public Sector Pension Investment Board, nëpërmjet përfutimit të 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë Hotchtief Airport GmbH.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 289, Datë 4/07/2013

“Për

**mbylljen e procedurës së hetimit paraparak në tregun e shërbimit
të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm në portin “Porto Romano”**

Komisioni i Konkurrencës, me përberjen e:

▪	Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪	Rezana	KONOMI	Zv/Kryetar
▪	Servete	GRUDA	Anëtar
▪	Koço	BROKA	Anëtar
▪	Iva	ZAJMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 4.7.2013 me pjesmarrjen e Znj.Lindita Milo(Lati), Znj. Servete Gruda, Znj. Iva Zajmi, dhe Z. Koço Broka,i çështjen me:

Objekt: Ekzistenca ose jo e abuzimit me pozitën dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm në portin “Porto Romano”.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 43, pika 5

Ligji . 8485 datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit “Mbi hetimin paraparak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm në portin “Porto Romano” të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm,

KONSTATOI:

I. PROCEDURA E NDJEKUR:

1. Bazuar në një ankesë nga një operator në tregun e importit dhe shitjen me shumicë së gazit të lëngshëm të naftës (GLN), Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit nr. 277, datë 03.04.2013, të Komisionit të Konkurrencës, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm në zonën “Porto Romano””, vendosi hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm në portin “Porto Romano”, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës.

2. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, grupi i punës kërkoi të dhëna dhe informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe nga ndërmarrja “Romano Port” SHA.

3. Në bazë të nenit 35 dhe 36 të Ligjit nr. 9121, dt 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe autorizimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 169, datë 09.04.2013 “Autorizim Inspektorësh”, grupi i inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektime pranë ndërmarrjes “Romano Port” SHA, ku u mbajtën dhe procesverballi “Për marrje shpjegimesh për fakte dhe dokumente, që lidhen me objektin dhe qëllimin e inspektimit”, si dhe procesverbal “Mbi inspektimin në ndërmarrje”. Gjithashtu, u morën shpjegime nga përfaqësuesi i ndërmarrjes “Alb Marine”, i cili kryen veprimtarinë e agentit spedicioner, pranë portit “Porto Romano” si dhe nga përfaqësuesit e ndërmarrjeve importuese të GLN-së si “Prima Gas”, “Mare Oil” Sh.a, “Global Gas”, “Kurum” dhe “A&V Gas”, si palë që përfitojnë nga shërbimi i ngarkim shkarkimit të GLN-së.

II. Ndërmarrja nën hetim dhe periudha e hetimit

4. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 277 datë 03.04.2013 vendosi për fillimin e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim shkarkimit të GLN-së në rrugë detare ndaj ndërmarrjes Romano Port SHA, që është ndërmarrja koncesionare e vetme që ofron këtë shërbim në portin Romano Port, Durrës.

5. Periudha e hetimit e përcaktuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 277, datë 03.04.2013 është nga 11.04.2012 deri në 31.03. 2013.

III. Tregu përkatës

6. Bazuar në Ligjin nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Udhëzimin nr. 76, datë 07.04.2008 të Komisionit të Konkurrencës “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit përfshin shërbimin e ngarkim shkarkimit të GLN-së në zonën e Porto Romanos, Durrës. Karakteristikat e këtij tregu janë paraqitur në mënyrë të detajuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr.221. datë 11.04.2012.

IV. Vlerësimi i pozitës dominuese

7. Në bazë të pikës 5 të nenit 3 të Ligjit nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, pozitë dominuese është ajo pozitë e një ose më shumë ndërmarrjeve që i bën ato të jenë të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës” në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si: konkurrentët, klientët ose konsumatorët.

8. Vlerësimi i pozitës dominuese të ndërmarrjes nën hetim Romano Port sha është bërë duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara në nenin 8 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të cilat janë analizuar në mënyrë të detajuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.221. datë 11.04.2012. Kjo analizë është e vlefshme edhe për këtë procedurë hetimore, pasi nuk kanë ndryshuar kushtet e tregut përkatës.

9. Shoqëria “Romano Port” SHA, operon sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet saj dhe Qeverisë Shqiptare dhe më pas të miratuar në Parlament me Ligjin nr. 9298, datë 11.07.2004, (i ndryshuar). Në bazë të marrëveshjeve koncesionare të lidhura nga ana e Shtetit Shqiptar me këtë ndërmarrje, ekziston e drejta e ekskluzivitetit për një periudhë 30 vjeçare të këtij porti. Sipas kësaj kontrate, për periudhën kohore në vijimësi nuk mund të ndërtohen porte të tjera në vend përveç përjashtimeve të parashikuara në marrëveshjet koncesionare për sa i përket ngarkimit-shkarkimit dhe depozitimit të naftës dhe nënprodukteve të saj. Ndërmarrja Romano Port sha ka ekskluzivitetin për ofrimin e shërbimit të ngarkim-shkarkimit, i cili në kuptim të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” përbën një pengesë në hyrje në tregun përkatës.

10. Për sa më sipër, në zonën e Porto Romanos Durrës, ndërmarrja “Porto Romano SHA” ka pozitë dominuese në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm të naftës (GLN)

V. ANALIZA E SJELLJES SË NDËRMARRJES “ROMANO PORT” SHA

11. Ndërmarrja “Prima Gas Albania” SHA në ankesën e paraqitur shprehet se Romano Port SHA nuk po zbaton rregulloren e funksionimit të portit duke lejuar jashtë radhe dhe shkarkimin e anijeve të tjera, ndërkohë që anija e Prima Gas Albania mbetet në pritje.

12. Në lidhje me ankesën, nga ana e grupit të punës janë marrë shpjegime nga ankuesi, ndërmarrja “Prima Gas Albania” SHA, kapiteni i kapitanerisë së portit Romano Port Sh.a dhe nga agjenti detar spedicioner i agjencisë “Alb Marine”, i cili është përfaqësues i ndërmarrjes Primagas Albania Sha, pranë Portit “Romano Port” SHA.

13. Nga shpjegimet e dhëna, si dhe nga informacioni i marrë gjatë procedurës hetimore rezulton se anija “Worcester” ka ardhur për llogari të ndërmarrjes “Primagas” më datë 27.02.2013 në radin e portit të Durrësit, ndërsa në datat 01 dhe 02 Mars 2013 është akostuar dhe ka shkarkuar sasinë prej 1200 ton (shkarkim parcial) në portin Romano Port. Me kërkesën e saj kjo anije është larguar nga pontili i portit Romano Port drejt radit të portit të Durrësit.

14. Më datë 05.03.2013 nga ana e Romano Port Sha është lëshuar fatura me nr. 41 për kryerjen e shërbimit të sigurisë dhe tarifën kundër zjarrit për anijen Workcester. Ky është një shërbim i cili kryhet nga ana e portit sa herë futet anija dhe nuk lidhet me faturën e parë paguar nga ana e pritësit të mallit me nr. 29, datë 25.02.2013. Fatura nr 41, datë 05.03.2013 është nënshkruar nga ana e përfaqësuesit të Prima Gaz Sha, por kjo faturë nuk është paguar dhe është raportuar në organet tatimore si faturë e anuluar. Gjithashtu referuar lejes së akostimit për shkarkim të lëshuar nga Dega e Doganës Durrës anija Workcester do shkarkonte me tre pjesë ngarkesën. Për të mos krijuar probleme vonesash në shkarkim Porto Romano e ka lëshuar faturën për shërbimin e shkarkimit të dytë që do realizonte kjo anije që në datën 05.03.2013. Kjo anije ka qenë e planifikuar për të rihyrë në pontil në datë 13.03.2013, por për arsye të kushteve atmosferike anija nuk ka hyrë në pontil.

15. Nga praktikat e shkarkimit të analizuara, rezulton se të gjitha ndërmarrjet që kanë realizuar shërbimin e shkarkimit të GLN-së kanë parapaguar shërbimin e ofruar nga Romano Port SHA, bazuar në “Rregulloren e funksionimit të portit të përpunimit të lëndëve djegëse” miratuar nga Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) me vendimin nr. 4, datë 27.04.2009.

16. Duke qenë se rasti i anijes Workcester është një praktikë e veçantë (shkarkim i pjesshëm), është vlerësuar praktika e realizuar nga ana e një ndërmarrjeje, për shkarkimin

e produktit naftë, procedurë e cila është e vetmja praktikë e ngjashme (shkarkim i pjesshëm) që është realizuar në Portin Romano Port SHA. Nga kjo praktikë rezulton se pritësi i mallit, ka parapaguar shërbimin e shkarkimit në port, sipas zërave përkatës të përcaktuar në “Rregulloren e funksionimit të portit të përpunimit të lëndëve djegëse”, për çdo shkarkim të pjesshëm të realizuar.

17. Ndërmarrja Romano Port Sha, siç përcaktohet edhe në rregulloren e funksionimit të portit, miratuar nga OSHA, ka zbatuar të njëjtën procedurë për të dy praktikat, si në rastin e anijes me naftë edhe në rastin e anijes Workcester me pritës subjektin Prima Gas Albania SHA, duke kërkuar parapagimin e tarifës për shërbimin që do të ofrohet në port. Këto dy anije janë të vetmet praktika shkarkimesh të pjesshme të realizuara nga porti Romano Port SHA, gjatë periudhës objekt hetimi.

18. Gjatë procedurës hetimore u realizuan intervistime të ndërmarrjeve që operojnë në tregun e importimit dhe tregtimit të GLN-së, të cilat evidentuan problematikën e lidhur kryesisht me mosrakordimin e peshës së mallit nga anija në depozitat e ndërmarrjeve duke kërkuar që të sigurohen linja të personalizuar për transportin e GLN-së nga anija në depozitat e çdo subjekti në mënyrë që sistemi i kontrollit teknik të jetë transparent dhe i monitorueshëm nga palët.

19. Gjithashtu gjatë procedurës së hetimit u analizuan dhe ndryshimet që kanë ndodhur në strukturën e tregut të importit dhe të shitjes me shumicë së GLN-së për periudhën 2010 – 2012, në sasi dhe në vlerë, nga e cila u evidentua se sjellhja e ndërmarrjes objekt hetimi për periudhën hetimore nuk ka ndikuar në ndryshimin e strukturës të tregut të importit të GLN-së

Si konkluzion, bazuar në të gjitha faktet dhe evidencat e grumbulluara gjatë procesit të hetimit paraparak në tregun e ngarkim-shkarkimit të GLN-së në rrugë detare në Porto Romano, mbi të gjitha praktikave të ngarkim shkarkimit të realizuara nga ana e “Romano Port” Sha për periudhën hetimore si dhe nga analiza e sjelljes së ndërmarrjes me pozitë dominuese “Romano Port’ SHA, rezulton se nuk ka shenja të abuzimit me pozitën dominuese nga ana e ndërmarrjes Romano Port SHA, të parashikuara në nenin 9, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d) dhe 43, pika 5, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” si dhe në nenin 4, pika 9, gërma a, të Rregullores “Për procedurat hetimore të Autoritetit të Konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të ngarkim-shkarkimit të gazit të lëngshëm në zonën “Porto Romano”, pasi nuk ka shenja të kufizimit të konkurrencës, në bazë të nenit 9 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e vendimit palëve nën hetim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS**Servete GRUDA****Koço BROKA****Iva ZAJMI****Rezana KONOMI**

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar**Lindita MILO (LATI)**

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

Nr. 290, Datë 23.07.2013

**“Për
vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Ferlut” SHA, “Tirana Lines” Shpk,
“Alba Trans” Shpk, “Tirana Urban Trans” SHA dhe “Parku i Transportit
Urban të Udhëtarëve” shpk, për kufizim të konkurrencës në tregun
e tregtimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme
dhe studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve
në qytetin e Tiranës”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

▪	Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪	Rezana	KONOMI	Zv/Kryetar
▪	Servete	GRUDA	Anëtar
▪	Koço	BROKA	Anëtar
▪	Iva	ZAIMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.07.2013, 15.07.2013 dhe 23.07.2013 shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Ekzistenca ose jo e marrëveshjes së ndaluar në tregun e tregtimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe të studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës, ndërmjet ndërmarrjeve “FERLUT” SHA, “TIRANA LINES” SHPK, “ALBA-TRANS” SHPK, “TIRANA-URBAN-TRANS” SHA dhe “PARKU I TRANSPORTIT URBAN TË UDHËTARËVE” SHPK dhe “OTTO-AL” SHPK

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d); neni 26; neni 4, pika 1; neni 74 pika 1, shkronja a) dhe neni 75, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar (këtu e mëposhtë Ligji);
Ligji Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”.

Ndërmarrjet nën hetim: Vendimi nr. 262, datë 14.01.2013 i Komisionit të Konkurrencës ka përcaktuar ndërmarrjet objekt hetimi që janë: “FERLUT” SHA, “TIRANA LINES” SHPK, “ALBA-TRANS” SHPK, “TIRANA-URBAN-TRANS” SHA, “PARKU I TRANSPORTIT URBAN TË UDHËTARËVE” SHPK dhe “OTTO-AL” SHPK

Periudha e hetimit: Vendimi nr. 262, datë 14.01.2013 i Komisionit të Konkurrencës ka përcaktuar periudhë objekt hetimi 1 Janar 2007 - 31 Dhjetor 2012

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të grupit të punës mbi hetimin e thelluar në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës të hapur me Vendimin nr.262, datë 14.01.2013 të Komisionit të Konkurrencës dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Dosjen hetimore të grupit të punës
- Pretendimeve të ndërmarrjeve nën hetim “FERLUT” SHA, “ALBA-TRANS” SHPK, dhe “TIRANA-URBAN-TRANS” SHA në seancat dëgjimore përkatëse: të datës 21.05.2013, 22.05.2013 dhe 11.06.2013, si dhe ato me shkrim të dorëzuara pranë Autoritetit të Konkurrencës, përkatësisht me shkresat me nr. 204/3 prot, dt. 21.05.2013, nr. 241 prot., datë 11.06.2013 dhe nr. 204/4 prot, dt. 22.05.2013,

VËREN SE:

I. Çështja në shqyrtim

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, ndërmarrja “ALBA-TRANS” SH.P.K ka paraqitur në datë 12.11.2012 një ankesë nëpërmjet të cilës pretendohet se Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas (SHKTQ) e përbërë nga anëtarët e saj: Tirana Urban Trans, Tirana Lines dhe Ferlut, të cilët operojnë në fushën e transportit rrugor qytetas, tregëtonin në kushte të padrejta abonetë e përgjithëshme duke mos i njohur abonetë e shitura nga kjo ndërmarrje gjatë muajve tetor – nëntor 2012.

2. Gjithashtu më datë 27.11.2012 ndërmarrja “Gerard-A” Sh.p.k paraqiti pranë Autoritetit të Konkurrencës një ankesë nëpërmjet të cilës pretendon se duke qenë se shoqëria “Gerard-A” nuk është pjesë e SHKTQ-së, kjo e fundit vendosi në mënyrë arbitrare mospajisjen me kartonin shoqërues për abonetë për muajin tetor.

3. Disa nga ndërmarrjet nën hetim janë anëtare të Shoqatës Kombëtare të Transportit Qytetas Tiranë (SHKTQ). Kjo shoqatë është themeluar më datë 15.12.2003 në Tiranë dhe është regjistruar si person juridik dhe ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë qytetin e Tiranës.

II. PROCEDURA

4. Bazuar në ankesat e sipërpërmendura, me propozim të Sekretariatit, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit, u shpreh me anë të Vendimit nr. 252, datë 26.11.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës.

5. Në përfundim të hetimit paraprak u konstatua se anëtarët e SHKTQ-së kanë refuzuar dhënien e kartonave shoqërues të aboneve sipas sasisë së vendosur nga Bashkia Tiranë ndërmarrjes “Gerard – A” SHPK, si dhe kanë refuzuar për të njohur abonete pa kartonin shoqërues me logon e SHKTQ të ndërmarrjes “ALBA-TRANS” SHPK, fakte të cilat mund të përbëjnë pengim, kufizim ose shtrembërim të konkurrencës në tregun përkatës.

6. Gjithashtu, gjatë procedurës së hetimit paraprak u gjeten evidenca në formë të shkruar dhe elektronike, pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës, si dhe pranë SHKTQ-së, nga të cilat rezulton se ndërmarrjet “FERLUT” SHA, “TIRANA- LINES” SHPK, “ALBA-TRANS” SHPK, “TIRANA-URBAN-TRANS” SHA, “PARKU I TRANSPORTIT URBAN TË UDHËTARËVE” SHPK dhe “OTTO-AL” SHPK, kanë bërë një marrëveshje me anë të së cilës kanë bllokuar shitjen e 50% të sasisë së aboneve të studentit, për vitin 2007 dhe rreth 80% të sasisë së aboneve të studentit për periudhën 2008-2012. Kjo marrëveshje në kuptim të nenit 4, pika 1, germa (b) dhe (c), të Ligjit mund të përbënte kufizim apo shtrembërim të konkurrencës në treg duke kufizuar dhe kontrolluar shitjen e aboneve të studentit.

7. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, germa (d) dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit, si dhe të nenit 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit, u shpreh me anë të Vendimit nr. 262, datë 14.01.2013 për hapjen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë në këtë treg.

8. Gjithashtu, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me Vendimin nr. 263, datë 14.01.2013 “Për marrjen e masave të përkohshme për tregtimin e biletave të pajtimin mujor (aboneve) të studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”, në mbështetje të neneve 4, pika 1, 24, germa d, 44, pika 1 dhe 2, të Ligjit, duke marrë në konsideratë rrezikun e kryerjes së një dëmi të rëndë dhe të pariparueshëm për konkurrencën pasi ka të ngjarë të ketë shkelje të nenit 4 të Ligjit, dhe vendosi: *Marrjen e masave të përkohshme për eliminimin e pasojave antikonkurruese sipas nenit 44, pika 1, si vijon: Shpërndarjen dhe tregtimin e menjëhershëm dhe pa vonesë nga ndërmarrjet: “FERLUT” SHPK, “TIRANA LINES” SHA, “ALBA TRANS” SHPK,*

“TIRANA URBAN TRANS” SHA dhe “PARKU I TRANSPORTIT URBAN TË UDHËTARËVE” SHPK.” të të gjithë sasisë së biletave të pajtimit mujor për nxënësit dhe studentët (abone studenti) sipas sasisë së përcaktuar nga Bashkia e Tiranës, duke filluar nga muaji Janar 2013.”

9. Në bazë të të dhënave nga ana e Bashkisë Tiranë, për periudhën Janar – Shkurt 2013, konstatohet se ndërmarrjet Ferlut, Tirana Urban Trans dhe Parku i Udhëtarëve kanë tregtuar dhe shitur 100% të sasisë e përfutur të aboneve të studentit për këtë periudhë. Ndërmarrja Tirana Lines, sipas të dhënave, të cilat janë 2 mujore, ka shitur 52 % të sasisë së përfutur të aboneve të studentit për këtë periudhë. Për ndërmarrjen Alba Trans të dhënat janë vetëm në vlerë, të cilat vlerësohen përafërsisht me 60% të sasisë së aboneve të studentit të përfutur për periudhën Janar – Shkurt 2013. Ndërmarrja “OTTO AL” ka dalë jashtë tregut në muajin qershor, 2012.

10. Sa më sipër, të gjithë ndërmarrjet objekt hetmi në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës e kanë zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 263, datë 14.01.2013, duke hedhur në treg në mënyrë të pavaruar nga njëri-tjetri të biletave të pajtimit mujor për nxënësit dhe studentët (abone studenti).

11. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 273, datë 18.03.2013 “Për një ndryshim në Vendimin nr. 262, datë 14.01.2013 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”, u shpreh për të zgjatur periudhën për dorëzimin e raportit deri në datë 15 prill 2013, pasi informacioni i ardhur nga palët nën hetim dhe institucioni rregullator Bashkia Tiranë nuk ishte i plotë. Komisioni çmoi se sigurimi i një informacioni të plotë dhe të detajuar për të parë më mirë sjelljen e ndërmarrjeve në treg është i nevojshëm për të siguruar një vendimarrje sa më objektive.

12. Në zbatim të nenit 39 të Ligjit, Komisioni i Konkurrencës ftoi ndërmarrjet objekt hetimi në seancë dëgjimore me shkresat nr.240 prot., datë 7.05.2013, duke i vendosur në dispozicion raportin e hetimit të thelluar dhe dosjen hetimore. Vetëm ndërmarrjet “FERLUT” SHA, “ALBA-TRANS” SHPK, dhe “TIRANA-URBAN-TRANS” SHA paraqitën pretendimet e tyre me shkrim dhe në mënyrë verbale gjatë seancave dëgjimore.

III. ANALIZA E KONKURRENCES

Analiza e konkurrencës realizohet për një treg përkatës, i cili nënkupton produktet apo shërbimet që vlerësohen si të zëvendësueshme nga konsumatorët, ose klientët e tjerë, për sa u përket karakteristikave, çmimit dhe funksionit të tyre dhe që ofrohen, ose kërkohen nga ndërmarrjet në një zonë gjeografike me kushte të njëjta konkurrence, zonë kjo e cila veçohet nga zonat e tjera kufizuese

III.1. Tregu përkatës

Tregu përkatës, në bazë të nenit 3 pikës 7 të Ligjit dhe të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 76, datë 07. 04. 2008 “Për miratimin e udhëzimit për përcaktimin e tregut përkatës” përcaktohet në dy dimensione:

- a)** Tregu i produkteve
- b)** Tregu gjeografik

III.1.1 Tregu përkatës i produktit

13. Transporti i udhëtarëve është shërbimi në linjë të rregullt transporti me frekuencë dhe itinerare të pandryshuara, ku udhëtarët mund të merren dhe të lihen në vendqëndrime të përcaktuara më parë. Ky shërbim në qytetin e Tiranës kryhet vetëm me autobus, i cili plotëson nevojat e popullsisë së qytetit, brenda vijave kufizuese të tij ose, duke lidhur qendra të rëndësishme ekonomike dhe sociale me pjesët e tjera të qytetit.

14. Shërbimi i transportit qytetas realizohet nëpërmjet biletave, të cilat janë:

- për një udhëtim vajtje ose kthim;
- biletë pajtimi mujor, për një linjë;
- biletë pajtimi mujor, e përgjithshme (abone e përgjithshme);
- biletë pajtimi mujor, e përgjithshme, për nxënësit dhe studentët, për të gjitha linjat, brenda qytetit (abone studenti).

15. Karakteristikat e produktit:

- Biletë e pajtimimit mujor (Abone) e përgjithshme, është biletë udhëtimi mujore e parapaguar, e cila shërben për transportin qytetas nëpërmjet autobusëve në të gjitha linjat e autobusëve për të gjithë qytetarët. Aboneja e përgjithshme ka një vlerë të përcaktuar me VKM¹.
- Biletë e pajtimimit mujor (Abone) studenti, është biletë udhëtimi mujore e parapaguar, e cila shërben për transportin qytetas nëpërmjet autobusëve në të gjitha linjat e autobusëve për nxënësit dhe studentët. Aboneja e studentit ka një vlerë të përcaktuar me VKM, e cila është sa ½ e vlerës së abonesë së përgjithshme, me qëllim favorizimin e kategorive të veçanta si nxënës dhe studentë².

16. Shërbimi i transportit urban është një e drejtë ekskluzive sipas linjave përkatëse, por ky shërbim ndërthuret pasi përdoruesit e abonesë së përgjithshme dhe abonesë së studentit mund të përfitojnë këtë shërbim nga të gjitha linjat. Pra, bileta e pajtimimit mujor e përgjithshme (apo aboneja e përgjithshme) dhe bileta e pajtimimit mujor studenti (apo

¹ VKM Nr 146, Datë 26.02.1998, e azhurnuar me VKM Nr 637, Datë 21.05.2008.

² Neni 22 kontratës Në kontratat shërbimit të lidhura për transportin e udhëtarëve në linjat qytetase në bashkinë e Tiranës ndërmarrjet e transportit qytetas të udhëtarëve marrin përsipër respektimin e kuadrit ligjor dhe akteve të nxjerra nga organet e qeverisjes vendore, lidhur me transportin e kategorive të veçanta të udhëtarëve si : - Studentët dhe Nxënësit; - Udhëtimin falas për invalidët paraplegjik dhe tetraplegjik etj.

aboneja e studentit) mund të përdoret në të gjitha shërbimet e transportit publik të udhëtarëve në qytetin e Tiranës.

17. Bileta e pajtimit mujor (aboneja) është biletë udhëtimi, që emetohet dhe shpërndahet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, modeli i së cilës përcaktohet nga kjo drejtori. Tërheqja e biletave për transportin rrugor të udhëtarve për shërbimin qytetas realizohet nga shoqëritë e licencuara për këtë lloj transporti, të cilat duhet të pajisin udhëtarët me biletë si provë të qënies së një kontrate midis tyre (sipas Ligjit nr.8308 datë 18.3.1998, neni 10 pika a).

18. Për sa më sipër, bazuar në Udhëzimin e Tregut Përkatës, tregu përkatës i produktit është tregtimi i biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës.

III. 1.2 Tregu gjeografik

19. Ndërmarrjet nën hetim ushtrojnë veprimtarinë e tyre në transportin rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës. Për vlerësimin e sjelljes së këtyre ndërmarrjeve, treg gjeografik do të konsiderohet qyteti i Tiranës.

III. 2. SJELLJA E NDËRMARRJEVE NË TREG

III.2.1. Sjellja e ndërmarrjeve në tregëtimin e abonesë së përgjithëshme

20. Pranë Autoritetit të Konkurrencës dy ndërmarrjet “Alba-Trans” sh.p.k dhe “Gerard-A” Sh.p.k kanë paraqitur ankesat nëpërmjet të cilave pretendojnë se Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas (SHKTQ) e përbërë nga anëtarët e saj: Tirana Urban Trans, Tirana Lines dhe Ferlut, të cilët operojnë në fushën e transportit rrugor qytetas, ka shkelur Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”, duke vendosur kushte të padrejta tregëtimi të abonesë së përgjithëshme.


21. Ndërmarrja “Alba-Trans”, ka patur disa mosmarrëveshje me SHKTQ dhe ka deklaruar daljen nga SHKTQ si dhe nuk ka tërhequr kartonat shoqërues të aboneve me logon e SHKTQ për muajin korrik 2012. Anëtarët e tjerë të SHKTQ kanë nxjerrë njoftimin e mëposhtëm (shih faksimilen në këtë vendim) duke e vendosur në çdo autobus urban, si dhe në kioskat e shitjes së aboneve.

N J O F T I M !

joftojmë qytetarët se në kuadër të luftës
ndër falsifikim it dhe informalitetit,
konetë e muajit Korrik-2012, e në vazhdim
o të njihen vetëm të shoqëruar me kartonin
miratuar nga Bashkia e Tiranës dhe
hoqata. Çdo karton tjetër është i pa
lefshëm .



Pjesa e parë



Pjesa e dytë

SHOQATA KOMBETARE E TRANSPORTIT QYTETAS

22. Ky njoftim është gjetur në formë elektronike edhe në zyrën e SHKTQ-së. Ky veprim i SHKTQ është kryer me qëllim për të penguar shitjen e aboneve të përgjithshme të ndërmarrjes “Alba-Trans”, e cila është një ndërmarrje me eksperiencë të gjatë në këtë treg.

23. Shoqëria “Gerard-A” Sh.p.k pretendon se me marrëveshje anëtarët e SHKTQ, kanë vendosur në xhamat e autobusëve urbanë dhe kioskat shitëse të aboneve, një njoftim me titull: “KUJDES nga abonete dhe kartonat falsë”. Megjithatë përmbajtja e këtij njoftimi është për mos-njohjen e aboneve të përgjithshme dhe të studentit të tregëtuar nga ky operator pa kartonin shoqërues.

24. Meqenëse ndërmarrja “Gerard-A” nuk është pjesë e SHKTQ, kjo e fundit vendosi mos-pajisjen me kartonin shoqërues për abonete për muajin tetor 2012. Gjatë inspektimeve, në zyrën e SHKTQ-së është gjetur vendimi i Shoqatës i datës 29.10.2012, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të ndërmarrjeve “Ferlut”, “Tirana Lines”, “Tirana Urban Trans” si dhe nga Sekretari dhe Kryetari i SHKTQ, nëpërmjet të cilit anëtarët e SHKTQ-së, në kundërshtim me aktin e Bashkisë Tiranë, për dhënien e 5500 kartonave shoqërues për ndërmarrjen “GERARD-A” SHPK, kanë vendosur që për muajin nëntor 2012, operatori i ri “Gerard-A” SHPK të pajiset me vetëm 1200 copë kartona shoqërues aboneje, duke penguar këtë konkurrent të tregtojë abone sipas numrit të përcaktuar nga Bashkia.

25. Ndërmarrjet, anëtare të ShQKT-së, kanë kundërshtuar Bashkinë në dhënien e një numri kaq të madh të aboneve për “Gerard-A” sh.p.k, pasi ishte në kundërshtim me

metodologjinë që lidhet me numrin e mjeteve dhe vendeve për çdo mjet. Në përgjigje të këtij kundërshtimi, përfaqësuesit e Bashkisë së Tiranës kanë deklaruar se kësaj ndërmarrjeje i është akorduar një numër i madh abonesh për shkak të zonës që mbulon, e cila është në distancë të madhe nga qendra e qytetit, si dhe për shkak të gjendjes ekonomike të banorëve të kësaj zone. Kjo linjë përfshin edhe Qytetin Studenti dhe përdoret gjerësisht nga studentet që jetojnë në këtë zonë.

26. Sipas Ferlut, është pikërisht ndërhyrja e qeverisë vendore që ka çuar anëtarët e SHKTQ përfshi edhe Ferlut, që të refuzojnë furnizimin me kartona për muajin nëntor 2012. Një gjë e tillë njihet edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane në rastin e Kartelit të Sheqerit, çështja 40/73 (1975) ku sjellja e operatorëve për kufizimin e konkurrencës ishte shkaktuar nga vetë qeveria që ndërhynte në punën e tyre. Për rrjedhojë nuk ka një marrëveshje të ndaluar në kuptim të nenit 4 të Ligjit 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

27. Bashkia e Tiranës është shprehur për mosnjohjen e abonesë pa kartonin shoqërues, gjatë muajit tetor 2012, me anë të disa shkresave drejtuar të gjithë operatorëve që ushtrojnë veprimtari në fushën e transportit rrugor qytetas në qytetin e Tiranës ju bën me dije se: duke parë problematikën e krijuar nga mosnjohja e aboneve pa kartonin shoqërues të prodhuar nga SHKTQ, Bashkia e Tiranës nuk do të njohë më kartonin shoqërues të aboneve që prodhohet nga SHKTQ. Megjithatë atë, ndërmarrjet anëtare të SHQKT-së, me vendimin e datës 29.10.2012 vendosen mosnjohjen e aboneve pa kartonin shoqërues.

28. Pretendimi se sjellja e ndërmarrjeve është një kundër-përgjigje ndaj vendimit të Bashkisë, nuk është rast analog me atë të Kartelit të Sheqerit, madje është e kundërta pasi në këtë rast ishte vetë qeveria italiane që kishte nxitur ndërmarrjet të hynin në marrëveshje me njëra tjetrën e madje ishte një politikë e shtetit italian për të pasur çmime të njëjta të sheqerit. (Paragrafi 54. I çështjes)³. Sjellja e ndërmarrjeve është një kundër-përgjigje ndaj masës së marrë nga Bashkia, ka efekte të drejtpërdrejta ndaj konkurrencës në treg si dhe ndaj konsumatorëve.

29. Gjatë seancave dëgjimore ndërmarrja “Ferlut” pretendoi se nuk i ka refuzuar ndërmarrjes Alba Trans njohjen e aboneve pa kartonin shoqërues të SHKTQ për muajin korrik 2012. Lidhur me këtë pretendim edhe ndërmarrja Alba Trans në pretendimet e saj shprehet se: “.... me shoqërinë “Ferlut” SHA ne nuk e kemi pasur këtë problematikë. Pra e thënë ndryshe, kjo shoqëri ka njohur të gjitha abonetë pa karton të lëshuara në treg nga shoqëria jonë”. Gjithashtu ndërmarrja Ferlut, pretendon se pavarësisht refuzimit të furnizimit me kartona nga SHKTQ ndaj “Gerard – A” SHPK, Bashkia e Tiranës, ka

³ Judgment of the Court of 16 December 1975. - Coöperatieve Vereniging “Suiker Unie” UA and others v Commission of the European Communities. - Joined cases 40 to 48, 50, 54 to 56, 111, 113 and 114-73, marrë nga faqja e Bashkimit Europia <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:61973CJ0040:EN:HTML>.

urdhëruar që për muajin nëntor e në vazhdim të njihen abonetë e tregtuara nga operatorët edhe kur nuk janë të shoqëruara nga kartoni. Në këtë mënyrë ndërmarrja “Gerard-A” nuk është cënuar nga ky vendim i shoqatës.

30. Marrëveshja e anëtarëve të SHKTQ e shprehur nëpërmjet vendimeve të SHKTQ-së, e cila përbën një evidencë direkte, për të refuzuar njohjen e biletave të pajtimit mujor pa kartonat shoqërues, si dhe lëshimi i një numri të kufizuar kartonësh për ndërmarrjet “Alba Trans” shpk dhe “Gerard – A” SHPK, ka kufizuar tregtimin e biletave mujore (aboneve). Në këtë mënyrë, kartonat shoqërues janë përdorur si mjet për të kufizuar tregun e shitjes së aboneve. Ky kufizim ka përfunduar pasi Bashkia e Tiranës ka urdhëruar që abonetë të tregtohen edhe pa karton shoqërues, me anë të shkresës nr. 9645/1 prot., datë 29.10.2012, drejtuar të gjithë operatorëve që ushtrojnë veprimtari në transportin rrugor qytetas.

31. Kartoni shoqërues i biletave të pajtimit mujor, i cili duhet të përmbajë elementet e sigurisë si dhe të dhënat personale të zoteruesit të abonesë, është një instrument i ligjshëm për të mbrojtur tregun nga falsifikimi dhe informaliteti, por sikurse del e qartë nga vendimet dhe orientimet nëpërmjet njoftimit të vendosur në autobuzat e ndërmarrjeve anëtare të SHKTQ-së, ky instrument është përdorur për të kufizuar tregëtimin e aboneve të ofruara nga dy konkurrentë të tregut përkatës.

32. *Si përfundim, sjellja e anëtarëve të SHKTQ (“TIRANA-URBAN-TRANS”, “FERLUT” dhe “TIRANA LINES”) lidhur me refuzimin e dhënies së kartonave shoqërues të aboneve ndërmarrjes “Gerard – A” si dhe refuzimin për të njohur abonetë pa kartonin shoqërues me logon e SHKTQ të ndërmarrjes “Alba-Trans”, nga ndërmarrjet Tirana Urban Trans dhe Tirana Lines, në kuptim të nenit 3, pika 4, të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, është një marrëveshje, e cila bazuar në nenin 4, pika 1, germa (b) dhe (c) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar) përbën marrëveshje të ndaluar, pasi ndan dhe kontrollon tregun.*

III.2.2 Sjellja e ndërmarrjeve në treg në lidhje me abonete e studentit për periudhën 2007-2012.

33. Në lidhje me tregëtimin e biletave të pajtimit mujor të studentit gjatë periudhës objekt hetimi janë evidentuar faktet e mëposhtme:

34. Për vitin 2007, referuar Vendimeve të SHKTQ-së, të siguruar nga grupi i punës gjatë hetimit, ndërmarrjet nën hetim për periudhën janar – nëntor 2007 kanë rënë dakord për të bllokuar 50% të numrit total të aboneve të studentit dhe nga muaji dhjetor 2007 kanë rënë dakord për të bllokuar 80% të tyre. Gjithashtu, referuar vendimeve rezulton se ndërmarrja “OTTO AL” nuk ka zbatuar vendimet e SHKTQ-së për periudhën janar - maj 2007. Nga dokumentet e shqyrtuara nga inspektorët e Autoritetit të Konkurrencës rezulton se kjo ndërmarrje nuk i ka zbatuar këto vendime, madje operatorët e tjerë kanë kërkuar që të merren masa që të zbatohet marrëveshja edhe nga ky operator (Vendimi

12.5.2007, 22.5.2007 i SHKTQ etj.). Referuar numrit të aboneve të studentit të përfituara dhe të tregtuara nga ndërmarrjet nën hetim, rezulton se sasia e tregtuar e aboneve të studentit për periudhën janar – nëntor 2007 është 50% e sasisë së aboneve të përfituara, kurse për muajin dhjetor 2007 është 20%.

35. Për vitin 2008, referuar të dhënave të shitjeve si dhe akteve të SHKTQ, të administruara gjatë hetimit, lidhur me sasinë e aboneve të studentit të përfituara dhe të tregtuara nga secila prej ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e transportit qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës, përkatësisht: Ferlut, Alba Trans, Tirana Lines dhe Tirana Urban Trans, kanë bllokuar dhe nuk kanë tregtuar 80 % të sasisë së përfituar për periudhën janar – dhjetor 2008. Në vitin 2008, referuar Vendimeve të SHKTQ (Vendimi i SHKTQ dt. 25.11.2008) rezulton se ndërmarrjes “OTTO AL” i janë dhënë vetëm 50 % e kartonëve shoqërues të aboneve, pa të cilët nuk mund të tregtohej aboneja, pasi nuk njihej nga anëtarët e SHKTQ-së. Pra, kartoni shoqërues i aboneve është përdorur nga SHKTQ-ja, si formë presioni ndaj anëtarëve për zbatimin e marrëveshjes. Ky fakt shprehet në dokumentin e SHKQT-së si më poshtë:

NJOFTIM PËR DETYRIMET
(PER KUJTESE)

DREJTUAR DREJTORAVE : “FERLUT; “TIRANA LINES”; “ALBA TRANS”
TE SHOQERIVE “TIRANA URBAN TRANS” “OTTO-AL”

Ne zbatim te vendimeve te mara nga vete anetaret(pronaret) e SHKTQ, ne lidhje me kartonat e aboneve, ju kujtojmë :

Para marjes se kartonave per abone per muajin **TETOR - 2008** edo shoqeri te zbatoje pikat si me poshte :

1. Te jete bere likuidimi i kuotes shoqates per muajin Shtator – 08 (Sejcili te sjelli mandatin e likuidimit)
2. Te dorzoje per bllokim sasine prej 80 % e aboneve te studentit per muajin Tetor-08, prane zyres se SHKTQ.
3. Te dorzoje prane zyres se SHKTQ, nje kopje te Proces – Verbalit te marjes se aboneve nga Dega e Tatimeve te Tiranes per muajin Tetor - 08, qe ka te shenuar numurin e serive te aboneve.
4. Mandatin e shlyerjes se kartonave te muajit Shtator-08, ne Nr. e llogarise se shtypshkronjes “Albdesign”.
- 5.

Ne se ndonje shoqeri nuk do te zbatoje pikat e me sipërme, nuk do ti jepen kartonat e aboneve. Kjo do te zbatohet edhe per muajt pasardhes.

36. Për vitin 2009, referuar të dhënave të shitjeve si dhe akteve të SHKTQ të administruara gjatë hetimit, lidhur me sasinë e aboneve të studentit të përfituara dhe të

tregtuara nga secila prej ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e transportit qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës, përkatësisht: FERLUT, ALBA TRANS, TIRANA LINES. TIRANA URBAN TRANS dhe “PARKU I TRANSPORTIT URBAN TE UDHETARVE”, kanë bllokuar dhe nuk kanë tregtuar 80 % të sasisë së përfituar për periudhën janar – dhjetor 2009.

37. Për vitin 2010, referuar të dhënave të shitjeve si dhe akteve të SHKTQ të administruara gjatë hetimit, lidhur me sasinë e aboneve të studentit të përfituara dhe të tregtuara nga secila prej ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e transportit qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës, përkatësisht: Ferlut, Alba Trans, Tirana Lines dhe Tirana Urban Trans, vazhdojnë të kryejnë të njëjtën sjellje, duke bllokuar dhe mos tregtuar 80 % të sasisë së përfituar për periudhën janar – dhjetor 2010.

38. Për vitin 2011, referuar të dhënave të shitjeve si dhe akteve të SHKTQ të administruara gjatë hetimit, lidhur me sasinë e aboneve të studentit të përfituara dhe të tregtuara nga secila prej ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e transportit qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës, përkatësisht: Ferlut, Alba Trans, Tirana Lines dhe Tirana Urban Trans, kanë bllokuar dhe nuk kanë tregtuar 80 % të sasisë së përfituar për periudhën janar – dhjetor 2011.

39. Për vitin 2012, referuar të dhënave të shitjeve si dhe akteve të SHKTQ të administruara gjatë hetimit, lidhur me sasinë e aboneve të studentit të përfituara dhe të tregtuara nga secila prej ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e transportit qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës, përkatësisht: Ferlut, Alba Trans, Tirana Lines dhe Tirana Urban Trans, kanë bllokuar dhe nuk kanë tregtuar 80 % të sasisë së përfituar për periudhën janar – qershor 2012.

40. Vendimet dhe rekomandimet të SHKTQ-së janë zbatuar nga ndërmarrjet anëtare ose jo të SHKTQ-së, sic evidentohet mëposhtë:

a) Në ndërmarrjen “ALBA TRANS”, janë gjetur në formë elektronike tabela për vitet 2011 dhe 2012 ku paraqitet sasia e aboneve të përgjithshme, aboneve të studentit dhe aboneve të linjave të marra nga kjo ndërmarrje dhe sasia e shitur për secilën nga llojet e aboneve. Tabelat përmbajnë edhe një rresht, i cili quhet “BLOKUAR” që korrespondon me kolonën e aboneve të studentit dhe në të cilën jepet sasia e aboneve të studentit të bllokuara dhe të pa tregëtuara nga kjo ndërmarrje.

b) Pranë ndërmarrjes “ALBA-TRANS” SHPK është gjetur korrespondencë elektronike midis një punonjësi të ndërmarrjes “ALBA-TRANS” SHPK dhe Sekretarit të Përgjithshëm të SHKTQ-së. Në këtë korrespondencë, të zhvilluar në datat 27.07.2012, 20.09.2012, 08.10.2012, 10.10.2012 dhe në datë 16.10.2012, flitet në lidhje me bllokimin e shitjes së aboneve të studentit dhe nxjerrjen në shitje të vetëm 20% të sasisë totale. Bllokimi do kryhej në zyrën e Shoqatës për të gjithë operatorët. Në një e-mail të dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të SHQKT-së nga punonjësi i “ALBA-TRANS” konfirmohet bllokimi i 80% të aboneve të

studentit (4240 copë kundrejtë 5300 copë abone studentit) që kishte në dispozicion kjo ndërmarrje.

c) Në ndërmarrjen “TIRANA LINES” SHPK, është gjetur shkresa me titull: “TABELË PËRMBLEDHËSE E KARTONAVE E ABONEVE PËR PLANIFIKIM MUJOR”, e cila i përket muajit shkurt 2012, në të cilën tregohen sasinë faktike të marrjes së aboneve të përgjithshme, studenti dhe linje, për secilën nga ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës, përkatësisht: “FERLUT” SHA, “TIRANA LINES” SHA, “ALBA TRANS” SHPK, “TIRANA-URBAN-TRANS” SHA, “PARKU I TRANSPORTIT URBAN TË UDHËTARËVE” SHPK dhe “OTTO-AL”. Në kolonën që i korrespondon aboneve të studentit, rezulton se 80% e sasisë së këtyre aboneve bllokohen nga të gjitha ndërmarrjet dhe vetëm 20% e tyre hidhen në shitje.

41. Pranë SHKTQ-së janë gjetur të gjitha porositi e kryera nga Shoqata për kartona të aboneve të studentit dhe të përgjithshme, për të gjitha linjat e shërbimit të transportit qytetas të Tiranës, si dhe muajin për të cilin janë porositur, për vitet 2011 dhe 2012. Nga krahasimi i numrit total të aboneve të përgjithshme dhe aboneve të studentit, numri i kartonave të porositur është i barabartë me shumën e aboneve të përgjithshme plus rreth 20% të shumës së aboneve të studentit.

42. Gjatë seancave dëgjimore ndërmarrjet “FERLUT” SHA dhe “ALBA-TRANS” SHPK, pranuan ekzistencën e një marrëveshjeje midis ndërmarrjeve që ushtronin veprimtari në transportin rrugor qytetas në qytetin e Tiranës, por pretendojnë se meqenëse të gjitha ndërmarrjet e këtij tregu kanë qenë pjesë e këtyre vendimeve, atëherë nuk plotësohet kushti i nenit 4, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, që kërkon jo vetëm ekzistencën e një marrëveshjeje, por gjithashtu që marrëveshja të jetë e ndaluar dhe në bazë të kësaj dispozite. Në rastin konkret, vendimet e marra nga ndërmarrjet e tregut nuk kishin për objekt ose për pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës në treg, sepse këto vendime nuk i shkaktonin dëm asnjë prej ndërmarrjeve në treg, pasi të gjitha ndërmarrjet ishin pjesë e këtyre vendimeve.

43. Gjithashtu, në pretendimet e saj ndërmarrja “FERLUT” SHA shprehet se: “Në rastin konkret, vendimet e marra mund të kenë dëmtuar konsumatorët që konkretisht janë studentët, por nuk dëmtojnë konkurrencën pasi asnjë nga ndërmarrjet e transportit publik qytetas nuk ka pësuar dëm, pasi të gjithë kanë qenë pjesë e këtyre vendimeve”.

44. Një marrëveshje midis të gjithë ndërmarrjeve të tregut nuk mund të quhet e ndaluar vetëm nëse provohet se shumica e përfitimit nga kjo marrëveshje u kalon konsumatorëve. Ky fakt nuk provohet në rastin e marrëveshjes midis ndërmarrjeve objekt hetimi për bllokimin në masën 80% të aboneve të studentit, e cila i ka sjellë pasoja të drejtpërdrejta këtij grupi konsumator, studentëve, që kanë qënë të detyruar të blejnë bileta 50% me të shtrenjta.

45. Palët kanë pretenduar se sjellja e tyre ka ardhur si pasojë e mos-dhënies së rimbursimeve për abonetë e studentit dhe për kategoritë e tjera që përfitojnë udhëtim falas në transportin publik. Gjithashtu, pretendohet se kjo sjellje ka qenë e domosdoshme për tu mbrojtur nga falsifikimet e abuzimet e ndryshme të përdoruesve të biletave të pajtimit mujor (përdorimi i biletave mujore nga persona që nuk janë studentë).

46. Bazuar në aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat funksionon tregu objekt hetimi, si dhe sipas evidencave të grumbulluara gjatë procesit hetimor, vërtetohet se ndërmarrjet që operojnë në tregun përkatës duhet të ishin rimbursuar, dhe që Bashkia e Tiranës gjatë gjithë periudhës objekt hetimi 2007-2012 ka qenë në dijeni të fenomenit të kufizimit të tregëtimit të aboneve të studentit dhe nuk ka ndërmarrë asnjë masë.

47. Palët duhet të ndjekin, të gjithë mjetet e ligjshme për të adresuar si problemin e rimbursimit, ashtu edhe problemin e falsifikimeve dhe abuzimeve në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, si dhe në organet e ndjekjes penale në rastet e falsifikimeve, por kurrësi nuk mund të përdorin një mjet të ndaluar nga ligji për mbrojtjen e konkurrencës pra duke u bërë pjesë e marrëveshjeve të ndaluara nga ky ligj.

48. Ligji për mbrojtjen e konkurrencës ka si qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, e cila do të thotë lirinë për të konkurruar nëpërmjet ndalimit të marrëveshjeve antikonkurrese dhe të abuzimit me pozitën dominuese, pavarësisht se interesat e operatorëve mund të realizohen duke shkelur ligjin.

Si përfundim, rezulton se ndërmarrjet “FERLUT” SHA, “TIRANA LINES” SHA, “ALBA TRANS” SHPK, “TIRANA URBAN TRANS” SHA, “PARKU I TRANSPORTIT URBAN TË UDHËTARËVE” SHPK dhe “OTTO-AL” SHPK me anë të vendimeve të marra në SHKTQ, kanë bërë një marrëveshje, si pasojë e së cilës kanë kufizuar tregtimin e 50% të sasisë së aboneve të studentit, për vitin 2007 dhe rreth 80% të sasisë së aboneve të studentit për periudhën 2008-2012. Nga evidencat konstatohet që ndërmarrja “OTTO-AL” SHPK nuk i ka zbatuar vendimet e SHKTQ-së si dhe ka dale nga tregu përkatës në muajin qershor 2012. Vendimet i anëtarëve të SHKTQ-së për të kufizuar sasinë e tregëtimit të biletave të pajtimit mujor (abone) studenti, përbëjnë evidenca direkte të një marrëveshje, si pasojë e së cilës është ulur pavarësia vendimmarrëse e palëve⁴. Në kuptim të nenit 3, pika 4 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, kjo përbën një marrëveshje, e cila në bazë nenit 4, pika 1, germa (b) të Ligjit është marrëveshje e ndaluar.

Për përcaktimin e masës së gjobës Autoriteti i Konkurrencës, në bazë të nenit 75 të Ligjit, si dhe në bazë të rregullores “Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre”, ka marrë

⁴ Notice of EC (2011/C11/01) “Guidelines on the applicability of article 101 of TFEU to horizontal co-operation agreement”.

parasysh rëndësinë, kohëzgjatjen e shkeljes, rrethanat e tjera lehtësuese e rënduese për secilën ndërmarrje, si dhe bashkëpunimin me ndërmarrjen ankimuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 4, pika 1, germa b) dhe c), nenit 24, shkronja d), nenin 74, pika 1, germa “a” dhe nenin 75, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Rregullores “Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre”,

V E N D O S I:

I. Lidhur me refuzimin për të njohur abonetë e përgjithëshme pa kartonin shoqërues me logon e SHKTQ të ndërmarrjes “Alba-Trans”, si dhe refuzimin e dhënies së kartonave shoqërues të aboneve të përgjithshme ndërmarrjes “Gerard – A” :

1. Të gjobisë ndërmarrjen “FERLUT” SHA, për pjesëmarrje në marrëveshje të ndaluar, në shumën prej 337,133 (treqind e tridhjet e shtatë mijë e njëqind e tridhjetë e tre) lekë;
2. Të gjobisë ndërmarrjen “TIRANA LINES” SHA për pjesëmarrje në marrëveshje të ndaluar, në shumën prej 424,080 (katërqind e njëzet e katër mijë e tetëdhjetë) lekë;
3. Të gjobisë ndërmarrjen “TIRANA URBAN TRANS” SHA, për pjesëmarrje në marrëveshje të ndaluar, në shumën prej 828,274 (tetëqind e njëzet e tetë mijë e dyqind e shatëdhjetë e katër) lekë;

II. Lidhur me kufizimin e tregtimit të sasisë së aboneve të studentit, për vitet 2007-2012

1. Të gjobisë ndërmarrjen “FERLUT” SHA, për pjesëmarrje në marrëveshje të ndaluar, në shumën prej 1,263,618 (një milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtë qind e tetëmbëdhjetë) lekë;
2. Të gjobisë ndërmarrjen “TIRANA LINES” SHPK për pjesëmarrje në marrëveshje të ndaluar, në shumën prej 777,618 (shtatëqind e shatëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë) lekë;
3. Të gjobisë ndërmarrjen “ALBA-TRANS” SHPK, për pjesëmarrje në marrëveshje të ndaluar, në shumën prej 615,434 (gjashtëqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e katër) lekë;

4. Të gjobisë ndërmarrjen “TIRANA-URBAN-TRANS” SHA, për pjesëmarrje në marrëveshje të ndaluar, në shumën prej 1,302,498 (një milion e treqind e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë;

5. Të gjobisë ndërmarrjen “PARKU I TRANSPORTIT URBAN TË UDHËTARËVE” SHPK, për pjesëmarrje në marrëveshjen të ndaluar, në shumën prej 530,906 (pesëqind e tridhjetë mijë e nëntëqind e gjashtë) lekë;

III. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës, ndaj ndërmarrjeve: “FERLUT” SHA, “TIRANA LINES” SHPK, “ALBA-TRANS” SHPK, “TIRANA-URBAN-TRANS” SHA , “PARKU I TRANSPORTIT URBAN TË UDHËTARËVE” SHPK dhe “OTTO-AL” SHPK

IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe për komunikimin e tij ndërmarrjeve të mësipërme, si dhe Bashkisë së Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R

Datë 23 /07/2013

MENDIM PAKICE

i Komisionerit Koço Broka

Lidhur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës datë __.07.2013 **“Për Vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Ferlut” Shpk, “Tirana Lines” Sha, “Alba Trans” Shpk, “Tirana Urban Trans” Sha dhe “Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve” shpk për kufizim të konkurrencës në tregun e tregimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe studenti në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”**

Jam shprehur me Votë “Kundër”, me arsyet e mëposhtëme:

I- Qëndrimi i shumicës. Në përfundim të Hetimit të Thelluar, mbi bazën e Raportit të grupit të punës mbi “Hetimin e thelluar në transportin rrugor qytetas të udhëtarve në Qytetin e Tiranës”, Relacionit të Sekretares së Përgjithshme, pretendimeve me shkrim të ndërmarrjeve nën hetim, si dhe në seancat dëgjimore, dosjen hetimore të Grupit të Punës, në mbledhjet e Komisionit të Konkurrencës shumica e anëtarve të Komisionit të Konkurrencës vendosi :

*“Lidhur me refuzimin për të njohur abonetë e përgjithshme pa kartonin shoqërues me logon e SHKTQ të ndërmarrjes “Alba-Trans”, si dhe refuzimin e dhënies së kartonave shoqërues të aboneve të përgjithshme ndërmarrjes “Gerard-A” -1.Të gjobisë ndërmarrjen **“Ferlut” SHA**, për pjesëmarrje në marrëveshje të ndaluar, në shumën prej 337 133 (treqind e tridhjet e shtatë mijë e njëqind e tridhjet e tre) lekë; 2.Të Gjobisë ndërmarrjen **“Tirana Lines” SHA** për pjesëmarrjen në marrëveshje të ndaluar në shumën prej 424 080 (katërqind e njëzet e katër mijë e tetëdhjetë) lekë; 3. Të gjobisë ndërmarrjen **“Tirana Urban Trans” Sha**, për pjesëmarrje në marrëveshje të ndaluar, në shumën prej 828,274 (tetëqind e njëzet e tetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e katër lekë.*

Lidhur me kufizimin e tregëtimit të sasisë së aboneve të studentit, për vitet 2007-2012
1. Të gjobisë ndërmarrjen **“Ferlut” SHA**, për pjesëmarrje në marrëveshje të ndaluar, në shumën prej 1263618 (një milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë lekë; **2.** Të gjobisë ndërmarrjen **“Tirana Lines” SHA** për pjesëmarrjen në marrëveshje të ndaluar në shumën prej 777 618 (shtatëqind e shtatëmbëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë lekë; **3.** Të gjobisë ndërmarrjen **“ALBA – TANS” SHPK** , për pjesëmarrje në marrëveshje të ndaluar, në shumën prej 615 434

(gjashtëqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë) lekë. **4. Të gjobisë ndërmarrjen “Tirana Urban Trans” Sha**, për pjesëmarrje në marrëveshje të ndaluar, në shumën prej 1302498 (një milion e teqind e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë) lekë; **5. Të gjobisë ndërmarrjen “PARKU I TRANSPORTIT URBAN TE UDHETAREVE” SHPK**, për pjesëmarrje në marrëveshjen e ndaluar , në shumën prej 530906 (pesëqind e tridhjet mijë e nëntëqind e gjashtë) lekë.

II- Qëndrimi im si komisioner ndaj Raportit të Grupit të Punës, Relacionit të Sekretares së Përgjithshme dhe ndaj vendimarrjes së shumicës së Komisionit të Konkurrencës, mbështetur në provat dhe faktet e ndodhura në dosjen e hetimore, pretendimet e paleve me shkrim, apo në seancat degjimore është :- Nga ana e grupit të punës nuk është kryer një hetim i plotë, objektiv i paanshëm; nuk është siguruar informacioni i nevojshëm dhe i domosdoshëm, për të mundësuar një gjykim të shëndosh e objektiv, për të përcaktuar saktë situatën problemore, shkaqet, fajësinë e masën e gjobës, por sidomos kapërcimin e situatës të kufizimit të konkurrencës në tregun e tregëtimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe “studenti”. Në këto kushte unë nuk e miratova Raportin e Grupit të Punës dhe kërkoj ringritjen e një grupi pune për të bërë një hetim të plotë të mbështetur në prova dhe fakte. Mbi këtë bazë nuk jam dakort as dhe me qëndrimin e **shumicës** së Komisionit dhe për rrjedhojë kam dhënë votën KUNDER, duke propozuar, kryerjen e një hetimi objektiv e të paanshëm dhe sigurimin e një informacioni të plotë e të saktë para se të realizohej/et vendimarrja. Në kushtet e një hetimi jo të plotë dhe të dhënave të pasakta vendimarrja e komisionit, ose të paktën e imja do të ishte e deformuar.

II.1 Hapja e hetimit me kërkesën e ndërmarrjeve të interesuara, ose në bazë të një ankese të të tretëve. Karakteristikë e këtij procesi hetimor, është se kryerja e hetimit dhe vendimarrja e tij është bazuar në ankesat e ndërmarrjes **ALBA –TRANS” SHPK** “, e cila ka qënë prej vitesh në këtë treg dhe ankesës e ndërmarrjes **“Gerard-A”**, e cila hyri në Shtator 2012, në këtë treg, ndaj Shoqatës Kombëtare të Transportit Qytetas (SHKTQ), i përbërë nga anëtarët e saj **Tirana Urban Trans” Sha** , **“Tirana Lines” SHA, Ferlut” SHA**; pra ndaj konkurrentëve në tregun e aboneve të përgjithshme dhe “studentit”. Në vetvete hapja e hetimit mbi këtë bazë është e ligjshme dhe e parashikuar nga ligji Për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Thelbi i ankesës nga ndërmarrja **ALBA –TRANS” SHPK**, nuk kishte dhe nuk ka të bëjë me denoncimin e ndonjë marrëveshje të ndaluar (si ajo e ndalimit të shitjes të gjithë aboneve të studentit, në vitin 2007 deri në 50 % dhe për periudhën 2008-2012 deri 80 %). **Për gjykimin dhe vlerësimin tim ajo është një marrëveshje që kufizon dhe deformon konkurrencën në tregun përkatës kam qënë dhe jam për ndalimin e saj por dhe për verifikimin e plotë objektiv të këtij ndalimi në fakt** ku ajo ka qënë pjesë së bashku me ndërmarrjet e akuzuara prej saj duke e konsideruar atë të

ndaluar, por thjesht me atë se tre ndërmarrjet konkurrense **“tregëtonin në kushte të padrejta abonete e përgjithshme duke mos i njohur abonete e shitura nga kjo ndërmarrje gjatë muajve Tetor - Nëntor 2012”** (Shih pikën 1 i Vendimit të Komisionit.) Duke shqyrtuar këto ankesa personalisht kam qënë dhe jam dakort me hapjen e hetimit paraprak dhe të thelluar duke qënë i ndërgjegjshëm për **sfidat** e hetimeve në raste të tilla (ankesa ndaj konkurrentëve) pa paragjykuar e prezumuar fajin paraprakisht.

Kjo për faktin se siç theksohet edhe në dokumentin e Komisionit të Konkurrencës **“Politika Kombëtare e Konkurrencës”** gjendja mund të përkeqësohet, nëse ndërhyrja e shtetit nuk është efektive. Praktika tregon se zgjidhjet nuk qëndrojnë vetëm midis tregjeve jo perfekte dhe ndërhyrjes së shtetit, por në mjaft raste midis tregjeve jo perfekte dhe ndërhyrjeve jo perfekte ose të mangta të shtetit” Ndërkohë ekonomisti i njohur Paul Heyne në librin e vet **“Mënyra ekonomike e të Menduarit”**⁵⁾ tërheq vemendjen: **“Historia e ndërhyrjes qeveritare në jetën ekonomike zbulon një model të tillë përkujdesje për interesa të veçantë të konkurruesve që është po aq e fuqishme sa interesi i treguar për konkurrencën. Dhe këto të dyja nuk janë identike, edhe pse retorika jonë i përdor ato kaq shesh në mënyrë të ndërthurur”**

Duke patur parasysh se interesi për mbrojtjen e konkurrencës s’është i njëjtë si interesi për konkurruesit, Komisioni i Konkurrencës ka qënë shumë i kujdesshëm në vendimarrje të tij. Në këtë rafsh në Vendimin Nr.273, Datë 18/03/2013 **“Për një ndryshim në vendimin nr 262, datë 14.01.2013”** Për Hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e shërbimit të transportit rrugor qytetas të udhëtarve në qytetin e Tiranës” në pikën 4 evidentohet: **“Komisioni i Konkurrencës çmon se sigurimi i një informacioni të plotë dhe të detajuar, për të parë më mirë sjelljen e ndërmarrjeve në treg është i nevojshëm për të siguruar një vendimarrje objektive”** Kjo është pranuar nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Konkurrencës, pa ndonjë qëndrim ndryshe. **Por për fat të keq ky vendim jo vetëm që nuk është zbatuar për gjykimin tim, (më poshtë do të sillen provat dhe fakte), por është anashkaluar në mënyrë të vetëdijshme nga grupi i punës, pa u kontrolluar nga ana e organeve eprorë të Sekretariatit. Them se është anashkaluar në mënyrë të vetëdijshme dhe jo thjesht nga padija, të paktën për arsyet e mëposhtme.**

II.2. Në mbledhjen e Komisionit të Konkurrencës, datë, 27.6.2013 me temë **“Mbi prapsimet e grupit të punës ndaj pretendimeve të paraqitura nga ndërmarrjet “Tirana Urban Trans” shpk” Ferlut” sha, dhe ALBA –TRANS” SHPK”** , duke patur parasysh mos reflektim të grupit të punës për kërkesat e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr 273, Datë 18/03/2013, tërhoqa vemendjen në përgjithësi duke sugjeruar” Drejtoria Juridike të përgatisë material për përgjegjësitë e stafit të Autoritetit të Konkurrencës në

⁵⁾ Paul Heyne **“Mënyra Ekonomike e të Menduarit”** botim i shtëpisë botuese “Libri Universitar” Tiranë 1994 faqe 294.

treg dhe për individët që shkelin kërkesat e ligjit dhe u shkaktojnë dëm të tretëve, të evidentojë përgjegjësitë ...”

Është e tepërt të thuhet se në një vend me ekonomi tregu dhe demokratik autoriteti i një institucioni shtetëror përfshirë dhe Autoritetin e Konkurrencës, nuk është një e drejtë, pushtet i pakufizuar, apo arbitrar i administratës, e drejtuesve të tyre për të vendosur gjëra, por një pushtet, që kërkon aftësi profesionale dhe integritet për të kontrolluar veprimet e “aktorëve” që deformojnë konkurrencën, në përputhje me hapësirat që u jep ligji e rregulloret për të ushtruar atë ose këtë pushtet të çdo institucioni. Ndërkohë Kushtetuta mbron të drejtën e qytetarve dhe firmave **për të kërkuar për t’u trajtuar në mënyrë të drejtë e të barabartë para ligjit nga institucionet shtetërore.**

II.3.Lidhur dhe sa më sipër, në kushtet e mangësive të theksuara të hetimit të thelluar, konform kërkesave të Ligjit “për Mbrojtjen e Konkurrencës”, nga ana ime është kërkuar në mënyrë eksplicite që para vendimarrjes të Komisionit të sigurohet informacioni: i plotë qoftë e sintetik sipas kërkesave të mëposhtme:

“Për një vendimarrje sa më objektive.

Për të realizuar një vendimarrje objektive nga ana ime është e nevojshme të sigurohen ky informacion :

1. Operatoret e tregut, shtesat dhe pakësimet në tregun përkatës gjatë periudhës hetimore 2007-2012 + 2013 (shih Aneksi 1, bashkëlidhur)
2. Plotësimi i tabelës bashkëlidhur mbi abonete e porositura dhe të shitura, të përgjithshme, për “studentet” dhe së bashku (gjithsej)- Të dhënat të sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve që emeton dhe shpërndan abonete dhe Bashkia Tiranë.
3. Urdhëri i Bashkisë për të furnizuar ndërmarrjen Gerard-A, në muajin e parë dhe në vazhdim (Tetor, Nëntor, Dhjetor 2012 Janar Shkurt, Mars, Prill, Maj ,Qershor 2012 me (5000) abone, sa studenti dhe të përgjithshme, qëndrimi i Shoqatës, dhe sa janë realizuar në fakt.
4. Evidenca Statistike Për Muajin Dhjetor dhe për Vitin 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012 sipas Formularit të Bashkisë.
5. Evidenca Përmbledhse për sejcilin operator-Treguesit Tekniko Financiare për vitet 2007- deri në 2012 shih faqe 7 .
6. Evidenca Përmbledhse për Treguesit Tekniko –Financiare për vitin 2011 dhe vitin 2012 për të gjithë operatorët (me të dhëna të krahasueshme sipas tipeve të tabelave në faqen 6 dhe 7-të (po aty).

7. Evidenca Statistikore për Muajin Qershor 2013 mujore dhe progresive sipas Formularit të Bashkisë faqe 6.) (për të konfirmuar zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës)
8. Nga QKR , bilancet financiare të -6 operatorve në vitet 2007-2012 dhe për GERARD –A për vitin 2012 (përjashto bilancet që janë)

Grupi i punës ka kthyer përsëri një përgjigje të pjesshme.

Më konkretisht. Të dhënat e Tabelës nr 2 janë pa të dhënat e ndërmarrjet OTTO-AL. Nuk nuk është realizuar kërkesa e parë pikës 3 Pra nga ana ime u kërkuar shkresa “Urdhëri i Bashkisë ndaj SHKTQ për të furnizuar ndërmarrjen Gerard-A, duke filluar nga muaji Tetor 2012,” për t’u njohur se ku ishte/është mbështetur ky Urdhër, (në cilin ligj, apo akt tjetër ligjor, në cilin kriter për shpërndarjen e biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe të studentit Ishte e njohur se kjo shpërndarje është bazuar nga vitit 2007 deri në Qershorin 2012 në dy tregues:1) Numurin e autobuzve për çdo linjë dhe 2) kapacitetin për çdo autobus) Shkresa ishte dhe është e nevojshme për t’ë ballafaquar qëndrimin-sjelljen e Bashkisë me atë të SHKTQ dhe ndërmarrjeve të akuzuara për këtë çështje dhe jo vetëm apo thjesht shkresa përcjellse për prodhimin shpërndarjen e biletave të udhëtimit të transportit qytetas, ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Ka qënë e njohur se Bashkia ndërkohë në shkresën përcjellse drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për prodhimin dhe shpërndarjen e biletave të udhëtimit, nuk i ka ballafaquar ato në vazhdimësi me shitjet në muajin paraardhës dhe nuk ka marrë masa për këto ndaj këtyre mosshitjeve gjatë gjithë periudhës hetimore (pra si organ mbikqyrës rregullator nuk ka marrë masa ndaj një marrëveshje të ndaluar që shkel konkurrencën në treg. Në një nga shkresat e ndërmarrjeve nën hetim të gjobitura evidentohet:”Nga ana e Bashkisë Tiranë për gjatë kësaj periudhe nuk kemi patur as një sanksion apo penalitet përse i përket blerjeve apo shitjeve për vitin 2012”

Nuk është siguruar informacioni i pikës 4 dhe për rrjedhojë dhe pikave 5, 6, Mjafton të mbajmë parasysh se gjatë periudhës hetimore por dhe në vitin 2011, në tregun përkatës kanë operuar 6 operatorë, ndërsa përgjigja nga ana e grupit të punës është vetëm për 4 operatorë, vetëm për “Tirana Urban Trans shpk” Ferlut” SH A, dhe ALBA –TANS” SHPK”, dhe “Tirana Lines” SHA, pa dhënë informacion se si kanë vepruar operatorët e tjerë, OTTO-AL SHPK;e .”PARKU i TRANSPORTIT URBAN Të UDHETARVE” SHPK të cilët mund t’i kenë shitur ose mos kenë shitur abonetë e emetura dhe shpërndara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve gjatë periudhës hetimore 2007-2012.

Sipas shkresës me nr protokolli 52/1 të AK datë 8.02.2013 të “Parkut të Transportit Urban të Udhëtarve” për vitin 2012, numuri i aboneve të studentit të blera dhe të shitura ka qënë respektivisht 6571-6507 copë, për vitin 2011 4500-4500 copë, për vitin 2010- 4500-4500 copë. Këto të dhëna janë të ndryshme nga ato në Tabelën e permendur më sipër. Kjo ndërmarrje është trajtuar me të njëjtin koeficient vite shkeljesh 6 si ndërmarrjet e tjera që kanë realizuar shkelje për një periudhë 6 vjet (shih më poshtë-kur trajtohet tabela e llogaritjes së gjobës). Në çdo rast Grupi Hetimor pasi ka bërë çekimet dhe balalfaqimet përkatse të të dhënave nga burimet e ndryshme duhet të pasqyrojë se cilat janë të dhënat e sakta, nga janë marrë ato duke evidentuar se cili subjekt nuk ka dhënë informacion të saktë.

Ndërkohë formulari i Bashkisë bashkëngjitur pyetjeve të bëra nga ana ime, ka qënë për të siguruar në mënyrë eksplicite informacionin për **numrin e aboneve të studentit dhe të përgjithshme të blera e të shitura**, veç e veç; ndërsa nga ana Grupit të Punës është dhënë përgjigje vetëm për të Ardhurat gjithsej, të klasifikuar kjo për bileta, abone, të tjera, por duke përjashtuar detajimin në abone studenti (copë –vlerë) dhe në abone të përgjithshme.

Këtu do patur parasysh se Grupi i Punës në përgjithësi ka paraqitur informacionin që shumica e ndërmarrjeve ka ofruar, pra të dhënat për abone studenti dhe të përgjithshme, në sasi dhe në vlerë veç e veç për çdo muaj e vit, gjatë gjithë periudhës hetimore por dhe gjatë muajit Janar –Shkurt 2013, për një nga ndërmarrjet ankuese që ka marrë dhe lehtësimet më të mëdha nga gjoba, Alba Trans nuk e ka dhënë informacion se sa janë abonete të përgjithshme dhe të studentit të blera dhe të në copë e në vlerë, si gjatë periudhës hetimore por dhe për muajt Janar-Shkurt, për të mësuar se si e ka zbatuar vendimin nr 263, datë 14.01.2013 të Komisionit të Konkurrencës për masat e përkohshme. Pra nuk ka trajtim të barabartë ndaj firmave.

Siç pohohet në pikën 9 të Vendimit të shumicës së Komisionit “Për ndërmarrjen Alba Trans të dhënat janë vetëm në vlerë, të cilat vlerësohen përafërsisht me 60 % të sasisë së aboneve të studentit të përfituara për periudhën Janar-Shkurt 2013.”

Mbështetur në këtë fakt dhe në atë se ndërmarrja Tirana Lines ka blerë 3900- copë abone studenti dhe ka shitur 2010 copë për periudhën Janar - Shkurt 2013, unë nuk mund të jem dakort me pikën 10 të Vendimit të Shumicës së Komisionit të Konkurrencës sipas të cilit:

10. Sa më sipër, të gjithë ndërmarrjet objekt hetimi në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarve në qytetin e Tiranës e kanë zbatuar Vendimin e Komisionit të

Konkurrencës nr 263, datë 14.01.2013, duke hedhur në treg në mënyrë të pavarur nga njeri tjetri të biletave të pajtimit mujor për nxënësit dhe studentë (abone studenti)”

Në fakt të dhënat- provat dhe faktet hedhin dritë se kërkesat e Vendimit të Komisionit të Konkurrencë janë zbatuar në mënyrë të pjeshme nga disa ndërmarrje dhe nuk janë zbatuar nga ndërmarrje të tjera përfshirë ndërmarrjen ankuese.

Ndërsa duke mos u siguruar informacioni i pyetjes 7, i cili do hidhte dritë **të plotë** e të qartë për këdo se si po zbatohet, apo jo Vendimi i Nr 263 datë 14.01.2013 i Komisionit të Konkurrencës”, **në fakt konfirmohet se veprimtaria e grupit të punës për mungesën e një hetimit të plotë, objektiv e të paanshëm, është e vetëdijshme** duke dëmtuar kështu seriozisht veprimtarinë e rolin e Komisionit të Konkurrencës, por dhe Autoritetit të Konkurrencës, duke e zëvendësuar mbrojtjen e konkurrencës me mbrojtje të konkurrentëve, duke dëmtuar seriozisht besimin e firmave ndaj këtij institucioni.

Gjykimi im është se pa informacionin e plotë me të njëjtën metodologji (i mundshëm për t’u siguruar objektivisht nga Autoriteti i Konkurrencës) për tregun përkatës se si paraqitet Ai në rastin e dhënë, emetimi, shpërndarja, shitja e aboneve të përgjithshme, e studenti, për të gjithë operatorët e marrë nën hetim, si veç e veç por dhe në tërësi, si në vlerë dhe në tregues natyrorë, për çdo vit të periudhës hetimore, nuk ka mundësi të njohim situatën reale, shkaku dhe fajësinë apo përmasat e tij të gjithësecilit por dhe përcaktimin e rmasave dhe rekomandimeve përkatëse nga ana e Komisionit të Konkurrencës, konform kërkesave të Ligjit. Nga ana e grupit të punës jepet një informacion për *ALBA –TRANS” SHPK, i ndryshëm metodologjikisht nga ai për ndërmarrjet e tjera*. Në këto kushte si komisioner zor se mund të realizoj një gjykim objektiv e të paanshëm pa rrezikuar që mbrojtja e konkurrencës, të precipitojë dhe infiltrojë në mbrojtjen e njëanshme të këtij, apo atij konkurrenti dhe dënimin e pamerituar të një konkurrenti tjetër. Kjo nuk është një mundësi hipotetike por reale.

II.4 Mjafton të mbahet parasysh se **tregu përkatës** për të cilin në AK askush nuk ka kontestim, është “... **tregëtimi i biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarve në qytetin e Tiranës**” Në nenin 4 pika 1 dhe 3 të Rregullores “Për gjobat dhe lehtësimin e prej tyre” **Vlera bazë e gjobës**, thuhet “1. Komisioni në përcaktimin e vlerës bazë, përdor vlerën e të ardhurave nga shitja e produkteve të ndërmarrjes, me të cilat lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose të tërthortë, shkelja e kryer, në tregun përkatës. Komisioni merr për bazë vlerën e shitjeve të realizuara nga ndërmarrja gjatë vitit të fundit financiar të pjesëmarrjes në shkelje. Këtu e më pas “vlera e shitjeve” ...3. Autoriteti, në përcaktimin e vlerës së shitjeve nga një ndërmarrje, përdor të dhëna të plota e të besueshme që disponon për atë ndërmarrje. Kur të dhënat që janë vënë në dispozicion nga një ndërmarrje

janë të paplota ose jo të besueshme, Autoriteti mund të përcaktojë vlerën e shitjeve të saj mbi bazën e të dhënave të pjesshme që ai ka siguruar dhe/ose çdo informacioni tjetër të cilin ai e sheh si të përshtatshëm”

Por si është përcaktuar Vlera bazë e Gjobës nga Grupi i Punës mbështetur në shkresën me nr protokolli 108/1 datë 23.07.2013 të Grupit të Punës, mbi bazën e së cilës është marrë dhe vendimi nga Shumica e Komisionit të Konkurrencës ?

Disa nga treguesit e marrë për bazë për llogarritjen e gjobës, nga Grupi i Punës dhe Shumica e Komisionit të Konkurrencës.

1.2. Nga sa më sipër rezulton se në përlogarritjen e gjobës nuk merret për bazë vlera e tregut përkatës por njëherë merret volumi i shitjeve fakt të Aboneve të Studentit, (që është sa 1/5 e aboneve të emetuara, në vitet 2008-2012), një herë volumi i shitjeve të Aboneve të Përgjithshme fakt.

2. Nga procedura e llogaritjes së gjobës rezulton se në dy rastet ndërmarrjet i paskan dhënë fund deformimit të konkurrencës në këtë, për të cilin janë gjobitur.

Në fakt kjo nuk ka ndodhur. Mbështur në Tabelen 1 Sasia e përftuar dhe tregëtuar e aboneve të studentit për periudhën Janar- Shkurt 2013, paraqitur në Raportin e hetimit të Thelluar, faqe 11 për firmat Alba-trans dhe Tirana Lines nuk provohet pretendimi se ndërmarrjet kanë zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr 263, datë 14.01.2013 duke hedhur në treg të gjithë sasine e biletave të pajtimit mujor për nxënësit e studentet. Pavarësisht nga provat dhe faktet, grupi i punës angazhohet të japë certifikatën e virgjërimit të konkurrencës në këtë treg.

E njëjta gjë mund të thuhet për pretendimin se ndërmarrja i jep fund shkeljes lidhur me kartonin shoqërues të aboneve. Aktualisht përdorimi i aboneve të përgjithshme bëhet me kartonin shoqërues (me të cilin unë jam dakort dhe unë nuk e konsideroj shkelje nga ana e ndërmarrjeve) si në muajin Qershor 2012 -pra para hapjes së hetimit nga ana e konkurrencës ashtu dhe në muajin Qershor-Korrik 2013.

3. Ndërsa lidhur me lehtësimin nga gjoba për ndërmarrjen Alba Trans, personalisht jam i mendimit se nuk jemi para një situatë të përcaktuar në Nenin 77 pika 1 të Ligjit nr nr 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës të ndryshuar sipas të cilës" Lehtësimi nga gjobat 1. Një ndërmarrje, të përfshirë bashkë me të tjerat në një marrëveshje të ndaluar sipas nenit 4, mund t'i jepet lehtësimi, i plotë ose i pjesshëm, nga gjobat, nëse ajo ndihmon në zbulimin dhe ndalimin e marrëveshjes së ndaluar, si dhe përcaktimin e personave përgjegjës, duke siguruar të dhëna, të pazotëruara më parë nga Autoriteti”

Në vendimarrjen e shumicës së Komisionit të Konkurrencës ka qëndrime të njëanshme jo objektive e të pa bazuara në prova dhe fakte. Nga ‘to rezulton se veprimtaria e Autoritet të Konkurrencës në tërësi nuk ka patur dhe nuk ka efekte reale në këtë treg deri tani për rivendosjen e konkurrencës, veç gjobës së vendosur.

III. Rregullimi i Tregut.

III.1 Tregu i tregëtimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe studenti në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës **është një treg plotësisht i rregulluar** ku aktorë kryesorë përveç ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg janë:

Këshilli i Ministrave. Cmimet në tregun e transportit urban për biletat dhe biletat e pajtimit mujor, aboneve të përgjithshme, të linjës dhe studentit rregullohen, përcaktohen nga shteti-Këshilli i Ministrave dhe nuk vendosen në mënyrë të lirë nga ndërmarrjet.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve e cila emeton dhe shpërndan biletat e pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme, të linjës dhe studentit.

Bashkia Tiranë e cila licenson ndërmarrjet që operojnë në këtë treg dhe rregullon e mbikqyr veprimtarinë e tyre, përfshirë shpërndarjen e aboneve të përgjithshme dhe të studentit.

Agjensitë e Udhëtimit që shesin biletat e pajtimit mujor.

III.2. Operatorët e tregut përkatës. Operatorët që kanë vepruar në këtë treg gjatë periudhës të hetimit të thelluar 2007-2012, kanë qënë ndërmarrjet e mëposhtme:

1. FERLUT Shpk; gjatë gjithë periudhës
2. TIRANA LINES SHA gjatë gjithë periudhës
3. TIRANA URBAN TRANS SHA gjatë gjithë periudhës.
4. "PARKU I TRANSPORTIT URBAN Të UDHETARVE" SHPK- gjatë gjithë periudhës.
5. OTT-AL SHPK DERI –Nga vitit 2007 deri në Qershor 2012
6. GERARD Vetëm për periudhën Shtator-Dhjetor 2012 dhe më pas.

Krahas tyre operon: Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas (SHKTQ)

III.3 Rregullimi i Cmimeve-tarifave. Në këtë treg të rregulluar, çmimi- tarifave e biletave në tërësi por dhe biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme, linjës dhe studentit, nga të cilat sigurohen të ardhurat e ndërmarrjeve në këtë treg, përcaktohen nga shteti-Këshilli i Ministrave dhe çmimi i tyre është i përcaktuar në një periudhë të dhënë. Ndryshimi më i fundit i tyre ka qënë VKM Nr 637 datë 21.5.2008.

Tarifat e transportit qytetas (në lekë)						
Nr	Emertimi	Njësia	VKM-146-26.2.1998	VKM 45-22.1.2004	VKM-637-21.5.2008	Rritja 2008/2004 në %
1	Bilete vajtje ose kthim	lek	15	20	30	150.00
2	Abone 1 linjë	lek	?	600	900	150
3	Abone e përgjithshme	lek	?	800	1200	150
4	Abone për nxënës, studentë	lek	330	400	600	150

Kjo gjendje ndodh megjithatë në këtë treg kanë ndodhur ndryshime shumë të mëdha si në çmimin e karburantit ashtu dhe rinovimin e mjeteve të transportit, pra në pjesën e shpenzimeve të ndërmarrjeve që operojnë në këtë treg. Është e tepërt të thuhet se qoftë vetëm për këto aspekte ky treg paraqitet një treg me probleme. Megjithatë duke patur parasysh se çmimi –tarifat në këtë treg janë rritur 3-4 here më shumë se sa rritja mesatare e ICK krahasuar me vitin 1990, çdo pretendim i SHKTQ për të zbatuar subvencione kërkon një studim e vlerësim të posaçëm nga organet përkatëse Këshilli i Ministrave dhe Bashkia.

Mos shitja e aboneve të studentit (marrëveshja e ndaluar për kufizimin e konkurrencës) ka ndodhur si para rritjes së fundit të tarifave në Maj 2008 dhe pas tij, megjithatë rritja e tyre ishte jo e vogël 50 %, duke patur parasysh se është vendosur një çmim që të mundësonte blerjen e mjeteve të reja nga ndërmarrjet private për realizimin e këtij shërbimi.

Në se gjatë muajit Mars të këtij viti ndërmarrje që operojnë në këtë treg i kanë kërkuar Kryeministrit rritjen e çmimit të biletave dhe aboneve në transportin qytetas (dyfishimin e tyre pas kërkesës që i kanë bërë vite më parë edhe Bashkisë) natyrisht nuk është Autoriteti i Konkurrencës që duhet t'u japë një përgjigje në vend të aktorëve që rregullojnë dhe mbikqyrin këtë treg. Në rastin më të mirë në kushtet kur Autoriteti po trajton ankesat për këtë treg duhet të sigurojë fillimisht informacionin që japin evidencat vjetore e mujore për treguesit ekonomike financiare teknike të Bashkisë të ballafaquara me bilancet e ndërmarrjeve. Vetëm pas kësaj mund të japë një opinion të plotë dhe rekomandimet e bazuara në Ligjin Për Mbrojtjen e Konkurrencës Për rrjedhojë personalisht i përmbahem qëndrimit se marrëveshja midis ndërmarrjeve që kanë operuar

në këtë treg për mos shitjen të aboneve të studentit, 50 % për vitin 2007 dhe 80 % për vitet 2008-2012 të paktën pas majit 2008 dhe gjatë gjysmës së atij viti është një marrëveshje që ka ndodhur pavarësisht dhe nuk mund të justifikohet nga problematikat e tjera në këtë treg. Në çdo rast problemet në këtë rafsh trajtohen dhe zgjidhen nga organet që rregullojnë këtë treg Këshilli i Ministrave, Bashkia në lidhje dhe bashkëpunim me ndërmarrjet që operojnë në këtë treg dhe shoqatat e tyre.

III.4 Rregullat e funksionimit të tregut të tregëtimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe studenti në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës; gjatë periudhës të hetimit të thelluar 2007-2012.

Si gjatë hetimit por dhe në Raportin e Hetimit të Thelluar nuk është hedhur dritë e plotë dhe e qartë mbi rregullat dhe **sidomos për zbatimin e tyre nga aktorët rregullues**, veprimtari nga e cila varet dhe veprimtaria dhe sjellja e ndërmarrjeve, ndonse aktet ligjore në vetvete janë listuar në Raportin e Hetimit të Thelluar (shih faqe 7).

Ankesat e drejtuara ndaj Autoriteti të Konkurrencës hedhin dritë se në këtë në këtë treg ka probleme si në sjelljen e ndërmarrjeve por jo vetëm por dhe në sjelljen e aktorve rregullues e mbikqyrë. Por siç ndodh në mjaft raste problem me sa duket nuk janë vetë problemet por fakti se si trajtohen ato nga institucionet shtetërore, përfshirë këtu Autoritetin e Konkurrencës në rastin e dhënë, i cili u përfshi për trajtimin e tyre.

Për më tepër për Autoritetin e Konkurrencës po rezulton se në plan të parë, po precipiton çështja se si janë trajtuar ato nga Grupi i Punës të ngritur për hetimin paraprak dhe të thelluar të tij, nga Sekretariati që mbikqyr veprimtarinë e grupit të punës, si janë trajtuar provat dhe faktet nga Këshilltari i Kabinetit të Komisionit të Konkurrencës, në se faktet dhe provat trajtohen në mënyrë të plotë e të paanshme apo në mënyrë të pjesshme e të njëanshme. Nga mënyra dhe rezultatet e tyre varet dhe vendimarrja e Komisionit të Konkurrencës.

III.4.1 Aktet ligjore e nënligjore

Siç përmenda edhe më lart një ndër aktorët e rëndësishëm që merr pjesë dhe ndikon në rregullimin e këtij tregu është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve e cila emeton dhe shpërndan biletat e pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme, të linjës dhe studentit. Veprimtaria e saj lidhur me këtë çështje gjatë periudhës hetimore 2007-2012, është rregulluar midis të tjerash nga:

- VKM NR 183 , DATë 28.3.2007 për ORGANIZMIN, SHTYPJEN DHE EMETIMIN E BILETAVE TE TRANSPORTIT RRUGOR,

UDHEZIMI Nr 11, datë 25.3.2007 për ‘ORGANIZIMIN, SHTYPJEN DHE EMETIMIN E BILETAVE TE TRANSPORTIT RRUGOR;

VKM NR 643, DATE 11.6.2009 Për”PRODHIMIN, SHPERNDARJEN DHE PAISJEN E UDHETARVE ME BILETA TRANSPORTI RRUGOR”

III.4.2 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe veprimtaria e ndikimi i saj në mirëfunksionimin e tregut përkatës dhe rivendosjen e konkurrencës në këtë treg

Në VKM dhe Udhëzimin e vitit 2007, kërkohet:

“Agjensitë e udhëtarve, të licensuara nga Ministria e Transporteve dhe organeve tatimore, terheqin biletat e udhëtarve dhe abonetë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me çmimin e prodhimit , në mënyrë të organizuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nënshkruan aktmarrëveshje me shoqatat e transportit të udhëtarve për bashkërendimin e punës për sigurimin e zbatimit të legjislacionit në transportit rrugor.

Gjithashtu, drejtoria e Përgjithshme e tatimeve nxjerr rregullore të posaçme për administrimin e kërkesave , realizimin e porosive dhe shpërndarjen e biletave të transportit rrugor të udhëtarve “

Pra fryma dhe gërma sipas këtyre akteve rregullatore ishte se biletat shiten nga Agjensite e Udhëtimit, ndërsa alokimi i aboneve midis ndërmarrjeve rregullohej edhe nga bashkërendimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Shoqatatë e transportit të udhëtarve, siç është dhe SHKTQ.

Ndërsa me VKM nr 643, datë 11.6.2009, midis të tjerash kërkohet:

“Tërheqja e biletave për transportin rrugor të udhëtarve, për shërbimin qytetas, ndërqytetas, rrethqytetas dhe transportin nderkombetar rrugor realizohet nga shoqëritë e licensuara për këtë lloje transporti apo nga përfaqësuesi i agjensisë së transportit (në se shoqëria e licensuar disponon edhe agjensi udhëtimit). Terheqja e biletave kryhet prane drejtorive rajonale tatimore, kundrejt kostos së prodhimit të tyre”

Pra nuk është vështirë të shihet se tashmë me aktet e reja ligjore- rregulluese (për të cilat duhet evidentuar se nuk kanë abroguar aktet paraardhëse, duke krijuar mundësinë e një kakafonie) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk e ka detyrueshme të bashkëpunojë më me Agjensitë e Udhëtarve duke bashkërenduar me shoqatat e transportit të udhëtarve, por ajo bashkëvepron drejtpërdrejt me shoqëritë e transportit ose përfaqësuesit e agjensisë së transportit.

Ky ndryshim në aktet ligjore, duke mos abroguar VKM dhe Udhëzimin e vitit 2007, duke lënë në hije bashkëpunimin me shoqatat e transportit, krijon potencialisht një ngërç dhe nuk krijon kushtet e nevojshme për transparencën e nevojshme e të

domosdoshme që kanë nevojë ndërmarrjet që operojnë në tregun përkatës për të njohur se sa është emetimi, shpërndarja por edhe shitja e aboneve të përgjithshme dhe të studentit si në tërësi por dhe nga çdo ndërmarrje. **Në kushtet kur blerësit e aboneve në një ndërmarrje udhëtojnë dhe në linjat e ndërmarrjeve të tjera, kjo transparencë është jo vetëm e nevojshme por dhe e domosdoshme dhe kusht i domosdoshëm për funksionimin e konkurrencës në këtë treg. Të ardhurat e secilës ndërmarrje varen në fakt nga shitja e aboneve të përgjithshme dhe të studentit të shitura por dhe kriteret e shpërndarjes së tyre midis ndërmarrjeve. Për rrjedhojë interesimi ndërmarrjeve për ‘to apo për shpërndarjen e kartonave është një veprim i ligjshëm dhe i shërbën mbrojtjes reale të konkurrencës**

Mungesa e transparencës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ndaj Autoritetit të Konkurrencës, për të mos i dhënë informacionin e kërkuar lidhur me emetimin shpërndarjen e aboneve të përgjithshme dhe të studentit, të kërkuar zyrtarisht nga Grupi i Punës, për t’i ballafaquar këto të dhëna me të dhënat e firmave dhe Bashkisë për shitjen e tyre si gjatë periudhës hetimore por dhe gjatë periudhës pas hetimore, nuk mundëson një hetim të plotë dhe objektiv dhe për rrjedhojë një vendimarrje objektive nga Komisioni i Konkurrencës. Për gjykimin tim ky defekt dhe mungesa e transparencës duhet shmangur jo vetëm ndaj Autoritetit të Konkurrencës por dhe ndaj çdo ndërmarrje që operon në këtë treg dhe që e kërkon këtë informacion. Vendosja e kësaj transparencë është një nga kushtet për shmangjen e marrëveshjeve të ndaluara që dëmtojnë konkurrencën në këtë treg, një kusht i domosdoshëm për rivendosjen e konkurrencës në këtë treg. Për rrjedhojë mendoj se duhet të përbëjë dhe një nga elementet e vendimarrjes dhe rekomandimeve të Komisionit të Konkurrencës për të mundësuar rivendosjen dhe funksionin e konkurrencës në tregun përkatës.

4.2.3 Veprimtaria e Bashkisë për rregullimin e këtij tregu.

Në përputhje me Ligjin nr 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet Rrugore”- ndryshuar, sipas nenit 10 pika b) Tarifat e transportit të udhëtarve zbatohen mbi bazën e dispozitave të ligjit “për çmimet dhe tarifat” Tarifat e transportit të udhëtarve me subvencion nga shteti miratohen nga Këshilli i Ministrave. Ndërsa sipas Nenit 14 të tij “Këshilli bashkiak, duke u mbështetur në nevojat e popullsisë për transportin qytetas, përcakton linjat, organizon, financon dhe vendos për këtë lloj transporti brenda juridiksionit të vet. Transporti qytetas kryhet me autobus vetëm nga shoqëritë, të cilat kanë shprehur në aktet e themelimit, si objekt të veprimtarisë, veprimtarinë e transportit të udhëtarve. Licensa për transporti qytetas jepet nga kryetari i Bashkisë”

Si mbi bazën e ligjit por dhe në fakt Bashkia Tiranë ka një mbikqyrje të plotë dhe të gjithanshme për këtë treg që mundësonte dhe mundëson si ruajtjen dhe rivendosjen e konkurrencës në këtë treg. Ajo siguron informacion të plotë çdo muaj dhe vit për numurin

e aboneve të përgjithshme dhe të studentit të emetuara, shpërndara, shitura, porosituara, evidentuar në dokumentat ekonomike financiare dhe bilancet e ndërmarrjeve, të dhëna të tjera teknike- ekonomike-financiare që mundësojnë jo vetëm zbulimin e marrëveshjeve të ndaluara që dëmtojnë tregun, konkurrencën, konsumatorin por dhe shmangien e tyre dhe rivendosjen e konkurrencës në treg. Sjellja e çdo ndërmarrje në këtë treg është e ndërruar drejtpërdrejt nga veprimtaria e Bashkisë.

Në këtë rafsh natyrshëm lindi kërkesa se cili është akti ligjor rregullator i Bashkisë Tiranë- si rregullues i drejtpërdrejtë i këtij tregu, që rregullon shpërndarjen e biletave mujore (aboneve) të studentit të përgjithshme dhe të studentit në shërbimin qytetas në Tiranë ?

Sipas informacionit të siguruar në dosjen hetimore dhe shpjegimeve nga Bashkia Tiranë rezulton se:

“Shpërndarja e aboneve ishte bërë në marrëveshje midis operatorve.

Kjo është ndryshuar me urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë Nr 281, datë 12.4.2012 mbi “Mënyrën e shpërndarjes së numrit të biletave të pajtimit mujor për transportin qytetas të udhëtarve” sipas të cilit:

1. Shpërndarja e numrit të biletave të pajtimit mujor për operatorët qytetas, të bëhet duke u bazuar mbi evidencat vjetore të deklaruara për sejcilën linjë gjatë vitit fiskal parardhës.
- 2 . Planifikimi vjetor për shpërndarjen e numrit të biletave të pajtimit mujor për sejcilën linjë, të bëhet njëherë në vit.
3. Për zbatimin e këtij urdhëri, ngarkohet Drejtoria e Transportit dhe Lëvizshmërisë.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë”

Por Ky urdhër është ndryshuar me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë të datës 281/1, datë 25.07.2012 “Pë revokimin e Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr 281, datë 12.04.2012 mbi “Mënyrën e shpërndarjes së numrit të biletave të pajtimit mujor për transportin qytetas të udhëtarve” :

1. Revokimin e Urdhërit Nr 281, datë 12.4.2012 mbi Mënyrën e shpërndarjes së numrit të biletave të pajtimit mujor për transportin qytetas të udhëtarve.
2. Të kryhet studim mbi baza sondazhi për përcaktimin e strukturës reale të udhëtarve në çdo linjë.
3. Të mbetet në fuqi shpërndarja para daljes së Urdhërit Nr 281, datë 12.04.2012 deri në përfundim të studimit.

4. Për zbatimine këtij urdhëri, ngarkohet Drejtoria e Transportit dhe Lëvizshmërisë.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë”

Pra sipas kateve nën ligjore- kanë mbetur në fuqi kriteret dhe rregullat, mbi bazë e të cilave kishin operuar ndërmarrjet dhe SHKTQ. Por në vend të zbatohet ky rregull dhe për rrjedhojë kriteret të njëjta dhe për Firmën e re Gerald –A që hyn në treg, shpërndarja e aboneve përcaktohet jo mbi bazën e kriterëve të njëjta , por përcaktohet nga Bashkia.

Pra është Bashkia ajo që ka deformuar konkurrencën në tregun përkatë, dhe jo ndërmarrjet FERLUT Shpk; TIRANA LINES SHA; TIRANA URBAN TRANS SHA.dhe SHKTQ që kërkojnë të shpërndahen aq abone sa rezultojnë nga përlllogaritjet mbi bazen e kriterëve të përcaktuara të barabarta për të gjithë. Në këtë rafsh dhe qëndrimi i tyre për të shpërndarë abonetë me kartonin shoqërues është një veprim i drejtë dhe në funksion të mbrojtjes së konkurrencë në treg. Për rrjedhojë jam kundër lidhur me vendimin e Shumicës së Komisionit të Konkurrencës 1.Të gjobisë ndërmarrjen “FERLUT” SHA, TIRANA LINES SHA; TIRANA URBAN TRANS SHA *Lidhur me refuzimin për të njohur abonetë e përgjithshme pa kartonin shoqërues me logon e SHKTQ të ndërmarrjes “Alba-Trans”, si dhe refuzimin e dhënies së kartonave shoqërues të aboneve të përgjithshme ndërmarrjes “Gerard-A*

Konkurrenca në këtë treg është deformuar për gjykimin tim nga rregullatori Bashkia, duke mos respektuar rregulla të njëjta për të gjithë operatorët e në këtë treg, duke përcaktuar vetë se sa abone do të shpërndahen për këtë ose atë opertor, duke mos ruajtur kriteret të njëjta për të gjithë. Konkurrenca deformohet kur në vend të zbatimit të kriterëve të njëjta dhe për ndërmarrjen e re Gerard-A, përcaktohen numurat e aboneve të përgjithshme dhe aboneve të studentit.

Për rrjedhojë Komisioni duhet të dalë me vendim me Rekomandimet përkatse për rivendosjen e konkurrencës në këtë treg deri sa të përfundojë studimi dhe kriteret dhe rregullat aktuale të zëvendësohen me rregulla dhe kriteret të reja .

Ndërkohë Bashkia duhet të jetë më transparente me Autoritetin e Konkurrencës. Ketu e kam fjalën për transparencës që duhet të ketë Bashkia Tiranë lidhur me detyrimin ligjor për të dhënë informacionin e kërkuar nga Grupi i Punës në datë 28/01/2013 ku i kërkohej midis të tjerash numuri e total i aboneve të përfituara dhe shitura nga secili operator gjatë periudhës Janar 2007-Dhjetor 2022, të ndara sipas llojit (të përgjithshme dhe studenti) dhe muajve.

Duke pasur informacionin mbi emetimin, shpërndarjen, e aboneve të përgjithshme e të studentit shitjen e tyre, evidentimin e tyre në evidencat e dërguara në Bashki por dhe te

pasqyruara në Bilancet e ndërmarrjeve Rregullatori i drejtpërdrejtë Bashkia Tiranë i ka të gjitha mundësitë të realizojë dhe kontrollojë zbatimin e konkurrencës në këtë treg, duke perjashtuar deformimet e tij që mund të vijnë nga sjella e mundshme e ndërmarrjeve të veçanta. Fakti që ajo nuk e ka dhënë këtë informacion të plotë në Autoritetin e Konkurrencës dhe të njëllojtë për të gjithë ndërmarrjet dëshmon se roli i saj në mbrojtjen dhe promovimin e konkurrencës është i mangët Komisioni i Konkurrencës duhet ta disponojë këtë informacion për të realizuar detyrën e vet funksionale që i ngarkon ligji.

4.3 Trajtimi i barabartë i gjithë ndërmarrjeve në treg.

Siç është evidentuar edhe më lart gjatë periudhës hetimore 2007-2012 në tregun përkatës kanë operuar gjashtë ndërmarrje. Ndërsa Grupi i Punës ka pretenduar se “Referuar evidencave në formë të shkruar dhe elektronike, të gjetura pranë ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtarve në qytetin e Tiranës dhe pranë SHKTQ-së, rezulton se ndërmarrjet “FERLUT”SHPK, ‘TIRANA LINES’ SHA , ‘ALBA TRANS’SHPK’ ‘TIRANA URBAN TRANS’SHA, DHE ‘PARKU I TRANSPORTIT URBAN TE UDHETARVE ‘SHPKQ me anë të vendimeve të marra në SHKTQ, kanë bërë një marrëveshje me anën të së cilës kanë kufizuar tregëtimin e 50% të sasisë së Aboneve të Studentit, për vitin 2007 dhe rreth 80 % të sasisë së Aboneve të studentit për periudhë 2008-2012", pra se kjo shkelje është realizuar nga 5 kompani dhe jo nga gjashtë edhe nga OTTO-AL

Duke qënë dakort me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës për këtë çështje –lidhur me marrëveshjen e ndaluar për kufizimin e shitjes së aboneve të studentit, nuk jam dakort lidhur me çështjen e hetimit dhe evidentimit numrit të ndërmarrjeve të përfshirë në këtë marrëveshje.

Gjatë prapësimeve të Grupit të Punës ndaj çështjes të ngritur në seancat degjimore lidhur me numrin e ndërmarrjeve në marrëveshjen e mosshitjet se aboneve të studentit Ai nënvizon :

“Ndërmarrja pretendon se deri në korrik 2012 në treg ka ushtruar veprimtari edhe ndërmarrja “OTTO AL” dhe nuk e kuptojmë përse për këtë kompani inspektorët e autoriteti nuk janë shprehur me gjobë? Në lidhje me operatorin OTTO AL raporti paraqet në faqen 24, pika 2 se shoqërisë OTTO AL do ti jepet vetëm 50% e kartonave shoqerues. Ky vendim ka pasur si qëllim rivendosjen e ekuilibrit të konkurrencës brenda grupimit të operatorëve të transportit “ Lidhur me këtë pretendim, sqarojmë se ndërmarrja OTTO AL që nga muaji Korrik 2012 nuk ushtron më veprimtari. Grupi i Punës ka marrë në shqyrtim të gjitha të dhenat dhe evidencat e administruara gjatë procedurës hetimore në lidhje me ndërmarrjen OTTO AL nga ku ka rezultuar se ashtu sic e ka përmendur edhe vete ndërmarrja OTTO AL nga ku ka rezultuar se ashtu sicç e ka përmendur edhe

vete ndermarrja “ALBA TRANS” anetare SHKTQ kanë kufizuar disa herë dhenien e kartonave shoqërues të aboneve për ndërmarrjen OTTO AL me qëllim kontrollin e sasisë së aboneve që kjo ndermarrje duhet te tregëtonte. **Gjithashtu nga të dhënat lidhur me sasinë e përfituar dhe tregtuar të aboneve nga kjo ndërmarrje nuk u bë e mundur të vërtetohej pjesmarrja e saj në marreveshje”**

Në fakt në dosjen hetimore nuk ndodhen të dhëna lidhur me sasinë e aboneve të përgjithshme dhe të studentit të përfituara dhe të tregëtuara por vetem mbi të ardhurave e përfituara nga abonetë gjithsej nga ndërmarrja OTTO-AL për periudhën 2007-2010. Në këtë ndërmarrje nuk është kryer inspektim dhe nuk janë siguruar të dhëna që janë marrë gjatë inspektimeve ndërmarrjet e tjera. Referuar shkresës së datës 15.02.2013 të OTTO-AL, kthim përgjigje Autoritetit të Konkurrencës protokolluar datë 15/02/2013 me numer protokoll nr 54/4 midis te tjerash thuhet “Duke qënë se veprimet përmbyllse të aktivitet finaciari të shoqërise”OTTO-AL” janë kryer në qershor te vitit 2012, Ju informojmë se shoqëria “OTTO-AL” nuk disponon asnjë nga të dhënat dhe informacionet e lidhura me transportin qytetas të udhëtarve të kërkuar nga ana juaj”

Pra qëndrimi ndaj OTTO-AL nuk është mbështetur në prova dhe fakte të plota.

Mbështetur sa më sipër jap votën Kundër Vendimit të Shumicës së Komisionit të Konkurrencës.

Në kushtet kur nuk është siguruar një informacion i plotë dhe i saktë dhe ka trajtime të njëjashme të pa mbështetur në prova dhe fakte, duke cënuar serizosht rolin e Autoritetit të Konkurrencës për mbrojtjen edhe rivendosjen e konkurrencës në treg.

Distancohem nga metoda edhe qëndrimi i Grupit të Punës, si për grumbullimin e provave dhe fakteve, cilësinë çekimit të tyre, trajtimin jo të drejtë dhe të barabartë ndaj ndërmarrjeve nën hetim, për prezantimin e tyre jo konsistent para Komisionit të Konkurrencës. Qëndrimi i Grupit të Punës gjatë këtij hetimi- nga kryerjate inspektive, grumbullimi i të dhenave, pasyrimi i tyre ne raport, qendrim gjatë prapsimeve është për gjykimin tim një model i mos angazhimit të Autoritetit të Konkurrencës për mbrojtjen e konkurrencës në treg.

Për rrjedhojë mbështetur sa më sipër dhe në Nenin 46, pika c, te Ligjit nr 9121 Datë 27.7.2003- (ndryshuar) Për Mbrojtjen e Konkurrencës –Revokimi i Vendimeve, propozoj revokimin e Vendimit të Shumicë së Komisionit të Konkurrencës

Komisioner

Koço Broka

MENDIM

(Mbi qëndrimin në pakicë)

Une Rezana Konomi, anetare e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës, nuk jam dakort me përfundimet e arritura nga shumica e anetareve të Komisionit, lidhur me hetimin e thelluar në tregun e transportit rrugor qytetas të udhëtareve në qytetin e Tiranës, ndaj po paraqes qëndrimin tim si më poshtë vijon :

Autoriteti i Konkurrencës me vendimin Nr.262 datë 14.01.2013 vendosi të hapë hetimin e thelluar në tregun e shërbimit të transportit rrugor qytetas të udhëtareve në qytetin e Tiranës kundrejt shoqërive që ushtrojnë veprimtarinë në këtë treg: Ferlut SHpk, "Tirana Lines" Sha, "Alba Trans" Shpk, "Tirana Urban Trans" Sha, "Parku i Transportit Urban të Udhëtareve" Shpk, dhe "Otto AI" . Në vijim të kësaj procedure për të zgjidhur shqetësimet aktuale në këtë treg, me Vendimin Nr.263 datë 14.01.2013 të Komisionit u vendos : "Marrja e masave të përkohshme për tregtimin e biletave të pajtimin mujor(aboneve) të studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtareve në qytetin e Tiranës, sipas sasise së përcaktuar nga Bashkia, bazuar në nenin 4, pika 1, neni 24, germa d, dhe 44 pika 1 dhe 2 të Ligjit Nr.9121 datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" .

Në përfundim të hetimit të thelluar shumica e anetareve të Komisionit vendosi :

1.Lidhur me refuzimin e dhënies së kartonëve shoqëruar të aboneve sipas sasise së vendosur nga Bashkia Tirane ndërmarrjes "Gerald-A" Shpk si dhe për refuzimin për të njohur abonete pa kartonin shoqëruar me logon e SHKTQ(Shoqates) të ndërmarrjes "Alba Trans" Shpk, të gjobise ndërmarrjen "Ferlut" Shpk për pjesëmarrje në marrëveshje të ndaluar, të gjobise ndërmarrjen "Tirana Lines" Sha për pjesëmarrje në marrëveshje të ndaluar, të gjobise ndërmarrjen "Tirana Urban Trans" Sha, për pjesëmarrje në marrëveshje të ndaluar.

2.Lidhur me kufizimin e tregimit të 50% të sasise së aboneve të studentit për vitin 2007 dhe rreth 80% të sasise së Aboneve të studentit për periudhën 2008-2012, të gjobise ndërmarrjen "Ferlut" Shpk për pjesëmarrje në marrëveshje të ndaluar, si dhe ndërmarrjen "Tirana Lines" Sha, "Alba Trans" Shpk, "Tirana Urban Trans" Sha, "Parku i transportit urban të udhëtareve" Shpk.

Ligji Nr.9121 datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", në nenin 1 të tij ka përcaktuar qëllimin, sipas të cilit " Qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e konkurrencës së lire dhe efektive në treg, duke përcaktuar rregullat e sjelljes së ndërmarrjeve, si dhe institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e konkurrencës dhe përgjegjësitë e tyre". Në këtë kuptim Autoriteti i Konkurrencës, sa herë që konstaton se konkurrenca e lire në treg po cenohet, pengohet apo shtrëmbërohet, i lind e drejta që pasi të hetojë çështjen në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme të identifikojë problemet, të përcaktojë përgjegjësit dhe të penalizojë fajtoret për këtë gjendje të krijuar. Një

nga format me te renda te cënimit te konkurrences se lire dhe efektive ne treg, janë marrëveshjet e ndaluar, sipas neni 4 te ligjit organik. Neni 4 pika 1, germa b dhe e e ligjit Nr.9121 date 28.07.2005 " Per mbrojtjen e konkurrences" parashikon se ;*"Ndalohen te gjalla marrëveshjet te cilat kane si objekt ose si pasqje pengimin, kufizimin ose shtrëmbërimin e konkurrences ne treg, vecanerisht marrëveshjet qe : kufizojne ose kontrollojne tregjet, zhvillimin teknik ose investimet .e) ndajne tregjet ose hartimet e furnizimit..."*. Ne kuptim te kesaj dispozite qe marrëveshjet te ndalohen(pra jo te gjitha mund te ndalohen), duhet se pari qe ato te kene si objekt te tyre ose si pasqje pengimin, kufizimin ose shtrëmbërimin e konkurrences ne treg.

Cfare duhet te hetohet ne rastin konkret ? Se pari, e rendesishme eshte te provohet se marrëveshja (apo sjellja e anetareve te shoqates, e materializuar me vendimnartje perkatese) perkundrajt shoqerise "Gerald-A"Shk, per t'i refuzuar kesaj te fandit furnizimin me kartona per 5500 abone per muajin nentor 2012 dhe dhenia veteri per 1200 copo kartona per kete muaj- ka patur ose jo per objekt apo si pasqje, pengimin, kufizimin ose shtrëmbërimin e konkurrences ne treg. Per kete duhet te hetohet ne menyre te plote, sjellja e anetareve te shoqates, per arsye dhe shkaqet se perse ketij subjekti i eshte refuzuar dhenia e kartonave per 5500 copo abone, sipas ndarjes se Bashkise dhe nga ana tjeter per shkaqet se perse Bashkia ka vendosur t'i akordojte ketij subjekti nje numer abonesh ne kundërshtim me metodiken e perdorur per shume vite, por edhe aktualisht perkundrajt gjithë subjekteve te tjere. Duke mos hetuar ne menyre te plote, me thirrje shkaqeve eshte konkluduar ne menyre te gabuar dhe siperfaqore se kjo menyre sjellje e shoqates eshte mjet precisioni perkundrajt shoqerise Gerald-A, meqenese kjo e fundit nuk eshte partner e kesaj shoqate. Per te gjykuar ne menyre te drejte me kesaj sjellje, e rendesishme eshte te kuptojme se si ka funksionuar tregu deri ne momentin kur u shfaq per here te pare subjekti "Gerald-A".

Ne historine e ekzistences se saj Shoqata ka ezauruar nje korrespondence vijuese me Bashkine, lidhur me metodiken qe duhet zbatuar per shpërndajen e biletave majore (aboneve) te përgjithshme dhe te stadenit ne shërbimin qytetas ne Tirane, duke u bazuar ne dy tregues :1)numrin e autobuzeve per cdo linje dhe 2) kapacitetin per cdo autobus. E vetëdijshme qe kjo nuk eshte metoda me e mire e mundshme, por ne mungese te studimeve te tjera te bollësishme per nje ndarje sa me te drejte te aboneve, Bashkia ka pranuar dhe ka zbatuar kete metode te propozuar nga Shoqata, duke siguruar nje ndarje sa me te drejte dhe te barabarte midis operatorave pa përfitime te padrejta. Deri ne momentin kur kjo menyre dhe model eshte zbatuar nga Bashkia, midis kesaj dhe shoqates dhe midis veto shoqates dhe operatorave te tregut nuk ka lindur asnjë shqetësim. Problemet filluan te shfaqen kur ne treg si hyres i ri filloi aktivitetin shoqëria "Gerald-A". Qe ne fillim Bashkia i akordoi ketij subjekti nje numer abonesh ne kundërshtim me praktikën e mëparshme tregtare, te pranuar dhe te zbatuar nga ajo nder vite, duke sjelle nje gjendje pabarazie ne treg, nje shtrëmbërim dhe kufizim te konkurrences. Shoqata e nxitur nga ky veprim i gabuar i Bashkise, e cila cenonte te drejtat e tyre te ligjshme por edhe shtrëmbëronte konkurrencen e lire, reagoi duke vendosur qe subjekti Gerald-A te trajtohet si gjithë subjektet e tjera, ne menyre te barabarte dhe t'i akordoheshin abone sipas modelit te

ndarjes për gjithë operatorët e tjerë. Më tej për t'ia siguruar këtij subjekti se asgjë nuk ishte e paragjyqshme apo e realizuar me qëllim që kjo shoqëri të pengëhej në udhëtimin e aktivitetit të saj, në vendimin e Shoqatës ishte parashikuar se në momentin e rritjes së numrit të mjeteve nga shoqëria, ajo ka të drejtë të kërkojë që të bëhen edhe ndryshimet përkatëse sipas gjendjes faktike të mjeteve. Ky fakt është evidentuar edhe në procesverbalet e pyetjeve që grupi i punës ka marrë nga menaxheri i kësaj shoqërie, ku qartazi del në pah qëllimi për të siguruar një ndarje të drejtë të abonentëve midis operatorëve. Kjo mënyrë e trajtimit që shoqata mbua kundrejt shoqërisë nuk mund të konsiderohet si pjesë e ndaj subjektit për t'ia penguar në aktivitetin e saj, për një mënyrë për të rivendosur konkurrencën e lirë, për të rregulluar gjendjen e pabarabeteve nga veprimet e padrejta të Bashkisë, të cilat vranë interesat e ligjshme të të gjithë operatorëve të tjerë. Natyrisht mund të pyesim : Nëse këtij subjekti do t'i ishte dhënë të gjitha kartonat sipas numrit të abonentëve të caknuara nga Bashkia, a du të kishim konkurrencë të lirë, të drejtë dhe efektive midis operatorëve, kur në fakt trajtimi i tyre pikërisht nga Enti i cili duhet të sigurojë këtë barazi, është censur rëndë? Nëse do të kishim ndodhur kjo, do të konkludonim se vetëm konkurrenca është shprehëse e barazisë? Në gjykimin tim po. Fakti që subjektet të cilave u demtonen interesat e tyre pikërisht nga vete mbikqyesi, që duhet t'ia sigurojë se parë, reagojnë dhe marrin iniciativë vullnetshëm për të siguruar konkurrencë të lirë dhe efektive dhe trajtim të barabartë nuk mund të konsiderohen fajtorë, për më tepër që vendimarrja e shoqatës (ose marrëveshja) nuk plotëson kushtin që nën 4 pikën 1 parashikohet , *por marrëveshje që ka për qëllim apo për parojë programin, ligjzotën ose shprehësin e konkurrencës në treg* ...Duke mos u plotësuar ky kusht që ligji parashikon edhe vendimet e shoqatës (marrëveshja) për këtë arsye nuk mund të konsiderohen të ndaluar. Ekziston edhe një arsye tjetër në gjykimin tim, se përse kjo shtyllë e shoqatës nuk mund të jete e ndaluar. Reagimi i shoqatës ndaj vendimarrjes ka bërë shprehje se vet një shtak ka legjitim aq dhe të drejtë, sepse në fakt kontribuon me shumë në vendosjen e konkurrencës së lirë në treg, për të cilën autoriteti ushtron dhe kompetencat në bazë të ligjit, se sa kur ajo marrëveshje për të penguar apo shprehësin konkurrencën. Më tej veprimet të shoqatës dhe marrëveshjet të saj për të mos reaguar kundrejt kësaj shtakje të Bashkisë, prandaj ka veprimet e shoqatës ndaj reagimit me mekanizmat që zotëron ndaj veprimeve të padrejta të Bashkisë, pasi qëllimi që ka për të e justifikon tërësisht rejtën që ka përdozuar. Për këtë arsye kjo vendimarrje e shoqatës (e konsideruar marrëveshje) në gjykimin tim nuk mund të jete e ndaluar. Përkundrazi kam vlerësuar qëllimin e mirë të saj, për të siguruar barazi në treg, sepse vetëm kështu mund të startojë një lojë e drejtë midis konkurrentëve. Nuk mund të konsiderohen fajtorë ato subjektet që kontribuojnë në favor të rivendosjes së konkurrencës dhe aq më pak të penalizohen sepse kërkojnë të mbrojnë barazinë në treg.

Sipas legjislacionit të BE për konkurrencën, në rast se nga Autoriteti i Konkurrencës pretendohet se kjo mënyrë sjellje është përdorur si mjet presion, vleras është konkluduar gabim sipas mendimit tim, barra e provës për të provuar dhe argumentuar këtë fakt e ka bërë Autoriteti sipas parimit të përgjithshëm të ligjit. Udo dyshim është në favor të ndërmarrjes derisa të provohet e kundërta dhe nuk mund të nxirret konkluzioni se cilat janë vetëm hipoteza të paprovuara dhe të pabazuara në mënyrë të plotë dhe bindëse. Autoriteti ndër të tjera duhet jo vetëm të administrojë

prova, të sigurojë se ato janë të saktë dhe të besueshme, por edhe duhet të hetojë nëse këto prova përmbajnë gjithë informacionin që duhet konsideruar për vlerësimin e një situate të plotë dhe nëse mundet të mbledhesh gjithë konkluzionet e nevojshme prej tij në këtë provë. Në mendimin tim sekretariati në këtë hetim, në kundërshtim me dispozitat e ligjit shqiptar dhe në kundërshtim me jurisprudencën e DE, edhe mbledhjet në një analizë sipërfaqësore dhe të shpeshtë të të dhënave pa i analizuar në mënyrë të plotë, për të vendosur nëse ka shkelje të rregullave të konkurrencës.

Ndërsa kërkesa e shqyrtës për pajisjen e abonësve me kartomin shqyrtues, në gjykimin tim është një masë që është e drejtë që dhe e ligjshme, pasi përmban elemente të tillë sigurie, të cilat do të minimizojnë dëmet që i sillin tregu informal dhe falsifikimet e shumta që i bëheshin abonëve nga përfituesit abuziv (shqyrtësime të cilat provohen nga procedurbalet e pyetjeve të menaxherëve të subjekteve, por edhe nga korespondencat e shqyrtës me Bashkimin, si dhe me denoncimet e vazhdueshme në organet përkatëse). Qëllimi i kësaj masë për mendimin tim, është i drejtë dhe i justifikuar, nuk sjell asnjë dëm për konkurrencën, nuk është asnjë kosto shpreh për konsumatorin, por vetëm disiplina tregu dhe luftën fenomenet negative ende të veshtra për t'u marramshur nga anti mbikqyrës, nga të cilat shpesh i vjen një dëm edhe me i madh nëse i sigurohet terren i përshatshëm. Arsyet e tjera të cilat përmenden në raportin e hetimit janë vetëm dyshime, por jo të provuara.

Zelluluar me sjelljen e ndërmarrjeve në treg, në lidhje me kufizimin e tregimit të abonentëve të studentit dhe të përgjithshme, kam theksuar mendimin tim kuader dhe nuk jam dakord me pjesën tjetër të Komisionit lidhur me gjykimin dhe konkluzionet që kanë nevojë në përfundim të hetimit. Për këtë arsye po paraqes argumentet e mëposhtme:

Tregu i shërbimit të transportit mjetet qytetas është një treg i rregulluar dhe benesist i kontrolluar nga shteti, c'ka në vetvete e përjashton konkurrencën. I vendi segment ku ndërmarrjet mund të jnë në marrëdhënie rivaliteti është tregu i tregimit të biletave të pajtimin mujor(abonëve) të përgjithshme dhe të studentit në tregun përkatës gjeografik, qytet, llogarë. Ekzistenca e konkurrencës në thelb shfaqet në marrëdhënie që vendoset midis një marramshjeje të cilat shesin mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, në të njëjten kohë, kundrejt një mund të identifikueshëm konsumatorësh. Kjo do të thotë, që edo ndërmarrje mund të hyj në një marrëdhënie konkurrenciale apo rivaliteti me ndërmarrjet e tjera që kanë të njëjten shtrirje gjeografike në treg. Shogata, pjesë e të cilës janë të gjithë operatorët që veprojnë në treg, kanë vendosur me vullnetin e tyre të kufizojnë tregtimin e abonentëve të studentit, vendim i cili nuk cenon, nuk dëmton dhe as prek asnjë nga konkurrentët në këtë treg. Në kuptim të nenit 4 pikë 1 e Ligjit Nr.512/ datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", nuk plotësohet kushti i paraktuar në të : pra është një vendimarrje e përbashkët (manevrësje) e cila nuk ka për qëllim të pengojë, të kufizojë apo shtrëmbërojë asnjë konkurrent tjetër në këtë treg dhe për rrjedhojë as vën konkurrencën ekzistuese. Ligji organik ka për qëllim të ndalojë ato manevrësje të cilat i sjellin dëm konkurrencës dhe jo manevrësjet të cilat mund të kenë edo qëllim tjetër (i cili duhet të hetohet, provohet dhe argumentohet) por jo pengimin e konkurrencës. Pyetje që

shprehur dhe që në fund të procesit duhet të merret një përgjigje tërësisht të argumentuar në bazë të tërësive së faktive, është :

“Për operatorët kanë vendosur me vullnetin e tyre të lirë dhe të përbashkët të kufizojnë tregtimin e abonentëve të studentit?”

Subjektet në secënast degjimore të zhvilluara pranë Autoritetit të Konkurrencës, parashtruan një sërë arsyesh, të cilat i kanë shfrytëzuar për të vepruar në këtë mënyrë. Ndërsa raporti hetimor dhe mbi këtë bazë dhe vendimi i shumicës së Komisionit të Konkurrencës, është miratuar vetëm të rëndise vendimet e njëposnjeshme të Shoqatës për këtë çështje, duke rrethuar faktin se në c'mase është kufizuar tregtimi i abonentëve të studentit kështu pas kësaj dhe vit pas viti, pa i analizuar shkaqet dhe arsyet, pasojat dhe lidhjet shkak pasqje që duhet të ekzistojë për të provuar një shkelje të ligjit të konkurrencës. Është kështu dhe jam dakort me konstatimin se ky veprim është shkelje, por nuk mund të pajtohem me vendimin e shumicës që këtë shkelje e konsideron shkelje të ligjit të konkurrencës. Arsyes që paraqiten subjektet për kufizimin e tregimit të abonentëve të studentit, janë të gjitha arsye të qendrësishme dhe nuk mund të mohohet që janë ekzistuese në këtë treg. Mospajisja me kartën e studentit, përlitim nga ky shkak i konsumatorëve jo studente, falsifikime dhe mashtrime të ndryshme të denoncuar rast pas rasti pranë shoqatës, i ka bërë operatorët të pasigurtë në treg dhe të ndjeshëm për të reaguar në mënyrë të tillë, sepse nga ana e organeve shtetërore nuk përmbusheshin detyrimet ligjore të mesipërme, por nga ana tjetër nuk përmbushet as detyrimi i përlitimit të subvencioneve për diferencat e crimeve në tregimin e abonentëve të studentit me crime të ulët. Konstatimi i grupit të punës se kufizimi vjen si rezultat se subjektet nuk kanë interes në tregtimin e abonentëve të studentit, pasi u intereson të tregtojnë abonentët e përgjithshëm, sepse janë me crime të lartë, është shumë sipërfaqësore. Strategjitë e operatorëve në këtë treg sa të kontrolluar nga shteti atë dhe infernal në funksionimin e tij, për të zvogëluar humbjet dhe rritur fitimet është një reagim i zgjatur në vlerë të kushteve të tregut për qasë konkurrent në këtë treg, ku ka pasur dhe dalje nga operatorët të tjerë, arsye të të cilëve mbeten të pa zbuluara. Marrja për sipër nga ana e operatorëve e kostave të shërbimit abonentëve të studentit është një detyrim shtetëror dhe nuk është as e drejtë, as ligjore. Ky është një detyrim i cili i takon organeve shtetërore dhe nuk mund t'i delegohen të tjerëve, sepse në parim pjesë në politikën sociale të shtetit, dhe se dyti çeson në thellë konkurrencën.

Sikurse citova më lart, bashkohem me idenë e pjesës tjetër të Komisionit që kufizimi i tregimit, pavarësisht arsyes të ligjshme ekonomike është shkelje, por jo shkelje e konkurrencës në treg, detyrë të cilën ekskluzivisht ushtron Autoriteti i Konkurrencës. Në këndvështrimin tim, veprimi i shoqatës ka detyruar të drejtat e konsumatorëve, të cilat mirëkohen me ligjin Nr.9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”. Objekt i këtij ligji është : “ mbrojtja e konsumatorëve në treg, si dhe përcaktimi i rregullave dhe rregullave të rregullimit për të mbrojtur të drejtat e konsumatorëve. Zbatimi parafshirë të gjitha ligjet e marrëdhënies ndërmyqer tregtare dhe konsumatorëve që janë të bëjnë me rezultat e konsumatorëve apo shërbimeve”. Në këtë kuptim ligji jone organik na autorizon të nderhyjmë vetëm në rastet e

marrëveshjeve që kufizojnë apo pengojnë konkurrencën, sjellje të cilat padyshim në fund demtojnë konsumatorin. Por nëse ky veprim i shqiptes nuk demton konkurrencën, përkundrazi e favorizon konkurrencën e drejtë, për nga ana tjetër demton vetëm konsumatorin, a mund të na zbatim të ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës" të penalizojmë subjektin ?

Në gjykimin tim, në rastin kur Autoriteti i Konkurrencës konstaton shkeljen si në këtë rast, apo problemat që shfaq tregu, mund t'ia delegojë cështjen organit kompetent për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve. Autoriteti i Konkurrencës duhet të ndalojë ato marrëveshje të cilat demtojnë konkurrencën dhe jo marrëveshjet të cilat nuk demtojnë konkurrencën në vetvete, por demtojnë vetëm të drejtat e konsumatorëve. Një marrëveshje që demton konkurrencën gjellë për mjedijet dhe demtimin e interesave të konsumatorit, ndërsa një marrëveshje që mund të çojë të drejtat e konsumatorit jo gjellëmonë mund të demtojë, pengjë e apo kufizojë dhe konkurrencën. Rasti që kemi shqyrtuar është rasti që e tipizon këtë natyrë të marrëveshjes. Në këtë kushte vlersoj se vendimet e shqiptes të pretenduara si marrëveshje, kanë patur si objekt të tyre rregullimin e situatës treg. Problema të cilat kanë rrjedhur nga mospërmirësimi i detyrimeve të shërb. shërbimeve e bashkëpunimit të gjithë aktorëve dhe nuk kanë patur si objekt, qëllim ose pasqje pengimin e konkurrencës, kufizimin apo shtrëmbërtimin e saj, sikurse kërkon nën 4 pikat 1 e ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës".

Për këtë arsye, mosmarrëveshtja e organeve të shtetit, nuk mund t'ia rëndojë subjekteve si faj dhe të bashkohem me pjesën tjetër të Komisionit për t'i deklaruar faktore të gjithë operatorët në tregun e tregtimit të hiletave të pajtimit meqanëse të përgjithshme dhe të studentit, vetëm me shkakun se shoqëria ka vepruar si një organizim për të kontribuar në vendosjen e ekuilibrit të drejtë në treg, për të vendosur rregulla lojë të barabarta për të gjithë dhe për të patur një konkurrencë të lirë dhe efektive.

Roli efektiv i Autoritetit të Konkurrencës në këtë rast hetimet, mendoj se duhet të konsistonte në faktin, që pasi të identifikonte tregun, aktorët e tij, rregullat e lojës dhe rolin e autoriteteve përgjegjëse në këtë treg të rregulluar, për pa rregulla lojë të mirëcaktuara, të mund të identifikonte ato segmente të tregut ku shfaqeshin problemet, shqetësimet, mosveprimet apo veprimet e parregullta, të kontribuonte në vendosjen e rregullave të sjelljes së subjekteve dhe të përcaktonte përgjegjësitë dhe përgjegjësit për mbrojtjen e konkurrencës në treg duke siguruar kështu nëvojën e rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Komisioneri



Rezana Kononi



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 291 , Datë 23.07.2013

“Mbyllja e hetimit të thelluar në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të çimentos 42.5 rifuxho dhe të paketuar ndaj ndërmarrjeve “ANTEA CEMENT” SHA, “FUSHE-KRUJE CEMENT FACTORY”, SHPK, “EUROTECH CEMENT” SHPK, “ELBASAN CEMENT FACTORY” SHPK dhe “COLACEM ALBANIA” SHPK”

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

▪	Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪	Rezana	KONOMI	zv/Kryetar
▪	Servete	GRUDA	Anëtar
▪	Koço	BROKA	Anëtar
▪	Iva	ZAIMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.07.2013, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Ekzistenca ose jo e marrëveshjes së ndaluar ndërmjet ndërmarrjeve “ANTEA CEMENT” SHA, “FUSHE-KRUJE CEMENT FACTORY”, SHPK, “EUROTECH CEMENT” SHPK, “ELBASAN CEMENT FACTORY” SHPK dhe “COLACEM ALBANIA” SHPK” në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të çimentos 42.5 rifuxho dhe të paketuar.

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d); neni 26; neni 4, pika 1; të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”(i ndryshuar);
Ligji Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i procedurave administrative”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të çimentos 42.5 rifuxho dhe të pakeluar, të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës dhe relacionit shoqërues;
- Pretendimeve të ndërmarrjeve nën hetim “EUROTECH CEMENT” SHPK, “ANTEA CEMENT” SHA, “FUSHE-KRUJE CEMENT FACTORY” SHPK, “ELBASAN CEMENT FACTORY” SHPK, dhe “COLACEM ALBANIA” SHPK, në seancat dëgjimore përkatëse: të datës 25.05.2013, 20.06.2013, 21.06.2013 dhe 02.07.2013, si dhe ato me shkrim të dorëzuara pranë Autoritetit të Konkurrencës, përkatësisht me shkresat me nr. 205/11 prot, dt. 25.05.2013, nr.205/9prot. datë 20.06.2013, nr.229/1 prot. dt. 21.06.2013, nr.228/1prot. datë 21.06.2013, dhe 205/9 Prot. datë 14.06.2013 dhe nr.205/10 Prot. datë 26.06.2013,
- Kundërpretendimeve të grupit të punës dhe relacionit përkatës.

VËREN SE:

I. PROCEDURA

1. Autoritetit të Konkurrencës, në bazë të informacioneve se në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të çimentos kishte rritje të njëkohëshme të çmimeve të shitjes, duke dyshuar për një marrëveshje të fshehtë për rritjen e çmimit të çimentos, monitoroi tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të produktit çimento.
2. Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm dhe raportit të monitorimit, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (ketu e në vijim Ligji), me anë të Vendimit Nr. 233, datë 16.07.2012 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, importit dhe shitjes me shumicë të çimentos”, vendosi të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak, për të parë nëse ka kufizime apo shtrembërime të konkurrencës në këtë treg.
3. Në përfundim të hetimit paraprak, rezultoi së të gjitha ndërmarrjet që ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit dhe të importit të produktit çimento 42.5 R, duke filluar nga data 22 shkurt 2012 (Ndërmarrjet prodhuese), deri në datën 2 Mars 2012 (Ndërmarrjet importuese), kishin rritur në mënyrë të njëkohëshme dhe në një masë të konsiderueshme çmimin e tregtimit me shumicë të produktit çimento 42.5 R, gjë e cila në kuptim të nenit 4, pika 1, gërma (a) e Ligjit mund të përbëjë një marrëveshje të ndaluar dhe/ose sjellje të koordinuar midis ndërmarrjeve që operojnë në tregun përkatës.

4. Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 24, germa (d) dhe nenit 43, pika 1, të Ligjit, si dhe të nenit 12 të Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit, me anë të Vendimit Nr. 253, datë 03.12.2012, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të çimentos 42.5 rifuxho dhe të pakeluar”, vendosi hapjen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtarinë në këtë treg dhe konkretisht: “ANTEA CEMENT” SHA, “FUSHE-KRUJE CEMENT FACTORY” SHPK, “ELBASAN CEMENT FACTORY” SHPK, “EUROTECH CEMENT” SHPK dhe “COLACEM ALBANIA” SHPK.

5. Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, realizoi njoftimin e ndërmarrjeve nën hetim në lidhje me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 253, datë 03.12.2012.

6. Në zbatim të nenit 39 të Ligjit, Komisioni i Konkurrencës organizoi seancat dëgjimore, në të cilat ndërmarrjet nën hetim paraqitën në mënyrë verbale edhe me shkrim pretendimet e tyre mbi raportin e hetimit të thelluari dhe evidencat përkatëse. Pretendimet e palëve me shkrim, si dhe evidencat përkatëse u depozituan në protokollin e Autoritetit të Konkurrencës, të cilat janë marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës.

II. PERIUDHA E HETIMIT DHE NDËRMARRJET NËN HETIM

7. Periudha e hetimit, e përcaktuar nga Komisioni i Konkurrencës në Vendimit Nr. 253, datë 03.12.2012, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të çimentos 42.5 rifuxho dhe të pakeluar” përfshin periudhën kohore nga 01.01.2011 deri në 31.12.2012.

8. Ndërmarrjet në hetim të përcaktuara me anë të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 253 datë 03.12.2012 që ushtrojnë veprimtari në tregun e importit dhe prodhimit të çimentos në Republikën e Shqipërisë janë:

1- Ndërmarrja “ANTEA CEMENT” SHA, person juridik shqiptar, me seli në Adresën: Autostrada Tiranë-Durrës, Km.7, Katund i Ri, Kashar, Tiranë,

2- Ndërmarrja “COLACEM ALBANIA” SHPK, person juridik shqiptar, me seli në Adresën: Rruga Nacionale Lezhë – Shkodër, Km.7, Balldre, Lezhë,

3- Ndërmarrja “FUSHE-KRUJE CEMENT FACTORY” SHPK, person juridik shqiptar, me seli në Adresën: Fabrika e Çimentos Fushë Krujë.

4- Ndërmarrja “ELBASAN CEMENT FACTORY” SHPK, person juridik shqiptar, me seli në Adresën: Rruga Abdyl Frashëri, Pallati Nr.11/1, Kati7, Tiranë,

5- Ndërmarrja “EUROTECH CEMENT” SHPK, person juridik shqiptar, me seli në Adresën: Lagjja Nr.14, Shkozë, Durrës.

9. Referuar ekstrakteve të regjistrit tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR), rezulton se ndërmarrja “SEAMENT HOLDING” zotëron me anë të ndërmarrjes “SEAMENT ALBANIA” SHPK 77% të pjesëve të kapitalit të ndërmarrjes “ELBASAN CEMENT FACTORY” SHPK dhe 100% të pjesëve të kapitalit të ndërmarrjes “FUSHE-KRUJE CEMENT FACTORY” SHPK. Gjithashtu referuar ekstrakteve të QKR-së, edhe disa prej përfaqësuesve ligjore të këtyre ndërmarrjeve janë të njëjtë.

III. ANALIZA E KONKURRENCES

III.1. Tregu përkatës

10. Përcaktimi i tregut përkatës është realizuar në bazë të Udhëzimit Nr.76, date 07/06/2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”. Përkufizimi i tregut përkatës përfshin dy dimensione:

- a) *Tregu përkatës i produktit*
- b) *Tregu përkatës gjeografik*

III.1.1 Tregu përkatës i produktit

11. Në vlerësimin e tregut përkatës janë marrë në konsideratë faktorë si: zëvendësueshmëria nga ana e kërkesës dhe nga ana e ofertës. Në përputhje me objektin e hetimit është marrë parasysh diferenca në çmim midis çimentos së bardhë, gri dhe të zezë. Në analizë është marrë çmimi CIF për të tre kategoritë. Ka një variacion të konsiderueshëm çmimi midis Çimentos gri, Çimentos së zezë dhe të bardhë, përkatësisht 12% ndërsa për Çimento e bardhë 3-fishi i grisë. Pra ka zëvendësueshmëri të ulët nga ana e kërkesës duke pasur parasysh variacionin e lartë në çmim. Këto produkte kanë një zëvendësueshmëri të ulët edhe për shkak të destinacionit final të përdorimit, ku çimento e bardhë përdoret për punime dekorative e skulptura, çimento e zezë për ndërtimin e strukturave të forta, (ura etj.) ndërsa çimentoja gri, përdoret për përdorim për prodhimin e betonit. Çimento gri rifuxho është e ndarë në disa klasa, duke filluar nga 32.5 R deri në 52.5 R. Kjo ndarje varet nga cilësia e çimentos, dhe masa e klinkerit, fakt i cili ndikon në sasinë e çimentos që përdoret si dhe në vlerën e tij si input për procese të njëjta.

12. Duke marrë në konsideratë shkallën e zëvendësueshmërisë së llojeve të çminetos si dhe efektet në nivelin e çmimeve në raport me sasinë, konkludojmë se tregu përkatës i produktit çimento 42.5 R rifuxho dhe me thasë, është veçuar nga kategoritë e tjera të çimentos për vetë faktin se karakteristikat e tij janë të veçanta dhe nuk mund të përdoret nga ndërmarrjet e ndërtimit në të njëjtat procese teknike si produktet e tjera të çimentos. Pra, duke u bazuar në karakteristikat e produktit, Çimento 42.5 R dhe e Paketuar përbën tregu përkatës të produktit.

III.1.2. Tregu përkatës gjeografik

13. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet tregu i brendshëm, tregu gjeografik i cili përfshin territorin e Republikës së Shqipërisë.

III.2. Struktura e tregut

14. Bazuar në të dhënat e përpunuara nga grupi i punës si dhe nga të gjitha evidencat e paraqitura nga ndërmarrjet objekt hetimi gjatë seancave dëgjimore, është paraqitur struktura e tregut sipas treguesit të shitjeve në tregun kombëtar dhe atë ndërkombëtar të produktit përkatës, çmimento 42.5R dhe të paketuar, në Tabelën 1. “Pjesët e tregut sipas totalit të shitjeve brënda dhe jashtë vendit të produktit përkatës për vitet 2011 dhe 2012” si në vijim.

15. Nga të dhënat e pjesëve të tregut vërehet se dy prodhuesit vendas (“Elbasan cement factory” shpk dhe “Fushe-kruje cement factory” shpk¹, si dhe “Antea cement” sha) kanë një pjesë të konsiderueshme tregu (mbi 40% secila). Në këtë mënyrë tregu i prodhimit të produktit përkatës është një treg duopol. Ndërsa i gjithë tregu objekt hetimi është shumë i përqëndruar.

Tabela1. Pjesët e tregut sipas totalit të shitjeve brenda dhe jashtë vendit të produktit përkatës për vitet 2011 dhe 2012

16. Nga të dhënat e Tabelës të mësipërme konstatohet se në rastin e tregut përkatës ka një ndryshim të pjesëve të tregut të ndërmarrjeve nga njëri vit në tjetrin. Fakt i cili tregon se tregu nuk ka qënë statik gjatë periudhës objekt hetimi.

III.3. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve objekt hetimi në tregun përkatës

17. Gjatë procedurave hetimore u kryen inspektime (Dawn Raids) në ambientet e ndërmarrjeve nën hetim për gjetjen e evidencave direkte dhe indirekte të një bashkëpunimi të mundshëm midis konkurrentëve, por gjatë këtyre inspektimeve nuk u gjet asnjë prove direkte apo gjurmë komunikimi midis tyre.

18. Nga analiza e strukturës së tregut të prodhimit, importit dhe shitjes me shumicë të cimentos 42.5R dhe e paketuar u konstatua se ky treg është shumë i përqëndruar dhe se gjatë vitit 2012 ndërmarrjet nuk kanë rruajtur pjesët e tregut përkatës krahasuar me vitin 2011.

19. Për të identifikuar sjelljen e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit dhe të importit të çimentos, në lidhje me çmimin e tregtimit të këtij produkti

¹ Për shkak të aksionerit të përbashkët maxhoritar Seament, këto ndërmarrje do të analizohen së bashku për efektet e tyre në treg.

nga Grupi i Punës janë parë të gjitha faturat ditore të shitjes së këtij produkti, rifuxho dhe të pakeluar për vitet 2011 dhe 2012.

20. Nga analiza e faturave të shitjes të ndërmarrjeve, rezulton se 2 (dy) ndërmarrje prodhuese të çimentos “ANTEA CEMENT” SHA dhe “FUSHE-KRUJE CEMENT FACTORY” SHPK, në datën 22.02.2012, kanë rritur çmimin e tregtimit të çimentos Rifuxho 42.5 R, përkatësisht ndërmarrja ANTEA e ka rritur nga 47 euro/ton në 62 euro/ton (32% rritje), kurse ndërmarrja “FUSHE-KRUJE CEMENT FACTORY” SHPK e ka rritur nga 46 euro/ton në 60 euro/ton (31% rritje).

21. Palët kanë pretenduar ky çmim nuk pasqyron saktë realitetin pasi nuk merr parasysh skontot për sasi dhe për tregti afatgjatë të cilat pasqyrohen në blerjet e muajve të mëvonshëm.

22. Nga analiza e faturave të shitjes, rezulton se 2 (dy) ndërmarrjet importuese “EUROTECH CEMENT” SHPK dhe “COLACEM ALBANIA” SHPK, përkatësisht në data 01.03.2012 dhe 02.03.2012, kanë rritur çmimin e tregtimit të produktit çimento Rifuxho 42.5 R, përkatësisht ndërmarrja “COLACEM ALBANIA” SHPK e ka rritur çmimin nga 45 euro/ton në 61 euro/ton (36% rritje), kurse ndërmarrja “EUROTECH CEMENT” SHPK nga 51 euro/ton në 61 euro/ton (20% rritje).

23. Nga krahasimi i çmimeve mesatare mujore të shitjes së produktit çimento 42.5 nga ana e ndërmarrjeve importuese dhe prodhuese në vend për vitet 2011 – 2012 dhe kostove përkatëse të prodhimit dhe importit, konstatohet se ka një rritje të fortë e të njëkohshme të çmimeve mesatare mujore, gjë e cila del në pah për periudhën Shkurt 2012 dhe paraqitet e plotë në muajin Mars 2012.

24. Kjo sjellje e ndërmarrjeve nën hetim ka zgjatur deri në muajin Gusht 2012. Nga analiza e faturave të rezulton se ndërmarrjet prodhuese “ANTEA CEMENT” SHA dhe “FUSHE-KRUJE CEMENT FACTORY” SHPK në fillim të muajit Gusht 2012 kanë filluar të ndryshojnë çmimin e tregtimit të produktit çimento 42.5 R, duke e ulur atë. Gjithashtu dhe ndërmarrja importuese “COLACEM ALBANIA” SHPK e ka ndryshuar çmimin e tregtimit të produktit Çimento 42.5 R, duke e ulur atë në fund të muajit Gusht 2012. Ndërmarrja tjetër importuese “EUROTECH CEMENT” SHPK nuk e ka ndryshuar çmimin, duke vazhduar të tregtojë në të njëjtat nivele.

25. Duke qenë se gjatë inspektimeve nuk u gjetën evidenca direkte të komunikimit mes konkurrenteve, bazuar në metodologjinë e OECD-së, janë kryer analiza ekonomike me qëllim evidentimin e sjelljes së mundshme të bashkërenduar mes konkurrenteve për rritjen e njëkohshme të çmimit të shitjes së produktit përkatës.

26. Analiza e sjelljes së ndërmarrjeve në lidhje me çmimin e shitjes me shumicë ka për qëllim të vlerësojë nëse ndërmarrjet vendosin direkt apo indirekt çmimet e shitjes me shumicë në mënyrë të koordinuar apo mbi bazën e politikave dhe/ose strategjive individuale gjatë periudhës objekt hetimi.

27. Ndërmarrjet “COLACEM ALBANIA” SHPK dhe “EUROTECH CEMENT” SHPK gjatë seancave dëgjimore, kanë pretenduar që sjellja e tyre është karakterizuar si sjellja e një ndjekësi (pasuesi). Kjo sjellje e tyre është në përputhje me praktikën e Gjykatës Europiane të Drejtësisë në rastin *Woodpulp II* ku theksohet se: “Megjithëse neni 85 i Traktatit (sot neni 101 i TFBE ekuivalent me nenin 4, të Ligjit), ndalon cdo formë bashkëpunimi që shtrembëron konkurrencën, ai nuk privon operatorët ekonomikë nga e drejta për tu përshtatur në mënyrë inteligjente ndaj sjelljes ekzistuese dhe të pritshme të konkurrentëve të tyre”.

28. Palët pretendojnë se gjatë periudhës 2011 dhe 2012, kanë pësuar humbje operative dhe zvogëlim të pjesëve të tregut dhe në këtë mënyrë i janë përshtatur sjelljes së konkurrentëve të tyre (prodhuesve vendas të çimentos), duke rritur çmimet në mënyrë që të rrisnin fitimin e tyre. Kjo rritje ka ndodhur disa ditë pas rritjes së çmimit nga prodhuesit vendas.

29. Nëse i referohemi të dhënave të administruara nga ndërmarrjet prodhuese objekt hetimi pretendohet se ka patur shkaqe të ndryshme të rritjes së çmimit të cilat kanë ndikuar në një politikë të pavarur të përcaktimit të çmimit nga ana e tyre.

30. Disa nga argumentat e paraqitura gjatë procedurës janë:

a) Tregues të ndryshëm të tregut si: çmimet, pjesët e tregut, sasitë e shitura kanë qenë të ndryshueshme përgjatëgjithë periudhës në hetim duke qenë një tregues i konkurrencës dhe jo i bashkërendimit të sjelljes,

b) Ka pasur arsye të ndryshme për rritjen e kostos totale të produktit (si rritja e akcizës së karburanteve, taksa e karbonit, çmimi i blerjes e energjisë, renta minerare etj, të shkaktuara nga ndryshime ligjore të miratuara në fund të vitit 2011 fillim 2012),

c) Norma e fitimit ka qenë e ulët ose negative (ka pasur humbje),

d) Rritje e importeve nga vendet fqinje,

e) Mos-rimbursimi i TVSH,

f) Transparenca e tregut për shkak të homogjenitetit të produktit, e numrit të vogël të ndërmarrjeve ku çmimet e konkurrentëve monitorohen nga njëri tjetri apo nga klientët,

g) Tre ndërmarrjet që prodhojnë çimento në vend janë nën kapacitete potenciale të prodhimit (deklaruar në procesverbale nga drejtorët përkatës), duke mos

rikupruar kostot fikse të produktit për njësi që në këto raste janë të larta dhe risin humbjen për njësi,

h) Ndërmarrjet kanë provuar me anë të analizës së kostove se gjatë periudhës Maj 2011- Shkurt 2012 janë përballur me humbje për njësi, madje çmimet e shitjes së produktit çimento 42.5 R Rifuxho dhe të paketuara kanë qenë nën koston e ndryshueshme mesatare duke mos justifikuar as operimin e tyre në treg.

31. Bazuar në evidencat e grumbulluara gjatë procedurës hetimore si dhe në faktet e paraqitura nga ndërmarrjet objekt hetimi gjatë seancave dëgjimore, rezulton se rritja pothuajse e njëkohëshme e çmimeve të shitjes nga prodhuesit dhe importuesit ka ardhur si rezultat i një sjellje dhe strategjie individuale konkurruese për t’ju përshtatur kushteve të tregut gjatë periudhës objekt hetimi, dhe nuk është shkaktuar nga një sjellje e bashkërenduar.

32. Si konkluzion, sjellja e bashkërenduar ndërmjet ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e prodhimit (“ANTEA CEMENT” SHA dhe “FUSHE-KRUJE CEMENT FACTORY” SHPK,) dhe të importit (“COLACEM ALBANIA” SHPK dhe “EUROTECH CEMENT” SHPK) për produktin çimento Rifuxho dhe me thasë 42.5 R, duke filluar nga data 22 shkurt 2012 (ndërmarrjet prodhuese) deri në datën 2 Mars 2012 (ndërmarrjet importuese), në kushtet e mungesës së evidencave direkte apo të evidencave të komunikimit, nuk provohet pasi ndryshimi pothuajse i njëkohshëm i çmimeve, nuk mund të përbëjë provë për një marrëveshje të ndaluar në formën e sjelljes së bashkërenduar, përveçse kur bashkërendimi është i vetmi shpjegim për sjelljen paralele.

33. Tregu objekt hetimi paraqet një shkallë të lartë përqëndrimi si dhe është i rëndësishëm për ekonominë e vendit. Struktura oligopolistike e tij është më e ekspozuar ndaj praktikave të mundshme anti-konkurruese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 43, pika 5 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar,

V E N D O S I:

I. Mbyllja e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të çimentos 42.5 rifuxho dhe të paketuara ndaj ndërmarrjeve “ANTEA CEMENT” SHA, “FUSHE-KRUJE CEMENT FACTORY”, SHPK, “ELBASAN FACTORY” SHPK, “EUROTECH CEMENT” SHPK dhe “COLACEM ALBANIA” SHPK”;

II. Monitorimin në vazhdim të tregut të prodhimit, importit dhe shitjes me shumicë të çimentos.

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe për komunikimin e tij ndërmarrjeve të mësipërme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr.292, Datë 16.09.2013

“Për

**hapjen e procedurës së hetimit paraprak nëtregun e importit, prodhimit
dhe shitjes me shumicë tëkarburanteve për kufizime të mundshme
të konkurrencës”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- | | | | |
|---|---------|-------------|-------------|
| ▪ | Lindita | MILO (LATI) | Kryetare |
| ▪ | Rezana | KONOMI | Zv/Kryetare |
| ▪ | Servete | GRUDA | Anëtare |
| ▪ | Koço | BROKA | Anëtare |
| ▪ | Iva | ZAJMI | Anëtare |

Në mbledhjen e tij të datës 16.09.2013, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e kërkesës së Sekretariatit për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve për kufizime të mundshme të konkurrencës”.

Baza ligjore: Nenet 24, shkronja d), neni 26 dhe neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi monitorimin nëtregun e karburanteve.

VËREN SE:

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, në zbatim të nenit 28 të Ligjit 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, ka realizuar një monitorim në tregun e karburanteve.

Qëllimi i monitorimit në tregun e karburanteve ka qenë evidentimi i ndryshimeve në strukturën e tregut të karburanteve, diesel 10ppm dhe benzinë, ecuria e çmimeve në treg për të parë nëse ka shenja të kufizimit të konkurrencës si pasojë e mundësisë së koordinimit të sjelljes në treg dhe/ose abuzimit me pozitën dominuese(në rast të ekzistencës) të një ose disa(dominancë kolektive) ndërmarrjeve aktive në tregun përkatës.

Nga të dhënat e administruara si dhe nga analiza e realizuar u konstatua se tregu i importit të naftës 10 ppm dhe benzinës paraqitet me ndryshime të theksuara strukturore ku ndërmarrjet kanë ndryshuar ndjeshëm pjesët e tregut gjatë viteve 2010-gusht 2013. Në treg kemi ndërmarrje që kanë dalë nga tregu i importit duke operuar vetëm në tregun e pakicës, sikurse kemi hyrje të reja në treg.

Nga vlerësimi i indeksit të përqendrimit në tregun e importit të dieselit, vihet re se gjatë 8 muorit 2013 tregu paraqitet shumë i përqëndruar, por me një ulje të pjesës së tregut që zënë tre(CR3) dhe pesë(CR5) ndërmarrjet më të mëdha në treg.

Treguesit e përqendrimit në tregun e importit të benzinës paraqiten në nivelin më të lartë të një tregu mesatarisht të përqëndruar (800-1800) me një rritje krahasuar me vitet e kaluara. Gjithashtu rritje paraqesin edhe treguesit e përqendrimit për tre dhe pesë konkurrentët kryesorë, e cila është si pasojë e rritjes së pjesës së tregut të tre ndërmarrjeve më të mëdha në treg.

Çmimi i importit të dieselit dhe benzinës ka patur vlerën më të ulët gjatë muajit maj 2013 me trend rritës për muajt në vazhdim, por këto ulje nuk janë reflektuar në çmimet në tregun e pakicës.

Nga analiza e të dhënave mbi volumin dhe çmimin e shitjes me shumicë të karburantëve për vitin 2012, u vu re se nga analiza e çmimit të shitjes në stacionet me logon e tyre, keto çmime kanë patur ulje dhe ngritje, por trendi i ndryshimit të çmimeve për tre ndërmarrje kryesore është i njëjtë. Kjo vërehet veçanërisht pas muajit maj 2012, ç’ka mund të ngrejë dyshimin për një marrëveshje në vendosjen e çmimit. Ndërmarrjet e integruara të pakicës pasqyrojnë politikën e ndërmarrjeve importuese në përcaktimin e çmimit të shitjes së karburanteve nën logon e tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 4, nenit 9, nenit 24, shkronja d, si dhe nenit 42, pika 1, të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me propozim të Sekretariatit,

V E N D O S I:

I. Hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumice të karburanteve për të parënësë ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës si pasojë e sjelljes së ndërmarrjeve në treg.

II. Periudha e hetimit do të jetë ngjajuar 2010 deri në gusht 2013.

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak jo më vonë se 3 muaj nga dalja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS**Servete GRUDA****Koço BROKA****Iva ZAJMI****Rezana KONOMI**

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar**Lindita MILO (LATI)**

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

Nr. 293, Datë 1.10.2013

“Për

**shqyrtimin e kërkesës së ndërmarrjes “Alba Trans” sh.p.k për revokimin e
Vendimit nr. 290, datë 23.07.2013 “ Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve
“Ferlut” SHA, “Tirana Lines” Shpk, “Alba Trans” Shpk, “Tirana Urban
Trans” SHA dhe “Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve” shpk, për kufizim
të konkurrencës në tregun e tregtimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve)
të përgjithshme dhe studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas të
udhëtarëve në qytetin e Tiranës”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

▪	Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪	Rezana	KONOMI	Zv/Kryetar
▪	Servete	GRUDA	Anëtar
▪	Koço	BROKA	Anëtar
▪	Iva	ZAIMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 1.10.2013, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i kërkesës së ndërmarrjes “Alba Trans” Shpk për revokimin e Vendimit nr. 290, datë 23.07.2013 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Ferlut” SHA, “Tirana Lines” Shpk, “Alba Trans” Shpk, “Tirana Urban Trans” SHA dhe “Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve” shpk, për kufizim të konkurrencës në tregun e tregtimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 24, gërma d, dhe neni 46.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të kërkesës së ndërmarrjes “Albatrans SHA” për revokimin e Vendimit nr. 290, datë 23.07.2013 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Ferlut” SHA, “Tirana Lines” Shpk, “Alba Trans” Shpk, “Tirana Urban Trans” SHA dhe “Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve” shpk, për kufizim të konkurrencës në tregun e tregtimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës” të Komisionit të Konkurrencës, dhe pretendime të paraqitura gjatë seancës dëgjimore të mbajtur në datën 27.09.2013.

VËREN SE:

Komisioni i Konkurrencës me Vendimit nr. 290, datë 23.07.2013 ka vendosur me tre vota pro dhe dy kundër për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Ferlut” SHA, “Tirana Lines Shpk, “Alba Trans” Shpk, “Tirana Urban Trans” SHA, dhe “Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve shpk, për kufizim të konkurrencës në tregtimin e biletave të pajtimit mujor (aboneve të përgjithshme dhe studentit) në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës.

Lidhur me këtë vendim ndërmarrja “Alba Trans” Shpk ka paraqitur kërkesën përrevokimin e tij me anë të shkresës nr 286/1 prot., datë 26.08.2013 si dhe kërkesën për t’u dëgjuar nga Komisioni i Konkurrencës me anë të shkresës nr 320 prot. datë 9.09.2013, procedurë e cila u realizua në datën 27.09.2013.

Nga vlerësimi i kërkesës së ndërmarrjes “Alba Trans” Sh.a. dhe i argumenteve të dhëna nga kjo ndërmarrje, konstatohet se të gjitha çështjet e ngritura janë trajtuar në raportin e hetimit të thelluar në tregun e tregtimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës si dhe kanë qënë objekt shqyrtimi nga Komisioni i Konkurrencës gjatë procesit vendimmarrës pasqyruar në vendimin nr. 290, datë 23.07.2013 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Ferlut” SHA, “Tirana Lines” Shpk, “Alba Trans” Shpk, “Tirana Urban Trans” SHA dhe “Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve” shpk, për kufizim të konkurrencës në tregun e tregtimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”.

Kërkesa e ndërmarrjes “Alba Trans” sh.p.k për revokimine Vendimit nr 290, datë 23.07.2013 nuk përmbush asnjë nga kriteret e përcaktuara në Nenin 46 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d, dhe nenin 46 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së ndërmarrjes “Alba Trans” Shpk për revokimin e vendimit nr 290, datë 23.07.2013 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Ferlut” SHA, “Tirana Lines” Shpk, “Alba Trans” Shpk, “Tirana Urban Trans” SHA dhe “Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve” shpk, për kufizim të konkurrencës në tregun e tregtimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”
2. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 290, datë 23.07.2013 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Ferlut” SHA, “Tirana Lines” Shpk, “Alba Trans” Shpk, “Tirana Urban Trans” SHA dhe “Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve” Shpk, për kufizim të konkurrencës në tregun e tregtimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij Vendimi shoqërisë “Alba Trans”shpk.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA	Koço BROKA	Iva ZAJMI	Rezana KONOMI
_____	_____	_____	_____
Anëtar	Anëtar	Anëtar	Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 294, Datë 28.10.2013

“Mbi

autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit nga shoqëria AD-Trade Sh.p.k të shoqërisë Primo Communications Sh.p.k, nëpërmjet përfitimit të 100% të kuotave të saj nga Telekom Slovenije d.d”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | |
|----------------|-------------|-------------|
| ▪ Znj. Lindita | Milo (Lati) | Kryetar |
| ▪ Znj. Rezana | Konomi | Zv. Kryetar |
| ▪ Znj. Servete | Gruda | Anëtar |
| ▪ Z. Koço | Broka | Anëtar |
| ▪ Znj. Iva | Zajmi | Anëtar; |

Në mbledhjen e tij të datës 28.10.2013, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit nga shoqëria AD-Trade Sh.p.k të shoqërisë Primo Communications Sh.p.k, nëpërmjet përfitimit të 100% të kuotave të saj nga Telekom Slovenije d.d.”

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, 10-12, dhe neni 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit “ dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit të Primo Communications dhe AD-Trade dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E:

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet nëpërmjet “Kontratë Shitblerje Kuotash”, e nënshkruar ndërmjet palëve pjesëmarrëse (Telekom Slovenije d.d në cilësinë e shitësit dhe Ad-Trade Sh.p.k në cilësinë e blerësit me objekt të gjithë kapitalin e shoqërisë Primo Communication Sh.p.k) më datë 3 tetor 2013.

Shitësi është zotëruesi i ligjshëm dhe me titull të plotë ligjor mbi kuotat, të cilat përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë Primo Communications Sh.p.k. Blerësi përfton kuotat së bashku me të gjithë të drejtat dhe privilegjet shoqëruese, të lira nga çdo barrë, kundrejt çmimit të blerjes dhe me plotësimin e kushteve të përcaktuara në kontratë.

Përqendrimi i ka për qëllim të sjellë ndryshimin e kontrollit të shoqërisë objekt të përqëndrimit (*target*), Primo Communications në formën e ndryshimit të pronësisë, i cili i jep blerësit (AD-Tarde) kontrollin e vetëm ekskluziv mbi shoqërinë target. Ky transaksion përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 pika 1, shkronja b) të Ligjit dhe për pasojë duhet autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës

2. Palët në transaksion

2.1. AD-Trade Sh.p.k, në cilësinë e **Blerësit** është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon që prej vitit 2007, me seli në adresën: Rruga e Durrësit, përballë doganës, Tiranë. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj tregtare në: (i) import-eksport dhe tregtim me shumicë e pakicë të artikujve industrial, ushqimore, materiale të ndërtimit , të pajisjeve elektrike dhe elektronike të të gjitha llojeve, etj.; (ii) prodhim të artikujve industriale, ushqimore, materiale të ndërtimit, të pajisjeve elektrike dhe elektronike të makinerive të të gjitha llojeve të pajisjeve dhe impiante të ndryshme, etj.

2.2. Primo Communications Sh.p.k, në cilësinë e **shoqërisë Target**, është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon sipas legjislacionit shqiptar që më 1998, me seli në adresën: Kashar Autostrada Tiranë-Durrës, Km1, Tiranë. Objekti i veprimtarisë tregtare të shoqërisë është: (i) zhvillimi dhe kryerja e aktivitetit të shërbimeve, kërkimeve, konsulencës, projekteve, menaxhimit dhe studimeve të të gjitha llojeve; (ii) shërbimi në postën elektronike dhe në internet dhe shërbim telefonik nëpërmjet internetit, etj. Shoqëria ka mbi 10 vjet që operon të tregun e telekomunikacioneve në Shqipëri. Fillimisht ajo ka qenë me pronësi shqiptare për tu shitur në vitin 2008 tek shoqëria Telekom Slovenije d.d e cila ka vepruar si investitor në fushën e telekomunikacioneve në Europën Jug-Lindore

2.3. Telekom Slovenije d.d, në cilësinë e **Shitësit**, është një shoqëri e themeluar në 1999 dhe që funksionon në bazë të legjislacionit sloven, me seli në adresën: Cigaletova

15, 1000 Ljubljana. Shoqëria është ofruesi kryesor i komunikimeve elektronike në Slloveni. Aktivitetet e saj përfshin: (i) aktivitetin e telekomunikacionit wireless dhe aktivitete të tjera; (ii) aktivitete të programacionit dhe broadcasting/transmetimit televiziv; (iii) ndërtimi i projekteve për shërbimet elektrike dhe telekomunikacionit, etj.

3. Xhiro për vitin 2011

Transaksioni ndodh në tregun gjeografik të Republikës së Shqipërisë ku e ushtrojnë veprimtarinë si pala blerëse ashtu edhe shoqëria objekt i këtij përqendrimi pasi AD-TRADE dhe Primo Communications nuk janë prezent në tregun ndërkombëtar.

Xhiro totale në **tregun e brendshëm**: është **XXXX Lekë**, ku:

- AD-TRADE sh.p.k : XXX Lekë
- Primo Communications sh.p.k: XXX Lekë

Pra, xhiro e palëve pjesëmarrëse në transaksion e kalon dhe është shumë afër kufirit të xhiros të parashikuar në pikën 1 të nenit 12 të ligjit nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar

4. ANALIZA E KONKURRENCËS

4.1. Tregu përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- I) tregu i produktit, dhe
- II) tregu gjeografik.

AD-TRADE sh.p.k është një kompani që operon në fushën e tregtisë së materialeve hidraulike. Objekti i veprimtarisë së saj përfshin import-eksport, tregti, materiale hidraulike dhe hidrosanitare.

Primo Communications sh.p.k e ushtron aktivitetin në sektorin e telekomunikacionit me ofrimin e shërbimeve të internetit, telefonisë dhe data transmission. Primo është një Internet Service Provider (shërbim interneti), e cila operon në tregun shqiptar që prej vitit 1998, në atë kohë si Albania Online Service Provider (AOLSP). Në vitin 2008 kjo kompani iu shit Telekomit Slloven (TS). Pas vitit 2009 kjo kompani u quajt Primo Communications.

Primo Communications sh.p.k është një shoqëri e cila kryesisht ofron shërbimet e internetit me brez të gjerë (broadband), telefonisë fikse dhe transmetim të dhënash (data service) në qytetet Tiranë, Durrës, Kavajë, Shkodër dhe zonat rurale përreth tyre. Primo u ofron shërbimin e internetit rreth XXXX klientëve dhe shërbimin e telefonisë fikse rreth XXXX klientëve. Gjithashtu ajo i ofron shërbimin e të dhënave (*data services*) disa prej bankave më të mëdha në Shqipëri.

4.1.1 Tregu i produktit

Bazuar në raportin e AKEP-it¹ tregu i komunikimeve elektronike ndahet në tre nën tregje:

- Telefoni celulare
- Telefoni fikse
- Internet

Por duke marrë parasysh objektin e veprimtarisë ku shoqëria Primo Communication sh.p.k ushtron aktivitetin e saj, treg përkatës të produktit do të konsiderojmë shërbimet e internetit dhe të telefonisë fikse. Ofruesit kryesorë të shërbimit të internetit me bazë të gjerë (broadband) janë Albtelecom, Vodafone, AMC, ABCom, Abissnet, ASC (Tring), Primo, etj. Ofruesit kryesorë të shërbimit të telefonisë fikse janë Albtelecom, ABCom, AMC fiks (nëpërmjet rrejtit GSM), ASC (Tring), Primo, Nisatel (vetëm në qytetin e Vlorës), etj.

4.1.2 Tregu gjeografik:

Ky treg përfshin hapësirën ku tregtohen produktet apo shërbimet e ofruara të përcaktuara në tregun e produktit. Për vlerësimin e këtij përqendrimi, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet Republika e Shqipërisë.

5. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Nëpërmjet këtij transaksioni AD-Trade do të marrë kontrollin e 100% të Primo Communications, pa e përfshirë atë në aktivitetin e saj. Primo Communications do të vazhdojë të qëndrojë si kompani më vete, duke iu ndryshuar vetëm pronësia nga 100% slllovene në 100% shqiptare.

Primo Communications dhe AD-Trade do të veprojnë si kompani të ndara pa patur asnjë lidhje ekonomike midis tyre, pa patur asnjë përzierje të strukturave organizative, teknike dhe të shitjes, duke qëndruar veçmas siç kanë qenë deri më sot.

Pjesa e tregut që Primo Communications sh.p.k do të zotërojë pas transaksionit do të mbetet po e njëjtë me pjesën e tregut të zotëruar nga kjo shoqëri para tij, pasi AD-Trade sh.p.k (blerësi) nuk është prezent në asnjë nga tregjet e produktit në të cilat Primo Communications është aktive.

6. Konkluzione

Përqendrimi i njoftuar është një ndryshim kontrolli sipas parashikimeve të nenit 10, pika 1, shkronja b dhe plotëson kriteret e xhiros sipas nenit 12 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

¹ Burimi: AKEP, Treguesit statistikorë dhe financiarë të tregut të komunikimeve elektronike, viti 2012.

Përqendrimi në momentin e njoftimit nuk sjell asnjë ndryshim në strukturën dhe pjesën e tregut që zë aktualisht shoqëria Primo Communications, pasi përfituesi i kontrollit nuk është prezent në tregun e produktit para përqendrimit dhe për pasojë nuk ndryshon struktura e tregut pas përqendrimit. Gjithashtu, pas përqendrimit nuk do të kemi krijim apo forcim të pozitës dominuese të ndërmarrjes Primo Communications sh.p.k. në tregun përkatës.

Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria AD-Trade Sh.p.k të shoqërisë Primo Communications Sh.p.k, nëpërmjet përfutimit të 100% të kuotave të saj nga Telekom Slovenije d.d.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 295 , Datë 14.11.2013

**Per miratimin e Udhëzimit
“Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

• Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
• Rezana	KONOMI	Zv/Kryetar
• Servete	GRUDA	Anëtar
• Koço	BROKA	Anëtar
• Iva	ZAJMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të dates 14.11.2013, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimin e Udhëzimit “Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale” në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar);

Baza ligjore: Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), neni 24, shkronja d), dh).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Projekt – udhëzimit “Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale”
- Opinioneve të paraqitura nga palët e interesuara:

VENDOSI:

1. Të miratojë Udhëzimin “Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale” sipas tekstit të bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS**Servete GRUDA****Koço BROKA****Iva ZAJMI****Rezana KONOMI**

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar**Lindita MILO (LATI)**

K R Y E T A R

Udhëzim

“Për vlerësimin e marrëveshjeve horizontale”¹

Pasqyra e përmbajtjes

1. Hyrje
 - 1.1. Qëllimi dhe fusha e veprimit
 - 1.2. Parimet bazë të vlerësimit bazuar në Nenin 4
 - 1.2.1. Neni 4 i ligjit
 - 1.2.2. Nenet 5 dhe 6 të ligjit
2. Parimet e përgjithshme të vlerësimit konkurrues të shkëmbimit të informacionit
 - 2.1. Përcaktimi dhe qëllimi
 - 2.2. Vlerësimi bazuar në Nenin 4 të ligjit
 - 2.2.1. Shqetësimet kryesore të konkurrencës
 - 2.2.2. Kufizimet e konkurrencës nga objekti
 - 2.2.3. Efektet kufizuese të konkurrencës
 - 2.3. Vlerësimi sipas në Neneve 5 dhe 6 të ligjit
 - 2.3.1. Përfitimet nga efica
 - 2.3.2. Domosdoshmëria
 - 2.3.3. Kalimi tek konsumatori
 - 2.3.4. Nuk ka eliminim të konkurrencës
3. Marrëveshjet e kërkuar zhvillimit
 - 3.1. Përkufizimi
 - 3.2. Tregjet përkatëse
 - 3.3. Vlerësimi bazuar në Nenin 4 të ligjit
 - 3.3.1. Shqetësimet kryesore të konkurrencës
 - 3.3.2. Kufizimet e konkurrencës nga objekti
 - 3.3.3. Efektet kufizuese të konkurrencës
 - 3.4. Vlerësimi sipas në Neneve 5 dhe 6 të ligjit
 - 3.4.1. Përfitimet nga Eficenca
 - 3.4.2. Domosdoshmëria
 - 3.4.3. Kalimi tek konsumatori
 - 3.4.4. Nuk ka eliminim të konkurrencës

¹ 52011XC0114(04); Udhëzues mbi aplikimin e Nenit 101 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian ndaj marrëveshjeve horizontale të bashkëpunimit (*Fletorja zyrtare C 011* , 14/01/2011 P. 0001 – 0072; 2011/C 11/01).

- 3.4.5. Koha e vlerësimit
- 4. Marrëveshje të prodhimit
- 4.1. Përkufizimi dhe qëllimi
- 4.2. Tregjet përkatëse
- 4.3. Vlerësimi sipas Nenit 4 të ligjit
- 4.3.1. Shqetësimet kryesore të konkurrencës
- 4.3.2. Kufizimet e konkurrencës për nga objekti
- 4.3.3. Efektet kufizuese të konkurrencës
- 4.4. Vlerësimi bazuar në Nenet 5 dhe 6 të ligjit
- 4.4.1. Përfitimet nga Eficenca
- 4.4.2. Domosdoshmëria
- 4.4.3. Kalimi tek konsumatori
- 4.4.4. Nuk ka eliminim të konkurrencës
- 5. Marrëveshjet e blerjes
- 5.1. Përkufizimi
- 5.2. Tregjet përkatëse
- 5.3. Vlerësimi sipas nenit 4 të ligjit
- 5.3.1. Shqetësimet e konkurrencës
- 5.3.2. Kufizimet e konkurrencës për nga objekti
- 5.3.3. Efektet kufizuese të konkurrencës
- 5.4. Vlerësimi bazuar në Nenet 5 dhe 6 të ligjit
- 5.4.1. Përfitimet nga Eficenca
- 5.4.2. Domosdoshmëria
- 5.4.3. Kalimi tek konsumatori
- 5.4.4. Nuk ka eliminim të konkurrencës
- 6. Marrëveshjet e tregtimit
- 6.1. Përkufizimi
- 6.2. Tregjet përkatëse
- 6.3. Vlerësimi sipas Nenit 4 të ligjit
- 6.3.1. Shqetësimet kryesore për konkurrencën
- 6.3.2. Kufizimet e konkurrencës për nga objekti
- 6.3.3. Efektet kufizuese të konkurrencës
- 6.4. Vlerësimi sipas Neneve 5 dhe 6 të ligjit
- 6.4.1. Përfitimet nga Eficenca
- 6.4.2. Domosdoshmëria
- 6.4.3. Kalimi tek konsumatori
- 6.4.4. Nuk ka eliminim të konkurrencës
- 7. Marrëveshjet e standardizimit
- 7.1. Përkufizimi

- 7.2. Tregjet përkatëse
- 7.3. Vlerësimi sipas Nenit 4 të ligjit
 - 7.3.1. Shqetësimet kryesore për konkurrencën
 - 7.3.2. Kufizimet e konkurrencës për nga objekti
 - 7.3.3. Efektet kufizuese të konkurrencës
- 7.4. Vlerësimi sipas Neneve 5 dhe 6 të ligjit
 - 7.4.1. Përfitimet nga Eficenca
 - 7.4.2. Domosdoshmëria
 - 7.4.3. Kalimi tek konsumatori
 - 7.4.4. Nuk ka eliminim të konkurrencës

1. Hyrje

1.1. Qëllimi dhe fusha e veprimit

1. Ky udhëzim përcakton parimet për vlerësimin sipas nenit 4 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” (i ndryshuar) (këtu e më poshtë Ligji), të marrëveshjeve ndërmjet ndërmarrjeve, vendimeve dhe praktikave të bashkërenduara të grupimeve të ndërmarrjeve, të cilat kanë të bëjnë me bashkëpunimin horizontal. Bashkëpunimi është i një natyre “horizontale”, nëse një marrëveshje është lidhur midis konkurrentëve aktual ose potencial. Gjithashtu, ky udhëzim përfshin marrëveshjet horizontale të bashkëpunimit, të lidhura midis ndërmarrjeve jo-konkurrente, për shembull, në mes të dy ndërmarrjeve aktive në tregjet e të njëjtin produkt, por në tregje të ndryshme gjeografike, pa qenë konkurrentë potencialë.

2. Marrëveshjet horizontale të bashkëpunimit mund të çojnë në përfitime ekonomike të konsiderueshme, sidomos nëse kombinojnë aktivitetet plotësuese, aftësitë apo asetet. Ato mund të jenë një mjet për të ndarë rrezikun, për të kursyer kostot, për të rritur investimet, know-how, për të rritur cilësinë e produkteve të ndryshme dhe për të sjellë risi.

3. Nga ana tjetër, marrëveshjet horizontale mund të shkaktojnë probleme në konkurrencë. Kjo ndodh në rastet kur palët bien dakord për të rregulluar çmimet e produkteve, apo të ndajnë tregjet, ose nëse bashkëpunimi i mundëson palëve të ruajnë, fitojnë apo të rrisin fuqinë në treg dhe në këtë mënyrë sjellin rritje të efekteve negative të tregut në lidhje me çmimet, prodhimin, cilësinë dhe shumëllojshmërinë e produkteve apo risive.

4. Autoriteti i Konkurrencës (këtu e më poshtë Autoriteti) duke njohur përfitimet si rezultat i marrëveshjeve horizontale të bashkëpunimit, duhet të sigurohet se është ruajtur konkurrenca efektive. Dispozitat ligjore mbi marrëveshjet ofrojnë kuadrin e duhur ligjor për të kryer nga ana e Autoritetit, vlerësimin e një marrëveshjeje duke marrë në konsideratë efektet dhe pasojat që sjell një marrëveshje.

5. Qëllimi i udhëzimit është që të sigurojë një kuadër analitik për llojet më të zakonshme të marrëveshjeve të bashkëpunimit horizontal. Udhëzimi analizon marrëveshjet e kërkimit dhe zhvillimit, marrëveshjet e prodhimit, duke përfshirë nënkontraktimin dhe marrëveshjet e specializimit, marrëveshjet e blerjeve, marrëveshjet e shitjeve, marrëveshjet e standardizimit, përfshirë kontratat standarde dhe shkëmbimin e informacionit. Analiza kryhet bazuar në kriteret ligjore dhe ekonomike që ndihmojnë për të analizuar një marrëveshje horizontale bashkëpunimi dhe rrethanat në të cilat ajo lidhet. Kriteret ekonomike të tilla si fuqia e tregut e palëve dhe faktorë të tjerë që lidhen me strukturën e tregut, përbëjnë një element kyç të vlerësimit të ndikimit në treg të shkaktuara nga marrëveshjet horizontale të bashkëpunimit, në kuadër të nenit 4 të Ligjit.

6. Ky udhëzim merr në analizë llojet më të zakonshme të marrëveshjeve horizontale të bashkëpunimit, me përjashtim të transaksioneve që përbëjnë një përqendrim dhe janë objekt i rregulloreve dhe kuadrit ligjor për përqendrimet

7. Ky udhëzim do të ndihmojë bizneset në vlerësimin e përputhshmërisë së një marrëveshje individuale bashkëpunimi me nenin 4. Secili rast duhet të vlerësohet mbi bazën e fakteve të veta, të cilat mund të kërkojnë një zbatim të saktë të këtij udhëzimi rast pas rasti.

8. Kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim, vlejné për marrëveshjet horizontale të bashkëpunimit, si për produktet ashtu dhe për shërbimet.

9. Edhe pse ky udhëzim përmban referenca të caktuara për marrëveshjet e ndaluara, nuk ka për qëllim të japë një vlerësim lidhur me faktin nëse një marrëveshje është e ndaluar ose jo.

10. Termi “konkurrentët”, siç është përdorur në këtë udhëzim përfshin të dy llojet e konkurrentëve, aktual dhe potencial. Dy ndërmarrje konsiderohen si konkurrentë aktual në qoftë se janë aktive në të njëjtin treg përkatës. Një ndërmarrje konsiderohet si konkurrent potencial i një ndërmarrjeje tjetër në qoftë se, në mungesë të marrëveshjes, në rast të një rritje të vogël, por të përhershme në çmimet relative, është e mundshme që ndërmarrja e parë, brenda një periudhe të shkurtër kohe, të ndërmarrë investimet e nevojshme shtesë ose kosto të tjera për të hyrë në tregun përkatës, në të cilin kjo e fundit është aktive.

11. Për qëllim të këtij udhëzimi, nuk konsiderohen konkurrentë shoqëritë që janë pjesë e të njëjtës ndërmarrje në kuptim të Nenit 4 të Ligjit. Neni 4 zbatohet vetëm për marrëveshjet midis ndërmarrjeve të pavarura. Kur një ndërmarrje ushtron ndikim vendimtar mbi një ndërmarrje tjetër, ato formojnë një njësi të vetme ekonomike dhe rrjedhimisht, janë pjesë e të njëjtës ndërmarrje. E njëjta gjë vlen dhe për ndërmarrjet simotra, domethënë, për ndërmarrje që drejtohen nga e njëjta shoqëri mëmë. Këto ndërmarrje nuk konsiderohen konkurrencte edhe pse të dyja janë aktive në të njëjtin treg përkatës dhe gjeografik të produktit.

12. Marrëveshjet që lidhen midis ndërmarrjeve që veprojnë në nivele të ndryshme të zinxhirit të prodhimit ose të shpërndarjes, ose thënë ndryshe, marrëveshjet vertikale, janë trajtuar në Udhëzimin “Për Vlerësimin e marrëveshjeve Vertikale” dhe Rregullorja “Për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”.

13. Marrëveshjet Horizontale të bashkëpunimit mund të kombinojnë faza të ndryshme të bashkëpunimit, për shembull kërkimin dhe zhvillimin (“K & ZH”) prodhimin dhe / ose tregtimin e rezultateve të tyre.

1.2. Parimet bazë për vlerësimin sipas Nenit 4

1.2.1. Neni 4 i Ligjit

2. Vlerësimi sipas nenit 4 kryhet në dy hapa. Hapi i parë, është vlerësimi nëse një marrëveshje ndërmjet ndërmarrjeve është anti-konkurruese ose ka efekte kufizuese

aktuale ose potenciale për konkurrencën. Hapi i dytë, është përcaktimi i efekteve pro-konkurrese si rezultat i marrëveshjes dhe përfitimet e marrëveshjes, për të vlerësuar nëse këto efekte pro-konkurrese tejkalojnë efektet kufizuese të konkurrencës.

3. Në raste të caktuara, ndërmarrjet inkurajohen nga autoritetet publike për të hyrë në marrëveshje bashkëpunimi horizontale, në mënyrë që të arrihet objektivi i politikave publike me anë të vetë-rregullimit. Megjithatë, ndërmarrjet mbeten objekt vlerësimi sipas nenit 4 të Ligjit. Me fjalë të tjera, fakti që autoritetet publike inkurajojnë marrëveshjet horizontale të bashkëpunimit, nuk do të thotë se janë të lejueshme sipas nenit 4 të Ligjit.

4. Neni 4 ndalon marrëveshjet, që kanë për objekt ose pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës.

(i) Kufizimet e konkurrencës për nga objekti

5. Kufizimet e konkurrencës për nga objekti janë ato që nga natyra e tyre kanë aftësinë për të kufizuar konkurrencën në kuptim të nenit 4 të Ligjit. Kur përcaktohet se një marrëveshje është anti-konkurrese, nuk është e nevojshme që të analizohen efektet aktuale ose potenciale të një marrëveshjeje në treg.

6. Për të vlerësuar nëse një marrëveshje është anti-konkurrese, kujdes duhet patur me përmbajtjen e marrëveshjes, objektivat që kërkon të realizojë dhe konteksti ekonomik dhe ligjor i saj. Gjithashtu, edhe pse qëllimi i palëve në marrëveshje nuk është një faktor i nevojshëm për përcaktimin nëse një marrëveshje është ose jo antikonkurrese, Autoriteti mund të mbajë në konsiderate edhe këtë element në analizën e tij.

(ii) Efektet kufizuese të konkurrencës

1. Nëse një marrëveshje horizontale bashkëpunimi, nuk kufizon konkurrencën nga objekti, duhet të analizohet nëse ka efekte të ndjeshme kufizuese për konkurrencën. Parasysh duhen patur si efektet aktuale ashtu dhe ato potenciale.

2. Që një marrëveshje të ketë efekte kufizuese për konkurrencën në kuptim të nenit 4 të Ligjit, ajo duhet të ketë një ndikim të dukshëm negativ në të paktën një prej parametrave të konkurrencës në treg, të tilla si: çmimi, prodhimi, cilësia e produktit, shumëllojshmëria apo risitë. Marrëveshjet mund të kenë efekte të tilla, duke kufizuar ndjeshëm konkurrencën midis palëve në marrëveshje apo midis cilado prej palëve në marrëveshje dhe palëve të treta. Kjo do të thotë se marrëveshja duhet të zvogëlojë pavarësinë vendim-marrëse të palëve (për shkak të detyrimeve të përfshira në marrëveshje, ose duke ndikuar në sjelljen e tregut e të paktën njërës prej palëve duke shkaktuar një ndryshim në nxitjen e saj).

3. Efektet kufizuese të konkurrencës brenda tregut përkatës, ka të ngjarë të shfaqen kur, për shkak të marrëveshjes, palët janë në gjendje të rrisin çmimet ose të zvogëlojnë

prodhimin, cilësinë e produktit, shumëllojshmërinë apo risitë e tij. Kjo do të varet nga disa faktorë: të tilla si natyra dhe përmbajtja e marrëveshjes, shkalla në të cilën palët individualisht apo së bashku kanë përftuar fuqi tregu, si dhe shkalla në të cilën marrëveshja kontribuon në krijimin, mbajtjen ose forcimin e fuqisë së tregut apo lejon palët të shfrytëzojnë këtë fuqi tregu.

4. Vlerësimi nëse një marrëveshjeje horizontale bashkëpunimi ka efekte kufizuese për konkurrencën në kuptim të nenit 4, bëhet duke krahasuar kontekstin aktual ligjor dhe ekonomik në të cilin është konkurrenca në mungesë të marrëveshjes me të gjithë kufizimet e pretenduara te saj (që do të thotë, në mungesë të marrëveshjes, ose siç parashikohet, nëse akoma nuk është zbatuar, në kohën e vlerësimit).

5. Marrëveshjet horizontale të bashkëpunimit midis konkurrentëve që nuk janë të aftë të kryejnë veprimtarinë e mbuluar nga bashkëpunimi në mënyrë të pavarur, (për shembull, për shkak të aftësive të kufizuara teknike të palëve) normalisht nuk do të sjellin efekte kufizuese për konkurrencën në kuptim të nenit 4 të Ligjit .

Natyra dhe përmbajtja e marrëveshjes

1. Natyra dhe përmbajtja e një marrëveshjeje lidhet me faktorë të tillë si: zona dhe objekti i bashkëpunimit, marrëdhënia konkurruese midis palëve dhe masa në të cilën ato kombinojnë aktivitetet e tyre. Këta faktorë përcaktojnë se cilat janë shqetësimet e mundshme të konkurrencës, që vijnë nga një marrëveshje horizontale bashkëpunimi.

2. Marrëveshjet Horizontale të bashkëpunimit mund ta kufizojnë konkurrencën në mënyra të ndryshme. Marrëveshja mund:

- Të jetë ekskluzive, në kuptimin që kufizon mundësinë e palëve për të konkurruar me njëra-tjetrën ose palët e treta si ndërmarrje ekonomike të pavarura;
- t'u kërkojë palëve të kontribuojnë me asete të tilla, në mënyrë që pavarësia në vendimmarrje të ulët ndjeshëm; ose
- të ndikojë në interesat financiare të palëve, në mënyrë të tillë që pavarësia e tyre në vendim-marrje të zvogëlohet ndjeshëm.

3. Efekti i mundshëm i marrëveshjeve të tilla mund të jetë mungesa e konkurrencës midis palëve në marrëveshje. Gjithashtu, konkurrentët mund të përfitojnë nga zvogëlimi i presionit të konkurrencës që rezulton nga marrëveshja dhe si rrjedhojë mund të rrisin çmimet e tyre. Reduktimi i këtyre kufizimeve konkurruese mund të çojë në rritjen e çmimit në tregun përkatës. Për vlerësimin e konkurrencës në marrëveshje janë të rëndësishëm faktorë të tillë si:

- nëse palët në marrëveshje zotërojnë një pjesë të madhe të tregut;
- nëse ata konkurrojnë ngushtë;
- nëse klientët kanë mundësi të kufizuara për të ndryshuar furnizues;

- nëse konkurrentët nuk mund të rrisin furnizimet nëse rriten çmimet, dhe
- nëse një prej palëve në marrëveshje është forcë e rëndësishme konkurruese,

4. Një marrëveshje horizontale bashkëpunimi mundet gjithashtu :

- të çojë në zbulimin e informacioneve të rëndësishme të cilat rrisin mundësitë e koordinimit ndërmjet palëve brenda apo jashtë fushës së bashkëpunimit;
- të arrijë bashkërendim në kosto (që do të thotë proporcionin atyre kostove që palët i kanë të përbashkëta), që palët të mund të koordinojnë më lehtësisht çmimet e tregut dhe të prodhimit.

5. Ngjashmëria e konsiderueshme e kostove të arritura me anë të një marrëveshjeje bashkëpunimi horizontal, mund të lejojë palët të koordinojnë më lehtë çmimet e tregut dhe të prodhimit, ku:

- palët kanë fuqi në treg,
- karakteristikat e tregut janë të favorshme për një koordinim të tillë,
- zona e bashkëpunimit llogarit një proporcion të lartë të shpenzimeve të ndryshueshme të palëve në një treg të caktuar, dhe
- palët kombinojnë aktivitetet e tyre në fushën e bashkëpunimit në një masë të konsiderueshme.

Ky është rasti, kur ata prodhojnë ose blejnë së bashku një produkt të ndërmjetëm të rëndësishëm ose prodhojnë ose shpërndajnë bashkërisht një sasi të lartë të prodhimit të tyre të përgjithshëm të produktit final.

6. Një marrëveshje horizontale për këtë arsye mund të ulë pavarësinë e vendimmarrjes së palëve dhe si rrjedhojë të rrisë mundësinë që ata të koordinojnë sjelljen e tyre në mënyrë që të arrijnë një rezultat të fshehtë, por ajo gjithashtu mund ta bëjë koordinimin më të lehtë, më të qëndrueshëm ose më efikas për palët që ishin pjesë e koordinimit. (ose duke e bërë koordinimin më të fuqishëm ose duke i lejuar ata të arrijnë çmime edhe më të larta).

Fuqia e tregut dhe karakteristikat e tjera të tregut

1. Fuqia në treg është aftësia për të mbajtur çmimet në mënyrë fitimprurëse mbi nivelin konkurrues për një periudhë kohore, ose për të ruajtur në mënyrë fitimprurëse prodhimin për sa i përket sasisë së produktit, cilësisë së produktit dhe shumëllojshmërinë apo risinë në nivelet konkurruese për një periudhë kohore.

2. Në tregjet me kosto fikse ndërmarrjet duhet t'i vendosin çmimet mbi kostot e ndryshueshme të prodhimit, në mënyrë që të sigurojnë një kthim konkurrues për investimet e tyre. Fakti që ndërmarrjet i vendosin çmimet mbi kostot e ndryshueshme, nuk përbën në vetvete një shenjë që konkurrenca në treg nuk po funksionon mirë dhe që ndërmarrjet kanë fuqinë në treg që i lejon ato të vendosin çmimet mbi nivelin konkurrues. Është rasti kur kufizimet konkurruese janë të pamjaftueshme për të mbajtur çmimet,

prodhimin, cilësinë e produktit, shumëllojshmërinë e produktit dhe risitë në një nivel konkurrues që ndërmarrjet kanë fuqi në treg në kontekstin e nenit 4 të Ligjit për Konkurrencën.

3. Krijimi, ruajtja ose forcimi i fuqisë së tregut mund të vijë si rezultat i aftësisë së lartë, largpamësisë apo risive. Ajo gjithashtu mund të vijë si rezultat i konkurrencës së reduktuar mes palëve në marrëveshje apo mes njëres prej palëve dhe palëve të treta.

4. Pikënisja për analizën e fuqisë së tregut është pozita e palëve në tregjet e prekura nga bashkëpunimi. Për të kryer këtë analizë tregu përkatës, përdoret Udhëzimin “Për përcaktimin e tregut përkatës”

5. Nëse palët kanë pjesë të vogla të kombinuara të tregut, marrëveshja horizontale e bashkëpunimit nuk ka gjasa të sjellë efekte kufizuese për konkurrencën sipas nenit 4 dhe, normalisht, nuk do të kërkohej analiza të mëtejshme. Ajo që konsiderohet si “pjesa e vogël e kombinuar e tregut”, varet nga lloji i marrëveshjes në fjalë dhe mund ti referohemi pjesëve të tregut përcaktuar në Rregulloren “Për marrëveshjet me rëndësi të vogël”. Duke pasur parasysh shumëllojshmërinë e marrëveshjeve horizontale të bashkëpunimit dhe efekteve të ndryshme që mund të shkaktojnë në situata të ndryshme të tregut, nuk është e mundur të jepet një prag i pjesës së përgjithshme të tregut, mbi të cilën mund të pretendohet fuqia e mjaftueshme e tregut, për të shkaktuar efekte kufizuese mbi konkurrencën.

6. Në varësi të pozitës dhe të përqendrimit të palëve në treg, duhet të merren parasysh faktorë të tjerë si stabiliteti i pjesëve të tregut në kohë, pengesat në hyrje, mundësitë e hyrjes në treg dhe fuqia kundërvepruese e blerësit / furnizuesit.

7. Autoriteti përdor pjesët aktuale të tregut kur kryen një analizë të konkurrencës në treg. Megjithatë, mund të merren parasysh edhe zhvillimet e ardhshme të tregut, për shembull, hyrjet dhe daljet, apo dhe zgjerimi në tregun përkatës. Të dhënat historike mund të përdoren nëse pjesët e tregut kanë qenë të paqëndrueshme.

8. Kur hyrja në një treg është mjaft e lehtë, normalisht nuk pritet që një marrëveshje horizontale bashkëpunimi të sjellë efekte kufizuese për konkurrencën.

1.2.2. Nenet 5 dhe 6 të Ligjit

1. Vlerësimi i kufizimeve të konkurrencës nga objekti apo pasojat bazuar në nenin 4 të Ligjit, është vetëm njëra anë e analizave. Ana tjetër, e cila është reflektuar në nenet 5 dhe 6 të Ligjit, është vlerësimi i efekteve konkurruese në marrëveshjet kufizuese. Kur në një rast individual, kufizimi i konkurrencës sipas nenit 4 është i provuar, Nenet 5 dhe 6 të ligjit mund të përdoren si mbrojtje. Barra e provës i takon ndërmarrjes që përfiton nga kjo dispozitë. Prandaj, argumentet faktike dhe dëshmitë e siguruara nga ndërmarrja duhet ti mundësojë Komisionit për të arritur në bindjen se marrëveshja në fjalë ka mjaft gjasa të sjellë efekte pro konkurruese ose jo.

2. Zbatimi i rregullit të përjashtimit të nenit 5 dhe 6 është subjekt i katër kushteve kumulative, dy pozitive dhe dy negative:

- Marrëveshja duhet të kontribuojë në përmirësimin e prodhimit/shpërndarjen e produkteve ose të kontribuojë në nxitjen e progresit teknik ose ekonomik, që do të thotë, të çojë në eficientë;
- Kufizimet duhet të jenë të domosdoshme për arritjen e këtyre objektivave;
- Konsumatorët duhet të marrin një pjesë të konsiderueshme të përfitimeve. Këto duhet të mbarten tek konsumatorët, në mënyrë që ata të paktën të kompensohen për efektet kufizuese të marrëveshjes; dhe
- Marrëveshja nuk duhet t'i sjellë palëve mundësinë e eliminimit të konkurrencës në lidhje me një pjesë të konsiderueshme të produkteve në fjalë.

3. Në fushën e marrëveshjeve horizontale të bashkëpunimit ekzistojnë rregulloret e përjashtimit në bllok bazuar në nenin 6 të Ligjit, për kërkimin dhe zhvillimin dhe (duke përfshirë prodhimin e përbashkët) marrëveshjet e specializimit.

4. Një marrëveshje kërkimi dhe zhvillimi mund të bashkojë aftësi të ndryshme kërkimi që lejojnë palët për të prodhuar produkte më të mira me çmim të ulët dhe kohë më të shkurtër të nxjerrjes në treg. Një marrëveshje prodhimi mund të lejojë palët për të arritur ekonominë e shkallës apo objektivat që nuk mund t'i arrijnë individualisht. Marrëveshjet horizontale të bashkëpunimit që nuk përfshijnë kombinimin e aftësive apo aseteve plotësuese, mund të sjellin eficientë më të ulët për konsumatorin. Marrëveshje të tilla mund të zvogëlojnë dyfishimin e shpenzimeve të caktuara, për shembull për shkak se disa kosto fikse mund të eliminohen.

2. Parime të përgjithshme të vlerësimit të konkurrencës në shkëmbimin e informacionit

2.1. Përcaktimi dhe qëllimi

1. Qëllimi i këtij kapitulli është që të përcaktojë metodologjinë e kryerjes së vlerësimit të konkurrencës së shkëmbimit të informacionit. Shkëmbimi i informacionit mund të marrë formë të ndryshme.

- Së pari, informacioni mund të shkëmbehet drejtpërdrejt, ndërmjet konkurrentëve.
- Së dyti, informacioni mund të shkëmbehet në mënyrë të tërthortë nëpërmjet një agjencie të përbashkët (për shembull, një shoqatë tregtare) ose një pale të tretë, të tilla si një organizatë kërkimore e tregut ose nëpërmjet furnizuesve apo shitësve të kompanive.

2. Shkëmbimi i informacionit realizohet në formë të ndryshme: nëpërmjet marrëveshjeve, vendimeve të grupimeve të ndërmarrjeve ose praktikave të bashkërenduara. Për më tepër, shkëmbimi i informacionit mund të jetë pjesë e një lloji tjetër marrëveshjeje horizontale bashkëpunimi (për shembull, palët në një marrëveshje

prodhimi, shkëmbejnë informacion të caktuar mbi kostot). Ky Vlerësim i shkëmbimi të informacionit, kryhet në kontekstin e vlerësimit të vetë marrëveshjes horizontale të bashkëpunimit.

3. Shkëmbimi i informacionit është një tipar i përbashkët i shumë tregjeve konkurruese dhe mund të sjellë lloje të ndryshme përfitimesh. Ai mund të zgjidhë problemet e asimetrisë së informacionit², duke i bërë tregjet më të efektshme. Për më tepër, ndërmarrjet mund të përmirësojnë efencën e tyre të brendshme nëpërmjet krahasimit të praktikave më të mira me njëri-tjetrin. Konsumatorët mund të përfitojnë direkt nga shkëmbimi i informacionit, duke ulur kostot e tyre dhe duke përmirësuar zgjedhjen e tyre.

4. Megjithatë, shkëmbimi i informacionit mbi tregun, mund të çojë në kufizim të konkurrencës, në veçanti në rastet kur i mundëson ndërmarrjeve marrjen e informacionit mbi strategjitë e tregut të konkurrentëve të tyre.

5. Për më tepër, komunikimi midis konkurrentëve mund të përbëjë një marrëveshje, një praktikë të bashkërenduar, ose një vendim nga një grupim ndërmarrjesh, që ka për objekt fiksimin e çmimeve ose ndarjen e tregut. Këto lloje shkëmbimesh informacioni normalisht konsiderohen dhe gjobiten si marrëveshje të ndaluara. Shkëmbimi i informacionit mund të lehtësojë zbatimin e një marrëveshjeje të ndaluar duke u mundësuar ndërmarrjeve të monitorojnë nëse pjesëmarrësit po përmbushin kushtet e marrëveshjes. Këto lloje të shkëmbimeve të informacionit do të vlerësohen si pjesë e marrëveshjes së ndaluar.

Praktikat e bashkërenduara

1. Kur marrëveshja është lidhur për të shkëmbyer informacion, mund të jetë objekt i nenit 4 të Ligjit. Ekzistenca e një marrëveshjeje, një praktikë e bashkërenduar apo vendimi i një grupimi ndërmarrjesh nuk paragjykon nëse marrëveshja, praktika e bashkërenduar apo vendimi i një grupimi i ndërmarrjeve, sjell kufizimin e konkurrencës sipas nenit 4. Përcaktimi i ekzistencës së një praktikë të bashkërenduar, ka të bëjë me faktin se një ndërmarrje duhet të përcaktojë në mënyrë të pavarur politikën me të cilën ajo synon të përshtatet në treg, dhe kushtet të cilat ajo synon t'ua ofrojë konsumatorëve të saj .

2. Kjo nuk i privon ndërmarrjet nga e drejta për t'u përshtatur me sjelljet e konkurrentëve të tyre. Megjithatë, nuk përjashton mundësinë e ndonjë kontakti të drejtpërdrejtë apo të tërthortë mes konkurrentësh, objekti ose efekti i të cilave, është krijimi i kushteve konkurruese, të cilat nuk korrespondojnë me kushtet normale konkurruese të tregut në fjalë, në lidhje me natyrën e produkteve ose shërbimeve që

² Teoria ekonomike mbi informacionin asimetrik, merret me studimin e vendimeve mbi transaksionet, ku njëra palë ka më shumë informacion se tjetra.

ofrohen, madhësia dhe numri i ndërmarrjeve, si dhe vëllimi i tregut në fjalë. Kjo ndalon çdo kontakt të drejtpërdrejtë apo të tërthortë mes konkurrentëve, objekt ose efekti i së cilës është të ndikojë sjelljen në treg të një konkurrenti aktual ose potencial dhe gjithashtu jep informacion shpjegues për konkurrentin mbi sjelljen që ata vetë kanë vendosur të miratojnë ose planifikojnë të zbatojnë në treg, duke lehtësuar në këtë mënyrë lidhjen e marrëveshjeve të fshehta në treg.

3. Edhe në rastin kur, vetëm një ndërmarrje jep informacione të rëndësishme ndaj konkurrentit që e pranon atë, mund të përbëjë gjithashtu një praktikë të bashkërenduar. Kjo dhënie informacioni mund të ndodhë për shembull, nëpërmjet kontakteve me ane te postës, e-mail-it, thirrjeve telefonike, takimeve etj. Nuk ka rëndësi nëse është vetëm një ndërmarrje që në mënyrë të njëanshme informon konkurrentët, për sjelljen e saj të qëllimshme në treg, apo nëse të gjitha ndërmarrjet pjesëmarrëse informojnë njëra-tjetrën përreth diskutimeve dhe qëllimeve të tyre. Kur një ndërmarrje e vetme zbulon këtë informacion tek konkurrentët e saj, në lidhje me funksionimin e ardhshëm të tregut për të gjithë konkurrentët e përfshirë, një informacion i cili lidhet me politikat tregtare të ardhshme, rrit rrezikun e kufizimit të konkurrencës. Për shembull, pjesëmarrja qoftë edhe për një kohë të shkurtër në një takim, në të cilin një ndërmarrje zbulon për konkurrentët çmimin e planifikuar të saj, është objekt i nenit 4, edhe në mungesë të një marrëveshje të posaçme për të rritur çmimet. Kur një ndërmarrje merr informacione të rëndësishme nga një konkurrent (qoftë nga një takim, me postë ose në mënyrë elektronike), ajo do të prezumohet që ka pranuar informacion dhe ka përshtatur sjelljen e saj në treg në përputhje me rrethanat, nëse nuk i përgjigjet me një deklaratë të qartë se nuk dëshiron të marrë të dhëna të tilla.

4. Kur një ndërmarrje bën një njoftim të njëanshëm në mënyrë publike për shembull përmes një gazete, në përgjithësi kjo nuk përbën një praktikë të bashkërenduar sipas nenit 4 të Ligjit. Megjithatë, duke shqyrtuar faktet rast pas rasti, mundësia e ekzistencës së një praktikë të bashkërenduar nuk mund të përjashtohet, për shembull, në një situatë ku një njoftim i tillë, pasohet nga njoftime publike të konkurrentëve të tjerë, sepse përgjigjet strategjike të konkurrentëve ndaj njëri-tjetrit me njoftime publike mund të jenë prova të një strategjie për të arritur në një mirëkuptim të përbashkët në lidhje me kushtet e koordinimit.

2.2. Vlerësimi sipas nenit 4 të ligjit

2.2.1. Shqetësimet kryesore të konkurrencës

1. Sapo konfirmohet një marrëveshje, praktike e bashkërenduar, apo një vendimmarrje nga një grupim ndërmarrjesh, duhet pasur parasysh se problemi kryesor ka të bëjë me shkëmbimin e informacionit.

(Rezultati) Marrëveshja e fshehte

1. Duke rritur artificialisht transparencën në treg, shkëmbimi i informacionit të rëndësishëm mund të lehtësojë koordinimin (që do të thotë, përshtatjen) e sjelljes së ndërmarrjeve konkurruese dhe rezultatin e efekteve kufizuese për konkurrencën.
2. Një mënyrë është, që përmes shkëmbimit të informacionit, ndërmarrjet arrijnë në një mirëkuptim të përbashkët mbi kushtet e koordinimit, gjë e cila mund të çojë në marrëveshje të fshehta në treg. Ndërmarrjet mund të arrijnë një mirëkuptim të përbashkët mbi kushtet e koordinimit të sjelljes së tyre konkurruese, madje edhe pa nevojën e një marrëveshje të mirëfilltë (konkrete) koordinimi. Shkëmbimi i informacionit në lidhje me sjelljen e ardhshme është mënyra më e mundshme për t'u mundësuar ndërmarrjeve arritjen e një marrëveshje të tillë .
3. Një tjetër mënyrë përmes të cilës shkëmbimi i informacionit mund të çojë në efekte kufizuese për konkurrencën, është duke rritur stabilitetin e brendshëm të një marrëveshje të fshehtë në treg. Në veçanti, kjo mund të bëhet duke u mundësuar ndërmarrjeve të përfshira të monitorojnë devijimet. Kështu, shkëmbimi i informacionit mund ta bëjë tregun aq transparent sa duhet, për të lejuar ndërmarrjet që të bashkëpunojnë për të monitoruar nëse ka ndërmarrje që devijojnë nga marrëveshja e fshehte dhe duke ditur kështu se kur të kundërveprojnë. Qofte shkëmbimi i informacionit aktual ashtu dhe ai i kaluar, mund të përbëjnë një mekanizëm të tillë monitorues. Kjo u mundëson ndërmarrjeve lidhjen e marrëveshjeve të fshehta në tregjet ku ato, nuk do t'a kishin të mundur të lidhnin marrëveshje ose mund të rrisë qëndrueshmërinë e një marrëveshje të fshehte ekzistuese në treg (shih Shembullin 3.).
4. Një mënyrë e tretë përmes të cilës shkëmbimi i informacionit mund të çojë në efekte kufizuese për konkurrencën, është duke rritur stabilitetin e jashtëm të një marrëveshje të fshehte në treg. Shkëmbimi i informacionit që e bën tregun mjaftueshëm transparent sa mund të lejojë ndërmarrjet që bashkëpunojnë që të monitorojnë ku dhe kur ndërmarrjet e tjera po tentojnë hyrjen në treg, duke i lejuar kështu ndërmarrjet bashkëpunuese që të pikasin hyrësit e rinj në treg. Qofte shkëmbimi i informacionit aktual qoftë edhe i informacionit të kaluar mund të përbëjnë një mekanizëm të tillë monitorues.

Sjelljet Anti-konkurruese përjashtuese

1. Përveç lehtësimit të marrëveshjeve të fshehta, shkëmbimi i informacionit mund të çojë gjithashtu në sjellje anti-konkurruese përjashtuese. Shkëmbimi ekskluziv i informacionit mund të çojë në një sjellje anti-konkurruese përjashtuese në të njëjtin treg ku shkëmbimi i informacionit ka ndodhur. Kjo mund të ndodhë kur shkëmbimi i informacionit të ndjeshëm i vendos konkurruesit e tjerë në një disavantazh krahasuar me konkurruesit e tjerë që janë pjesë e shkëmbimit të informacionit. Ky lloj përjashtimi

është i mundur vetëm nëse informacioni në fjalë është shumë strategjik dhe mbulon një pjesë të konsiderueshme të tregut përkatës.

2. Shkëmbimi i informacionit mund të çojë gjithashtu në sjellje anti-konkurrese. Nuk përjashtohet mundësia, që shkëmbimi i informacionit mund të çojë gjithashtu në sjellje anti-konkurrese përjashtuese të palëve të treta në një treg përkatës. Për shembull, duke fituar fuqi tregu të mjaftueshme nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, palët që shkëmbejnë informacion në rrjedhën e sipërme të tregut, për shembull ndërmarrjet e integruara vertikalisht, mund të jenë në gjendje që të rrisin çmimin e një përbërësi kyç në rrjedhën e poshtme të tregut. Në këtë mënyrë, mund të rrisin shpenzimet e rivalëve të tyre në drejtim të rrjedhës së poshtme, e cila mund të rezultojë në sjellje anti-konkurrese në treg.

2.2.2. Kufizimi i konkurrencës nga objekti

1. Çdo shkëmbim informacioni me objekt kufizimin e konkurrencës në treg, konsiderohet si kufizim i konkurrencës për nga objekti. Autoriteti në vlerësimin e tij, merr parasysh nëse shkëmbimi i informacionit nga natyra e tij, mund të çojë në kufizim të mundshëm të konkurrencës.

2. Shkëmbimi i informacioneve qëllimisht nga ana e ndërmarrjeve, në lidhje me sjelljen mbi çmimet, sasitë ose ndarjen e tregut mund të çojë në një marrëveshje të fshehte. Ky Informim, mund të lejojë konkurrentët, të arrijnë në një nivel të përbashkët çmimi më të lartë, pa shkaktuar rrezikun e humbjes së pjesës së tregut ose duke nxitur një luftë të çmimeve gjatë periudhës së vendosjes të çmimeve të reja (shih Shembullin 1).

3. Shkëmbimi i informacionit individual midis konkurrentëve që kanë lidhje me çmimet e ardhshme apo sasitë, duhet të konsiderohet si një kufizim i konkurrencës nga objekti. Përveç kësaj, shkëmbimet private midis konkurrentëve për qëllime individuale në lidhje me çmimet e ardhshme apo sasitë, normalisht konsiderohen si marrëveshje të fshehta dhe gjobiten për shkak se në përgjithësi kanë për objekt fiksimin e çmimeve apo sasinë. Shkëmbimet e informacionit që përbëjnë marrëveshje të fshehta janë objekt i nenit 4, të Ligjit dhe, nuk përmbushin kushtet e nenit 5 dhe 6 të Ligjit.

2.2.3. Efektet kufizuese të konkurrencës

1. Efektet e mundshme të shkëmbimit të informacionit mbi konkurrencën, analizohen rast pas rasti. Vlerësimi i efekteve kufizuese për konkurrencën krahason efektet e mundshme të shkëmbimit të informacionit me situatën konkurrese që do të ekzistonte në mungesë të këtij shkëmbimi të informacionit. Në mënyrë që një shkëmbim informacioni, të ketë efekte kufizuese për konkurrencën në kuptim të nenit 4, duhet të ketë një ndikim të dukshëm negativ në një (ose disa) parametra konkurrence të tilla si, çmimet, prodhimi, cilësia e produktit, shumëllojshmëria e produktit apo risitë. Nëse

shkëmbimi i informacionit do të ketë efekte kufizuese për konkurrencën, varet si nga kushtet ekonomike në tregun përkatës ashtu edhe nga karakteristikat e informacionit të shkëmbyer.

2. Kur kushtet e tregut janë të tilla që koordinimi është i vështirë për t'u mbështetur para shkëmbimit, shkëmbimi i informacionit mund të ndryshojë kushtet e tregut në një mënyrë të tillë që koordinimi bëhet i mundur pas shkëmbimit. Për këtë arsye është e rëndësishme të vlerësohen efektet kufizuese të shkëmbimit të informacionit në kontekstin e dy kushteve, në atë të kushteve fillestar të tregut dhe mënyra se si shkëmbimi i informacionit i ka ndryshuar këto kushte. Po kaq i nevojshëm është edhe shqyrtimi i frekuencës së shkëmbimit të informacionit, lloji i informacionit që shkëmbehet (për shembull, nëse është publik ose konfidencial, i përgjithshëm apo i detajuar, historik apo aktual), dhe rëndësia e informacionit për fiksimin e çmimeve, volumet ose kushtet e shërbimit.

Faktorët e mëposhtëm janë të rëndësishëm për këtë vlerësim.

(i) Karakteristikat e Tregut

1. Ndërmarrjet kanë më shumë gjasa të lidhin më shumë marrëveshje të fshehta, në tregjet të cilat janë transparente, të përqendruara, jo-komplekse dhe të qëndrueshme. Në këto lloj tregjesh, ndërmarrjet mund të arrijnë një mirëkuptim të përbashkët me kushtet e koordinimit, monitorimit me sukses dhe kundërveprimit ndaj devijimeve. Megjithatë, shkëmbimi i informacionit mund t'i mundësojë gjithashtu ndërmarrjeve arritjen e një marrëveshjeje të fshehtë në situata të tjera të tregut, ku ata nuk do të ishin në gjendje ta realizonin këtë, në mungesë të shkëmbimit të informacionit.

2. Marrëveshjet e fshehta ka më shumë propabilitet të lidhen në tregjet transparente. Transparenca mund ta lehtësojë lidhjen e marrëveshjeve e fshehta, duke u mundësuar ndërmarrjeve arritjen e një mirëkuptimi të përbashkët për sa i përket kushteve të koordinimit, dhe/ose duke rritur stabilitetin e brendshëm dhe të jashtëm të marrëveshjes së fshehtë. Shkëmbimi i informacionit mund të rrisë transparencën dhe kështu të rrit sigurinë rreth ndryshimeve strategjike të konkurrencës (për shembull, çmimet, prodhimi, kërkesa, kostot etj.) Sa më i ulët të jetë niveli i transparencës në treg, aq më i vlefshëm është shkëmbimi i informacionit për arritjen e një marrëveshjeje të fshehtë. Shkëmbimi i informacionit që ndikon më pak mbi transparencën në një treg, ka më pak të ngjarë të ketë efekte kufizuese për konkurrencën, se sa një shkëmbim informacioni që rrit ndjeshëm transparencën. Prandaj, është kombinimi i këtyre të dyjave, i nivelit të transparencës dhe mënyra si ndryshon niveli i transparencës nga ky shkëmbim informacioni, që do të përcaktojnë mundësinë që shkëmbimi i informacionit të ketë efekte kufizuese për konkurrencën. Shkalla e transparencës, ndërmjet të tjerash, varet

nga numri i pjesëmarrësve të tregut dhe natyra e transaksioneve, të cilat variojnë nga transaksionet publike te negociatat konfidenciale dypalëshe midis blerësit dhe shitësit. Kur vlerësohet ndryshimi në nivelin e transparencës në treg, elementi kyç është identifikimi deri në çfarë mase mund të përdoren nga ndërmarrjet, informacioni i vënë në dispozicion, për të përcaktuar veprimet e konkurrentëve të tyre.

3. Oligopolet (e ngushta) lehtësojnë krijimin e marrëveshjeve të fshehta në treg, sepse është më e lehtë arritja e një mirëkuptimi të përbashkët midis një numri më të vogël ndërmarrjesh (në aspektin e koordinimit dhe monitorimit të sjelljeve). Një marrëveshje e fshehtë me më pak ndërmarrje pjesëmarrëse, ka më shumë gjasa të jetë e qëndrueshme. Sa më shumë ndërmarrje të koordinohen, aq më shumë përfitime vijnë nga devijimi sepse pjesët e mëdha të tregut mund të fitohen duke shitur me çmime të ulëta. Në të njëjtën kohë, përfitimet nga marrëveshjet e fshehta janë më të vogla, sepse sa më i madh të jetë numri i ndërmarrjeve të cilat marrin pjesë në marrëveshje, aq më shumë bien përfitimet nga kjo marrëveshje. Shkëmbimet e informacionit në oligopolet e ngushta ka më shumë të ngjarë të shkaktojnë efekte kufizuese për konkurrencën sesa në oligopolet e gjëra, dhe nuk shkaktojnë efekte të tilla kufizuese për konkurrencën në tregjet e shumë fragmentuara.

4. Ndërmarrjet mund ta kenë më të vështirë të lidhin një marrëveshje të fshehtë në një mjedis tregu kompleks. Megjithatë, përdorimi i shkëmbimit të informacionit mund t'i thjeshtojë këtë situatë, deri në një farë mase. Në një mjedis tregu kompleks, është normal dhe i nevojshëm shkëmbimi i sa më shumë informacioneve për të arritur një mirëkuptim të përbashkët mbi koordinimin dhe për të monitoruar devijimet. Për shembull, është më e lehtë të arrihet një marrëveshje e fshehtë për çmimin e një produkti të vetëm, homogjen, sesa për shumë çmime në një treg ku ka shumëllojshmëri produktesh. Megjithatë, është e mundur që të shmangen vështirësitë që lidhen me arritjen e një marrëveshje të fshehtë, mbi një numër të madh çmimesh.

5. Marrëveshjet e fshehta krijohen më shumë atëherë kur kërkesa dhe kushtet e furnizimit janë relativisht të qëndrueshme. Në një mjedis të paqëndrueshëm mund të jetë e vështirë që një ndërmarrje të dijë nëse shitjet e saj kanë rënë për shkak të nivelit të përgjithshëm të rënies së kërkesës apo për shkak të çmimeve të ulëta nga ana e konkurrentit. Për këtë arsye është e vështirë të fshehësh rezultatet e një marrëveshjeje të fshehtë. Në këtë kontekst, kërkesat e paqëndrueshme, zhvillimi domethënës i disa ndërmarrjeve në treg, ose hyrja e shpeshtë në treg e ndërmarrjeve të reja, mund të tregojnë se situata aktuale nuk është mjaft e qëndrueshme për t'u arritur një koordinim i tillë. Shkëmbimi i informacionit në situata të caktuara mund t'i shërbejë qëllimit për rritjen e stabilitetit në treg, dhe në këtë mënyrë mundëson krijimin e një marrëveshjeje të fshehtë në treg. Për më tepër, në tregjet ku risitë janë të rëndësishme, koordinimi mund të jetë më i vështirë duke qenë se, risitë veçanërisht domethënëse, bëjnë që një ndërmarrje të fitojë një avantazh të madh mbi konkurrentët e saj. Që një marrëveshje e fshehtë të

jetë e qëndrueshme, reagimet nga jashtë, si nga konkurrentët aktual dhe ata potencialë që nuk janë pjesë e koordinimit si dhe konsumatorët, nuk janë të aftë të ndikojnë në rezultatin e pritur nga marrëveshja e fshehtë. Në këtë kontekst, ekzistenca e pengesave të hyrjes në treg bën që të ketë më shumë të ngjarë, që një marrëveshje e fshehtë në treg të jetë e realizueshme dhe e qëndrueshme.

6. Kur ndërmarrjet janë simetrike /homogjene për sa i përket kostove të tyre, kërkesës, pjesës së tregut, gamës së produkteve, kapacitetet etj, ka më shumë të ngjarë për të arritur një mirëkuptim të përbashkët mbi kushtet e koordinimit, sepse qëllimet e tyre janë më të ngjashme. Megjithatë, në disa situata, shkëmbimi i informacionit mund të lejojë gjithashtu krijimin e marrëveshjeve të fshehta në struktura më heterogjene të tregut. Shkëmbimi i informacionit, i bën të vetëdijshme ndërmarrjet për ndryshimet midis tyre dhe i ndihmon ato që të gjejnë mjetet për të rënë dakord mbi kushtet e koordinimit.

7. Marrëveshjet e fshehta ka më shumë të ngjarë të krijohen midis ndërmarrjeve që do të vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet në të njëjtin treg për një kohë të gjatë, sepse në kushte të tilla ato do të jenë më të prirura për t'u koordinuar. Nëse një ndërmarrje e di që do të ndërveprojë me të tjerat për një kohë të gjatë, ajo do të ketë një nxitje më të madhe për t'u bërë pjesë e një marrëveshje të fshehte, sepse rrjedha e përfitimeve të ardhshme nga marrëveshja e fshehte do të jetë më me leverdi se fitimi afatshkurtër që mund të ketë nëse devijon, që do të thotë, para se ndërmarrjet e tjera të zbulojnë devijimin dhe të kundërveprojnë.

(ii) Karakteristikat e shkëmbimit të informacionit

Informacioni i rëndësishëm/strategjik

Shkëmbimi i të dhënave strategjike mes konkurrentësh, që do të thotë, të dhëna që reduktojnë pasigurinë strategjike në treg, ka më shumë të ngjarë të jenë objekt i nenit 4 se sa shkëmbimet e llojeve të tjera të informacionit. Shkëmbimi i të dhënave strategjike mund të sjellë rritje të efekteve kufizuese për konkurrencën, sepse ajo redukton pavarësinë vendim-marrëse të palëve, duke ulur nxitjen e tyre për të konkurruar. Informacioni strategjik mund të jetë i lidhur me çmimet (për shembull, çmimet reale, uljet, rritjet, reduktimet ose kompensimet), listën e konsumatorit, koston e prodhimit, sasitë, të ardhurat, shitjet, kapacitetet, cilësia, planet e marketingut, rreziqet, investimet, teknologjitë dhe programet e K & ZH dhe rezultatet e tyre. Në përgjithësi, informacioni në lidhje me çmimet dhe sasitë është më i rëndësishëm, pasuar nga informacioni në lidhje me kostot dhe kërkesën. Megjithatë, në qoftë se ndërmarrjet konkurrojnë në lidhje me K & ZH, të dhënat teknologjike janë më të rëndësishme për konkurrencën. Domosdoshmëria për të dhënat e rëndësishme varet edhe nga mbledhja dhe vjetërsia e tyre, si dhe konteksti i tregut dhe shpeshësia e shkëmbimit.

Mbulimi i tregut

1. Që një shkëmbim informacion të ketë efekte kufizuese për konkurrencën, ndërmarrjet e përfshira në shkëmbim, duhet të zënë një pjesë mjaft të madhe të tregut përkatës. Përndryshe, konkurrentët që nuk marrin pjesë në shkëmbimin e informacionit, mund të kufizojnë sjelljen anti-konkurruese të ndërmarrjeve të përfshira. Për shembull, duke caktuar një çmim nën çmimin e rënë dakord nga ndërmarrjet, ndërmarrjet që nuk kanë lidhje me këtë koordinim mund të kërcënojnë stabilitetin e jashtëm të një marrëveshje të fshehte.

2. Ajo që do të përbënte një “pjesë të tregut mjaftueshëmrisht të madhe” do të varet nga faktet e veçanta rast pas rasti dhe lloji i informacionit të shkëmbyer në këtë rast.

Te dhënat individuale dhe te përbashkëta (mbledhura)

Shkëmbimi i të dhënave të përbashkëta (te grumbulluara) origjinale, që do të thotë, ku njohja e nivelit të informacionit të kompanisë së individualizuar është mjaft i vështirë, ka shumë më pak të ngjarë të çojë në efekte kufizuese për konkurrencën se shkëmbimet e të dhënave në nivel të kompanisë. Mbledhja dhe publikimi i të dhënave të grumbulluara të tregut (të tilla si të dhënat e shitjes, të dhënat mbi kapacitetet apo të dhëna mbi kostot e imputeve dhe komponentët) nga një organizatë tregtare apo bashkimi me zgjuars i tregut mund të sjellë përfitim nga ana e furnizuesit dhe konsumatorit duke i lejuar të marrin një pasqyrë më të qartë ekonomike të gjendjes të një sektori. Një mbledhje e tillë e të dhënave dhe publikimi mund të lejojë pjesëmarrësit e tregut për të bërë zgjedhje individuale në mënyrë më të mirë-informuar për të përshtatur me efikasitet strategjinë e tyre për kushtet e tregut. Përgjithësisht, përveç rasteve kur ajo zhvillohet në një oligopol të ngushtë, shkëmbimi i të dhënave të grumbulluara ka gjasa të sjellë efekte kufizuese për konkurrencën. Në anën tjetër, shkëmbimi i të dhënave individuale lehtëson një mirëkuptim të përbashkët në treg dhe strategjitë e ndëshkimit duke i lejuar kompanitë koordinuese të veçojnë një anëtar të ri apo nje që devijon. Megjithatë, nuk mund të përjashtohet mundësia se edhe shkëmbimi i të dhënave të grumbulluara mund të lehtësojë një marrëveshje të fshehtë në tregjet me karakteristika të veçanta. Domethënë, anëtarët e një oligopoli shumë të ngushtë dhe të qëndrueshëm mbledhin të të cilat zbulojnë çmimin e tregut nën një nivel të caktuar automatikisht mund të supozojmë se dikush ka devijuar nga marrëveshja e fshehtë dhe të marrin masa të rrepta hakmarrëse në treg. Me fjalë të tjera, për të mbajtur të qëndrueshme një marrëveshje të fshehtë, kompanitë nuk duhet të dinë gjithmonë kush devijoi, mjafton informacioni i thjeshtë se “dikush” ka devijuar.

Vjetërsia e të dhënave/Të dhënat historike

Shkëmbimi i informacionit historik nuk të çon në marrëveshje të fshehta ashtu si nuk ka gjasa të jetë tregues i sjelljes së konkurrentëve në të ardhmen apo të sigurojë një mirëkuptim të përbashkët në treg. Për më tepër, shkëmbimi i të dhënave historike nuk lehtëson monitorimin e devijimeve sepse sa më të vjetra të dhënat, aq më pak i dobishëm do të jetë zbulimi në kohë i devijimeve. Nuk ka prag të paracaktuar kur të dhënat konsiderohen historike, që do të thotë, duhet të jenë aq të vjetra sa të mos paraqesin rreziqe për konkurrencën. Vjetërsia e të dhënave varet nga karakteristikat specifike të tregut përkatës dhe në veçanti nga frekuenca e çmimit të ri-negociatave në industri. Për shembull, të dhënat mund të konsiderohen si historike në qoftë se janë disa herë më të vjetra se gjatësia mesatare e kontratave në industri, nëse këto të fundit janë një tregues i çmimit të ri-negociatave. Për më tepër, pragu kur të dhënat bëhen historike, varet nga natyra e të dhënave, grumbullimi, shpeshtësia e shkëmbimit, dhe karakteristikat e tregut përkatës (për shembull, stabiliteti i tij dhe transparenca).

Shpejtësia/frekuenca e shkëmbimit të informacionit

Shkëmbimet e shpeshta të informacionit rrisin rrezikun e krijimit të një marrëveshje të fshehtë. Në tregjet më të paqëndrueshme, mund të jetë më i nevojshëm shkëmbimi më i shpeshtë i informacionit, për të lehtësuar një marrëveshje të fshehtë sesa në tregjet e qëndrueshme. Në tregjet me kontrata afatgjata (të cilat janë tregues të ri-negociatave jo të shpeshta të çmimit) një shkëmbim më i rrallë i informacionit, normalisht është i mjaftueshëm për të arritur një marrëveshje të fshehtë. Në të kundërt, shkëmbimet e rralla të informacionit, nuk do të jenë të mjaftueshme për të arritur një marrëveshje të fshehtë, në tregjet me kontrata afatshkurtra mbi ri-negociatat e shpeshta për çmimin.

Informacioni publik/jo-publik

1. Në përgjithësi, shkëmbimi i informacionit të mirëfilltë publik nuk ka të ngjarë të përbëjë shkelje të nenit 4. Informacioni publik është informacioni që përgjithësisht është i (aksesueshëm) në mënyrë të barabartë për të gjithë konkurrentët dhe konsumatorët. Që një informacion të konsiderohet publik, marrja e tij nuk duhet të jetë më e kushtueshme për konsumatorët apo ndërmarrjet që nuk i përkasin sistemit të shkëmbimit të informacionit, sesa për ndërmarrjet që janë pjesë e këtij sistemi. Për këtë arsye, konkurrentët normalisht nuk do të zgjedhin që të shkëmbejnë të dhëna që mund të mblidhen lehtësisht nga tregu, dhe kështu nuk është e mundur praktika e shkëmbimeve të të dhënave publike. Në të kundërt, edhe në qoftë se të dhënat e shkëmbyera ndërmjet konkurrentëve të përmendura shpesh si “të dhëna publike”, nuk janë me të vërtetë

publike, nëse shpenzimet që nevojiten për mbledhjen e këtyre të dhënave, pengojnë ndërmarrjet e tjera dhe klientët për të bërë të njëjtën gjë.

Shkëmbimi publik/jo-publik i informacionit

Një shkëmbim informacioni është publik nëse ai bën që të dhënat e shkëmbyera të jenë një-trajtshmërisht të aksesueshme (për sa i përket shpenzimeve që nevojiten për të aksesuar informacionin) për të gjithë konkurrentët dhe konsumatorët. Nuk përjashtohet mundësia që edhe një shkëmbim publik informacionit çon në një marrëveshjet të fshehtë ne treg.

2.3. Vlerësimi sipas Nenit 5 dhe 6

2.3.1. Përfitime nga efica

1. Shkëmbimi i informacionit mund të sjellë efica. Informacioni në lidhje me kostot e konkurrentëve, i mundëson ndërmarrjet të jenë më efica, nëse vendosin performancën e tyre kundrejt praktikave më të mira në treg dhe hartojnë skema nxitëse të brendshme në përputhje me rrethanat e tregut.

2. Për më tepër, në situata të caktuara, shkëmbimi i informacionit mund të ndihmojë ndërmarrjet të shpërndajnë prodhimin në drejtim të kërkesës së lartë të tregut (për shembull, informacion rreth kërkesës) ose e shpërndajnë prodhimin ashtu si veprojnë ndërmarrjet me kosto të ulët (për shembull informacion rreth koston). Këto lloj efica varen nga karakteristikat e tregut, p.sh. nëse ndërmarrjet konkurrojnë për nga çmimi apo sasi dhe natyra e pasigurive në treg. Disa forma të shkëmbimeve të informacionit në këtë kontekst mund të lejojnë zvogëlim të konsiderueshëm të koston, si për shembull, mundësojnë ofrimin më të shpejtë të produkteve që prishen, në zonat me kërkesë të lartë dhe reduktimin e tyre në zonat me kërkesë të ulët (shih Shembullin 6).

3. Shkëmbimi i të dhënave midis ndërmarrjeve të konsumit, në tregjet me informacion asimetrik në lidhje me konsumatorët gjithashtu mund të sjellë rritje të efica. Për shembull, mbajtja në vëzhgim, e sjelljes së kaluar të konsumatorëve ofron një nxitje për të kufizuar ekspozimin e tyre ndaj rrezikut.

4. Shkëmbimi i të dhënave të kaluara dhe aktuale që lidhen me pjesët e tregut, mundet që në disa situata të sigurojnë përfitime si për ndërmarrjet ashtu edhe për konsumatorët, duke i lejuar ndërmarrjet që ta deklarojnë atë si një tregues të cilësisë së produktit të tyre për konsumatorët. Kur informacioni në lidhje me cilësinë e produktit nuk është i plotë, konsumatorët shpesh përdorin mjete të tërthorta për të marrë informacion mbi cilësitë e produkteve të tilla si p.sh çmimi dhe pjesët e tregut (për shembull, konsumatorët përdorin listat e librave më të shitur në mënyrë që të zgjedhin librin e tyre të ardhshëm).

5. Konsumatorët gjithashtu mund të përfitojnë nga shkëmbimi i informacionit që është publik, duke i ndihmuar ata për të bërë një zgjedhje më të mirë . Konsumatorët mund të përfitojnë në këtë mënyrë nga shkëmbimet publike të të dhënave aktuale. Në mënyrë të ngjashme, shkëmbim i informacionit publik rreth çmimit të lëndëve të para, mund të ulë kostot e kërkimit për ndërmarrjet, dhe sjell çmime më të ulëta.

6. Shkëmbimi i të dhënave aktuale dhe të kaluara ka më shumë mundësi të sjellë efikasitet sesa shkëmbimi i informacionit në lidhje me synimet e ardhshme. .

2.3.2. Domosdoshmëria

1. Kufizimet që shkojnë përtej asaj që është e nevojshme për të arritur efikasitet që vijnë nga një shkëmbim informacioni, nuk i plotësojnë kushtet e nenit 5 dhe 6.

2. Shkëmbimi i informacionit që është pjesë e marrëveshjes horizontale të bashkëpunimit, ka gjithashtu më shumë gjasa për të përmbushur kushtet e neneve 5 dhe 6, nëse ky shkëmbim nuk tejkalon çka është e domosdoshme për zbatimin e qëllimit ekonomik të marrëveshjes (për shembull, ndarjen e teknologjisë së nevojshme për një marrëveshje të K & ZH apo të dhënave të kostos në kontekstin e një marrëveshjeje të prodhimit).

2.3.3. Kalimi tek konsumatori

Efienca e arritur nga kufizimet e domosdoshme duhet të kalojë tek konsumatorët në një masë më të madhe sesa efektet kufizuese mbi konkurrencën, si rrjedhojë e shkëmbimit të informacionit.

2.3.4. Nuk ka eliminim të konkurrencës

104. Kriteret e neneve 5 dhe 6, nuk plotësohen nëse ndërmarrjet e përfshira në shkëmbimin e informacionit, kanë mundësinë që të eliminojnë konkurrencën, në një pjesë domethënëse të produkteve në fjalë.

3. Marrëveshjet e Kërkimit dhe Zhvillimit

3.1. Përkufizimi

Marrëveshjet e Kërkimit dhe Zhvillimit ndryshojnë nga forma dhe qëllimi. Ka marrëveshje K & ZH me aktivitete të caktuara që synojnë përmirësimin e përbashkët të teknologjive ekzistuese dhe bashkëpunimin në lidhje me kërkimin shkencor, zhvillimin dhe hedhjen në treg të produkteve krejtësisht të reja. Gjithashtu, ato mund të marrin formën e një marrëveshjeje bashkëpunimi ose të një ndërmarrjeje me kontroll të përbashkët. Ky Kapitull zbatohet për të gjitha format e marrëveshjeve të K& ZH, duke

përfshirë marrëveshjet e lidhura që kanë të bëjnë me prodhimin ose tregtimin e rezultateve të K & ZH.

3.2. Tregjet përkatëse

Për të përcaktuar tregun përkatës në rastin e një marrëveshjeje K & ZH, i rëndësishëm është identifikimi i produkteve, teknologjive apo përpjekjeve të K & ZH . Risi mund të sjellë një produkt (ose teknologji) e cila konkurren me një produkt ekzistues (ose teknologji) të tregut. Ky është rasti me K & ZH të drejtuar drejt përmirësimeve të vogla apo shumëllojshmërisë, si p.sh modele të reja të produkteve të caktuara. Këtu, efektet e mundshme kanë të bëjnë me tregun e produkteve ekzistuese. Gjithashtu, risi mund të sjellë një produkt krejtësisht i ri, i cili krijon tregun e vet të ri të produktit (për shembull, një vaksinë e re për një sëmundje që më parë ka qenë e pashërueshme). Megjithatë, ka problematika midis këtyre të dyjave, që do të thotë, situata në të cilat përpjekjet për të sjellë risi mund të krijojnë produkte (ose teknologji), të cilat, me kalimin e kohës, zëvendësojnë ato ekzistuese (për shembull, CD-të të cilat kanë zëvendësuar mbajtjen e shënimeve).

Tregjet ekzistuese të produktit

1. Kur bashkëpunimi ka të bëjë me K & ZH për përmirësimin e produkteve ekzistuese, produktet ekzistuese dhe zëvendësuesit e tyre të afërt, përbëjnë tregun lidhur me këtë bashkëpunim.

2. Nëse përpjekjet për K & ZH synojnë një ndryshim të rëndësishëm të produkteve ekzistuese apo edhe të një produkt të ri, që zëvendëson një produkt ekzistues, zëvendësimi me produktet ekzistuese mund të mos jetë i përsosur apo mund të kërkojë një periudhë më afatgjatë. Produktet e vjetra dhe të reja potencialisht nuk i përkasin të njëjtë treg përkatës. Tregu për produktet ekzistuese, gjithsesi mund të ndikohet, nëse përpjekjet për një bashkim për K & ZH ka të ngjarë të çojnë në një koordinim të e sjelljes së palëve si, për furnizuesit e produkteve ekzistuese, për shembull për shkak të shkëmbimit të informacionit të ndjeshëm konkurrues në lidhje me tregun e produkteve ekzistuese.

3. Nëse marrëveshja për K & Zh, ka të bëjë me një element të rëndësishëm të produktit përfundimtar, është i rëndësishëm vlerësimi jo vetëm për tregun e këtij elementi por edhe tregu i produktit përfundimtar. Për shembull, nëse prodhuesit e makinave bashkëveprojnë në K & ZH lidhur me një lloj të ri motori, tregu i makinave mund të ndikohet nga kjo marrëveshje bashkëpunimi K & ZH. Tregu për produktet përfundimtare, megjithatë, është i rëndësishëm për vlerësimin vetëm nëse përbërësi që ka pasur për qëllim marrëveshja e bashkëpunimit të i K & ZH është teknikisht apo ekonomikisht një element thelbësor për prodhimin e këtyre produkteve përfundimtare dhe nëse palët në marrëveshjen e K & ZH kane fuqi tregu në lidhje me këto produkte .

Tregjet ekzistuese teknologjike

1. Marrëveshjet e Bashkëpunimit të K & ZH nuk kanë të bëjnë vetëm me produktet, por edhe me teknologjinë. Kur të drejtat e pronësisë intelektuale tregtohen veçmas nga produktet me të cilat kanë të bëjnë, tregu teknologjik përkatës duhet të jetë gjithashtu i përcaktuar. Tregjet Teknologjike përbëhen nga pronësi intelektuale të licencuara dhe zëvendësuesit e tyre të ngushtë, që do të thotë, teknologji të tjera të cilat konsumatorët mund t'i përdorin si zëvendësues.
2. Metodologjia për përcaktimin e tregjeve të teknologjisë ndjek të njëjtat parime si tregu i përcaktuar i produktit.
3. Pozicioni i palëve në treg për teknologjinë ekzistuese, është një kriter i rëndësishëm vlerësimi, kur marrëveshjet e bashkëpunimit të K & ZH lidhen për një përmirësim të konsiderueshëm të një teknologjie ekzistuese ose një teknologji të re që mund të zëvendësojë një teknologji ekzistuese. Në tregjet e teknologjisë, theks i veçantë duhet të vendoset në konkurrencën potenciale. Nëse ndërmarrjet të cilat aktualisht nuk licencojnë teknologjitë e tyre dhe janë hyrës potencial në tregun e teknologjisë, mund të kufizojnë aftësinë e palëve për të rritur çmimin për teknologjinë e tyre.

Konkurrenca në lidhje me risitë (përpyjekjet e K & ZH)

1. Marrëveshjet e Bashkëpunimit të K& ZH mund të ndikojnë jo vetëm në konkurrencën në tregjet ekzistuese, por edhe në konkurrencën e tregjeve me risi dhe tregjet e produkteve të reja. Ky është rasti kur bashkëpunimi K & ZH ka të bëjë me zhvillimin e produkteve ose teknologjive të reja, të cilat mundet që një ditë të zëvendësojnë ato ekzistuese, apo të cilat janë duke u krijuar me qëllim për një përdorim tjetër të ri, dhe si të tilla nuk do të zëvendësojnë produktet ekzistuese, por do të krijojnë një kërkesë krejtësisht të re. Efektet mbi konkurrencën në risi janë të rëndësishme në këto situata, por në disa raste nuk mund të vlerësohen mjaftueshëm duke analizuar konkurrencën aktuale ose potenciale të produktit ekzistues/të tregjeve të teknologjisë. Në këtë drejtim, mund të jenë dy raste, në varësi të natyrës së procesit të risive në një industri të caktuar.
2. Në rastin e parë, i cili është, për shembull, i pranishëm në industrinë farmaceutike, procesi i risive është strukturuar në mënyrë të tillë që bën të mundur identifikimin në një fazë të hershme të kaheve të konkurrenteve të K & ZH . Aspektet që duhet të merren parasysh janë: natyra, fushëveprimi dhe madhësia e përpjekjeve të K & ZH, qasja e tyre ndaj burimeve financiare dhe njerëzore, (knoë-hoë/patents), apo asete tjera të specializuara si dhe koha e tyre dhe aftësitë për të shfrytëzuar rezultatet e mundshme.
3. Përveç efektit të drejtpërdrejtë mbi vetë risitë, bashkëpunimi mund të ndikojë edhe në tregun e një produkti të ri. Është e vështirë që të analizohen pasojat në një treg

të tillë i cili nga vetë natyra e tij, ende nuk ekziston. Analiza e tregjeve të tilla, do të përfshihet shpesh në mënyrë direkte në analizën e konkurrencës në risi. Megjithatë, mund të jetë e nevojshme marrja në konsideratë e efekteve direkte në një treg të tillë të aspekteve të marrëveshjes që shkojnë përtej fazës së K & ZH. Një marrëveshje K & ZH që përfshin prodhimin dhe tregtimin e përbashkët në tregun e produktit të ri mundet, për shembull, të vlerësohet ndryshe nga një marrëveshje e pastër K & ZH.

4. Në rastin e dytë, përpjekjet inovative në një industri nuk janë të strukturuar në mënyrë të qartë në mënyrë që të lejojnë identifikimin e K & ZH. Në këtë situatë, Autoriteti nuk do të përpiqet të vlerësojë ndikimin e një bashkëpunimi të caktuar K & ZH për risi, por do të kufizonte vlerësimin e tij për produktin ekzistues dhe / ose tregjet e teknologjisë të cilat janë të lidhura me bashkëpunimin e K& ZH në fjalë.

Llogaritja e pjesëve të tregut

1. Llogaritja e pjesëve të tregut, duhet të reflektojë dallimin midis tregjeve ekzistuese dhe tregut pas risive. Në fillim të një bashkëpunimi K & ZH pikë referimi është tregu ekzistues për produktet të afta të përmirësohen, të zëvendësuar ose që do të zëvendësohen nga produktet nën zhvillim. Nëse marrëveshja K&ZH synon vetëm përmirësimin e produkteve ekzistuese, tregu përfshin produktet e ndikuara drejtpërdrejt nga K & ZH. Pjesët e tregut mund të llogariten në bazë të vlerës së shitjes së produkteve ekzistuese.

2. Nëse synimi i K & ZH është zëvendësimi i një produkti ekzistues, produkt i ri, në qoftë se është i suksesshëm, do të bëhet zëvendësues për produktet ekzistuese. Në bazë të Rregullores së K& ZH, pjesa e tregut nuk mund të tejkalojë 25% .

3. Për tregjet teknologjike, një mënyrë procedimi është të llogariten pjesët e tregut në bazë të pjesës së çdo pjese teknologjike të të ardhurave totale, që përfaqësojnë pjesën teknologjike të tregut ku teknologjitë konkurruese janë të licencuara. Një qasje alternative është llogaritja e pjesëve të tregut në tregun e teknologjisë në bazë të shitjes së produkteve apo shërbimeve që përfshijnë teknologjinë e licencuar në tregjet e produkteve në rrjedhën e poshtme. Sipas kësaj qasjeje të gjitha shitjet në tregun përkatës të produktit janë marrë parasysh, edhe kur produkti përfshin një teknologji që është duke u licencuar. Gjithashtu për këtë treg të ndarë, në zbatim të rregullores K&ZH nuk mund të tejkalohet norma 25% (pavarësisht nga metoda e llogaritjes së përdorur) .

4. Nëse marrëveshja e Kërkimit dhe zhvillimit ka për qëllim krijimin e një produkti, që do sjellë një kërkesë tërësisht të re në treg, nuk mund të llogariten pjesët e tregut të bazuara te shitjet, por kryhet vetëm një analizë mbi pasojat e marrëveshjes të konkurrencës. Rrjedhimisht, përjashtimi në bllok i marrëveshjeve K&ZH i trajton këto marrëveshje si marrëveshje mes jo-konkurrentëve dhe i përjashton ato, pavarësisht pjesës së tregut, për kohëzgjatjen e K&ZH së përbashkët dhe për një periudhë prej shtatë vitesh pas

hedhjes për herë të parë të produktit në treg. Megjithatë, vendimi për dhënien e përjashtimit mund të revokohet nëse marrëveshja ka eliminuar risitë në konkurrencën në treg. Pas periudhës shtatë vjeçare, mund të llogariten pjesët e tregut të bazuara në vlerën e shitjeve dhe të zbatohet pragu i pjesës së tregut prej 25%.

3.3. Vlerësimi në bazë të nenit 4 të Ligjit

3.3.1. Problematikat/shqetësimet kryesore mbi konkurrencën.

Bashkëpunimi për K&ZH mund ta kufizojë konkurrencën në mënyra të ndryshme.

- Së pari, mund të zvogëlojë ose ngadalësojë risitë, duke çuar në më pak produkte në treg ose produkte me cilësi më të ulët nga sa do të ndodhte në një situatë tjetër.
- Së dyti, në tregjet e produktit ose teknologjisë, bashkëpunimi K&ZH mund të zvogëlojë ndjeshëm konkurrencën mes palëve jashtë qëllimit të marrëveshjes ose mund të sjell koordinim jo-konkurrues duke çuar në çmime më të larta. Përjashtimi mund të shfaqet vetëm për sa i përket bashkëpunimit që përfshin të paktën një lojtar me një pjesë tregu të konsiderueshme (e cila nuk përbën domosdoshmërisht pozitë dominuese) për një teknologji kryesore dhe shfrytëzim ekskluziv të rezultateve.

3.3.2. Kufizimet e konkurrencës për nga objekti.

Marrëveshjet K&ZH kufizojnë konkurrencën nga objekti nëse në realitet nuk kanë të bëjnë me marrëveshje K&ZH, por shërbejnë si mjet për të lidhur një marrëveshje të fshehtë, që do të thotë, fiksimit i ndaluar i çmimeve, kufizim prodhimi apo ndarje tregu. Megjithatë, një marrëveshje K&ZH e cila përfshin shfrytëzimin e përbashkët të rezultateve të mundshme në të ardhmen, nuk kufizon domosdoshmërisht konkurrencën.

3.3.3. Efekte kufizuese mbi konkurrencën

1. Shumica e marrëveshjeve K&ZH nuk janë objekt i nenit 4 të Ligjit. Kjo mund të thuhet për shumë marrëveshje që kanë të bëjnë me bashkëpunimin mbi K&ZH në një fazë të hershme, ende larg shfrytëzimit të rezultateve të mundshme.
2. Për më tepër, bashkëpunimi K&ZH mes jo-konkurrentëve përgjithësisht nuk çon në kufizim të konkurrencës. Marrëdhëniet konkurruese mes palëve duhet të analizohet në kontekstin e tregjeve ekzistuese të ndikuara dhe/ose risive. Nëse, mbi bazën e faktorëve objektivë, palët nuk janë në gjendje të kryejnë K&ZH në mënyrë të pavarur, për shembull, për shkak të kapacitetit teknik të kufizuar të palëve, normalisht marrëveshja K&ZH nuk sjell kufizimin e konkurrencës në treg. Kjo mund të zbatohet, për shembull, për ndërmarrjet që bashkërisht kanë, aftësi plotësuese, teknologji dhe burime të tjera. Çështja e konkurrencës së mundshme duhet të vlerësohet mbi baza reale. Për shembull, palët

nuk mund të përkufizohen si konkurrentë të mundshëm thjesht sepse bashkëpunimi u mundëson atyre të kryejnë aktivitete K&ZH. Pyetja vendimtare është, nëse secila palë në mënyrë të pavarur ka mjetet e nevojshme për sa i përket aseteve/pasurive, njohurive know-how dhe burimeve të tjera.

3. K&ZH shpesh kryhet nga kompani të specializuara, institute kërkimore ose organe akademike, të cilat nuk janë aktive në shfrytëzimin e rezultateve. Normalisht, marrëveshje të tilla shoqërohen me një transferim të njohurive know-how dhe/apo një dispozitë furnizimi ekskluzive lidhur me rezultatet e mundshme, të cilat, për shkak të natyrës plotësuese të palëve në këtë rast, nuk çojnë në kufizim të konkurrencës .

4. Nuk është objekt i nenit 4 të ligjit, Bashkëpunimi K&ZH që nuk përfshin shfrytëzimin e përbashkët të rezultateve të mundshme me anë të licencimit, prodhimit dhe/ose marketingut, pasi nuk shkakton kufizim të konkurrencës. Këto marrëveshje të pastra K&ZH mund të sjellin probleme mbi konkurrencën, vetëm nëse konkurrenca në lidhje me risitë është zvogëluar ndjeshëm.

5. Marrëveshjet K&ZH mund të sjellin pasoja kufizuese për konkurrencën, vetëm kur palët në bashkëpunim kanë fuqi tregu në tregjet ekzistuese dhe/ose konkurrenca në lidhje me risitë është zvogëluar ndjeshëm.

6. Nuk ka asnjë prag absolut tregu mbi të cilin mund të supozohet se marrëveshja K&ZH krijon ose mundëson mbajtjen e fuqisë së tregut, duke shkaktuar kështu kufizim të konkurrencës. Gjithsesi marrëveshjet K&ZH mes konkurrentëve mbulohen nga rregullorja për përjashtimin në bllok të K&ZH, me kusht që pjesët e tregut të tyre të kombinuara mos të kaloje 25% dhe kushtet e tjera për zbatimin e rregullores për përjashtimin në bllok të K&ZH të jenë plotësuar.

7. Marrëveshjet që për shkak të kalimit të pjesës prej 25% të tregut, janë jashtë objektit të rregullores për përjashtimin në bllok të K&ZH, dhe jo domosdoshmërisht sjellin për pasojë kufizim të konkurrencës. Megjithatë, sa më e fortë të jetë pozita e kombinuar e palëve në tregjet ekzistuese dhe/ose sa më shumë të kufizohet konkurrenca në risi, aq më shumë ka të ngjarë që marrëveshja K&ZH të sjell kufizim të konkurrencës.

8. Nëse marrëveshjet K&ZH lidhen me synimin për të sjellë përmirësimin ose përsosjen e produkteve apo teknologjive ekzistuese, efektet e kësaj marrëveshjeje lidhen me tregun/tregjet përkatës/e për ato produkte apo teknologji ekzistuese. Efektet mbi çmimet, prodhimet, cilësinë e prodhimit, shumëllojshmërinë e produkteve ose risinë në tregjet ekzistuese janë gjithsesi, të mundshme vetëm nëse palët së bashku kanë një pozitë të fortë në treg, hyrja në treg është e vështirë dhe vetëm kur ka pak aktivitete të tjera të reja innovative/të risive. Për më tepër, nëse K&ZH ka të bëjë vetëm me një input/lëndë të parë relativisht të vogël të produktit përfundimtar, efektet mbi konkurrencën të ato produkte përfundimtare janë (nëse ka), shumë të kufizuara.

9. Në përgjithësi, duhet bërë një dallim mes marrëveshjeve të pastra K&ZH dhe atyre marrëveshjeve që ofrojnë bashkëpunim më të plotë dhe që përfshijnë disa faza të

ndryshme të shfrytëzimit të rezultateve (që do të thotë, licencimi, prodhimi ose tregtimi). Marrëveshjet e pastra K&ZH rrallë herë sjellin kufizime të konkurrencës sipas nenit 4 të ligjit. Kjo ka të bëjë kryesisht me ato marrëveshje të K&ZH që lidhen me përmirësimin e produkteve apo teknologjive ekzistuese. Kur marrëveshjet e bashkëpunimit K&ZH përfshijnë shfrytëzimin e përbashkët vetëm më anë të licencimit të palëve të treta, efektet kufizuese të tilla si përjashtimi kanë pak gjasa të ndodhin. Megjithatë, nëse prodhimi i përbashkët dhe/ose tregtimi i produkteve ose teknologjive pak të përmirësuar, janë të përfshira, efektet mbi konkurrencën nga ky bashkëpunim, duhen shqyrtuar me kujdes. Efektet kufizuese mbi konkurrencën në formën e rritjes së çmimeve ose uljet e prodhimit në tregjet ekzistuese, kanë më shumë gjasa të ndodhin nëse në këtë situatë janë të përfshirë konkurrente të fuqishëm.

10. Nëse marrëveshja e K&ZH është e drejtuar drejt prodhimit të një produkti krejtësisht i ri (ose teknologji) i cili krijon tregun e tij të ri, nuk ka ndikim tek çmimet dhe tek produktet e tjera në treg. Analiza duhet të fokusohet te kufizimet e mundshme që lidhen me risitë, për shembull, cilësia dhe shumëllojshmëria e produkteve, teknologjive të reja ose shpejtësia e risive. Këto efekte kufizuese mund të lindin kur dy ose më shumë nga ndërmarrjet e angazhuara në zhvillimin e këtyre produkteve të reja, fillojnë të bashkëpunojnë në një fazë ku ato janë të pavarura nga njëra tjetra, në momentin e hedhjes në treg të produktit. Zakonisht, efekte të tilla kufizuese janë rezultat i drejtpërdrejtë i një marrëveshje mes palëve. Risitë mund të kufizohen madje edhe nga një marrëveshje e pastër K&ZH. Bashkëpunimi K&ZH që ka të bëjë me një produkt tërësisht të ri, nuk ka gjasa të sjellë efekte të kufizimit të konkurrencës në treg, përveçse në rastet kur ekziston një numër i kufizuar i K&ZH alternative të besueshme.

11. Shume marrëveshje K&ZH sjellin pasoja mbi risitë dhe tregjet përkatëse. Rrjedhimisht, si tregu ekzistues, ashtu edhe ndikimi të risitë ka rëndësi për kryerjen e vlerësimit, në lidhje me pozicionet e kombinuara të palëve, raportet e përqendrimit, numrin e lojtareve ose inovatorëve dhe kushtet e hyrjes në treg. Në disa raste, efektet kufizuese për konkurrencën janë në formën e rritjes së çmimeve ose pakësim produktesh, cilësisë së produkteve, shumëllojshmërisë së tyre apo inovacioni në tregjet ekzistuese si dhe në formën e ndikimit negativ të risitë duke ngadalësuar zhvillimin. Për shembull, nëse konkurrentët e rëndësishëm në një treg ekzistues, bashkëpunojnë për të zhvilluar një teknologji të re, e cila mund të zëvendësojë në të ardhmen produkte ekzistuese, ai bashkëpunim mund të ngadalësojë zhvillimin e një teknologjie të re, nëse palët kanë fuqi tregu në tregun ekzistues dhe gjithashtu një pozite të fuqishme në lidhje me K&ZH. Një efekt i ngjashëm mund të ndodhë nëse një lojtar i madh në tregun ekzistues, bashkëpunon me një konkurrent shumë më të vogël ose edhe me një konkurrent potencial, i cili është gati të hedhë në treg një produkt apo teknologji të re, e cila mund të rrezikojë pozicionin e ekzistuesit në treg.

3.4. Vlerësimi sipas neneve 5 dhe 6 te ligjit

3.4.1. Përfitimet nga efica

Shumë marrëveshje K&ZH (me ose pa shfrytëzim të rezultateve të mundshme) sjellin efica nga kombinimi i aftësive plotësuese dhe aseteve, duke çuar kështu në zhvillimin dhe tregtimin e produkteve apo teknologjive të përmirësuar, më shpejt nga çdo të ndodhte në një rast tjetër. Marrëveshjet K&ZH mund të çojnë edhe në një shpërndarje më të gjerë të njohurive, të cilat mund të shkaktojnë risi të mëtejshme. Marrëveshjet K&ZH mund gjithashtu të çojnë në zvogëlim të kostos.

3.4.2. Domosdoshmëria

Kufizimet që tejkalojnë atë që është e nevojshme për të arritur efica e përfutur nga një marrëveshje K&ZH nuk plotësojnë kriteret e nenit 5 dhe 6. Prandaj është e nevojshme për palët në një marrëveshje K&ZH që të provojnë që kufizime të tilla janë të domosdoshme për arritjen e këtij bashkëpunimi.

3.4.3. Kalimi tek konsumatorët

Efica e përfutur nga kufizimet e domosdoshme, duhet të kalohet tek konsumatori, në atë masë që të tejkalojë efektet kufizuese të konkurrencës të shkaktuara nga marrëveshja K&ZH. Për shembull, prezantimi i një produkti të ri ose të përmirësuar në treg, duhet të tejkalojë çdo rritje çmimi ose efekt tjetër kufizues të konkurrencës. Në përgjithësi, ka më shumë gjasa që një marrëveshje K&ZH të sjellë efica në të mirë të konsumatorëve, nëse marrëveshja e K&ZH çon në një kombinim të aftësive plotësuese dhe aseteve. Palët në një marrëveshje, për shembull, kanë aftësi të ndryshme kërkimore. Sa më e lartë fuqia e tregut e palëve, aq më pak gjasa ka që ato të pasojnë/kalojnë efica e fituar te konsumatorët në atë masë që do tejkalonte efektet kufizuese të konkurrencës.

3.4.4. Nuk ka eliminim të konkurrencës

Nuk janë objekt i nenit 5 dhe 6 ato marrëveshje Kërkimi dhe Zhvillimi të cilat sjellin kufizime të konkurrencës në lidhje me një pjesë të rëndësishme të produkteve (apo teknologjive) në fjalë.

3.4.5. Koha e vlerësimit

1. Kur jepet përjashtimi duhet të merren parasysh investimet fillestare të bëra nga secila prej palëve (sunk investments) koha dhe kontrollet e nevojshme për të bërë dhe rikuperuar një investim që përmirëson efektshmërinë. Kjo pikë nuk mund të zbatohet pa marrë parasysh investime të tillë *ex ante*. Rreziku me të cilin përballen palët dhe investimi fillestar që bëhet, bën që marrëveshja të mos analizohet sipas nenit 4 të ligjit, apo të përmbushë kushtet e nenit 5 dhe 6 të ligjit, siç mund të jetë rasti i kohës që nevojitet për rikuperimin e investimit.

2. Vlerësimi I marrëveshjeve duhet bërë ekskluzivisht mbi bazën e fakteve që kanë të bëjnë me kohën e zbatimit. Për shembull, në rastin e një marrëveshje K&ZH ku secila palë bie dakord të braktisë projektin respektiv kërkimor dhe të bashkojë aftësitë e veta me ato të palës tjetër, mund të jetë teknikisht e pamundur, nga pikëpamja teknike dhe ekonomike, të rindërtojë një projekt që është braktisur njëherë. Vlerësimi i efekteve pro dhe anti konkurruese të marrëveshjes për të braktisur projektet kërkimore individuale duhet të bëhen në kohën e përfundimit të zbatimit të tij. Nëse në atë moment, marrëveshja është në përputhje me nenin 4, për shembull kur një numër i mjaftueshëm i palëve të treta kanë projekte K&ZH konkurruese, marrëveshja e palëve për të braktisur projektet e tyre individuale mbetet në përputhje me nenin 4, edhe kur në një moment të mëvonshëm, projekti i palës së tretë dështon. Megjithatë, ndalimi sipas nenit 4 mund të zbatohet te palët e tjera pjesë e marrëveshjes për të cilën çështja e pathyeshmërisë nuk qëndron. Nëse, për shembull, përveç K&ZH së përbashkët, marrëveshja ofron edhe shfrytëzim të përbashkët, neni 4 mund të zbatohet për atë pjesë të marrëveshjes, nëse, për shkak të zhvillimeve të mëvonshme të tregut, marrëveshja çon në efekte të kufizimit të konkurrencës dhe nuk plotëson kushtet e nenit 5 dhe 6 duke marrë parasysh investimet E pakthyeshme (sunk)

4. MARRËVESHJET E PRODHIMIT

4.1. Përkufizimi dhe qëllimi

1. Marrëveshjet e prodhimit ndryshojnë nga forma dhe qëllimi. Ato përcaktojnë nëse prodhimi është realizuar nga një pale e vetme, dy apo më shumë pale. Ndërmarrjet mund të prodhojnë bashkërisht nëpërmjet një sipërmarrjeje të përbashkët, që do të thotë, një ndërmarrje e kontrolluar bashkërisht që ushtron aktivitet në prodhimin e një ose disa produkteve ose nga forma bashkëpunimi në prodhim si marrëveshje nën-kontraktimi ku njëra palë “kontraktuesi” i beson prodhimin e një produkti një pale tjetër “nen-kontraktorit”.

2. Ka disa lloje marrëveshjesh nën-kontraktore. Marrëveshjet nën-kontraktore horizontale lidhen mes ndërmarrjeve që ushtrojnë aktivitet në të njëjtin treg produkti, pavarësisht faktit nëse janë ose jo konkurrentë potenciale. Marrëveshjet nën-kontraktore vertikale lidhen mes kompanive që ushtrojnë aktivitet në nivele të ndryshme të tregut.

3. Marrëveshjet nën-kontraktore horizontale përfshijnë marrëveshje specializimi të njëanshme dhe reciproke si dhe marrëveshjet nën-kontraktore që synojnë rritjen e prodhimit. Marrëveshjet e njëanshme të specializimit janë marrëveshje mes dy palëve, të cilat janë aktive në të njëjtin treg apo tregje prodhimi, ku njëra palë ndalon plotësisht apo pjesërisht prodhimin e disa produkteve ose nuk i prodhojë këto produkte por i'a blejë ato palës tjetër, e cila bie dakord të prodhojë e furnizojë me këtë produkt.

Marrëveshjet reciproke të specializimit, janë marrëveshje mes dy ose më shumë palëve, të cilat janë aktive në të njëjtin treg apo tregje prodhimi, ku dy ose më shumë palë bien dakord, mbi baza reciprociteti, që të ndalojnë ose të kufizojnë pjesërisht apo tërësisht prodhimin e produkteve të ndryshme dhe ti blejnë këto produkte nga palët e tjera, të cilat bien dakord për furnizimin e tyre. Në rastin e marrëveshjes nën-kontraktore me synim rritjet e prodhimit, kontraktuesi i beson nën-kontraktorit prodhimin e produktit, ndërsa kontraktuesi në të njëjtën kohë nuk kufizon apo ndalon prodhimin e këtij produkti.

4. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha format e marrëveshjeve të sipërmarrjeve të përbashkëta dhe marrëveshjeve nën-kontraktore horizontale.

5. Marrëveshjet nën-kontraktore vertikale nuk mbulohen nga këto rregullore. Ato mund të përfitojnë nga Rregullorja e përjashtimit në bllok të kufizimeve vertikale.

4.2. Tregjet përkatëse

1. Për të vlerësuar marrëdhënien konkurruese mes palëve në bashkëpunim, është e nevojshme fillimisht të përcaktojmë tregun ose tregjet përkatëse që kanë të bëjnë me bashkëpunimin në prodhim, që do të thotë, tregjet të cilave iu përkasin produktet e prodhuara, si pasojë e marrëveshjes së prodhimit.

2. Një marrëveshje prodhimi mund të ketë gjithashtu efekte të cilat ndikojnë në tregjet, që janë afër tregjeve që lidhen direkt me këtë bashkëpunim, p.sh me tregjet e rrjedhës së sipërme ose të poshtme të marrëveshjes.

4.3. Vlerësimi sipas nenit 4 të Ligjit

4.3.1. Shqetësimet kryesore të konkurrencës.

1. Marrëveshjet e prodhimit mund të çojnë të një kufizim të drejtpërdrejtë të konkurrencës mes palëve. Marrëveshjet e prodhimit, dhe në veçanti prodhimi i përbashkët, mund t'i çojë palët drejt vendosjes së një çmimi për produktet dhe për cilësinë, çmim më të cilin sipërmarrja e përbashkët shet produktet e veta (ose në vendosjen e parametra të tjerë të rëndësishëm të vlerësuar nga konkurrenca). Kjo mund të kufizojë konkurrencën edhe nëse palët i tregtojnë produktet në mënyrë të pavarur.

2. Marrëveshjet e prodhimit mund të çojnë në një koordinim të sjelljes së palëve konkurruese, që çon drejt çmimeve më të larta apo uljes së prodhimit, cilësisë së produktit, shumëllojshmërisë së tij dhe risive, që do të thotë, një marrëveshje e fshehtë. Kjo mund të ndodhë, kur palët që kanë fuqi tregu dhe vetë tregu ka karakteristika të tilla, të cilat çojnë drejt bashkëpunimit, në veçanti kur marrëveshja e prodhimit rrit koston variabël (e cila është e njëjtë për palët), ose nëse marrëveshja përfshin shkëmbimin e informacionit të ndjeshëm tregtar, që mund të çojë në marrëveshje të fshehtë.

3. Marrëveshja e prodhimit mundet të çojë drejt përjashtimit nga tregu të palëve të treta (për shembull, tregu i rrjedhës së poshtme që ka të bëjë me lëndët e para pjesë e të cilit është dhe marrëveshja). Për shembull, duke fituar mjaftueshmërisht fuqi tregu, palët pjesë e sipërmarrjes së përbashkët në tregun e rrjedhës së sipërme, kanë mundësi që të rrisin çmimin e një përbërësi thelbësor për tregun e rrjedhës së poshtme. Në këtë mënyrë, ata mund të përdorin prodhimin e përbashkët për të rritur kostot e rivalëve të tyre në tregun e rrjedhës së poshtme dhe rrjedhimisht t'i detyrojnë ata të dalin jashtë tregut. Kjo nga ana tjetër, do të rrisë fuqinë e palëve në tregun e rrjedhës së poshtme që do i mundësonte atyre të mbajnë çmimet mbi nivelin konkurrues ose e thënë ndryshe, të dëmtonin konsumatorin. Shqetësime të tilla të konkurrencës mund të vijnë pavarësisht nëse palët në marrëveshje janë konkurrentë në tregun në të cilin ndodh bashkëpunimi. Gjithsesi, duhet që të paktën njëra nga palët të ketë pozitë të fortë në tregun ku vlerësohet se ekziston një rrezik për përjashtim, me qëllim që ky lloj përjashtimi të ketë efekte anti-konkurruese.

4.3.2. Kufizime të konkurrencës për nga objekti

1. Përgjithësisht, marrëveshjet që përfshijnë fiksimin e çmimeve, kufizimin e prodhimit apo ndarjen e tregjeve apo të konsumatorëve, e kufizojnë konkurrencën për nga objekti. Megjithatë, në kontekstin e marrëveshjeve të prodhimit, kjo nuk zbatohet kur:

- palët bien dakord për prodhimin që lidhet drejtpërdrejtë me marrëveshjen e prodhimit (për shembull, volumn e prodhimit ose sasia e rënë dakord për produktet e kontraktuara), me kusht që kriteret e tjera të konkurrencës të mos jenë eliminuar; ose
- një marrëveshje prodhimi, që siguron shpërndarjen e përbashkët të produkteve të prodhuara bashkërisht, parashikon vendosjen e përbashkët të çmimeve të shitjes vetëm për këto produkte, me kusht që kufizimi të jetë i nevojshëm për prodhimin e përbashkët, që nënkupton se në të kundërt palët nuk do kishin nxitjen e nevojshme për të lidhur marrëveshjen e prodhimit.

2. Në këto dy raste, do të kryhet një vlerësim sipas nenit 4 të Ligjit. Në të dy rastet, marrëveshja mbi produktet apo çmimet nuk do të vlerësohet veçmas, por do të vlerësohet nga pikëpamja e të gjithë efekteve në treg, të marrëveshjes së prodhimit në tërësi.

4.3.3. Kufizimet e konkurrencës

1. Shqetësimet e mundshme për konkurrencën që vijnë si pasojë e lidhjes së një marrëveshje prodhimi, varen nga karakteristikat e tregut në të cilin është lidhur marrëveshja, si dhe nga natyra e bashkëpunimit dhe mbulimi i tregut si pasojë e këtij bashkëpunimi dhe produkti në fjalë.

2. Shqetësimet e mundshme për konkurrencën që vijnë si pasojë e lidhjes së një marrëveshje prodhimi, varen nga situata në mungesë të marrëveshjes bashkë me gjithë kufizimet që ajo sjell. Rrjedhimisht, nuk është e mundur të kufizojnë konkurrencën ato marrëveshje prodhimi të lidhura midis ndërmarrjeve që konkurrojnë në tregje, tek të cilat ndodh bashkëpunimi, nëse u mundëson palëve krijimin e një tregu të ri, që do të thotë, nëse marrëveshja u mundëson palëve hedhjen në treg të një produkti apo shërbimi të ri, të cilin palët s' do kishin mundësi në rast tjetër ta hidhnin në treg, (psh. për shkak të mundësive teknike të palëve).

3. Në industritë ku prodhimi është aktiviteti kryesor ekonomik, edhe një marrëveshje e pastër prodhimi mundet në vetvete të eliminojë konkurrencën .

4. Një marrëveshje prodhimi, çon në një marrëveshje të fshehtë ose në përjashtim jo-konkurrues nëse sjell rritjen e fuqisë së tregut të ndërmarrjeve apo kostot e përbashkëta, ose nëse përfshin shkëmbimin e informacionit të ndjeshëm (rëndësishëm). Nga ana tjetër, nuk është e mundur të ndodhë një kufizim i drejtpërdrejtë i konkurrencës mes palëve, marrëveshje e fshehtë apo përjashtim jo-konkurrues, kur palët nuk kanë fuqi tregu. Vetëm fuqia e tregut i mundëson palëve mbajtjen e çmimeve mbi nivelin konkurrues, ose të përfitojnë duke mbajtur më poshtë nga sa përcakton konkurrenca: sasinë e prodhimit, cilësinë apo shumëllojshmërinë.

5. Në rastin kur një ndërmarrje me fuqi tregu, bashkëpunon me një hyrës potencial në treg, për shembull, me një furnizues të të njëjtit produkt nga një treg fqinj gjeografik/ produkti, atëherë marrëveshja mund të rrisë ndjeshëm fuqinë e tregut të ndërmarrjes me fuqi tregu.

6. Marrëveshjet e prodhimit të cilat përfshijnë edhe funksione tregtare , si shpërndarje apo tregtim i përbashkët, rrezikojnë të kufizojnë më tepër konkurrencën sesa marrëveshjet për prodhim të përbashkët. Tregtimi i përbashkët e sjell bashkëpunimin më pranë konsumatorit dhe zakonisht përfshin vendosjen e përbashkët të çmimeve të shitjes, që do të thotë, praktika që mbartin rrezikun më të lartë për konkurrencën. Megjithatë, marrëveshjet për shpërndarjen e përbashkët për produkte që janë prodhuar bashkërisht, kanë më pak gjasa të kufizojnë konkurrencën, sesa vetë marrëveshjet për shpërndarjen e përbashkët. Gjithashtu, një marrëveshje për shpërndarje të përbashkët e cila nevojitet në mënyrë që të lidhet marrëveshja e prodhimit të përbashkët, ka më pak gjasa të kufizojë konkurrencën sesa në rastin kur s' do ishin të nevojshme për prodhimin e përbashkët.

Fuqia e tregut

1. Pikënisja e analizës për fuqinë e tregut është pjesa e tregut që palët zotërojnë. Kjo zakonisht shoqërohet me raportin e përqendrimit, numrin e subjekteve në treg dhe nga faktorë të tjerë si hyrja e mundshme në treg, dhe pjesët e tregut .

2. Ka pak gjasa që ndërmarrjet të kenë fuqi tregu nën një nivel të caktuar të pjesës së tregut. Ndaj, marrëveshjet e specializimit të njëanshme apo bilaterale, si dhe marrëveshjet e prodhimit të përbashkët që përfshijnë disa funksione të integruara tregtimi si për shembull, shpërndarjen e përbashkët, përfshihen në Rregulloren për përjashtimin në bllok të specializimeve
3. Përgjithësisht, një marrëveshje prodhimi, ka më shumë të ngjarë që të çojë në kufizim të konkurrencës në një treg të përqendruar, sesa në një treg që nuk është i përqendruar. Në mënyrë të ngjashme, një marrëveshje prodhimi në një treg të përqendruar mund të rrisë rrezikun e një marrëveshje të fshehtë edhe kur palët kanë pjesë tregu të kombinuar jo domethënëse.
4. Rreziqet e efekteve kufizuese të konkurrencës, janë të ulta kur tregu është dinamik (një treg që lejon hyrjet e reja dhe pozicionet në treg ndryshojnë shpesh), edhe nëse pjesa e tregut e palëve në marrëveshje dhe përqendrimi i tregut është i lartë.
5. Në analizën e fuqisë së tregut të palëve pjesë e marrëveshjes së prodhimit, rëndësi për vlerësimin merr numri dhe intensiteti i lidhjeve (për shembull, marrëveshje të tjera bashkëpunimi).
6. Faktorë të rëndësishëm për vlerësimin e konkurrencës në një marrëveshje janë: kur palët në marrëveshje kanë pjesë të konsiderueshme tregu; kur janë konkurrentë të afërt, kur konsumatorët kanë mundësi të kufizuara për të kaluar në furnizues alternative; kur konkurrentët e kanë të pamundur që të rrisin prodhimin nëse çmimet rriten, ose kur një nga palët në marrëveshje paraqet një forcë e rëndësishme konkurruese.
7. Konkurrenca mes palëve në një marrëveshje prodhimi mund të kufizohet drejtpërdrejtë në mënyra të ndryshme. Palët e një ndërmarrje të përbashkët prodhimi, munden për shembull, të kufizojnë prodhimin krahasuar me prodhimin që do kishin hedhur në treg palët, nëse secila prej tyre do kishte vendosur për prodhimin në mënyrë të pavarur.

Marrëveshjet e fshehta

1. Mundësitë për lidhjen e një marrëveshje të fshehtë varen nga fuqia në treg e palëve si dhe nga karakteristikat e tregut përkatës. Një marrëveshje e fshehtë mund të vijë si rezultat veçanërisht (por jo vetëm) i kostove të përbashkëta ose i një shkëmbimi informacioni të ardhur nga një marrëveshje prodhimi.
2. Një marrëveshje prodhimi mes palëve me fuqi tregu, çon në kufizim të konkurrencës nëse rrit kostot e përbashkëta, (që do të thotë, përqindja e kostove të ndryshueshme të përbashkëta për palët) në atë nivel që mundëson lidhjen e marrëveshjes së fshehtë.
3. Një marrëveshje prodhimi ka më tepër të ngjarë të çojë në një marrëveshje të fshehtë, nëse para lidhjes së marrëveshjes, palët kanë patur të përbashkët një përqindje të lartë të kostove të ndryshueshme, .

4. (communality of costs) Kostot e përbashkëta rrisin rrezikun për një marrëveshje të fshehtë, vetëm nëse kostot e prodhimit zënë një përqindje të lartë të kostove të ndryshueshme në fjalë. Për shembull, ky nuk është rasti kur bashkëpunimi ka të bëjë me produktet që kërkojnë tregtim të kushtueshëm.

5. Një tjetër rast ku kostot e përbashkëta çojnë në një marrëveshje të fshehtë, ndodh kur palët bien dakord mbi prodhimin e përbashkët të një produkti të ndërmjetëm, i cili është përgjegjës për një pjesë të madhe të kostove të ndryshueshme të produktit përfundimtar për të cilin konkurrojnë palët në tregun e rrjedhën e poshtme. Palët mund të përdorin marrëveshjen e prodhimit për të rritur çmimin e lëndës së parë kryesore për produktin e tyre të përbashkët në tregun e rrjedhës së poshtme. Kjo do e dobësonte konkurrencën në tregun e rrjedhës së poshtme dhe do të çonte në çmime përfundimtare më të larta. Përfitimi do të zhvendosej nga niveli i rrjedhës së poshtë te ai i rrjedhës së sipërme, për tu ndarë më tej mes palëve të ndërmarrjes së përbashkët.

6. Në mënyrë të ngjashme, kostot e përbashkëta rrisin rrezikun ant-konkurrues të një marrëveshjeje nën-kontraktore horizontale nëse lënda e parë e cila blihet nga kontraktori prej nën-kontraktorit zë një përqindje të lartë të kostove të ndryshueshme të produktit përfundimtar për të cilin konkurrojnë palët.

7. Efektet negative të ardhura si pasojë e shkëmbimit të informacionit nuk do të vlerësohen veçmas, por në këndvështrimin e gjithë efekteve të marrëveshjes. Një marrëveshje prodhimi mund të sjellë efekte kufizuese për konkurrencën nëse në të përfshihet shkëmbim informacioni tregtar strategjik që mund të çojë në lidhjen e një marrëveshjeje të fshehtë ose në një përjashtim ant-ikonkurrues.

8. Nëse shkëmbimi i informacionit nuk tejkalon shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për prodhimin e përbashkët të produkteve objekt i marrëveshjes së prodhimit, atëherë marrëveshja ka me tepër të ngjarë të plotësojnë kriteret e neneve 5 dhe 6 edhe në rastin kur shkëmbimi i informacionit kufizon konkurrencën në kuptim të nenit 4, sesa në rastin kur shkëmbimi i informacionit tejkalon atë çka është e nevojshme për prodhimin e përbashkët. Në këtë rast, efica si pasojë e prodhimit të përbashkët tejkalon efektet kufizuese që vijnë nga shkëmbimi i informacionit. Nga ana tjetër, në rastin e një marrëveshjeje prodhimi, shkëmbimi i informacionit që lidhet me çmimet dhe shitjet, ka më pak të ngjarë të plotësojë kushtet e neneve 5 dhe 6 të Ligjit.

4.4. Vlerësimi sipas neneve 5 dhe 6 të Ligjit

4.4.1. Përfitimet nga efica

Marrëveshjet e prodhimit mund të jenë pro-konkurruese nëse sjellin efica në formën e kursimeve në kosto apo në teknologji prodhimi më të mira. Duke prodhuar bashkërisht, ndërmarrjet ulin kostot, që në të kundërt do të rriteshin. Prodhimi i përbashkët ndihmon ndërmarrjet të përmirësojnë cilësinë e produktit nëse bashkojnë aftësitë e tyre plotësuese

dhe njohuritë know-how. Bashkëpunimi u mundëson ndërmarrjeve të rrisin shumëllojshmërinë e produkteve, gjë të cilën ato nuk do mund ta arrinin në rast tjetër. Nëse prodhimi i përbashkët u mundëson palëve rritjen e numrit të produkteve të ndryshme, kjo çon gjithashtu në kursim të kostot nëpërmjet ekonomisë të qëllimit.

4.4.2. Domosdoshmëria

Kufizimet që tejkalojnë atë çka është e nevojshme për të patur efikasitet, si rezultat i një marrëveshjeje prodhimi, nuk plotësojnë kushtet e nenëve 5 dhe 6 të Ligjit. Për shembull, nuk do të konsiderohet domosdoshmëri kufizimet e vendosura nga një marrëveshje prodhimi mbi sjelljen e palëve në këtë marrëveshje, në lidhje me prodhimin jashtë bashkëpunimit. Në mënyrë të ngjashme, vendosja bashkërisht e çmimeve nuk do konsiderohet domosdoshmëri, nëse marrëveshja e prodhimit nuk parashikon tregtimin e përbashkët.

4.4.3. Kalimi te konsumatori

Efienca e arritur nga kufizimet e domosdoshme duhet të kalojë te konsumatori në formën e çmimeve më të ulta, në produkte me cilësi më të lartë apo në rritje shumëllojshmërie, në atë masë që tejkalon efektet e kufizimit të konkurrencës. Efienca nga e cila përfitojnë vetëm palët, apo kursimet në kosto që shkaktohen nga ulja e prodhimit, apo ndarja e tregut janë elementë që nuk mjaftojnë për plotësimin e kushteve të përcaktuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit. Nëse palët në një marrëveshje prodhimi arrijnë të kursejnë nga kostot e tyre të ndryshueshme, ka më tepër gjasa t'i kalojnë ato te konsumatorët, sesa në rastin kur ulin kostot e tyre fikse. Për më tepër, sa më e madhe fuqia e tregut të palëve, më pak të ngjarë kanë të kalojnë efikasitetin te konsumatori në atë masë që tejkalon efektet kufizuese për konkurrencën.

4.4.4. Nuk ka eliminim të konkurrencës

Kushtet e caktuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit, nuk plotësohen nëse palët eliminojnë konkurrencën në lidhje me një pjesë thelbësore të produkteve në fjalë. Kjo duhet të analizohet në tregun përkatës të cilit i përketin produkte objekt bashkëpunimi dhe në tregjet fqinje.

5. MARRËVESHJET E BLERJES

5.1. Përkufizimi

1. Ky kapitull analizon marrëveshjet që kanë të bëjnë me blerjen e përbashkët të produkteve. Blerja e përbashkët mund të kryhet nga një ndërmarrje e kontrolluar bashkërisht, nga një ndërmarrje në të cilën shumë ndërmarrje të tjera kanë aksione jo-kontrolluese, nga një marrëveshje kontraktuale ose nga forma të tjera bashkëpunimi

(marrëveshje blerjesh të përbashkëta). Marrëveshjet e blerjeve të përbashkëta, zakonisht synojnë krijimin e fuqisë blerëse, e cila çon në çmime më të ulëta ose në produkte të një cilësie më të lartë për konsumatorin. Gjithsesi, fuqia blerëse, në situata të caktuara, kufizon konkurrencën.

2. Marrëveshjet e blerjeve të përbashkëta mund të përfshijnë si marrëveshjet horizontale, ashtu edhe ato vertikale.

3. Një formë e zakonshme e marrëveshjeve së blerjes së përbashkët është ‘bashkimi i ndërmarrjeve’/ndërmarrjet e përbashkëta, që do të thotë një grupim ndërmarrjesh i formuar nga një grup shitësish me pakicë për blerjen e përbashkët të produkteve. Marrëveshjet horizontale të lidhura mes anëtarëve të këtij bashkimi apo vendimet e marra nga ky bashkim, fillimisht duhet të vlerësohen si një marrëveshje horizontale bashkëpunimi sipas këtij udhëzimi. Vetëm në rastin kur nga ky vlerësim nuk rezulton ndonjë kufizim i konkurrencës, ka rendësi vlerësimi i marrëveshjeve vertikale përkatëse të lidhura mes bashkimit dhe një anëtar të saj pra mes bashkimit dhe furnizuesit. Ato marrëveshje përfshihen – nëse plotësojnë disa kushte- nga Rregullorja e përjashtimit në bllok për kufizimet Vertikale. Marrëveshjet vertikale të cilat nuk përfshihen nga Rregullorja e përjashtimit në bllok, nuk prezumohen si të paligjshme por për to nevojitet vlerësim individual rast pas rasti.

5.2. Tregjet përkatëse

1. Ekzistojnë dy tregje, të cilët preken nga marrëveshjet e blerjes së përbashkët.
 - Së pari, tregu ose tregjet me të cilin/cilët lidhet drejtpërdrejtë marrëveshja e blerjes së përbashkët, që do të thotë tregu apo tregjet përkatëse të blerjes.
 - Së dyti, tregu apo tregjet e shitjes, që do të thotë, tregu apo tregjet e rrjedhës së poshtme ku palët e marrëveshjes së përbashkët janë aktivë si shitës.
2. Përkufizimi i tregjeve përkatëse të blerjes bëhet sipas Udhëzimit “Për përcaktimin e tregut përkatës” si dhe bazohet në konceptin e zëvendësueshmërisë për të identifikuar kufizimet e konkurrencës. Ndryshimi i vetëm prej përkufizimit të “tregjeve të shitjes” është fakti që zëvendësueshmëria përcaktohet nga pikëpamja e furnizimit dhe jo nga kërkesa. Me fjalë të tjera, alternativat e furnizuesve janë vendimtare në identifikimin e kufizimeve të konkurrencës të blerjet. Ato alternativa mund të analizohen, për shembull, duke analizuar reagimin e furnizuesit ndaj një ulje të vogël por jo-kalimtare të çmimeve. Pasi bëhet përcaktimi i tregut përkatës, pjesa e tregut llogaritet si një përqindje mbi blerjet nga palët, mbi shitjet totale të produktit të blerë në tregun përkatës.
3. Nëse palët përveç kësaj, janë konkurrentë në një ose më shumë tregje të shitjes, ato tregje gjithashtu janë të rëndësishëm për vlerësimin. Tregjet e shitjes përcaktohen nëpërmjet zbatimit të metodologjisë së përshkruar në Udhëzimin “Për përcaktimin e tregut përkatës”.

5.3. Vlerësimi sipas nenit 4 të Ligjit.

5.3.1. Shqetësimet kryesore mbi konkurrencën.

1. Marrëveshjet për blerjen e përbashkët kufizojnë konkurrencën mbi blerjet dhe/ose tregun apo tregjet e shitjes në rrjedhën e poshtme, të tilla si rritje çmimesh, ulje e produktit, e shumëllojshmërisë, cilësisë, risive, ndarje tregu apo përjashtim anti-konkurrues i blerësve të tjerë të mundshëm.
2. Nëse konkurrentët në tregun e rrjedhjes së poshtme blejnë së bashku një pjesë domethënëse të produkteve, nxitja për të konkurruar për sa i përket çmimeve në tregun apo tregjet e shitjes do të ulët ndjeshëm. Nëse palët kanë fuqi tregu (që nuk përbën domosdoshmëri pozitive dominuese) në tregun apo tregjet e shitjes, çmimet e ulëta të blerjes të arritura nga marrëveshja e përbashkët e blerjes nuk kalon te konsumatori.
3. Nëse palët kanë fuqi tregu në tregun e blerjes (fuqi blerëse), ekziston rreziku që ato të detyrojnë furnizuesit të ulin shumëllojshmërinë apo cilësinë e produkteve që prodhojnë, çka mund të sjellë kufizim të konkurrencës si ulje cilësie, ulje e përpjekjeve për risi dhe rrjedhimisht furnizim nën(jo) optimal.
4. Fuqia blerëse e palëve në marrëveshjen e përbashkët të blerjes mund të përdoret për të përjashtuar blerës konkurrentë, nëpërmjet kufizimit të aksesit të tyre te furnizuesit. Kjo ka më tepër mundësi të ndodhë në rastet kur ekziston një numër i vogël furnizuesish dhe ka pengesa në hyrjen në treg nga ana e furnizimit në tregun e rrjedhës së sipërme.
5. Gjithsesi, përgjithësisht, marrëveshjet e përbashkëta të blerjes kanë më pak të ngjarë të kufizojnë konkurrencën kur palët nuk kanë fuqi tregu në tregun apo tregjet e shitjes.

5.3.2. Kufizimet e konkurrencës për nga objekti

1. Marrëveshjet e përbashkëta të blerjes kufizojnë konkurrencën për nga objekti, në rastin kur nuk kanë të bëjnë realisht me blerjen e përbashkët, por shërbejnë si një mjet për të marrë pjesë në një marrëveshje të fshehtë, thënë ndryshe, fiksim çmimesh, kufizim produkti apo shpërndarje tregu.
2. Marrëveshjet që përfshijnë caktimin e çmimit të blerjes mund të kenë për objekt kufizimin e konkurrencës sipas nenit 4 të Ligjit. Gjithsesi, kjo nuk zbatohet kur palët në një marrëveshje të përbashkët blerjeje bien dakord mbi çmimin e blerjes që marrëveshja mund tu paguajë furnizuesve të saj në shkëmbim të produktit objekt kontrate. Në këtë rast nevojitet një vlerësim nëse marrëveshja çon në kufizim të konkurrencës sipas nenit 4 të Ligjit. Në të dy rastet, marrëveshja mbi çmimet e blerjes nuk do të vlerësohet veçmas, por në këndvështrimin e pasojave të përgjithshme që ajo sjell në treg.

5.3.3. Efektet kufizuese për konkurrencën

Marrëveshja e përbashkët e blerjes, e cila nuk ka për objekt kufizimin e konkurrencës, duhet të analizohet nga konteksti ligjor dhe ekonomik, në lidhje me pasojat aktuale dhe të mundshme mbi konkurrencën. Analiza e efekteve kufizuese për konkurrencën si pasojë e një marrëveshjeje të përbashkët blerjeje, përfshin pasojat negative mbi të dy tregjet, si atë të blerjes dhe atë të shitjes.

Fuqia e tregut.

1. Nuk ka prag absolut, me kalimin e të cilit mund të hamendësohet që palët në një marrëveshje të përbashkët blerjeje, kanë fuqi tregu të tillë që marrëveshja për blerjen e përbashkët të kufizojë konkurrencën sipas nenit 4 të Ligjit. Gjithsesi, në shumicën e rasteve, ka pak gjasa të ketë fuqi tregu, kur palët në marrëveshje kanë një pjesë tregu që nuk tejkalon 15% në tregun apo tregjet e blerjes, si dhe një pjesë tregu të kombinuar që nuk tejkalon 15% në tregun apo tregjet e shitjes. Për çdo rast, nëse pjesa e kombinuar e tregut të palëve, nuk tejkalon 15% si në tregun apo tregjet e blerjes apo shitjes, ka të ngjarë që të plotësohen kushtet e përcaktuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit.
2. Një pjesë tregu mbi atë të pragut, në një apo në të dy tregjet, nuk tregon automatikisht për një shkelje të konkurrencës nga kjo marrëveshje. Një marrëveshjeje e përbashkët blerjeje, e cila nuk përfiton nga përjashtimi, i nevojitet një vlerësim i detajuar për pasojat e saj në treg që kanë të bëjnë me faktorë të tillë si përqendrim i tregut apo fuqi kundërvepruese nga furnizuesit e fuqishëm.
3. Fuqia blerëse, në rrethana të caktuara mund të shkaktojë kufizim të konkurrencës. Fuqi blerëse anti-konkurruese, do të kemi nëse një marrëveshje për blerje të përbashkët, blen një pjesë domethënëse të volumit total të tregut të blerjes, aq sa hyrja në treg u është mohohuar blerësve konkurrentë. Një nivel i lartë i fuqisë blerëse, mund të ndikojë indirekt mbi produktin, cilësinë dhe shumëllojshmërinë e produkteve në tregjet e shitjes.
4. Në analizën e fuqisë blerëse të palëve në një marrëveshje, janë të rëndësishme, numri dhe intensiteti i lidhjeve (për shembull, marrëveshje të tjera blerjeje) mes konkurrenteve në treg.
5. Nëse blerësit konkurrentë (të cilët nuk janë aktivë në të njëjtin treg përkatës të shitjes) bashkëpunojnë, (për shembull, shitësit me pakicë që janë aktivë në tregje gjeografike të ndryshme dhe nuk mund të konsiderohen si konkurrentë potencialë), marrëveshja e blerjes nuk e kufizon konkurrencën, me përjashtim të rastit kur, palët kanë një pozitë të tillë në tregun e blerjes, që rrezikon pozicionin konkurrues të lojtarëve të tjerë në tregjet respektive të shitjes.

Marrëveshja e fshehtë

1. Marrëveshja mund të çojë në një marrëveshje të fshehtë nëse lehtëson koordinimin e sjelljes së palëve në tregun e shitjes. Kjo ndodh në rastin kur palët arrijnë një shkallë të lartë të kostove të përbashkëta nëpërmjet blerjes së përbashkët, nëse palët kanë fuqi tregu dhe karakteristikat e tregut lejojnë koordinim.
2. Kur palët në një marrëveshje kanë të përbashkët një pjesë domethënëse të kostove të ndryshueshme në tregun përkatës të rrjedhjes së poshtme, ka më tepër të ngjarë të kufizojnë konkurrencën. Për shembull, ky është rasti kur shitësit aktivë me pakicë në të njëjtin treg/tregje përkatës, blejnë bashkërisht një sasi domethënëse të produkteve që ata ofrojnë për ri-shitje. Ky mund të jetë rasti edhe kur prodhuesit apo shitësit konkurrentë të një produkti përfundimtar, blejnë bashkërisht një përqindje të lartë të lëndes së parë.
3. Zbatimi i marrëveshjes për blerjen e përbashkët kërkon shkëmbimin e informacionit të ndjeshëm tregtar, siç është çmimi i blerjes dhe volumet. Shkëmbimi i një informacioni të tillë lehtëson koordinimin në lidhje me çmimet e shitjes dhe produktet duke çuar kështu në marrëveshje të fshehtë në tregjet e shitjes. Efektet nga shkëmbimi i informacionit të ndjeshëm tregtar mund të minimizohen kur informacioni i grumbulluar nga një marrëveshje e përbashkët blerjeje nuk kalon te palët.
4. Çdo efekt negativ që vjen si pasojë e shkëmbimit të informacionit, nuk do të vlerësohet veçmas, por në këndvështrimin e gjithë pasojave të marrëveshjes.

5.4. Vlerësimi sipas neneve 5 dhe 6 të Ligjit**5.4.1. Përfitimet nga efica**

1. Marrëveshjet për blerjen e përbashkët mund të sjellin rritje domethënëse të efica. Në veçanti, ato çojnë në ulje të kostos, të tilla si çmime më të ulëta blerjeje, ulje të kostove të transportit dhe të ruajtjes. Për më tepër, marrëveshjet për blerjen e përbashkët rrisin efica duke i shtyrë furnizuesit që të hedhin në treg produkte të reja apo të përmirësuara.

5.4.2. Domosdoshmëria

Kufizimet që tejkalojnë atë çka është e domosdoshme për të arritur efica si rezultat i marrëveshjeve për blerjen, nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit. Një detyrim për blerje nëpërmjet bashkëpunimit mundet që në disa raste, të jetë i nevojshëm për të arritur volumet e domosdoshme për realizimin e ekonomisë së shkallës. Gjithsesi, një detyrim i tillë duhet të vlerësohet rast pas rasti.

5.4.3. Kalimi te konsumatori

Efica, e përftuar nga kufizime të domosdoshme, duhet të kalohet te konsumatorët në atë masë sa të tejkalojë efektet kufizuese të konkurrencës, të shkaktuara nga

marrëveshja e blerjes së përbashkët. Ndaj, kursimet në kosto, ose efica nca të tjera prej të cilave përfitojnë vetëm palët në marrëveshjen e blerjes së përbashkët, nuk do të mjaftojnë. Kursimet në kosto duhet të kalohen te konsumatorët, që do të thotë, te konsumatorët e palëve. Për shembull, ky kalim mund të ndodhë nëpërmjet çmimeve më të ulta në tregjet e shitjes. Çmimet e ulta të blerjes si rezultat i ushtrimit të fuqisë blerëse, nuk kanë gjasa të kalohen te konsumatorët, nëse blerësit së bashku kanë fuqi tregu ne tregjet e shitjes, dhe kështu, nuk plotësojnë kriteret e nenit 5 dhe 6 të Ligjit. Për më tepër, sa më e lartë të jetë fuqia e tregut që kanë palët ne tregun apo tregjet e shitjes, aq më pak gjasa ka që ato të kalojnë te konsumatorët efica ncën në atë masë sa të tejkalojnë efektet kufizuese të konkurrencës.

5.4.4. Nuk ka eliminim të konkurrencës

Kriteret e neneve 5 dhe 6 të Ligjit, nuk mund të plotësohen nëse palëve ju ofrohet mundësia e eliminimit të konkurrencës në lidhje me një pjesë thelbësore të produkteve në fjalë. Vlerësimi duhet të përfshijë si tregjet e shitjes, ashtu edhe tregjet e blerjes.

6. MARRËVESHJET E TREGTIMIT

6.1. Përkufizimi

1. Marrëveshjet e tregtimit përfshijnë bashkëpunimin midis konkurrentëve në shitjen, shpërndarjen apo promovimin e produkteve të tyre zëvendësuese. Kjo lloj marrëveshjeje mund të ketë qëllim të gjerë , në varësi të funksioneve të tregtimit të cilat përfshihen në marrëveshja. Marrëveshjet e shitjes së përbashkët mund të çojnë ne një përcaktim i përbashkët të të gjithë aspekteve tregtare që kanë lidhje me shitjen e produktit, përfshirë këtu, çmimin. Gjithashtu, ekzistojnë edhe marrëveshje të tjera, të cilat merren vetëm me një funksion specifik tregtimi, siç është shpërndarja, shërbimi pas shitjes, apo promovimi.

2. Një kategori e rëndësishme, janë marrëveshjet e shpërndarjes. Rregullorja e përjashtimit në bllok të marrëveshjeve vertikale përfshin përgjithësisht marrëveshjet e shpërndarjes, me përjashtim të rastit kur palët në marrëveshje janë konkurrentë aktualë apo potencialë. Nëse palët janë konkurrentë, Rregullorja e sipërpërmendur përfshin vetëm marrëveshjet vertikale jo-reciproke mes konkurrentëve, nëse (a)një furnizues është një prodhues dhe shpërndarës i produktit, ndërsa blerësi është një shpërndarës dhe jo një ndërmarrje konkurren te në nivelin e prodhimit ose, (b)nëse furnizues është një ofrues i shërbimeve në disa nivele tregtimi, ndërsa blerësi ofron të mirat dhe shërbimet në nivel pakice dhe nuk ofron shërbime konkurren te në nivelin e tregtimit, ku ajo blen shërbimet e kontratës.

3. Nëse konkurrentët bien dakord të shpërndajnë produktet e tyre zëvendësuese mbi baza reciprociteti (në veçanti, nëse e bëjnë këtë në tregje gjeografik të ndryshëm), ekziston një mundësi në disa raste, që marrëveshjet të kenë për shkak apo pasojë ndarjen e tregjeve mes palëve apo të çojnë në marrëveshje të fshehta. E njëjta gjë mund të jetë e vërtetë për marrëveshjet jo-reciproke mes konkurrentëve. Marrëveshjet reciproke dhe jo-reciproke mes konkurrentëve, kështu duhet të vlerësohen sipas parimeve të caktuara në këtë Udhëzim.

4. Një dallim tjetër kemi midipaimet e caktuara në Udhëzuesin për kufizimet vertikale. Marrëveshjeve ku palët bien dakord vetëm për tregtimin e përbashkët dhe marrëveshjet ku tregtimi është i lidhur me një tjetër lloj bashkëpunimi në rrjedhën e sipërme, si për shembull prodhimi apo blerja e përbashkët.

6.2. Tregjet Përkatëse

Për të vlerësuar marrëdhënien konkurruese mes palëve, duhet të përcaktohet tregu përkatës/gjeografik apo tregjet që lidhen drejtpërdrejt me bashkëpunimin (tregu ose tregjet të cilit i përkasin produktet e bashkëpunimit në fjalë). Në rastin kur një marrëveshje tregtimi në një treg, mund të ndikojë sjelljen konkurruese në një treg fqinj i cili është i lidhur ngushtë me tregun ku ndodh bashkëpunimi në fjalë, duhet përcaktuar edhe tregu fqinj. Tregu fqinj mund të jetë horizontalisht apo vertikalisht i lidhur me tregun në të cilin ndodh bashkëpunimi.

6.3. Vlerësimi sipas nenit 4 të Ligjit

6.3.1. Shqetësimet kryesore për konkurrencën

1. Marrëveshjet e tregtimit mund të çojnë në kufizim të konkurrencës në mënyra të ndryshme.

- Së pari, dhe në mënyrë më të dukshme, marrëveshjet e tregtimit mund të çojnë në vendosje çmimesh.
- Së dyti, marrëveshjet e tregtimit mund të lehtësojnë kufizimin e produktit, pasi palët mund të vendosin mbi volumin e produkteve që duhen hedhur në treg, duke kufizuar kështu furnizimin.
- Së treti, marrëveshjet e tregtimit mund të kthen në mjet të palëve për ndarjen apo shpërndarjen e tregjeve apo konsumatorëve, për shembull në rastet kur fabrikat e prodhimit të palëve janë të vendosura në tregje gjeografike të ndryshme apo kur marrëveshjet janë reciproke.
- Së fundmi, marrëveshjet e tregtimit mund të çojnë në shkëmbim informacioni strategjik në lidhje me aspektet brenda apo jashtë fushës së bashkëpunimit, ose kostove të përbashkëta – në veçanti me marrëveshjet që nuk përfshijnë vendosje çmimesh- të cilat mund të çojnë në një marrëveshje të fshehtë.

6.3.2. Kufizime të konkurrencës për nga objekti

1. Vendosja e çmimit është një shqetësim që vjen si rezultat i lidhjes së marrëveshjes së tregtimit mes konkurrentëve. Marrëveshjet me objekt shitjen e përbashkët, përgjithësisht kanë për objekt koordinimin mbi politikën e çmimit mes prodhuesve konkurrentë ose ofruesve të shërbimit. Marrëveshje të tilla, mund të mos eliminojnë konkurrencën e çmimeve mes palëve mbi produkte zëvendësuese, por mund të kufizojnë volumin total të prodhimit. Marrëveshje të tilla kufizojnë konkurrencën për nga objekti.

2. Një tjetër shqetësim specifik për konkurrencën lidhet me marrëveshjet e shpërndarjes mes palëve, të cilat janë aktive në tregje të ndryshme gjeografike. Këto marrëveshje mund të cojnë në ndarjen e tregut. Nëse palët përdorin një marrëveshje reciproke shpërndarjeje për të shpërndarë produktet e njëri-tjetrit, në mënyrë që të eliminojnë konkurrentët aktualë apo potencialë mes tyre duke caktuar qëllimisht tregjet apo konsumatorët, marrëveshja ka të ngjarë të ketë për objekt kufizimin e konkurrencës. Nëse marrëveshja nuk është reciproke, rreziku i ndarjes së tregjeve është më i ulët.

6.3.3. Efekte kufizuese të konkurrencës

1. Një marrëveshje tregtimi nuk ka gjasa të kufizojnë konkurrencën nëse ajo është e nevojshme për të lejuar një palë të hyjë në një treg, në të cilin ajo nuk mund të hyjë individualisht.

2. Disa marrëveshje reciproke për shpërndarjen, mund të kenë efekte mbi konkurrencën. Çështja kryesore në vlerësimin e një marrëveshjeje të këtij lloji është shqyrtimi nëse marrëveshja në fjalë është e nevojshme për hyrjen e palëve në tregjet e njëra-tjetrës. Nëse është e nevojshme, marrëveshja nuk krijon problem të një natyre horizontale për konkurrencën. Gjithsesi, nëse marrëveshja ul pavarësinë e vendimmarrjes të njëres prej palëve në lidhje me hyrjen e saj në tregun/tregjet e palës tjetër, ka gjasa të sjellë kufizim të konkurrencës. I njëjti arsyetim zbatohet për marrëveshjet jo-reciproke, ku rreziku i efekteve kufizuese të konkurrencës është më i ulët.

3. Për më tepër, një marrëveshje shpërndarjeje mund të çojë në kufizim të konkurrencës nëse përmban kufizime vertikale, si kufizime mbi shitjet pasive, mbajtja e çmimeve të rishitjes, etj.

Fuqia e tregut

1. Marrëveshjet e tregtimit mes konkurrentëve mund të cojnë në kufizim të konkurrencës vetëm nëse palët kanë fuqi tregu. Në shumicën e rasteve, nuk ka të ngjarë të ketë fuqi tregu kur palët kanë një pjesë tregu të kombinuar që nuk tejkalon 15%. Për

çdo rast, nëse pjesa e tregut të palëve, e kombinuar nuk tejkalon 15%, ka të ngjarë të plotësohen kushtet e caktuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit.

2. Nëse pjesa e kombinuar e tregut të palëve tejkalon 15%, marrëveshja mes tyre nuk do të përfitojë nga paragrafi i mësipërm dhe kështu do nevojitet vlerësim mbi ndikimin e marrëveshjes së përbashkët të tregtimit.

Marrëveshja e fshehtë

1. Një marrëveshje tregtimi që nuk përfshin caktim çmimesh mund të çojë gjithashtu në kufizim të konkurrencës nëse rrit kostot e përbashkëta të palëve në atë masë sa ka të ngjarë të çojë në një marrëveshje të fshehtë. Ky mund të jetë rasti për një marrëveshje të përbashkët tregtimi, nëse para lidhjes së marrëveshjes, palët kanë të përbashkët një pjesë të madhe të kostove të ndryshueshme. Në anën tjetër, nëse rritja është e madhe, rreziku për një marrëveshje të fshehtë mund të jetë i lartë, edhe kur niveli fillestar i kosotove të përbashkëta është i ulët.

2. Gjasat për një marrëveshje të fshehtë varen nga fuqia e tregut të palëve dhe nga karakteristikat e tregut përkatës. Kostot e përbashkëta mund të rrisin rrezikun e një marrëveshje të fshehtë vetëm nëse palët kanë fuqi tregu dhe nëse kostot e tregtimit përbëjnë një pjesë të madhe të kostove të ndryshueshme të lidhura me produktin në fjalë. Kostot e përbashkëta të tregtimit rrisin rrezikun e krijimit të një marrëveshjeje të fshehtë nëse marrëveshja e tregtimit ka të bëjë me produkte me tregtim të kushtueshëm, kosto të larta shpërndarjeje apo marketingu. Promovimi i përbashkët, mund të çojë në kufizim të konkurrencës nëse ato kosto përbëjnë një faktor thelbësor kostoje.

3. Tregtimi i përbashkët, përgjithësisht përfshin shkëmbimin e informacionit të ndjeshëm tregtar, në veçanti mbi strategjinë e tregut dhe çmimet. Në shumicën e marrëveshjeve të tregtimit, informacioni mund të shkëmbehet në njëfarë mase pasi është i nevojshëm për zbatimin e marrëveshjes. Ndaj është e nevojshme të verifikohet nëse informacioni i shkëmbyer mund të çojë në një marrëveshje të fshehtë në lidhje me aktivitetin e palëve brenda apo jashtë qëllimit të bashkëpunimit. Çdo efekt negativ si pasojë e shkëmbimit të informacionit nuk do të vlerësohet i ndarë por në kuadër të të gjithë efekteve të marrëveshjes.

4. Për shembull, nëse palët në një marrëveshje të përbashkët promovimi shkëmbejnë informacion mbi çmimet, kjo mund të çojë në një marrëveshje të fshehtë për sa i përket shitjes së produkteve të promovuara bashkërisht. Për çdo rast, shkëmbimi i një informacioni të tillë në kontekstin e marrëveshjes së promovimit të përbashkët shkon përtej asaj çka është e nevojshme për zbatimin e asaj marrëveshjeje. Efektet e mundshme të konkurrencës të shkaktuara nga shkëmbimi i informacionit në kontekstin e marrëveshjes së tregtimit varen nga karakteristikat e tregut dhe të informacionit të shkëmbyer, dhe duhen vlerësuar sipas udhëzimeve të caktuara në Kapitullin 2.

6.4. Vlerësimi sipas neneve 5 dhe 6 të Ligjit

6.4.1. Përfitimet nga efica

1. Marrëveshjet e tregtimit mund të çojnë në rritje të efica. Kjo mund të merret në shqyrtim kur vlerësohet nëse marrëveshja e tregtimit përmbush kriteret e caktuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit dhe do varet nga natyra e aktivitetit dhe nga palët në bashkëpunim. Fiksimi i çmimit përgjithësisht nuk justifikohet, me përjashtim të rastit kur është i domosdoshëm për integrimin e funksioneve të tjera tregtare dhe nga ky integrim priten efica thelbësore. Shpërndarja e përbashkët mund të sjellë efica thelbësore që gjenerojnë nga ekonomia e shkallës apo qëllimit, veçanërisht për prodhuesit e vegjël.

2. Për më tepër, efica nuk duhet të jenë kursime të cilat rezultojnë vetëm nga eliminimi i kostos që janë pjesë e konkurrencës, por duhet të rezultojnë nga integrimi i aktiviteteve ekonomike.

3. Efica duhet të demonstrohet nga palët në marrëveshje. Një element i rëndësishëm në lidhje me këtë, është kontributi i palëve me kapital domethënës, teknologji apo asete. Megjithatë, nëse tregtimi i përbashkët përfaqëson thjesht një agjenci shitjesh pa asnjë investim, ka gjasa të jetë një kartel i maskuar dhe kështu të mos përmbushë kriteret e neneve 5 dhe 6 të Ligjit.

6.4.2. Domosdoshmëria

Kufizimet që tejkalojnë atë çka është e nevojshme për të arritur efica e gjeneruar nga marrëveshja e tregtimit, nuk përmbushin kriteret e neneve 5 dhe 6 të Ligjit. Çështja e domosdoshmërisë është veçanërisht e rëndësishme për ato marrëveshje që përfshijnë caktim çmimesh apo ndarje tregu, çka mund të konsiderohen si të nevojshme vetëm në rrethana të jashtëzakonshme.

6.4.3. Kalimi te konsumatori

Efica e përftuar nga kufizimet e nevojshme duhet të kalohet te konsumatorët në atë masë sa të tejkalojë efektet kufizuese të konkurrencës prej marrëveshjes së tregtimit. Kjo mund të ndodhë në formën e çmimeve më të ulta ose produkte më cilësore, apo rritje të shumëllojshmërisë. Gjithsesi, sa më e lartë fuqia e tregut e palëve, aq më e ulët mundësia që efica të kalojë te konsumatorët në atë masë sa të tejkalojë efektet kufizuese të konkurrencës. Nëse palët përbëjnë një pjesë të kombinuar tregu poshtë 15%, ka të ngjarë që çdo efica e gjeneruar nga marrëveshja do të kalohet mjaftueshëm te konsumatorët.

6.4.4. Nuk ka eliminim të konkurrencës

Kriteret e nenit 5 dhe 6 nuk mund të përmbushen nëse palët kanë mundësinë e eliminimit të konkurrencës në një pjesë të konsiderueshme të produktit në fjalë. Kjo duhet të

analizohet në tregun përkatës të cilit i përkasin produktet, subjekt i bashkëpunimit dhe në tregjet e mundshme.

7. Marrëveshjet e standardizimit

7.1. Përkufizimi

Marrëveshjet e standardizimit

Marrëveshjet e standardizimit kanë si objekt përcaktimin e kërkesave teknike ose cilësore me të cilat mund të përshtaten produktet ekzistuese ose të ardhshme, proceset e prodhimit, shërbimet ose metodat. Marrëveshjet e standardizimit mund të përfshijnë çështje si: standardizimi i shkallëve ose madhësive të ndryshme të një produkti të caktuar, ose specifikime teknike të produktit ose të tregjeve të shërbimit ku është thelbësore përshtatshmëria dhe ndër-veprueshmëria me produkte ose sisteme të tjera. Kushtet e hyrjes tek një treg i veçantë cilësor ose për miratim nga një ent Rregullator mundet gjithashtu të vlerësohet si një standard. Marrëveshjet të cilat vendosin standarde mbi performancën mjedisore të produktit ose proceseve të prodhimit gjithashtu janë pjesë e këtij kapitulli.

Kushtet e standardit

1. Në disa industri, ndërmarrjet përdorin kushte të standardit të shitjes apo blerjes, të caktuara nga një shoqatë tregtare ose direkt nga ndërmarrjet konkurruese (“kushtet e standardit”). Të tilla kushte të standardit janë pjesë e këtij udhëzimi deri në masën që ata vendosin kushte të standardit të shitjes ose të blerjes së produkteve ndërmjet konkurrentëve dhe konsumatorëve (dhe jo kushtet e shitjes apo blerjes ndërmjet konkurrentëve) për produkte zëvendësuese. Kur këto kushte të standardit përdoren gjerësisht në një industri, kushtet e blerjes apo shitjes të përdorura në atë industri mund të konsiderohen de facto. Shembuj të industrive në të cilat kushtet të standardit luajnë rol të rëndësishëm janë sektorët bankarë dhe ai i sigurimeve.
2. Kushtet e standardit të përpunuara individualisht nga një ndërmarrje vetëm për përdorim individual kur kontraktin me ofruesit ose klientët e tyre nuk janë marrëveshje horizontale dhe si të tilla nuk mbulohen nga ky udhëzim.

7.2. Tregjet përkatëse

Marrëveshjet e standardizimit mund të shkaktojnë efektet e tyre në 4 tregje të mundshme, të cilat do të përcaktohen në përputhje me Udhëzimin për përcaktimin e tregut.

- Së pari, vendosja e standardeve mund të ketë një ndikim mbi tregun e produktit ose të shërbimeve, në tregje me të cilët lidhet standardi ose standardet.

- Së dyti, kur vendosja e standardeve përfshin përzgjedhjen e teknologjisë dhe kur të drejtat për pronësinë intelektuale janë caktuar veçmas nga produktet me të cilat ai lidhet, standardi mund të ketë efekte në tregun përkatës të teknologjisë.
- Së treti, tregu për vendosjen e standardeve mund të ndikohet nëse ekzistojnë ente të ndryshme të vendosjes së standardeve ose marrëveshje të ndryshme për vendosjen e standardeve. Së katërti, një treg i caktuar për testimin dhe certifikimin ndikohet nga vendosja e standardeve.

Për sa i përket kushteve të standardit, efektet në përgjithësi ndihen në tregun e rrjedhës së poshtme, ku ndërmarrjet që përdorin kushtet e standardit konkurrojnë nëpërmjet shitjes së produkteve të tyre tek klientët.

7.3. Vlerësimi sipas nenit 4 të ligjit

7.3.1. Shqetësimet kryesore mbi konkurrencën

Marrëveshjet e standardizimit

1. Marrëveshjet e standardizimit, zakonisht, sjellin efekte ekonomike pozitive, duke inkurajuar zhvillimin e produkteve të reja dhe të përmirësuara ose tregje dhe kushte furnizimi të përmirësuara. Standardet si të tilla normalisht rrisin konkurrencën dhe ulin kostot e produktit dhe të shitjes, duke bërë që të përftojë ekonomia si e tërë dhe të rrisë cilësinë si dhe të ofrojë informacion për konsumatorët.

Vendosja e standardeve mundet, në rrethana të caktuara të rrisë efektet kufizuese të konkurrencës nëpërmjet kufizimit potencial të çmimeve të konkurrencës dhe duke kufizuar ose kontrolluar prodhimin, tregjet, shpikjet ose zhvillimin teknik. Kjo mund të ndodhë nëpërmjet tre kanaleve kryesore, që janë zvogëlimi i çmimeve të konkurrencës, përjashtimi i teknologjive shpikëse dhe përjashtimi ose diskriminimi ndaj disa ndërmarrjeve nëpërmjet parandalimit të aksesit efektiv në standard.

- Së pari, nëse ndërmarrjet do të ishin angazhuar në diskutime anti konkurruese për sa i përket vendosjes së çmimeve, kjo mund të zvogëlonte ose eliminonte çmimin e konkurrencës në tregjet përkatëse, duke lehtësuar një marrëveshje të fshehtë.
 - Së dyti, standardet mund të vendosin specifikime teknike të detajuara për një produkt që mund të kufizojë zhvillimin teknik ose risitë. Sapo përzgjidhet një teknologji dhe vendoset standardi, teknologjitë konkurruese dhe ndërmarrjet përballen me një pengesë në hyrje në treg dhe mundet që potencialisht të përjashtohen nga tregu. Rreziku i kufizimit të shpikjeve rritet nëse një ose më shumë ndërmarrje përjashtohen në mënyrë jo të justifikuar nga procesi i vendosjes së standardeve.
2. Në kontekstin e standardeve që përfshijnë të drejtat e pronësisë intelektuale, dallohen tre grupe kryesore ndërmarrjesh me interesa të ndryshme në vendosjen e standardeve.

- Së pari, janë ndërmarrjet në tregun e rrjedhjes së sipërme që zhvillojnë dhe tregtojnë vetëm teknologji. Burimi i tyre i vetëm i të ardhurave janë të ardhurat e licencës dhe iniciativa e tyre për të maksimizuar fitimet.
- Së dyti, janë ndërmarrjet në rrjedhën e poshtme që prodhojnë vetëm produkte ose ofrojnë shërbime bazuar në teknologjitë që zhvillohen nga të tjerët dhe nuk gëzojnë të drejtat e pronësisë intelektuale përkatëse. Ndërmarrjet vertikalisht të integruara që zhvillojnë bashkërisht teknologji dhe shesin produkte kanë nxitje të kombinuara.
- Së treti, standardizimi mund të çojë në rezultate anti-konkurruese, me anë të parandalimit nga ndërmarrje të caktuara nga mbajtja e aksesit efektiv në rezultatet e procesit të vendosjes së çmimeve (specifikimet dhe/ose të drejtat e pronësisë intelektuale thelbësore për zbatimin e standardit). Nëse një ndërmarrje është ose totalisht e ndaluar që të ketë akses në rezultatet e standardit, ose i jepet akses vetëm për kushtet ndaluese ose diskriminuese, ekziston rreziku për një efekt anti konkurrues. Një sistem ku IPR potencialisht përkatëse është zbuluar mund të rrisë mundësinë që aksesit efektiv që i është dhënë standardit (përderisa i lejon pjesëmarrësit që të identifikojnë se cilat teknologji mbulohen nga IPR dhe cilat jo. Kjo mundëson pjesëmarrësit të jenë faktorë në efektin potencial të çmimit përfundimtar të standardit (p.sh nëpërmjet zgjedhjes së teknologjisë pa IPR është e mundur të ketë një efekt pozitiv mbi çmimin përfundimtar) dhe të verifikohet me mbajtësit e IPR-ve nëse ata janë të gatshëm të licencojnë nëse teknologjia e tyre përfshihet në standard.

3. E drejta e pronësisë intelektuale dhe ligji i konkurrencës ndajnë të njëjtat objektiva të promovimit të risive dhe rritjes së mirëqenies konsumatore. E drejta e pronësisë intelektuale nxit konkurrencën duke inkurajuar ndërmarrjet që të investojnë në zhvillimin e produkteve dhe proceseve të reja ose të përmirësuara. IPR si të tilla janë në përgjithësi pro konkurruese. Megjithatë, nisur nga IPR, një pjesëmarrës që zotëron një IPR thelbësore për zbatimin e standardit, mundet (në kontekstin specifik të vendosjes së standardit) të kërkojë gjithashtu kontrollin mbi përdorimin e standardit. Kur standardi përbën një barrierë në hyrje, ndërmarrja mundet të kontrollojë produktin ose shërbimin me të cilin lidhet standardi. Kjo në të kundërt mund t'i lejojë ndërmarrjeve që të sillen në mënyra anti konkurruese, duke penguar përdoruesit pas miratimit të standardit, ose duke refuzuar licencimin me IPR e nevojshme ose duke i hequr aksesin nëpërmjet përdorimit të tarifave shumë të larta³, duke ndaluar aksesin efektiv në standard. Fuqia në treg vlerësohet rast pas rasti.

³ Tarifa të larta mundet të cilësohen si ekseseve nëse përmbushen kushtet për një abuzim me pozitën dominuese sic përcaktohen në nenin 9.

Kushtet e standardit

1. Kushtet e standardit mund të kufizojnë konkurrencën duke kufizuar zgjedhjen e produktit dhe risitë. Nëse një pjesë e madhe e industrisë, zbaton kushtet e standardit dhe zgjedh të mos devijojë nga ato në raste individuale, (ose devijon vetëm nga ato në raste përjashtuese të fuqisë së lartë blerëse) klientët nuk kanë zgjedhje tjetër përveçse të pranojnë këto kushte. Megjithatë, rreziku i kufizimit të zgjedhjes dhe risitë është vetëm i mundur në rastet kur një kusht i standardit përcakton qëllimin e produktit përfundimtar. Për sa i përket produkteve të përdorura gjerësisht nga konsumatori, kushtet e standardit të shitjes në përgjithësi nuk kufizojnë risitë, cilësinë dhe shumëllojshmërinë e produktit.
2. Në varësi të përmbajtjes së tyre, kushtet e standardit mund të rrezikojnë që të ndikojnë në kushtet tregtare të produktit përfundimtar. Në veçanti, ka një rrezik që kushtet e standardit në lidhje me çmimin, të kufizojnë konkurrencën .
3. Për më tepër, nëse kushtet e standardit bëhen praktikë industriale, aksesit për to mund të jetë thelbësor për hyrjen në treg. Në raste të tilla, refuzimi i askesit për kushtet e standardit mund të rrezikojë të shkaktojë përjashtim antikonkurrues. Për sa kohë që kushtet e standardit mbeten efektivisht të hapura për përdorim për çdokënd që dëshiron të ketë akses për to, nuk ka gjasa që ato të japin efekte përjashtuese anti konkurruese.

7.3.2. Kufizimet e konkurrencës për nga objekti

Marrëveshjet e standardizimit

1. Kufizojnë konkurrencën për nga objekti, ato marrëveshje që përdorin një standard duke synuar përjashtimin e konkurrentëve aktualë ose potencialë. P.sh, një marrëveshje ku një bashkim i prodhuesve, vendos standarde dhe ushtron presion mbi palët e treta, janë pjesë e kësaj kategorie.
2. Përbën kufizim të konkurrencës për nga objekti, cdo marrëveshje për kufizimin e konkurrencës nëpërmjet vendosjes së kushteve kufizuese të licencimit para miratimit të standardit për të mbuluar caktimin e përbashkët të çmimeve ose të produkteve të rrjedhës së poshtme ose të IPR apo teknologjitë zëvendësuese.

Kushtet e standardit

Çdo kusht i standardit që përmban dispozita të cilat direkt ndikojnë mbi çmimet që paguajnë klientët (për shembull çmimet e rekomanduara, zbritjet etj) kjo do të përbënte një kufizim të konkurrencës për nga objekti.

7.3.3. Efektet kufizuese mbi konkurrencën

Marrëveshjet e standardizimit

Marrëveshje që nuk kufizojnë konkurrencën

1. Marrëveshjet e standardizimit të cilat nuk kufizojnë konkurrencën për nga objekti, duhet të analizohen në kontekstin e tyre ligjor dhe ekonomik përsa i përket efektit të tyre aktual dhe të mundshëm mbi konkurrencën. Në mungesë të fuqisë së tregut një marrëveshje standardizimi, nuk është në gjendje që të prodhojë efekte kufizuese mbi konkurrencën.
2. Nevojitet një vlerësim për të vendosur nëse marrëveshja është objekt i nenit 4 dhe nëse jo, nëse kushtet e nenit 5 dhe 6 plotësohen. Në këtë kontekst, ekzistojnë modele të ndryshme për vendosjen e standardit dhe konkurrenca brenda dhe ndërmjet këtyre modeleve është një aspekt pozitiv për një ekonomi tregu. Si e tillë, ndërmarrjet që vendosin standardin janë të pavarura për të vendosur rregulla dhe procedura që nuk kufizojnë rregullat e konkurrencës.
3. Kur pjesëmarrja në vendosjen e standardit nuk është e kufizuar dhe procedura për miratimin e standardit është transparente, marrëveshjet e standardizimit të cilat nuk përmbajnë detyrime për tu përmbushur me standardin dhe sigurojnë akses për standardin, (me kushte të drejta, të arsyeshme dhe jo diskriminuese) normalisht nuk do të kufizojnë konkurrencën sipas nenit 4.
4. Në veçanti, për të siguruar pjesëmarrje jo të kufizuar, rregullat për ndërmarrjen që vendos standardet duhet të garantojnë se të gjithë konkurrentët në treg ose tregjet e prekura nga standardi, marrin pjesë në procesin që çon drejt përzgjedhjes së standardit. Ndërmarrja që vendos standardin, duhet gjithashtu të ketë objektiva dhe procedura jo diskriminuese për shpërndarjen e të drejtave të votës ashtu si dhe kriteret objektive për zgjedhjen e teknologjisë që do të përfshihet në standard.
5. Duke respektuar transparencën, ndërmarrja përkatëse që vendos standardin, duhet të ketë procedura që lejojnë aksionarët që të informohen mbi procesin e standardizimit (të ardhshëm, të përfunduar dhe aktual) për secilën fazë të zhvillimit të standardit.
6. Për më tepër, rregullat e ndërmarrjes që vendosin standardin duhet të sigurojnë akses efektiv për standardin mbi kushte të drejta, të arsyeshme dhe jo diskriminuese.
7. Në rastin kur një standard përfshin IPR, një politikë e qartë dhe e balancuar e IPR, e miratuar për një industri të veçantë dhe nevojat e një ndërmarrjeje që vendos standardet në fjalë, rrit mundësinë që implemtnuesit/zbatuesit e standardit të garantojnë akses efektiv për standardet e përpunuar nga ndërmarrja që vendos standardin.
8. Me qëllim që të sigurohet akses efektiv për standardin, politika e IPR kërkon që pjesëmarrësit që duan të kenë IPR e tyre të përfshira në standard të angazhohen në mënyrë të përvokueshme me shkrim për të ofruar për licencim IPR kryesore të tyre të gjitha palët e treta me kushte të drejta, të arsyeshme dhe jo diskriminuese (angazhime

“FRAND”). Ky angazhim duhet të jepet para miratimit të standardit. Në të njëjtën kohë, politika e IPR duhet ti lejojë mbajtësit e IPR të përjashtojnë teknologji të veçanta nga procesi i vendosjes së standardeve dhe kështu nga angazhimi për të ofruar për licencim, duke siguruar se ky përjashtim do të ndodhë në një fazë të hershme në zhvillimin e standardit. Për sigurimin e efektivitetit të angazhimeve FRAND, ka nevojë gjithashtu që të bëhet një kërkesë për të gjithë pjesëmarrësit mbajtës të IPR-ve, të cilët sigurojnë një angazhim të tillë për të siguruar që çdo ndërmarrje (për të cilët zotëruesit e IPR transferojnë IPR e tyre (përfshirë të drejtën për të licencuar këtë IPR)) është i detyruar nga ky angazhim, për shembull nëpërmjet një dispozite kontraktuale ndërmjet blerësit dhe shitësit.

9. Për më tepër, politika e IPR nevojitet që të kërkojë besim të mirë në zbulimin nga pjesëmarrësit, të IPR të tyre që mund të jenë thelbësore për zbatimin e standardit nën zhvillim. Kjo do të mundësonte industrinë që të bënte një zgjedhje të informuar të teknologjisë dhe kështu duke asistuar në arritjen e qëllimit për aksesin efektiv në standard. Një detyrim i tillë mund të bazohet në zbulimin e vazhdueshëm duke qenë se standardi zhvillohet dhe mbi përpjekje të arsyeshme për të identifikuar IPR mbi standardin potencial. Është gjithashtu e mjaftueshme nëse pjesëmarrësi deklaron që është e mundur që të ketë pretendime IPR mbi një teknologji të veçantë (pa identifikuar pretendime të veçanta IPR ose aplikime për IPR). Duke qenë se rreziku në lidhje me aksesin efektiv nuk janë të njëjtët në rastin e një ndërmarrjeje që vendos standardin me një politikë besnikërie të lirë të standardeve, zbulimi i IPR nuk do të ishte i përshtatshëm në këtë kontekst.

Angazhimet FRAND

1. Angazhimet FRAND janë dizenuar për të siguruar se IPR për mbrojtjen e teknologjisë, të trupëzuara në një standard janë të aksesueshëm për përdoruesit e standardit mbi kushte dhe terma të drejta, të arsyeshme dhe jo diskriminuese. Në veçanti angazhimet FRAND mund të parandalojnë mbajtësit e IPR të bëjnë të vështirë zbatueshmërinë e standardit, duke refuzuar të licencojnë ose duke kërkuar tarifa të padrejta dhe të paarsyeshme (me fjalë të tjera tarifa ekseseve) pasi industria është e lidhur me një standard ose duke caktuar tarifa diskriminuese.

2. Pajtueshmëria me nenin 4 nga ndërmarrja e vendosjes së standardit nuk i kërkon ndërmarrjes që vendos standardin që të verifikojë nëse kushtet e licencës së pjesëmarrësve plotësojnë angazhimet e FRAND. Pjesëmarrësit e vetë-vlerësojnë nëse kushtet e licencimit dhe në veçanti tarifat që ata caktojnë, përmbushin angazhimet e FRAND.

3. Vlerësimi nëse tarifat e caktuara për aksesimin e IPR në kontekstin e vendosjes së standardeve, janë të padrejta ose të paarsyeshme, duhet të bazohet në faktin nëse tarifat sjellin një lidhje të arsyeshme me vlerën ekonomike të IPR. Në përgjithësi, ka

metoda të ndryshme për të bërë këtë vlerësim. Në parim, nuk preferohen metodat e orientuar drejt kostos, për arsye të vështirësisë në vlerësimin e kostove që i ngarkohen zhvillimit të një patente të veçantë ose grupi patentash. Është e mundur që të krahasohen tarifat e licencimit, caktuar nga ndërmarrja në fjalë, me patentat përkatëse në një mjedis konkurrues para se industria të ketë zgjedhur standardin (ex ante) me ato të caktuara pasi industria të ketë zgjedhur standardin (ex post). Kjo tregon se krahasimi mund të bëhet në një mënyrë të qëndrueshme dhe të besueshme.

4. Një metodë tjetër mund të jetë marrja e një eksperti të pavarur për vlerësim të standardit.

Vlerësimi bazuar në efektet për marrëveshjet e standardizimit

1. Vlerësimi për secilën marrëveshje standardizimi duhet të ketë parasysh efektet e mundshme të standardit në tregun përkatës.

2. Nëse marrëveshjet e standardizimit sjellin efekte kufizuese mbi konkurrencën, varet nga fakti nëse anëtarët e një ndërmarrjeve që vendos standardet, janë të lirë që të zhvillojnë standarde ose produkte alternative që nuk pajtohen me standardin e vendosur.

3. Vlerësimi nëse marrëveshja kufizon konkurrencën, do të fokusohet në aksesin tek standardi. Kur rezultati i një standardi (specifikimet sesi përputhen me standardin dhe nëse është e përshtatshme, IPR thelbësore për zbatimin e standardit) nuk është i aksesueshëm, ose vetëm i aksesueshëm me kushte diskriminuese, për palë të treta (jo anëtarë të ndërmarrjes përkatëse që vendos standardin) kjo mund të diskriminojë, përjashtojë ose të ndajë tregun në përputhje me qëllimin gjeografik të zbatimit dhe kështu çon në kufizimin e konkurrencës. Megjithatë, në rastet e disa standardeve konkurruese ose në rastin e konkurrencës efektive ndërmjet zgjidhjes së standardizimit dhe jo standardizimit, një kufizim i aksesit mundet të mos çojë në efekte kufizuese mbi konkurrencën.

4. Nëse pjesëmarrja në një proces të vendosjes së standardeve është e hapur në kuptimin që i lejon të gjithë konkurrentët në treg të ndikuar nga standardi për të marrë pjesë në zgjidhjen dhe përpunimin e standardit, kjo do të zvogëlonte rrezikun e një efekti të mundshëm kufizues mbi konkurrencën, duke mos përjashtuar disa ndërmarrje nga mundësia për të influencuar zgjedhjen dhe përpunimin e standardit. Sa më e madhe mundësia e ndikimit në treg të standardit dhe sa më e gjerë fusha potenciale e zbatimit, aq më i rëndësishëm është që të lejohet akses i barabartë në procesin e vendosjes së standardit. Megjithatë, nëse se ka konkurrencë ndërmjet disa standardeve të tilla dhe ndërmarrjeve që vendosin standardet (dhe nuk është e nevojshme që e gjithë industria të zbatojë të njëjtat standarde) mund të mos ketë kufizim të konkurrencës. Sa më transparente të jetë procedura për miratimin e standardit, aq më e mundur është që standardi i miratuar të marrë në konsideratë interesat e të gjithë aksionarëve.

5. Për të aksesuar efektet e marrëveshjes për vendosjen e standardit, duhet të merren në konsideratë pjesët e tregut të produktit bazuar në standardin. Në shumë raste pjesët përkatëse të tregut të ndërmarrjeve që kanë marrë pjesë në zhvillimin e standardit mund të përdoren si një përjasje për vlerësimin e pjesëve të tregut të mundshme të standardit (për sa kohë ndërmarrjet që marrin pjesë në vendosjen e standardit në shumicën e rasteve kanë një interes në zbatimin e standardit). Megjithatë, efektiviteti i marrëveshjes së standardizimit në shumicën e rasteve është proporcionale me pjesën në industrinë që përfshihet në vendosjen dhe/ose zbatimin e standardit. Pjesë tregu të mëdha të zotëruara nga palët në treg ose tregje të ndikuara nga standardi, nuk do të çojnë domosdoshmërisht në përfundimin se standardi ka të ngjarë që të kufizojë konkurrencën.

6. Mund të çojë në një kufizim të konkurrencës, çdo marrëveshje për vendosjen e standardit, e cila qartësisht diskriminon ndonjë nga pjesëmarrësit apo anëtarët potencialë. P.sh, nëse një ndërmarrje që vendos standardin, haptazi përjashton ndërmarrjet në tregun e rrjedhës së sipërme (ndërmarrjet jo aktive në tregun e rrjedhës së poshtme) kjo mund të çojë në një përjashtim të teknologjive potenciale më të mira.

7. Së fundmi, marrëveshjet e vendosjes së standardeve që parashikojnë ex ante zbulimin e shumicës së kushteve kufizuese të licencimit, nuk do të kufizojë konkurrencën sipas nenit 4. Në këtë kontekst, është e rëndësishme që palët e përfshira në zgjedhjen e standardit të informohen plotësisht jo vetëm për mundësitë teknike të disponueshme dhe IPR përkatëse, por gjithashtu edhe për kostot e mundshme të këtyre IPR

Kushtet e standardit

1. Krijimi dhe përdorimi i kushteve të standardit duhet të vlerësohet në kontekstin e duhur ekonomik dhe të tregut përkatës, me qëllim që të përcaktohen, nëse kushtet e standardit çojnë në kufizim të konkurrencës.

2. Sa më gjatë që pjesëmarrja në vendosjen e kushteve të standardit, është e pakufizuar për konkurrentët në tregun përkatës (ose drejtpërdrejtë ose nëpërmjet pjesëmarrjes në grupimin e ndërmarrjeve) dhe kushtet e standardit nuk janë detyruese dhe janë të aksesueshme për çdonjërin, marrëveshje nuk ka të ngjarë të kufizojë konkurrencën.

3. Kushtet e standardit të aksesueshme dhe jo detyruese për shitjen e produkteve tek konsumatorët (mbi supozimin se nuk kanë efekte mbi çmimin) nuk kanë ndonjë efekt kufizues mbi konkurrencën, duke qenë se ato e kanë të pamundur që të çojnë në efekte negative mbi cilësinë e produktit, shumëllojshmërinë e produktit ose ristë. Megjithatë ato janë dy përjashtime të përgjithshme ku nevojitet të kryhet një vlerësim më i thellë.

4. Kushtet e standardit për shitjen e produkteve dhe shërbimeve konsumatore, ku kushtet e standardit përcaktojnë qëllimin e produktit të shitur tek konsumatorët, dhe ku

si pasojë rreziku i kufizimit të zgjedhjes së produktit është më tepër i rëndësishëm, mund të sjellë efekte kufizuese mbi konkurrencën sipas kuptimit të nenit 4 ku zbatimi i tyre i zakonshëm ka të ngjarë të rezultojë në një grupim de facto. Ky mund të ishte rasti ku përdorimi i gjerë i përhapur i kushteve të standardit de facto çon në një kufizim të risive dhe shumëllojshmërisë së produktit. P.sh kjo ndodh kur kushtet e standardit në kontratat e sigurimeve kufizojnë zgjedhjen praktike të klientëve për elementët kyç të kontratës, të tilla si rreziku standard i mbuluar. Edhe nëse përdorimi i kushteve të standardit nuk është i detyrueshëm, ato mund të ulin (dëmtojnë) nxitjet e konkurrentëve për të konkurruar në shumëllojshmëri produktesh.

5. Kur vlerësohet se ka rrezik që kushtet e standardit ka të ngjarë të kenë efekte kufizuese nëpërmjet kufizimit të zgjedhjes së produkteve, duhet të merret në konsideratë faktorë të tillë si konkurrenca në treg. P.sh nëse ka një numër të madh të konkurrentëve të vegjël, rreziku i kufizimit të zgjedhjes konsumatore duket të jetë më i vogël sesa në rastin kur ka vetëm një numër të vogël konkurrentësh të mëdhenj. Pjesët e tregut të ndërmarrjeve pjesëmarrëse, në vendosjen e kushteve të standardit, mundet gjithashtu të jenë një tregues i mundësisë për një ngritje të kushteve të standardit ose për mundësinë që kushtet e standardit të përdoren nga një pjesë e madhe në treg. Megjithatë, në këtë kuptim, nuk është e rëndësishme të analizohet nëse kushtet e standardit, janë të mundshëm që të përdoren nga një pjesë e madhe në treg, por gjithashtu edhe nëse kushtet e standardit mbulojnë vetëm pjesë të produktit ose të gjithë produktin (sa më pak të shtrirë të jenë kushtet e standardit, aq më e vogël është mundësia që ato të mund të çojnë në një kufizim të përgjithshëm, të zgjedhjes së produktit). Për më tepër, në rastet e mungesës së vendosjes të kushteve të standardit, nuk do të ishte e mundur që të ofrohet një produkt i caktuar, me efekt kufizues mbi konkurrencën sipas kuptimit të nenit 4. Në këtë rast, zgjedhja e produktit është rritur nga vendosja e kushteve të standardit.

6. Së dyti, edhe pse kushtet e standardit nuk përkufizojnë qëllimin aktual të produktit përfundimtar, mund të përbëjë një pjesë vendimtare të transaksionit me klientin për arsye të tjera. Një shembull do të ishin blerjet on line ku konfidencialiteti i klientëve është thelbësor (p.sh në përdorimin e sistemeve të sigurta të pagesës, një përshkrim i duhur i produktit, i qartë dhe transparent i rregullave të çmimeve, fleksibiliteti i politikës së kthimit etj). Duke qenë se është e vështirë për klientët, që të bëjnë një vlerësim të qartë të këtyre elementëve, ata tentojnë të favorizojnë këto praktika të përhapura gjerësisht dhe kushte të standardit në lidhje me këto elementë dhe kjo mund të behët një standard de facto me të cilin ndërmarrjet duhet të pajtohen me qëllim që të shesin në treg.

7. Nëse përdorimi i kushteve të standardit është detyrues, ka një nevojë për vlerësimin e ndikimit të tyre mbi cilësinë e produktit, shumëllojshmëritë e produktit dhe risitë (në veçanti nëse kushtet e standardit janë detyruese mbi të gjithë tregun).

8. Për më tepër, nëse kushtet e standardit (detyruese ose jo detyruese) përmbajnë ndonjë kusht në lidhje me çmimet, ato kanë të ngjarë që të krijojnë efekte kufizuese mbi konkurrencën sipas kuptimit të nenit 4.

7.4. Vlerësimi sipas nenit 5 dhe 6 te ligjit

7.4.1. Përftimet nga efica

Marrëveshjet e standardizimit

1. Marrëveshjet e standardizimit zakonisht sjellin përfitime domethënëse nga efica. P.sh, standardet mund të lehtësojnë integrimin e tregut dhe i lejojnë ndërmarrjet që të tregtojnë të mirat e tyre dhe shërbimet (produktet), duke çuar në rritje të zgjedhjes konsumatore dhe duke ulur çmimet. Standardet të cilat vendosin ndër-veprueshmëri dhe përputhshmëri shpesh nxisin konkurrencën, dhe ndihmojnë në parandalimin e krijimit të lidhjes ekskluzive me një furnizues të caktuar. Për më tepër, standardet mund të reduktojnë kostot e transaksioneve për shitësit dhe blerësit. P.sh, standardet për cilësinë, sigurinë dhe aspektet mjedisore të një produkti, mundet gjithashtu që të lehtësojnë zgjedhjen konsumatore dhe mund të çojnë në rritjen e cilësisë së produktit. Gjithashtu, standardet luajnë një rol të rëndësishëm për sa i përket risive. Ato mund të zvogëlojnë kohën që nevojitet për të sjellë teknologji të reja dhe risi në treg.

2. Për të arritur këto përfitime të efica në rastin e marrëveshjeve të standardizimit, informacioni i nevojshëm për zbatimin e standardit duhet të jetë i disponueshëm për ata që duan të hyjnë në treg .

3. Përhapja e standardit mund të kryhet nëpërmjet markës ose logove që certifikojnë përputhshmëri dhe duke ofruar kështu siguri për klientët. Marrëveshjet për testimin dhe certifikimin shkojnë më tej se sa objektivi primar i përcaktimit të standardit dhe normalisht përbën një marrëveshje dhe treg të veçantë.

Kushtet e standardit

1. Përdorimi i kushteve të standardit mund të sjellë përfitime ekonomike në formën e reduktimeve në kostot e transaksionit dhe në sektorë të veçantë të lehtësojnë hyrjen. Kushtet e standardit mundet gjithashtu që të rrisin sigurinë ligjore për palët kontraktuale.

2. Sa më i madh numri i konkurrentëve në treg, aq më të mëdha janë përfitimet nga efica.

7.4.2. Domosdoshmëria

Kufizimet që shkojnë përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur përfitimet nga efica që mund të vijnë nga një marrëveshje standardizimi ose kushtet e standardizimit nuk plotësojnë kushtet e neneve 5 dhe 6.

Marrëveshjet e standardizimit

1. Vlerësimi i secilës marrëveshje standardizimi duhet të marrë në konsideratë efektet e saj në tregun përkatës, nga njëra anë dhe kufizimet që mund të shkojnë përtej objektivave për arritjen e efencave nga ana tjetër.
2. Pjesëmarrja në vendosjen e standardeve normalisht duhet të jetë e hapur për të gjithë konkurrentët në treg ose tregjet e ndikuar nga standardi.
3. Si një rregull i përgjithshëm, marrëveshjet e standardizimit duhet të mbulojnë jo më shumë sesa është e nevojshme për të siguruar qëllimet e tyre . Në rastet kur ka vetëm një zgjidhje teknologjike mbi përfitimin e konsumatorëve ose të ekonomisë në përgjithësi, ky standard duhet të vendoset mbi baza jo-diskriminuese. Standardet neutral teknologjike mundet në disa rrethana të çojnë në përfitime më të gjera të efencës
4. Kufizimet në një marrëveshje teknologjike duke e bërë një standard detyrues për industrinë janë në parim jo të domosdoshme.
5. Marrëveshjet e standardizimit që i jep enteve të caktuara të drejtën ekskluzive për të testuar përputhshmërinë me standardin, shkojnë më tej sesa objektivi primar i përcaktimit të standardit dhe mund të kufizojë gjithashtu konkurrencën. Ekskluziviteti mundet gjithashtu që të justifikohet për një periudhë të caktuar kohe, p.sh nga nevoja për të rikuperuar kostot fillestare domethënëse. Marrëveshja e standardizimit duhet në këtë rast që të përfshijë mbrojtje të përshtatshme për të zbutur/lehtësuar rreziqet e mundshme për konkurrencën që vijnë nga ekskluziviteti.

Kushtet e standardit

Në përgjithësi nuk është e justifikuar që kushtet e standardit të bëhen detyruese për industrinë apo anëtarët e bashkimeve të shoqërive që i krijojnë ato. Megjithatë, bërja detyruese e kushteve të standardit mundet në një rast të veçantë të jetë i domosdoshëm për arritjen e përfitimeve ekonomike që vijnë nga ato.

7.4.3. Kalimi tek konsumatorët

Marrëveshjet e standardizimit

Efienca e arritur nga kufizimet e domosdoshme, mund të kalohet tek konsumatorët deri në masën që tejkalon efektet kufizuese mbi konkurrencën të shkaktuara nga një marrëveshje standardizimi apo nga kushtet e standardizimit. Një pjesë e analizës të kalimeve të mundshme te konsumatorët, është se cila procedurë është përdorur për të garantuar që interesi i përdoruesve të standardit dhe konsumatorët përfundimtarë janë të mbrojtur. Kur standardet lehtësojnë ndër-veprueshmërinë teknike dhe përputhshmërinë ose konkurrencën ndërmjet produkteve të rinj dhe atyre ekzistues, shërbimeve dhe proceseve, mund të supozohet se nga standardi do përfitojnë konsumatorët.

Kushtet e standardit

1. Efektet kufizuese mbi konkurrencën dhe mundësia e përfitimeve nga efica rriten me rritjen e pjesëve të tregut të ndërmarrjes dhe masa në të cilën kushtet e standardit janë përdorur. Në këtë mënyrë është e pamundur që të sigurohet mjeti i sigurt në të cilin të mos ketë rrezik për efekte kufizuese mbi konkurrencën ose i cili të lejojë presupozimin se përfitimet e efica do të kalohen tek konsumatorët deri në masën që ato të kenë tejkaluar efektet kufizuese mbi konkurrencën.

2. Megjithatë, disa përfitime të efica si rrjedhojë e kushteve të standardit, të tilla si rritja e krahasueshmërisë të ofertave në treg, lehtësimi i shkëmbimit ndërmjet ofruesve, dhe siguria ligjore e dispozitave të vendosura në kushtet e standardit, janë domosdoshmërisht përfitues për konsumatorët. Për sa i përket përfitimeve të tjera të mundshme të efica, të tilla si kostot e ulta të transaksioneve, është e nevojshme që të behët një vlerësim mbi baza rast pas rasti dhe në kontekstin e duhur ekonomik, nëse këto janë të mundshme për tu kaluar tek konsumatorët.

7.4.4 Nuk ka eliminim të konkurrencës

Nëse një marrëveshje standardizimi, i jep palëve mundësinë për të eliminuar konkurrencën varet nga niveli i kufizimeve të konkurrencës që ata vendosin mbi palët dhe ndikimin që marrëveshja ka mbi këto kufizime të konkurrencës. Konkurrenca mund të eliminohet nëse palët e treta janë përjashtuar nga aksesit efektiv në standard. Kushtet e standardit të përdorura nga shumica e industrisë mund të krijojë një standard industrial de facto dhe kështu të krijojë shqetësime të njëjta. Megjithatë, nëse standardi ose kushtet e standardit i përkasin vetëm një pjesë të kufizuar të produktit, konkurrenca nuk ka të ngjarë që të eliminohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

V E N D I M

Nr. 296 , Datë 18.11.2013

**“Për
vlerësimin e ankesës së ndërmarrjes “NISATEL” për hapjen e hetimit
në tregun me shumicë të shërbimit të internetit “broadband”**

Komisioni i Konkurrencës, me përberjen e :

▪	Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪	Rezana	KONOMI	Zv/Kryetar
▪	Servete	GRUDA	Anëtar
▪	Koço	BROKA	Anëtar
▪	Iva	ZAIMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 28.10 .2013, me pjesmarrjen e Znj. Lindita Milo(Lati), Znj. Rezana Konomi, Znj. Iva Zajmi, dhe Z. Koço Broka, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i ankesës së ndërmarrjes “NISATEL” për problematikën në tregun e shërbimit me shumicë të aksesit broadband internet

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, germa d.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Kërkesës së ndërmarrjes “NISATEL”
- Relacionit të Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës për monitorimin e tregut dheshqyrtimin e ankesës.

VËREN SE:

Me anë të ankesës së saj të datës 23.08.2013 drejtuar AKEP dhe për dijeni Autoritetit të Konkurrencës, “NISATEL” SH.P.K. ankohet se ndërmarrja Albtelecom Sh.a nuk ka zbatuar kushtet teknike të kontratës së lidhur midis palëve për ofrimin me shumicë të shërbimit të internetit *broadband* dhe njëkohësisht ka vendosur kushte shtesë dhe ka abuzuar me çmimet e ofruara ndaj ndërmarrjes Nisatel Sh.p.k duke shfrytëzuar pozicionin e saj në tregun e shumicës dhe atë të pakicës (integrimin vertikal). Për këto arsye ndërmarrja Nisatel Sh.p.k ka kërkuar prishjen e kontratës së ofrimit të aksesit të internetit *broadband* me ndërmarrjen Albtelecom Sh.a, kërkesë e cila është refuzuar nga kjo e fundit.

Në zbatim të nenit 28 pika a, të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. me anë të Urdhërit nr 67, datë 09.09.2013, është ngritur grupi i punës për realizimin e monitorimit në tregun e dhënies së aksesit të internetit.

Grupi i punës me anë të shkresës 307/1/2/3, datë 20.09.2013 kërkoi nga ana e ndërmarrjeve Albtelecom Sha, Nisatel Sh.p.k dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, informacionin e nevojshëm për të realizuar procedurën e monitorimit.

I. Tregu përkatës:

Ndërmarrja Nisatel ankohet për ofrimin e shërbimit të aksesit në *broadband* internet.

Tregu i aksesit në *broadband* internet ndahet në dy nivele:

1. Tregu i pakicës së aksesit në *broadband* internet
2. Tregu i shumicës së aksesit në *broadband* internet

Tregu i ofrimit të aksesit në internet nuk është një treg i rregulluar për sa i përket çmimeve të aplikuara pasi nga ana e AKEP dhe praktikavetë vendeve të tjera nuk përkrahet ndërhyrja dhe rregullimi në këtë treg për shkak të zhvillimeve pozitive dhe rritjes së konkurrencës në tregun e ofrimit me pakicë të internetit.

Sipas AKEP tregu i pakicës së aksesit në *broadband* internet është një treg i cili ka pësuar zhvillime pozitive gjatë viteve të fundit duke rritur ndjeshëm konkurrencën në këtë treg. Pjesët e tregut të pakicës së aksesit në *broadband* internet janë si më poshtë:

Tabela nr.1: Pjesët e tregut të pakicës së aksesit në *broadband* internet

a) Pjesët e tregut të aksesit në *broadband* fikse viti 2011

Albtelekom	Abcom	ASC	Primo	Bleta	Nisatel	OA të tjerë
X	X	X	X	X	X	X

b) Pjesët e tregut të aksesit në *broadband* fikse viti 2012

Albtelekom	Abcom	Abissnet	ASC	OA të tjerë
X	X	X	X	X

Nga viti 2011 në vitin 2012 ndërmarrja Albtelekom ka humbur 1% të tregut të aksesit në broadband për tregun e pakicës.

Ndërmarrjet Nisatel dhe Albtelecom janë konkurrencte të njëra tjetrës në këtë nivel të tregut duke ofruar produktin e tyre për konsumatorin përfundimtar.

II. Struktura e tregut të shumicës(ë aksesit në broadband internet)

Në tregun e shumicës së aksesit në broadband ashtu si dhe në tregun e pakicës ndërmarrja Albtelekom është ndërmarrja me pjesën më të madhe të tregut duke qenë dhe operator me fuqi të ndjeshme në këtë treg.

Tabela nr. 2: Pjeset e tregut të shumicës (wholesale) internet në vitin 2012

Albtelecom	Abissnet	ATU	Enet	Nisatel	Totali
X	X	X	X	X	X

Burimi: Të dhëna të ardhura në formë elektronike nga AKEP

III. Pozita dominuese e Albtelekom

Për shkak se ndërmarrja Albtelecom Sha është operator me fuqi të ndjeshme në treg sipas parashikimit të nenit 33 (Sipërmarrësit me fuqi të ndjeshme në tregje) të Ligjit “Për komunikimet elektronike” që është e barasvlershme me përcaktimin e pozitës dominuese sipas nenit 3, pika 5 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, në tregun e aksesit me shumicë të internetit, AKEP ka propozuar në dokumentin “Analizë e tregut me shumicë të aksesit broadband” në Korrik 2013 që të vazhdojnë detyrimet rregullatore të vendosura në analizën e vitit 2011 ndaj Albtelecom në lidhje me tregun e shumicës të aksesit në broadband internet (bitstream akses nga vendndodhje fikse) dhe konkretisht:

- a.** Detyrimi për aksesin (sipas Ligjit 9918 i ndryshuar);
- b.** Detyrimi për mos-diskriminim (sipas Ligjit 9918 i ndryshuar);
- c.** Detyrimi për transparence (sipas Ligjit 9918 i ndryshuar);

IV. Vlerësimi i ankesës për abuzimin e mundshëm me pozitën dominuese:

Nga vlerësimi i kontratës së lidhur midis ndërmarrjes Albtelecom Sha dhe Nisatel Sh.p.k, vënë në dispozicion nga ndërmarrja Albtelecom Sha rezulton se Albtelecom sha dhe operatori Nisatel Sh.p.k kanë lidhur kontratën nr 5081, datë 11.10.2012 me afat 1 vjeçar. Meqenëse pjesa e ankesës lidhur me cilësinë e shërbimit nuk është në fushën e zbatimit të Ligjit ‘Për mbrojtjen e konkurrencës’, por nën rregullimin e AKEP, grupi i punës ka analizuar sjelljen e ndërmarrjes Albtelekom Sh.A sipas parashikimeve të nenit 8 (pozita

dominuuese ekuivalente me fuqinë e ndjeshme në treg sipas ligjit për komunikimet elektronike) dhe nenit 9 (abuzimi me pozitën dominuese) nëse është aplikuar një “ngushtim” i marzhit të apo “*margin squeeze*”(një ndërmarrje me pozitë dominuese mund të vendosë një çmim për produktin në tregun e rrjedhës së sipërme, i cili krahasuar me çmimin që vendoset në tregun e rrjedhës së poshtme, nuk lejon as një konkurrent eficient të tregtojë me fitim në tregun e rrjedhës së poshtme) Duke qenë se shërbimi i internetit të dedikuar ofrohet nga Albtelecom në terma komercialë, në kontratë është përcaktuar që për një kapacitet 600 MB ndërmarrja Albtelecom ofron një çmim prej 17 Euro/Mbps. Nga ofertat e paraqitura nga ndërmarrja Albtelecom Sha për operatorin Nisatel Sh.p.k rezulton se është ndër ofertat me çmim më të ulët që ndërmarrja Albtelecom Sha i ofron operatorëve në tregun e ofrimit me shumicë të aksesit të internetit.

Ne takimin e realizuar me ekspertët e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare është pranuar se një kapacitet 20 MB internet i dedikuar mund të shërbejë për të ofruar internet me teknologjinë ADSL në rreth 100 abonentë, nëse këta të fundit janë në një zonë të caktuar gjeografike. Në këto kushte analiza e realizuar nga ana e operatorit Nisatel ku llogaritet se oferta e shitjes me shumicë të aksesit të internetit nga ana e kompanisë Albtelecom është më e shtrenjtë se oferta që Albtelecom ofron në shitjen me pakicë, nuk është e njëjtë sipas kriterëve teknike që operatorët e ofrimit të internetit aplikojnë në tregun e shitjes me pakicë.

Në analizën e bërë mbi kontratën e lidhur midis ndërmarrjes Albtelecom sh.a dhe ndërmarrjes Nisatel Shpk rezulton se kapaciteti i ofruar për aksesin në internet është 600 MBps me një çmim prej 17 euro MBps pa TVSH që në total llogaritet në një shumë prej 10 200 euro pa TVSH në një muaj. Në një vit totali i paguar do të jetë 122 400 euro pa TVSH.

Pra, për të gjithë abonentët që Nisatel Shpk ka për këtë periudhë kohore, kapaciteti është 600 MBps dhe shuma në total është 10 200 euro në muaj. Sipas të dhënave të sjella nga operatori Albtelecom Sha, ndërmarrja Nisatel Shpk ka pasur për periudhën objekt i kontratës me Albtelecom një numër prej 3 600 abonentësh të cilëve u mundësohej furnizimi me internet pikërisht me anë të kapacitetit 600 MBps me një çmim prej 17 euro MBps për aksesin në internet që Nisatel i ka paguar Albtelecom. Pra kostoja e Nisatel Shpk për klient fundor, që del në bazë të këtij numri prej 3 600 klientësh të Nisatel Shpk, del disa herë më e ulët se oferta që Albtelecom Sha shet internetin me pakicë tek një klient fundor. Një rezultat i tillë vjen si pasojë e teknologjisë që në këtë rast përdor një kapacitet të dedikuar në një numër të madh përdoruesish, duke bërë që kostot për njësi të jenë të ulëta.

Kjo reflektohet edhe në tregun e pakicës ku konstatohet rritje e pjesës së operatorëve të vegjël. Kështu, nga të dhënat e paraqitura nga ana e ndërmarrjes Albtelecom Sha rezulton se gjatë vitit 2013 vetëm 3 abonentë kanë portuar numrin e tyre nga ndërmarrja Nisatel drejt Albtelecom ndërsa nga ndërmarrja Albtelecom drejt ndërmarrjes Nisatel kanë portuar numrin 118 Abonentë. Ky portabilitet i lartë drejt ndërmarrjes Nisatel nga ana e Klientëve të Albtelekom nuk provon pretendimin e ndërmarrjes Nisatel Shpk.

Albtelecom Sh.a nuk është i vetmi operator që ofron shërbimin e aksesit me shumicë në internet në territorin ku operon Nisatel Shpk dhe kjo vërtetohet nga vetë ankimuesi, i cili ka deklaruar se arsye për prishjen e kontratës është çmimi më i mirë që është ofruar nga një ndërmarrje tjetër që operon në tregun e ofrimit me shumicë të aksesit në internet.

V. Konkluzione

Nga procedura e monitorimit vlerësohet se operatori me pozitë dominuese në ofrimin e aksesit të dedikuar në tregun e internetit me shumicë Albtelecom Sha nuk aplikon sjelljen e pretenduar nga ana e Nisatel, ku ndërmarrja Albtelecom është e integruar vertikalisht. Portimi i numrave të telefonisë fikse nga ndërmarrja Albtelecom Sha drejt ndërmarrjes Nisatel Sh. p.k, në një numër disa herë më të madh se në drejtimin e kundërt (Nisatel portim drejt Albtelecom), tregon se ndërmarrja Albtelecom nuk është duke aplikuar *margin squeeze* në tregun e ofrimit të shërbimit të aksesit të internetit të dedikuar apo ndonjë sjellje tjetër diskriminuese. Mënyra e ofrimit të internetit të dedikuar për klientët fundorë aplikohet me teknologjinë e shpërndarjes paralele, duke ulur kostot e operatorëve që operojnë në tregun me pakicë dhe duke bërë që oferta e shitjes me shumicë të aksesit të internetit të dedikuar të mundësojë shërbimin e një numri të shumë operatorësh në tregun e shitjes me pakicë.

Si përfundim, bazuar në nenin 28 të Ligjit rezulton se nga analizimi i fakteve të ankesës dhe kushteve të tregut nuk ka kufizime, shtrembërime apo pengime të konkurrencës në treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Mbylljen e procedurës së vlerësimit në tregun me shumicë të shërbimit të internetit “broadband”.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi “Nisatel” SHA dhe Albtelecom SHA

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 297, Datë 18.11.2013

“Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimeve për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit policë sigurimi për mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

▪	Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
▪	Rezana	KONOMI	Zv/Kryetar
▪	Servete	GRUDA	Anëtar
▪	Koço	BROKA	Anëtar
▪	Iva	ZAJMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18.11.2013, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi një praktikë të mundshme (marrëveshje/praktikë e bashkërenduar) në sektorin e sigurimeve të detyrueshme për sigurimet motorrike të përgjegjësive ndaj palëve të treta”

Baza ligjore: Neni 24, shkronja d, neni 26 dhe neni 42, pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe neni 12/3 i Rregullores “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të informacionit dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi një praktikë të mundshme (marrëveshje/praktikë e bashkërenduar) në sektorin e sigurimeve të detyrueshme për sigurimet motorrike të përgjegjësive ndaj palëve të treta”.

VËREN SE :

Bazuar në disa sinjale të marra nga operatorët e tregut të sigurimeve, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës me kërkesën e Komisionit të Konkurrencës, në bazë të nenit 28 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, në datat 14 dhe 15 nëntor 2013, ka monitoruar tregëtimin e policës së sigurimit të detyrueshëm motorrik për përgjegjësitë ndaj palëve të treta. Qëllimi i monitorimit ishte vlerësimi i kushteve të tregtimit të këtij produkti nëse plotësoheshin kushtet për funksionimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Në këndvështrimin e Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” pista kryesore e dyshimit për kufizim të konkurrencës është vlerësuar sipas parashikimeve të nenit 4, pika 1, shkronjat a dhe c, respektivisht të caktimit të çmimit dhe ndarjes së tregut.

Duke patur parasysh karakteristikat e produktit përkatës dhe rregullimin e këtij tregu të dhënat nga monitorimi tregojnë që çmimet e aplikuara nuk janë të caktuara në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë dhe nuk janë të njëjta për kompani të ndryshme.

Nga monitorimi rezultoi se nga data 1 Nëntor 2013 të gjithë agjentët e shitjes i tregtonin këto polica nëpërmjet një sistem që quhej MSHM dhe menaxhohej nga një broker. *Të dhënat e sistemit të një agjenti në një moment të caktuar nuk të ofronin të gjitha kompanitë e licensuara për tregëtimin e produktit përkatës, por një numër më të kufizuar, mesatarisht 4-5 shoqëri. Ndërkohë që nuk është e qartë numri dhe mënyra e shfaqjes së kompanive të disponueshme për lëshimin e policave të sigurimit, pasi në një tjetër agjent, sipas deklarimeve të tij, shfaqeshin të gjitha shoqëritë e sigurimeve.*

Për sa më sipër, sjellja e ndërmarrjeve që ushtrojnë veprimtari në tregun e sigurimit të mjeteve motorrike, në kuptim të nenit 4, pika 1, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, mund të përbëjë kufizim, shtrembërim apo pengim të konkurrencës.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës në zbatim të nenit 42, pika 1 të ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

V E N D O S I:

- I.** Të miratojë hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun *policës së sigurimit për mjetet e transportit për sigurimin e përgjegjësive ndaj palëve të treta*.
- II.** Periudha e hetimit do të jetë nga 01.11.2013 deri në përfundimin e procedurave hetimore.
- III.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak, jo më vonë se data 02.12.2013.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS**Servete GRUDA****Koço BROKA****Iva ZAJMI****Rezana KONOMI**

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar**Lindita MILO (LATI)**

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 298, Datë 06.12.2013

“Për

**vleresimin ligjor mbi përputhshmërinë me ligjin dhe rregulloret e
“Marrëveshjes së bashkëpunimit mes shoqërive të tregut të sigurimeve mbi
shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të
mjeteve të transportit për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | |
|-----------|-------------|-------------|
| • Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| • Rezana | KONOMI | Zv/Kryetare |
| • Servete | GRUDA | Anëtar |
| • Koço | BROKA | Anëtar |
| • Iva | ZAJMI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 07.12..2013, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi e kërkesës së shoqërive të sigurimit “INSIG” Sh.a, “SIGMA VIG” Sh.a, “SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA” Sh.a, “INTERSIG VIG” Sh.a, “INTERALBANIAN VIG” Sh.a, “ATLANTIK” Sh.a, “EUROSIG” Sh.a, “ALBSIG” Sh.a dhe “ANSIG” Sh.a për përputhshmërinë e “Marrëveshjes së bashkëpunimit mes shoqërive të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve të transportit për përgjegjësinë ndaj palëve të treta” me legjislacionin primar dhe sekondar në fushën e konkurrencës.

Baza ligjore: Nenet 6 dhe 24, germa d, 48, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, këtu dhe me poshtë Ligji

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit e Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës
- Relacionit të Drejtorisë së Mbikëqyrjes dhe Hetimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike, Hetimit dhe Procedurave,

VËREN SE :

1. Në zbatim të nenit 6 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Rregulores “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”, shoqëritë e sigurimit me anë të shkresës nr. 383 prot, dt. 18.10.2013, e në vijim kanë depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës “Marrëveshjen e bashkëpunimit mes shoqërive të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve të transportit për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”.

2. Palët në marrëveshje kanë bërë vetëvlerësimin e përputhshmërisë së marrëveshjes me Rregulloren “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve, vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”. Sipas këtij vetëvlerësimi marrëveshja është në përputhshmëri të plotë me Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Rregulloren e mësipërme dhe për këtë arsye kërkojnë nga Autoriteti i Konkurrencës konfirmimin mbi këtë përpueshmëri.

3. Objekti i kësaj marrëveshjeje është vendosja e një marrëdhënie bashkëpunimi mes shoqërive të sigurimit në tregun e sigurimeve të detyrueshme MTPL e brendshme të mjeteve motorrike lidhur me vendosjen e tarifave të primeve të rrezikut të zakonshëm bazuar në statistika të konstatuara kolektivisht ose në numrin e pretendimeve; vendosjen e kushteve të policave standarde të përbashkëta; Mbulimi i zakonshëm për disa lloje të caktuara rreziqesh; Shlyerja e dëmeve; Testimi dhe pranimi i pajisjeve të sigurisë; Regjistrat dhe informacioni mbi rreziqet e rënda¹.

4. Qëllimi i marrëveshjes do të jetë shkëmbimi i informacionit mes palëve në marrëveshje për mbulimin e riskut të policave TPL e brendshme të periudhës para nënshkrimit të marrëveshjes (vitet 2011, 2012, 2013) për vendosjen e standarteve në sigurimin e mosfallsifikimit të policave të sigurimit të brendshëm MTPL, shqyrtimin e informacionit (i cili mund të përfshijë disa llogaritje statistikore) duke lejuar llogaritjen

¹ Në përputhje me pikën 2 të preambulës së Rregulores “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve”.

e kostos mesatare të mbulimit të një rreziku specifik në të shkuarën ose për siguracionin e jetës, hartimin e tabelave të normave të vdekshmërisë apo të frekuencës së sëmundjeve, aksidentet dhe invaliditeti, të cilat bëjnë të mundur përmirësimin e njohurive mbi rreziqet dhe lehtësojnë vlerësimin e rreziqeve për kompanitë individuale.

5. Marrëveshja synon përmirësimin e shërbimit ndaj konsumatorit duke vendosur bazat për zbatimin e projektit Bonus/Malus me qëllim përmirësimin e të dhënave teknike të sistemit të informacionit për klientin për mundësimin e vendosjes së kriterëve Bonus/Malus në përcaktimin e çmimit final të produktit MTPL, duke siguruar që çmimi për rreziqe potenciale të ndryshme do të jetë i ndryshëm për kompani të ndryshme. Gjithashtu përmirësimi i data bases së të dhënave do të synojë përmirësimin e raportit dëme/prime në një shkallë të konsiderueshme për të plotësuar kërkesat në rritje të të siguruarve dhe për të përmbyllur detyrimin kontraktor të blerjes së riskut nëpërmjet policës së sigurimit të detyrueshëm.

6. Konsumatorët do të kenë mundësi të përfitojnë nga marrëveshja si pasojë e zbatimit të sistemit Bonus/Malus dhe në mënyrë të veçantë do të përfitojnë ata konsumatorë që kanë një histori pozitive me dëmet e shkaktuara ndaj palëve të treta.

7. Në marrëveshje parashikohet si objektiv edhe sigurimi i mosfallsifikimit të policave të sigurimit të brenshëm MTPL. Në mënyrë që të realizohet ky objektiv pa rënë ndesh me Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës” është e domosdoshme që këto masa të raportohen pranë Autoritetit të Konkurrencës.

8. Palët pjesëmarrëse në marrëveshje shprehen se janë të ndërgjegjësuar për zbatimin e parimeve të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, duke shprehur angazhimin se nuk do të realizojnë kufizime që bien ndesh me nenin 4 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si ndarje tregu apo fiksime çmimi, por do ta mbështesin aktivitetin e tyre tregtar vetëm në kuadrin ligjor dhe nënligjor që mundëson bashkëpunimin me qëllim arritjen e standarteve të sistemit financiar të sigurimeve. Në seksionin II të Ligjit, parashikohen “Procedurat për përjashtimin e marrëveshjeve nga ndalimi”. Sipas nenit 48 të ligjit, Komisioni është i vetmi organ për të vendosur dhënien e përjashtimeve të parashikuara në nenet 5, 6 dhe 7 të këtij ligji”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 6 dhe 24, germa d, 48, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. “Marrëveshja e bashkëpunimit mes shoqërive të tregut të sigurimeve mbi shkëmbimin e informacionit për tregun e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve të transportit për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, për nga objekti dhe qëllimi është në përputhje me nenin 3 të Rregullores “Për zbatimin e nenit 6 të LPMK ndaj disa kategorive të marrëveshjeve vendimeve dhe praktikave në sektorin e sigurimeve” dhe plotëson kushtet për të përfituar nga përjashtimi i ndalimit të parashikuar në pikën 1 të nenit 4 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

2. Në marrëveshjen përfundimtare mes palëve Komisioni i Konkurrencës në zbatim të neneve 4 dhe 6 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, kërkon nga palët pjesëmarrëse në marrëveshje:

a. Në **angazhimet** e palëve për respektimin e parashikimeve të nenit 4 të ligjit të shtohen edhe kushtet si më poshtë:

i. Shoqëritë duhet të vazhdojnë ta tregtojnë policën e sigurimit të detyrueshëm me **logot respektive**.

ii. Palët të raportojnë pranë Autoritetit të Konkurrencës për masat që kanë si synim të marrin për sigurimin e mosfallsifikimit të policave të sigurimit të brendshëm MTPL për të shqyrtuar nëse këto masa mund të çenojnë konkurrencën e lirë dhe efektive në treg.

iii. Palët të vendosin në dispozicion të Autoritetit të Konkurrencës, informacionin e shkëmbyer në bazë të marrëveshjes sa herë që kërkohet nga ky autoritet.

b. Në pikën II.2 “**Qëllimi i Marrëveshjes**” të përcaktohet periudha kohore e shkuar për të cilën do të shkëmbehet informacioni me qëllim realizimin e llogaritjeve të përbashkëta, tabelave dhe studimeve të përbashkëta.

c. Në pikën II.3 “**Detyrimet e palëve**” të shtohet se palët kanë detyrimin që “Të mos japin asnjë informacion në lidhje me çmimin e policës së sigurimit, nivelin e fitimeve, kostot apo çdo element tjetër që ndikon në përcaktimin e çmimit fundor të policës së sigurimit, si dhe çdo informacion tjetër që mund të demtojë konkurrencën në treg”.

d. Në pikën II.6 “**Kontrolli i zbatimit të marrëveshjes**” të shtohet “Në rast përjashtimi të palëve nga marrëveshja të njoftohet Autoriteti i konkurrencës për këtë fakt”.

e. Në pikën III.2 “**Afati i vlefshmerisë së marrëveshjes**” të ndryshohet “Afati i marrëveshjes do të jetë 1 vit.”

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 299 , Datë 06.12. 2013

“Mbi

**autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100 %
të aksioneve të shoqërisë Europa Kazino 2009 SHA nga z. Edmond Plaku”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | |
|----------------|-------------|-------------|
| ▪ Znj. Lindita | Milo (Lati) | Kryetar |
| ▪ Znj. Rezana | Konomi | Zv. Kryetar |
| ▪ Znj. Servete | Gruda | Anëtar |
| ▪ Z. Koço | Broka | Anëtar |
| ▪ Znj. Iva | Zajmi | Anëtar; |

Në mbledhjen e tij të datës 06.12.2013, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100 % të aksioneve të shoqërisë Europa Kazino 2009 SHA nga Z. Edmond Plaku”

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, 10-12, dhe në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit të shoqërisë Europa Kazino 2009 ShA dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

V Ë R E N S E :

1. Transaksioni dhe përqendrimi

Transaksioni i përqendrimit realizohet me anë të “Kontratës për shitblerjen e aksioneve” të datës 11 Shtator 2013, me objekt transferimin e 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë Europa Kazino 2009 SHA nga aksioneri Z. Myftar Lleshi tek aksioneri i ri hyrës Z. Edmond Plaku. Për miratimin e transferimit të aksioneve me anë të kontratës së sipërpërmendur, aksioneri i vetëm i shoqërisë Europa Kazino 2009 ShA, Z. Myftar Lleshi ka marrë edhe “Vendim të aksionerit të vetëm” datë 9 Shator 2013 .

Përqendrimi konsiston në përfitim të kontrollit të vetëm ekskluziv të shoqërisë Europa Kazino 2009 ShA nga personi fizik Z. Edmond Plaku në formën e hyrjes së aksionerit të ri përfutës i kontrollit, i cili në bazë të nenit 10 pika 1) shkronja b) e Ligjit përben përqendrim dhe meqenëse plotëson dhe kriteret e xhiros sipas nenit 12 të Ligjit duhet autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës

2. Palët në transaksion

- **Z. Edmond Plaku** në cilësinë e aksionerit **Blerës**, person fizik i cili nuk ka asnjë histori përfshirje në ndonjë prej sektorëve të ekonomisë apo pjesëmarrje të çdo forme në tregun e brendshëm apo atë ndërkombëtar.
- **Z. Myftar Lleshi**, në cilësinë e aksionerit **Shitës** është një person fizik madhor me zotësi të plotë për të vepruar, zotërues i 100% të kapitalit fillestar të shoqërisë Europa Kazino 2009 SHA. Ai nuk ka asnjë pjesëmarrje si individ në ndonjë aktivitet tjetër të lidhur apo të pavarur në të njëjtin sektor të ekonomisë.
- **Europa Kazino 2009 SHA**, në cilësinë e shoqërisë **target** të përqendrimit është një shoqëri e themeluar dhe që funksionon në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi, me seli në adresën: Sheshi “Pranvera”, pranë Telekomit, Durrës. Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në fushën e lojrave të fatit - kazinove elektronike.

3. Xhiro për vitin 2011

Transaksioni ndodh në tregun gjeografik të Republikës së Shqipërisë ku e ushtrojnë veprimtarinë si pala blerëse ashtu edhe shoqëria objekt i këtij përqendrimit pasi Z. Edmond Plaku dhe shoqëria Europa Kazino 2009 SHA. nuk janë prezent në tregun ndërkombëtar.

Xhiro totale në **tregun e brendshëm**: është **341 948 136 Lekë**:

- Europa Kazino 2009 SHA.¹ : 341 948 136 Lekë.

¹ Burimi: Bilanci i audituar i shoqërisë Europa Kazino 2009 për vitin 2012.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros të përcaktuara në nenin 12, pika 1 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si rrjedhojë, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

4. ANALIZA E KONKURRENCËS

4.1. Tregu përkatës

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- I)** tregu i produktit, dhe
- II)** tregu gjeografik.

Tregu përkatës i produktit

Shoqëria Europa Kazino 2009 SHA e ushtron aktivitetin e saj vetëm në fushën e lojërave të fatit - kazino elektronike. Duke marrë parasysh objektin e veprimtarisë ku shoqëria Europa Kazino 2009 SHA ushtron aktivitetin e saj, treg përkatës të produktit do të konsiderojmë: Tregun e ofrimit të shërbimit të lojërave të fatit për konsumatorët nëpërmjet makinave elektronike.

Tregu përkatës gjeografik

Ky treg përfshin hapësirën ku tregtohen produktet apo shërbimet e ofruara të përcaktuara në tregun e produktit. Aktualisht shoqëria Europa Kazino 2009 SHA. e ushtron aktivitetin e saj në rrethet Tiranë, Peshkopi, Dibër, Elbasan dhe Librazhd, por potencialisht treg përkatës gjeografik do të konsiderohet Republika e Shqipërisë.

5. Vlerësimi i konkurrencës pas përqendrimit

Nëpërmjet këtij transaksioni Z. Edmond Plaku do të përfitojë kontrollin e 100% të aksioneve të shoqërisë Europa Kazino 2009 sha.

Ky përqendrim është një përfitim kontrolli në formën e zëvendësimit të pronësisë nëpërmjet blerjes së 100 % të aksioneve të shoqërisë target Europa Kazino 2009 SHA. Si pasojë, transaksioni nuk sjell ndryshime në strukturën e tregut pas përqendrimit dhe nuk krijon dhe as forcon një pozicion dominues të Europa Kazino 2009 SHA në tregun përkatës, duke mos e kufizuar kështu konkurrencën efektive në tregun përkatës të produktit.

6. Konkluzione

Përqendrimi i njoftuar është një ndryshim kontrolli sipas parashikimeve të nenit 10, pika 1, shkronja b dhe plotëson kriteret e xhiros sipas nenit 12 të Ligjit Nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.

Përqendrimi nuk sjell asnjë ndryshim në strukturën dhe pjesën e tregut që zë aktualisht shoqëria Europa Kazino 2009 SHA, pasi ky përqendrim është një përfitim kontrolli në formën e zëvendësimit të pronësisë nëpërmjet blerjes së 100 % të aksioneve të shoqërisë target. Gjithashtu, pas përqendrimit nuk do të kemi krijim apo forcim të pozitës dominuese të ndërmarrjes Europa Kazino 2009 SHA në tregun përkatës.

Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”:

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 100 % të aksioneve të shoqërisë Europa Kazino 2009 SHA nga z. Edmond Plaku.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

Koço BROKA

Iva ZAJMI

Rezana KONOMI

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 300, Datë 06.12.2013

“Për

**një ndryshim në Vendimin nr. 291, datë 18.11.2013 "Mbi hapjen e
procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimeve për kufizime të
mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit policë sigurimi për
mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

▪ Lindita	MILO(LATI)	Kryetar
▪ Rezana	KONOMI	Zv/Kryetar
▪ Servete	GRUDA	Anëtar
▪ Koço	BROKA	Anëtar
▪ Iva	ZAJMI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06.12.2013, trajtoi çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me procedurën e hetimit paraprak në tregun e sigurimeve për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit policë sigurimi për mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta.

Baza ligjore:

- Neni 24, shkronja d); neni 43, pika 1, të Ligjit nr. 9121 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (indryshuar);
- Ligji Nr. 8485, datë 11.11.1999 "Kodi i procedurave administrative".

Pasi mori në shqyrtim relacionin e Sekretarit të Përgjithshëm lidhur me procedurën e hetimit në tregun e sigurimeve për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit police sigurimi për mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit nr.291, datë 18.11.2013 ka hapur procedurën e hetimit në tregun e sigurimeve për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit police sigurimi për mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta për periudhën nga 1 nëntori 2013 deri në përfundim të procedurave hetimore.
2. Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, ngriti Grupin e Punës përgjegjës për ndjekjen e procedurave të këtij hetimi.
3. Për realizimin e kësaj procedure nga Grupi i Punës është kërkuar informacion nga institucione dhe ndërmarrje të ndryshme që disponojnë informacion të nevojshëm për hetimin. Ky informacion nuk ka ardhur akoma në mënyrë të plotë pranë Autoritetit të Konkurrencës.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se sigurimi i një informacioni të plotë dhe të detajuar, për të parë më mirë sjelljen e ndërmarrjeve në treg është i nevojshëm për të siguruar një vendim marrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 43, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", si dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11.11.1999 "Kodi i procedurave administrative",

VENDOSI:

1. Në Vendimin nr. 291, datë 18.11.2013 "Mbi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e sigurimeve për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregtimin e produktit police sigurimi për mjetet e transportit për përgjegjësitë ndaj palëve të treta", pika "III", të ndryshohet si vijon:

*“**III.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak, jo me vonë se data 17 Janar 2014.”*

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr. 301, Datë 06.12.2013

**Për
vlerësimin e ankesës së ndërmarrjes “GEN-I” në tregun e tregtimit me
shumicë të energjisë elektrike**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- | | | |
|-----------|-------------|------------|
| • Lindita | MILO (LATI) | Kryetar |
| • Rezana | KONOMI | Zv/Kryetar |
| • Servete | GRUDA | Anëtar |
| • Koço | BROKA | Anëtar |
| • Iva | ZAJMI | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 25.11.2013 trajtoi çështjen me:

Objekt: Vlerësimi i ankesës së ndërmarrjes “GEN-I Tirana” SHPK”

Baza ligjore: Neni 24, germa d, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, këtu dhe me poshtë Ligji

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të: Relacionit Sekretarit të Përgjithshëm dhe grupit të punës lidhur me ankesën e ndërmarrjes “GEN-I Tirana” SHPK , ankesat e shoqërisë “Gen-I” SHPK ndaj “Cez Shpërndarja” Sh.A; Pretendimet e ndërmarrjes “Cez Shpërndarje” SHA të paraqitura në seancën dëgjimore.

VËREN SE :

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës me datë 28.08.2013, është depozituar një ankesë nga shoqëria “Gen-I Tirana” sh.p.k. në lidhje me kërkesat teknike të Ftesës për Ofertë “Për blerjen e energjisë elektrike për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2014” të “Cez shpërndarje” Sh.A për mbulimin e humbjeve. Kjo ankesë është plotësuar nga pala ankimuese në datë 23.09.2013, datë 04.10.2013, e datë 13.11.2013. Gjithashtu pala ankuuese i është drejtuar Autoritetit të Konkurrencës edhe me dy kërkesa të tjera datë 17.10.2013 dhe 28.10.2013 në lidhje me abuzimin e pretenduar me pozitën dominuese të shoqërisë CEZ Shpërndarje SHA (në administrim të përkohshëm) në tregun e shpërndarjes së energjisë elektrike në Republikën e Shqipërisë në lidhje me procedurat e tenderimit për lëvrimin e energjisë elektrike. Ankimuesi pretendon se termat dhe kushtet financiare të ofruara nga “Cez Shpërndarje” çojnë në kufizimin e numrit të pjesëmarrësve dhe mungesë konkurrence, rrjedhimisht në çmime më të larta dhe jo konkurruese të energjisë me pasojë shtrembërimin e konkurrencës dhe dëmtimin e konsumatorëve të energjisë.
2. Pala ankimuese ka depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës informacione plotësuese mbi procedurat e tenderimit të kryera nga Cez shpërndarje sha përkatësisht për muajt gusht, shtator, tetor dhe nëntor 2013.
3. Shoqëria CEZ Shpërndarje sh.a, është një person juridik, që funksionon në formën juridike shoqëri aksionare. Me Vendimin Nr. 5, date 21.01.2013 “Mbi vendosjen në Administrim të Përkohshëm të Shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a”, ERE vendosi kalimin e CEZ Shpërndarje në Administrim të Përkohshëm. Administratori i përkohshëm ka si detyrë kryesore operimin dhe mirëmbajtjen e aseteve, të cilat janë në funksion të aktivitetit të shpërndarjes dhe furnizimit gjatë periudhës së administrimit të përkohshëm. Kompetencat e administratorit të përkohshëm dhe kufizimet e tyre, janë të përcaktuara në Rregulloren e miratuar me vendimin nr. 1, datë 10.01.2013 “Për miratimin e Rregullores “Mbi procedurat e emërimit të administratorit dhe kompetencat e tij”.
4. Tregu i energjisë elektrike është një treg i rregulluar me anë të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ka si qëllim sigurimin e kushteve për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve, sipas parametrave standarde, nëpërmjet funksionimit eficient të tregut të energjisë elektrike dhe zhvillimit të konkurrencës në këtë sektor, duke pasur parasysh mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, minimizimin e kostove të shërbimit të ofrimit të energjisë elektrike dhe përshtatshmërinë e tij me mjedisin.
5. Në bazë të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe vendimit nr. 338, datë 19/03/2008, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, i vetmi segment i tregut i parregulluar mbetet tregu i blerjes së energjisë për

mbulimin e humbjeve elektrike nga ana e “Cez Shpërndarje” SHA, e cila realizohet me çmimet e tregut.

6. Procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve nga “Cez Shpërndarje” SHA janë rregulluar sipas Vendimit nr. 42, datë 25.05.2009 të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), mbi “Rregullat dhe procedurat standarde të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH sh.a (Kompania)”. Kjo rregullore ka të bëjë me procedurat e shprehura në pikën 4.5 të Deklaratës Rregullatore të miratuar nga ERE me Vendimin nr. 12, datë 03.03.2009, të cilat do të jenë në fuqi deri më datë 31.12.2014.

7. Sipas “GEN-I Tiranë” sh.p.k termat dhe kushtet financiare të “Cez shpërndarje” sjellin kufizim të numrit të pjesëmarrësve në procedurat e prokurimit të energjisë elektrike duke ndryshuar termat e pagesës nga 20 ditë në 60 ditë pas fundit të çdo muaji përkatës të lëvrimit. Nga ana tjetër ndërmarrja “Cez shpërndarje” SHA kërkon garanci performance në shumën 10 % të vlerës së ofertës, ndërkohë vetë “CEZ shpërndarje” ShA nuk ofron asnjë lloj garancie për përmbushjen e detyrimeve të saj.

8. Ndërmarrja “Gen-I Tiranë” Sh.pk është ankuar për procedurat vjetore dhe mujore të blerjes së energjisë elektrike. Sipas tij për periudhën gusht, shtator, tetor dhe nëntor 2013, Cez Shpërndarje SHA ose ka patur një qasje përjashtuese ndaj shoqërisë GEN-I shpk.(duke mos e ftuar në tender) ose ka vazhduar të aplikojë të njëjtat kushte të padrejta tregtimi (pagesë e energjisë pas 90 ditëve nga lëvrimi, mungesë garancie bankare, trajtim i diferencuar i konkurrentëve duke i ofruar subjekteve të caktuara kushte të ndryshme nga ato të publikuara në tender dhe/ose me një “mundësi të fundit” për t’i përshtatur ofertat e tyre në raport me ofertat konkurruese të subjekteve të tjerë.

9. Ankimuesi pretendon se këto terma dhe procedura janë në kundërshtim flagrant me praktikën më të mira të industrisë dhe praktikën e mëparshme e të konsoliduar nga vetë kjo shoqëri. Për pasojë, sipas “GEN-I Tiranë” sh.p.k. kjo situatë do të sjellë kufizim të numrit të pjesëmarrësve mungesë të konkurrencës dhe sipas llogaritjeve të ankimuesit “kjo situatë do të çonte në rritje të kostove të përgjithshme të lëvrimit me bazë vjetore”. Ankimuesi pretendon se këto kosto mund të shmangen vetëm me zbatimin e termave standarde të pagesës, ose pagesë jo me vonë se 20 dite pas lëvrimit.

10. Ankimuesi pretendon se “Cez shpërndarje” SHA duke pasur pozicion monopol në ofrimin e një shërbimi publik, po përpiqet të përfitojë nga pozicioni dominues me anë të vendosjes së kushteve të padrejta të tregtimit me pasojë shtrembërimin e konkurrencës së lirë në tregun e energjisë elektrike dhe dëmtimin e konsumatorëve fundorë të cilët duhet paguajnë kosto më të larta të blerjes së energjisë elektrike.

11. Ndërmarrja “Cez shpërndarje”SHA gjatë seancës dëgjimore si dhe në pretendimet e saj shprehet se është në vështirësi financiare dhe për këtë arsye ka vendosur afatin maksimal të pagesës brenda 60 ditëve nga përfundimi i lëvrimit të energjisë. “Cez Shpërndarje”, sqaron se në ftesën për ofertë ka përcaktuar se nuk do të pranohet asnjë ofertë të cilat vendosin kushtet e paradhënies ose të lëshimit të garancive nga kompania

mëmë apo nga bankat. Këto kushte janë vendosur për të gjithë ofertuesit.

Gjithashtu afati maksimal i kryerjes së pagesës prej 60 ditësh është i lidhur me afatet e gjenerimit të të ardhurave nga CEZ shpërndarje SHA.

12. Ndërmarrja “CEZ shpërndarje” SHA ka provuar se pagesat e faturave të blerjes së energjisë elektrike, përgjithësisht, janë kryer brenda 30 ditëve, nga dita e fundit e lëvrimit të energjisë elektrike nga ofruesit.

13. Operatori CEZ Shpërndarje SHA në bazë të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike është i vetmi operator që ka të drejtën ekskluzive të shpërndarjes dhe furnzuesit publik me pakicë të energjisë elektrike dhe për pasojë ka pozicion dominues në tregun e shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike, sipas parashikimeve të nenit 8 të ligjit nr. 9121, datë 27.08.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar. Për të siguruar efencën dhe përfitimin e çmimeve sa më të lira të energjisë elektrike, lojtarët e tregut duhet të vendosen në pozita konkurruese bazuar mbi procedura transparente dhe jo diskriminuese në procedurat e tenderimit të energjisë elektrike.

14. Rregullatori ka autorizuar Cez Shpërndarje SHA që rregullat dhe procedurat për zhvillimin e tenderit vjetor të përdoren edhe për procedurat mujore, duke lënë një vakuum nënligjor, pra mungesën e një rregulloreje për zhvillimin e procedurave mujore të tenderimit dhe blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve.

15. Nga analiza e kuadrit ligjor dhe rregullator për funksionimin e tregut përkatës rezulton se rregullat dhe procedurat e parashikuara në rregulloren përkatëse për blerjen e energjisë elektrike nga ana e CEZ Shpërndarje SHA për mbulimin e humbjeve kanë krijuar kushte jo transparente (nuk publikohen, vetëm dërgohen me email). Kjo rregullore bie në kundërshtim me parimet bazë të Traktatit të Energjisë për një treg të hapur dhe transparent, dhe Deklaratën Rregullatore.

16. ERE, organi që monitoron zbatimin nga ana e “CEZ shpërndarje” SHA të rregullave për tregtimin e energjisë elektrike, ka deklaruar që kompania “Cez shpërndarje” ka zbatuar në mënyrë të drejtë rregulloren për kryerjen e prokurimit mujor dhe vjetor të energjisë.

17. Bazuar në problematikat e evidenruara gjatë shqyrtimit të kësaj ankese Autoriteti i Konkurrencës ka vendosur t’i rekomandojë Entit rregullator të Energjisë që të miratojë një rregullore të veçantë për procedurat mujore të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve mbështetur në:

- a- parimet e transparencës së procesit, mos-diskriminimit dhe trajtimit të barabartë të konkurrentëve;
- b- qartësimin e procedurës së negocimit midis Cez Shpërndarje SHA dhe ofertuesve, pas shpalljes së ofertave fillestare për blerjen e energjisë për mbulimin e humbjeve;

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Mbylljen e procedurës së vlerësimit të ankesës së ndërmarrjes “Gen-I Tirana” sh.p.k. në tregun e tregtimit me shumicë të energjisë elektrike.
- II.** “CEZ Shpërndarje SHA ka vepruar konform rregullores “Rregullat dhe procedurat standarde të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH” miratuar me vendim të ERE, nr. 42, datë 25.05.2009.
- III.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës për njoftimin e këtij vendimi GEN-I Shpk dhe CEZ Shpërndarje SHA
- IV.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS**Servete GRUDA****Koço BROKA****Iva ZAJMI****Rezana KONOMI**

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Zv. Kryetar**Lindita MILO (LATI)**

K R Y E T A R